

REFORMA E SISTEMIT PENSIONAL NË KOSOVË DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ

NEXHMEDIN SHAQIRI

Dorëzuar; 22/11/2018

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin Ekonomik,

Profili; Finance,

për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Hysen Muceku

Numri i fjalëve: 57,436

Tirane, Nentor 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj nën përgjegjësinë time, se ky punim është shkruar nga unë dhe se ky studim është punë e imja origjinale.

Gjatë punimit tim, deklaroj se nuk kam përdorur; ide, të dhëna ose formë tjetër të kopjimit pa shënuar njohjen dhe referencën specifike nga buron punimi dhe kush është autor i punimit të përdorur.

Gjithashtu deklaroj me përgjegjësi se ky punim do të prezantohet në formë elektronike, për t'u publikuar, apo vlerësuar para një audience të gjërë profesionale.

Ky punim nuk përmbanë asnjë lloj mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature.

Kjo deklaratë i prashtrohet Komisionit vlerësues të punimit.

Unë qëndroj pas kësaj deklarate, në rast se hetohet ndonjë pandershmëri akademike e cila përfshinë deklarime false, të dhëna të rreme, plagjiaturë (pos rasteve të mosrespektimit të rregullave të citimeve për shkak të pakujdesisë ose të mosdijes, të cilat dallohen nga ato ku pandershmëria është e qëllimshme, e dukshme dhe e qartë), do të mbaj përgjegjësinë dhe do të përgjigjem moralisht dhe sipas ligjeve në fuqi.

Më 26 Tetor 2018

ABSTRAKTI

Ky studim do të përqendrohet në reformën e sistemit ekonomik dhe social, me vështirësi të veçantë në Sistemin Pensional të Kosovës. Do të bëhet krahasimi në mes të ish sistemit pensional PAYGO (Pay-as-you-go) dhe të modelit të Sistemit të ri Pensional shumëshyrtor. Vëmendje e veçantë do t' i kushtohet studimeve të deritashme teorike mbi zhvillimin e sistemeve pensionale në Botë dhe të qëndrueshmërisë së tyre. Përmes këtij studimi synohet të arsyetohet nevoja për reformimin e Sistemit Pensional në Kosovë, duke vërtetuar aftësinë e tij për të përballuar kërkesat e pensionistëve (pensione të merituar) tash dhe në të ardhmen, përfshirja apo mbulueshmëria e personave të moshuar në sistemin e ri pensional dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut për pension. Do të studiohet modeli i sistemit pensional shumëshyrtor, i cili ishte përdorur në disa vende Evropiane dhe në vendet e Amerikës Latine, si model i vetëqëndrueshëm. Veçanërisht ky studim do të fokusohet në analizimin e faktorëve (makroekonomik dhe mikroekonomik) të cilët e kushtëzojnë qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional (GDP, popullsia, punësimi, pagat, kontributet, kontributorët, investimet, pensionet, etj.). Do të bëhet vlerësimi i efikasitetit dhe të efikasitetit të investimeve të aseteve pensionale, stabiliteti financiar, ndjeshmëria nga ndikimet e brendshme dhe të jashtme, menaxhimi i rreziqeve, mbikqyrja e sistemit pensional, etj. Qëllimi i studimit do të jetë vërtetimi i hipotezave të shtuara përmes metodës së analizës empirike, e cila do të përdoret për matjen e ndikimit të variablave të pavarura në variablën e varur, apo analizimi i shkaqeve të cilat e kushtëzojnë zhvillimin e procesit të sistemit pensional, si dhe qëndrueshmërinë e tij.

Fjalët kyçe: *Reformë, PYGO, shumëshyrtor, kontributet e definuara pensionale, stabiliteti financiar, vetëqëndrueshmëri, asete pensionale, investimet, kthimet nga investimet, tregu i kapitalit financiar, portfolio individuale, anuitete pensionale, pensione.*

ABSTRACT

This study will focus on the reform of the economic and social system, with a special view at the Kosovo Pension System. A comparison will be made between the former pay-as-you-go pension system and the multipillar pension system model. Particular attention will be paid to theoretical studies on the development of pension systems in the World and their sustainability. Through this study, the aim is to justify the needs for reforming the Kosovo Pension System, by verifying its ability to cope with pensioners' needs (merited pensions) now and in the future, including all of elderly persons in the new pension system and respect for fundamental human rights for retirement. The model of the multipillar pension system, which was used in several European countries and in Latin American countries, will be studied as a self-sustaining model. Specifically, this study will focus on analyzing the factors (macroeconomic and microeconomic) that conditions of the sustainability of the Pension System (GDP, population, employment, wages, contributions, contributors, investments, pensions, etc.). An assessment will be made of the efficacy and efficiency of pension assets investments, financial stability, sensitivity of internal and external influences, risk management, pension system oversight, and so on. The purpose of the study is to prove the respective hypothesis through the empirical analysis method, which will be used to measure the influence of independent variables in the dependent variables, or to analyze the causes that condition the development of the pension system process, as well as its sustainability.

Key words: Reform, PYGO, multipillar, defined contributions, contributors, financial stability, self-sustainability, pension assets, investments, return on investment, financial capital market, individual portfolio, pension annuities, pensions.

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet të gjithë akterëve që më mundësuan të formësohem si një ekonomist dhe një profesionist i profilit të financave, për të bërë këtë studim.

Në radhë të parë ky punim i dedikohet familjes sime të ngushtë, gruas sime Hanumshahes dhe fëmijëve të mi; Brikenës, Arbërit, Dardanës e Gencit, të cilët gjithnjë më kanë mbështetur dhe më kanë krijuar kushte të volitshme për punë studimore.

Për formësimin tim edukativ, do të veçoja prindërit e mi; Sadullah dhe Emine Shaqiri, të cilëve iu dedikoj këtë studim.

Për kontributin edukativ të cilin e kualituvuan në familje, do të veçoja gjyshërit e mi; Mulla Emin Shaqirin e Mulla Mustafë Nezirin, xhaxhallarët e mi; Mulla Shefqet Shaqirin dhe Mesuesin Reshat Shaqirin, si dhe hallat e mia; Bahrijen dhe Shefkijen.

Gjithashtu ky libër dedikohet edhe pjestarëve të tjerë të familjes sime, vëllezërve; Felahudinit e Jahjasë dhe motrës Arjetes, si dhe mbarë anëtarëve të tjerë të familjes së gjërë.

Ndërsa për formësimin tim si një ekonomist do të veçoja profesorët e mi; Prof. Dr. Hajrullah Goranin, Dr. Nexhmi Rexhën dhe Dr. Ali Jakupin, të cilëve iu jam mirënjohës.

Posaqerisht do t'i falenderohem kolegëve profesionist me të cilët kam punuar në Bordin Qeverisës të Fondit Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës; Neil McPherson, Harvey Kember, Estelle James, Steven Bates, Michael Ives, Basri Jupolli, Arieta Koshutova, Alexi Sluchynsky, John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin, Edgar Balbin.

FALËNDERIME

Falemnderoj posaqërisht Profesor Prof. Dr. Adrian Civicin për përkushtimin, durimin dhe këshillimet profesionale, të cilat m'i ka dhënë gjatë tërë procesit të studimeve të doktoraturës, e në veçanti si udhëheqës shkencor gjatë kryerjes së këtij studimi.

Veçanërisht falemnderoj profesorin Prof Dr. Myslym Osmanin i cili më ka dhënë ndihmë akademike në mënyrë të drejtëpërdrejtë, për të zhvilluar punët kërkimore, logjistike gjatë procesit të punimit të doktoraturës.

Për udhëheqjen profesionale gjatë përgatitjes së punimit final te doktoratures, falemnderoj udhëheqësin shkencor Prof. Asoc. Dr. Hysen Muceku.

PËRMBAJTJA

1. KAPITULLI I: HYRJE	15
1.1. Problematika e studimit.....	15
1.1.1. Arsyet e përzgjedhjes së temës	17
1.1.2. Konceptet kryesore të punimit.....	20
1.1.3. Objektivat e studimit	22
1.1.4. Qëllimi i studimit	23
1.1.5. Burimet e studimit	23
1.1.6. Teza e punimit	24
1.1.7. Kontributi i punimit	25
1.1.8. Pyetja kërkimore	25
1.1.9. Hipotezat	26
1.1.10. Debati aktual lidhur me tezen	27
1.1.11. Zgjidhjet e pritshme të studimit të problemit.....	29
2. KAPITULLI II: METODOLOGJIA	31
2.1. Baza metodologjike, qasjet, instrumentet dhe të dhënat parësore e dytësore	31
2.1.1. Qasjet metodologjike	32
2.1.1.1. Qasja metodologjike sasiore	32
2.1.1.2. Qasja metodologjike cilësore.....	35
2.3. Kufizimet e studimit të problematikës	37
2.4. Struktura e tezës së diplomës	38
3. KAPITULLI III: DISKUTIMI TEORIK	41
3.1. Teoritë bazë për studimin e punimit	41
3.2. Autorët bazë	42
3.3. Diskutimi kritik i shkollave dhe institucioneve të ndryshme teorike mbi sistemet pensionale	44
3.4. Analiza e thelluar teorike e punimit të tezës	45
3.4.1. Teoritë mbi ekonominë e tregut të lirë apo tregjet spontane	46
3.4.2. Teoritë mbi Reformën e Sistemit Pensional	47
3.4.3. Teoritë mbi qeverisjen.....	49
3.4.4. Teoritë mbi etikën dhe efikasitetin financiar	50
3.4.5. Teoritë mbi përgjegjësitë fiduciare në qeverisjen korporative	51

3.4.6. Teoritë mbi transparencën financiare.....	52
3.4.7. Teoritë mbi natyrën e planeve të kontributeve pensionale	53
3.4.8. Teoritë mbi punësimin	54
3.4.9. Teoritë mbi qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar	56
3.4.10. Teoritë mbi stabilitetin financiar	58
3.4.11. Teoritë mbi strategjitë e investimeve dhe të efikasitetit financiar	59
3.4.12. Teoritë mbi menaxhimin e rrezikut.....	60
3.5. Përmbledhja teorike për të argumentuar tezën	60
4. KAPITULLI IV: KONTEKSTI HISTORIK.....	62
4.1. Procesi i tranzicionit ekonomik në Kosovë	62
4.1.1. Sistemi i ri ekonomik	63
4.1.2. Rimëkëmbja ekonomike apo rregullimi makro- ekonomik.....	65
4.1.2.1. Politika e liberalizimit të tregut	66
4.1.2.2. Politikat monetare dhe kreditore.....	66
4.1.2.3. Politikat buxhetore dhe fiskale	67
4.1.2.4. Politika e konkurrencës dhe ambientit të ri ekonomik	67
4.1.2.5. Politikat mbi privatizimin dhe transformimin e pronës.....	68
4.1.2.6. Politikat sociale.....	68
4.2. Historiku i zhvillimit të Sistemit Pensional në Kosovë.....	68
4.3. Sistemi i ri Pensional në Kosovë	72
4.3.1. Shkaqet e reformës së Sistemit Pensional	73
4.3.2. Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë.....	74
4.3.3. Qëllimet themelore të reformës së Sistemit Pensional në Kosovë.....	76
4.3.4. Baza konceptuale e ndërtimit të Sistemit Pensional në Kosovë	77
4.4. Skemat pensionale në Kosovë	80
4.4.1. Shtylla e parë e Skemës së Pensioneve Bazë.....	81
4.4.1.1. Skemat e Pensioneve Bazë të moshës	83
4.4.1.2. Skema e pensioneve Bazë kontributive	84
4.4.1.3. Skema Pensionale Invalidore dhe skemat tjera pensionale të Shtyllës së Parë të Pensioneve	84
4.4.2. Shtylla e dytë e Sistemit Pensional- Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	85

4.4.3. Shtylla e tretë e Skemës së Fondeve Pensionale Suplementare.....	89
5. KAPITULI V: NDIKIMI I FAKTORËVE MAKROEKONOMIK DHE MIKROEKONOMIK NË QËNDRUESHMËRINË E SISTEMIT PENSIONAL	93
5.1. Liria ekonomike si faktor i qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë.....	93
5.2. Faktorët mikroekonomik dhe makroekonomik	95
5.2.1. Faktorët e pamatshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.....	96
5.2.1.1. Korniza ligjore.....	96
5.2.1.2. Politikat ekonomike dhe sociale	97
5.2.1.3. Mbikqyrja e Sistemit Pensional	97
5.2.1.4. Ndikimet e jashtme globale në Sistemit Pensional të Kosovës	99
5.2.2. Faktorët e pamatshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.....	100
5.2.2.1. Qeverisja dhe menaxhimi i Sistemit Pensional.....	100
5.2.2.2. Informacioni dhe transparenca.....	103
5.2.2.3. Ndikimi i teknologjisë informative në Sistemin Pensional	107
5.2.2.4. Marketingu	108
5.2.3. Faktorët e matshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional	109
5.2.3.1. Potenciali human.....	109
5.2.3.1.1. Punësimi	112
5.2.3.2. Bruto Produkti Vendor	116
5.2.3.3. Konsumi	118
5.2.3.4. Inflacioni	118
5.2.4. Faktorët e matshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional	119
5.2.4.1. Kontigjenti i kontributorëve	119
5.2.4.2. Lartësia e kontributeve	121
5.2.4.3. Kontribuimi i rregullt	122
5.2.4.4. Të hyrat nga kontributet vullnetare dhe të hyrat tjera	124
5.2.4.5. Barazimi i kontributeve	124
5.2.4.6. Krahasimi i Sistemit të ri Pensional në Kosovë me sistemet pensionale të vendeve në region	125

5.2.4.7. Shpërndarja e kontributit të punonjësve në regjion.....	127
5.2.4.8. Rrogat.....	127
5.2.4.9. Investimet e pasurive të Fondeve Pensionale	128
5.2.4.9.1. Principet e investimeve.....	130
5.2.4.9.2. Orientimi i investimeve në Tregun e Kapitalit Financiar	133
5.2.4.9.3. Shpërndarja e investimeve në Tregun e Kapitalit Financiar	134
5.2.4.9.4. Instrumentet për investime të hapura	136
5.2.4.9.5. Kriteret e investimeve	137
5.2.4.9.6. Rreziku i investimeve	138
5.2.4.9.7. Ekspozimi ndaj rrezikut përmes investimeve direkte dhe indirekte.....	139
5.2.4.9.8. Vlerësimi i funksionit të rrezikut	140
5.2.4.9.9. Menaxhimi i rreziqeve.....	141
5.2.4.9.10. Faktorët e rrezikut	143
5.2.4.9.11. Matja e performances së Fondeve Investuese	150
5.2.4.9.12. Performanca investuese e Fondeve Pensionale në regjion	152
5.3. Faktorët e stabilitetit financiar	154
5.3.1. Mjaftueshmëria financiare e Fondeve Pensionale	155
5.3.1.1. Mjetet financiare nën menaxhim	156
5.3.1.2. Profitabiliteti i fondeve pensionale	157
5.3.1.3. Rrjedha e parasë (Cash flow).....	159
5.3.1.4. Të hyrat e FP të TKPK.....	161
5.3.1.5. Shpenzimet investuese të FP të TKPK.....	161
5.3.1.6. Shpenzimet e menaxhimit të FP të TKPK.....	162
5.3.1.7. Shpenzimet operacionale të FP të TKPK	162
5.3.1.8. Tarifat menaxhuese në regjion.....	163
5.3.1.9. Likuiditeti i Fondeve Pensionale në Kosovë	163
5.3.1.10. Efektiviteti i Sistemit Pensional në Kosovë.....	166
5.3.1.11. Efikasiteti i operimeve financiare të Sistemit Pensional	167
5.4. Ekuilibrat e modelit të Sistemit pensional në Kosovë	171
5.5. Planet pensionale	173
5.5.1. Planet pensionale me përfitime të definuara.....	174

5.5.2. Llojet e pensioneve në Kosovë	176
5.5.2.1. Pensionet e Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti	177
5.5.2.2. Pensionet e Shtyllës së II-të të financuara nga Kontributet Pensionale Individuale	182
5.5.2.2.1. Mënyrat e tërheqjes së pensioneve nga kontributet e kursyera pensionale.....	183
5.5.2.2.2. Pensionet dhe pagesat e benefiteve të FP të TKPK në formë anuitetesh	183
5.5.2.2.3. Transferimi i Fondeve Pensionale në Programin e Tërheqjes me Faza.....	187
5.5.2.2.4. Tërheqja e kontributeve pensionale me një pagesë të vetme	188
5.5.2.3. Pensionet e shtyllës së III apo sigurimi pensional suplementar	189
5.5.2.3.1. Pensionet plotësuese individuale.....	189
5.5.2.3.2. Pensionet Plotësuese të Punëdhënësit	190
6. KAPITULLI I VI: ANALIZA EMPIRIKE.....	191
6.1. Analizat statistikore	191
6.2. Përshkrimi i të dhënave.....	191
6.3. Paraqitja grafike e trendit të variablave	194
6.4. Testi stacionaritetit të variablave (Unit Root Test).....	195
6.4.1. Testi stacionaritetit të variablave përmes testit të ADF (Augmented Dickey–Fuller)	197
6.4.2. Testi i stacionaritetit përmes Testi Augmented Dickey-Fuller (ADF test).....	198
6.5. Përfundimet mbi vërtetimin e hipotezave të punimit.....	200
7. KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	205
7.1. Konkluzione	205
7.2. Rekomandimet.....	210
8. LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA	211
8.1. Burime Parësore	211
8.2. Burime Dytësore.....	216
8.3. Burimet nga interneti	217
9. SHTOJCAT.....	218
9.1. Tabelat	218
9.2. Modeli ekonometrik.....	210

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ASK- Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASK- Agjencioni i statistikave të Kosovës
ATK- Administrata Tatimore e Kosovës
ATK- Administrata Tatimore e Kosovës,
BK- Bankat komerciale,
BKT- Banka Kombëtare Tregtare,
BPB- Banka Private e Biznesit
BQK- Banka Qendrore e Kosovës,
BVI-SHMSSP- Bashkësisa Veteqeverisëse e Interesit për Shëndetësi, Mbrojtje Sociale dhe Sigurim Social
DM- Departamenti i Makroanalizave
EPK- Enti Pensional i Kosovës
ETL- Ekonomia e Tregut të Lirë
FP i TKPK- Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës
FPP- Fondi i Përbashket Pensional
FPS- Fondeve Pensionale Suplementare
FPSK- Fondi Pensional Slloveno- Kosovar
IPVQK- Institucionet e Përkoheshme Vetë Qeverisëse të Kosovës
KSh- Kompensimi i Shtyrë
KShKI- Kosto e Shportës së Konsumit Individual
LDB- Lufta e Dytë Botërore
MPMS- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NLB- Nova Lublanska Banka
OECD- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PAYGO- (Pay-as-you-go)
PCB-Pro Credit Bank,
PLANÇ- Pensionet e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare
PLIIKP- Portfolio e Llogarise Individuale të Kursimeve Pensionale
PP- Planet Pensionale
PP- Plani Pensional
PPPD- Plani Pensional i Përfitimeve të Definuar
RB-Raiffaisen Bank,
RSESK- Reforma e Sistemit Ekonomik e Social në Kosovë.
RSFJ- Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
RSP- Reforma e Sistemit Pensional
RSS- Republika Socialiste e Serbisë
SE- Sistemet Ekonomike
SHDSP FP TKPK- Shtylla e dytë e Sistemit Pensional FP i TKPK
SHPS DP- Shtylla e parë e Sistemit Pensional- Departamenti i pensioneve bazë
SHTSP- Shtylla e tretë e Sistemit Pensional
SKI- Sistemit të Kontributeve të Investuara

SP i KSAK- Sistemi Pensional i Krahines Socialiste Autonome të Kosovës
SP i RSFJ-Sistemi Pensional në ish Republiken Socialiste Federative të Jugosllavisë
SPI-Sigurim Pensional dhe Invalidor
SPK- Sistemi Pensional i Kosovës
SPSBSPK- Skemen Plotesuese- të Skemës Bazë te Sistemit Pensional te Kosovës
SPSH- Sistemi Pensional Shumeshtyllor
SPSHSH- Sistemi Pensional Shumë Shtyllor
SPVL UÇK - Skema e Pensionistëve të Veteranëve të luftës së UÇK
SS- Skemat Sociale
SSP- Sigurimin Suplementar të Pensioneve
STI- Sistemi i Teknologjise Informative
STP- Sistemi i Transfereve Pensionale
TAI- Të Ardhurat të Individëve
TAP- Të Ardhurat Personale
TAP- Të ardhurat Personale
TEB- BNP PARIBAS Joint Venture
TKFG- Tregjet e Kapitalit Financiar Global
TMS- Teorite lidhur me Modeli i Sistemit
VBP- Vijë Buxhetore Pensionale

LISTA E TABELAVE, DIAGRAMEVE DHE FIGURAVE

Tabelat

- Tabela Nr. 1. Hulumtimi teorik qasjet për qëndrueshmërinë sociale
Tabela Nr.2. Lëvizjet natyrore të popullsisë në Kosovë (2003- 2017)
Tabela Nr.3. Shpërndarja sipas moshës
Tabela Nr.4. Jetëgjatësia mesatare në Kosovë
Tabela Nr. 5. Numri i fëmijëve, nxënësve dhe i studentëve
Tabela Nr. 6. Numri i të punësuarëve në Kosovë (2010-2017)
Tabela Nr. 7. Shkalla e punësimit nga viti 2000 deri 2009 ne shtetet e Eu dhe të disa vendeve të Europes
Tabela Nr.8. Popullsia sipas moshës
Tabela. Nr.9. Mjetet nën menaxhim të FP të KPK kundrejt BPV vjetor të Kosovës (2010-2017)
Tabela Nr. 10. Konsumi i përgjithshëm (2010- 2017)
Tabela Nr. 11. Shkalla e inflacionit në Kosovë (2010-2017)
Tabela Nr.12. Numri i llogarimbajtësve që nga themelimi i TKPK
Tabela Nr.13. Numri i llogarive të reja të hapura në TKPK (2010-2017)
Tabela Nr.14. Numri i kontributorëve në TKPK (2010-2017)
Tabela Nr.15. Kontributet e arkëtuara, të shpaguara dhe nën menaxhim në FP të TKPK (2002-2017)
Tabela Nr.16. Normat e kontributeve te punonjesve ne regjion qe i ngarkohen pages bruto
Tabela. Nr.17. Të dhënat kryesore për fondet e definuara dhe të obligueshme në regjion (2002-2007)
Tabela Nr.19. Rrogat neto mesatare në Kosovë gjatë periudhës 2010-2017
Tabela Nr.20. Mjetet nën menaxhim të Shtyllës së I-Pensionet e skemes bazë
Tabela Nr.21. Mjetet nën menaxhim te F P Trusti i Kursimeve Pensionale te Kosoves (2002-2017)
Tabela Nr.22. Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese ne FP te TKPK gjate vitit 2017
Tabela Nr.23. Fitimet e mbajtura të FP të TKPK (2017)
Tabela Nr.24. Normat e taksave të ngarkuara në Kosovë dhe rajon
Tabela Nr.25. Maturimet kontraktuale të mbetura të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FP te TKPK
Tabela Nr.26. Numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve Bazë të moshës gjatë periudhës 2002-2017
Tabela Nr.27. Numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve Bazë kontributive gjatë viteve 2008- 2017
Tabela Nr.28. Totali i mjeteve të paguara për pensione nga Skema e Pensioneve Bazë
Tabela Nr.29. Përfituesit e Pensionit për personat me aftësi të kufizuar gjatë viteve 2014-2017
Tabela Nr.30. Numri i tërësishem i përfituesve të skemave pensionale; Shtylla e I- Pensionet baze
Tabela Nr.31. Numri kontributoreve të cilët e bëjnë tërheqjen në faza
Tabela Nr.32. Vlera e mjeteve të tërhequra gjatë periudhës 2004 deri 2017
Tabela Nr.33. Numri dhe vlera e të pensionuareve në programin e Tërheqjes me faza
Tabela Nr.34. Testi stacionaritetit të variablave përmes testit të ADF
Tabela Nr.35. Të dhënat e përdorura.
Tabela Nr.36. Të dhënat e përdorura
Tabela Nr.37. Tabela (1-8) e përmbledhjet rezultateve të testit të kointegrimit

Grafiket

- Grafiku. Nr.1. Grafiku i paraqitjes së popullsisë (0-14, 15-64 dhe 65+vite) për periudhën 2011-2061
Grafiku. Nr.2. Grafikoni i kontributeve të shtyllës së parë dhe të dytë të vendeve të regjionit.
Grafiku Nr.3. Çmimi i akcionit të mjeteve të investuara të TKPK gjatë periudhës 2002-2017
Grafiku Nr.4. Kthimet nga investimet sipas Raportit vjetor të vitit 2017 të TKPK
Grafiku Nr.5. Performanca investuese e FKPK-së dhe fondeve pensionale në regjion.
Grafiku Nr.6. Rritja vjetore e çmimit të akcionit dhe kthimi bruto nga investimet e FP te TKPK 2011- 2015
Grafiku. Nr.7. Vlerat e mjeteve të tërhequra kundrejt kontributeve të tërhequra (në milion Euro)
Grafiku. Nr. 8. Paraqitja grafike e trendit te variablave

Figurat

- Fig. Nr.1. Skema e funksionimit te Fondit Pensional te TKPK
Fig. Nr.2. Perdorimet dhe burimet financiare

1. KAPITULLI I: HYRJE

1.1.Problematika e studimit

Teza e disertacionit tim është *“Reforma e Sistemit pensional në Kosovë dhe qëndrueshmëria e tij”*. Në këtë temë do të trajtohet arsyeshmëria e reformimit nga Holzmann (1997)¹ të sistemit pensional në Kosovë, braktisja e sistemit të vjetër pensional (PYGO), përzgjedhja e modelit të ri të sistemit pensional, mënyra e funksionimit dhe qëndrueshmëria e tij.

Përmes këtij studimi do të bëhet krahasimi i përparësive dhe i dobësive në mes të Sistemit të vjetër pensional (ishte zhvilluar nën kushtet e sistemit shoqëroro-ekonomik të socializmit vetëqeverisës të RSFJ dhe bazohej në parimin e solidaritetit, apo në parimin PAYGO- Pay-as-you-go²) dhe të modelit të Sistemit të ri pensional (sistemi shumë shtyllor i pensioneve), të bazuar në parimet e vetëqëndrueshmërisë (të studiuar nga Davis (1998)³ ekonomike, gjegjësisht të respektimit të drejtave themelore të njeriut.

Prandaj, qëndrueshmëria e modelit të vjetër të Sistemit pensional në Kosovë ishte e brishtë, sepse ai sistem ishte i qëndrueshëm deri sa shuma e të hyrave nga kontributet e pa identifikuara pensionale, ishte më e madhe se sa shpagimi i shumës së shpërndarë të dalurave nga fondet pensionale (shpagimi i pensioneve). Skema e vjetër pensionale nuk ishte e pa ndikueshme nga faktorët të cilët e kushtëzojnë qëndrueshmërinë e saj, sepse lartësia e shumës së mjeteve financiare të derdhura në fondet pensionale, ishte më e vogël se sa shuma e nevojshme për shpagimin e pensioneve (shpërndarje të mjeteve financiare nga fondet pensionale), kështu që këto fonde ishin përballur me deficit të lartë (gjendje financiare të pa mbuluar).

¹ Spjegimi mbi ndikimin e reformës së sistemit pensional në rritjen ekonomike kiliane, si dhe ndikimi i saj në tregjet financiare, si dhe marrëdhënia në mes të reformës së pensioneve dhe zhvillimit ekonomik.

² Skema pensionale e modelit PAYGO (Pay-as-you-go), bazohej në parimin; gjenerata paguan për gjeneratën, që në thelb ishte një mekanizëm për rishpërndarjen e të ardhurave kombëtare dhe për rregullimin e mbrojtjes sociale.

³ Në përgjithësi reformat e sistemeve pensionale e kanë futur elementin e vetefinancimit i cili mund të ketë ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e sistemeve pensionale dhe kanë ndikim në zhvillimin e tregut financiar. Zhvillimet e reformave pensionale kanë ndikuar nëpërmirësimin dhe funksionimin e tregjeve financiare.

Njëkohësisht modeli i Sistemit të ri pensional shumëshytlor, i cili ishte zbatuar në disa vende evropiane dhe në disa vende të Amerikës Latine, kishte dhënë prova se ishte më i qëndrueshëm. Ky model i Sistemit pensional përbëhet nga disa skema pensionale (i përbërë nga shumë fonde pensionale), të cilat mirreshin me administrimin e kursimeve të kontributeve të identifikuarra pensionale dhe shpërndanin pensione të merituarra. Te këto sistemet pensionale shumëshytllore, lartësia e shumës së të hyrave të fondeve pensionale varet nga; *niveli i lartësisë së kursimeve pensionale të kontributorëve, performanca e investimeve të mjeteve financiare të fondeve pensionale, nga kostot operacionale dhe kostot e menaxhimit, si dhe periudha e kontribuimit.*

Gjithashtu në këtë studim do t'i kushtohet rëndësi ndërlidhjes së komponenteve të Sistemit pensional shumëshytlor në Kosovë, i cili përbëhet prej një Skeme bazë të pensioneve dhe të dy Skemave të fondeve pensionale (Fondi i kursimeve të kontributeve pensionale të detyrueshme dhe Fondi i kursimeve të kontributeve pensionale vullnetare).

Gjatë shtjellimit të kësaj teme do të konsultohet literatura e cila trajton teoritë mbi; *zhvillimin e sistemeve pensionale në Botë, zhvillimin e planeve pensionale, qëndrueshmërinë e sistemeve pensionale, ekuilibrin dhe stabilitetin e sistemeve pensionale, etj.*

Një pjesë e veçantë në studim do t'i kushtohet; *ndikimit të reformës së Sistemit pensional në zhvillimin makroekonomik si dhe ndikimit të fondeve pensionale në zhvillimin e tregjeve financiare te studiuar nga Davis (1995, 2000), Walker dhe Lefort (2002)⁴, apo në fuqizimin e sistemit financiar.*

Veçanërisht ky studim do të fokusohet në; *funksionimin e modelit të sistemit pensional shumëshytlor, mënyrën e qeverisjes korporative të sistemeve pensionale, menaxhimin e fondeve pensionale, administrimin e kursimeve të kontributeve pensionale (sipas Disney (2001)⁵, investimet e mjeteve financiare të fondeve pensionale, kontrollin e riskut të fondeve*

⁴ Ndikimi i reformës së pensioneve në zhvillimin e tregjeve financiare e paraqet ndikimin e rritjes së fondeve pensionale në tregjet e kapitalit financiar evropian. Gjithashtu është studiuar ndikimi i reformes se sistemeve pensionale ne në tregjet e kapitalit financiar në zhvillim.

⁵ Ndikimi i reformes se sistemit pensional në normën e kursimit.

pensionale, rritjen e shkallës së vazhdueshme të sigurisë së fondeve pensionale, mbikqyrjen e fondeve pensionale, forcimin e besimit të kontributorëve ndaj operimeve të fondeve pensionale, shpërndarjen e portofoliove individuale, zhvillimin e pensioneve të merituar, etj.

Një pjesë e studimit do t'i kushtohet ndikimit të krizës ekonomike financiare globale⁶ gjatë viteve 2008-2009, e cila kishte rezultuar me zhvlerësimin e mjeteve financiare të fondeve pensionale të Kosovës. Pra, kjo krizë e kishte prekur edhe sistemin pensional të Kosovës, kështu që kjo përvojë shpjegon se sa të ndieshme janë skemat pensionale, të cilat i investojnë mjetet e tyre financiare në zonat e ndryshme të tregjeve Botërore të kapitalit financiar.

Duke i përdorur metodat empirike do të analizohen ndikimet e zhvillimeve (ekonomike dhe shoqërore) të brendshme dhe të jashtme në sistemin pensional të Kosovës dhe do të analizohet qëndrueshmëria e tij.

Kështu që studimi i përvojave të fondeve pensionale në Botë do të na mundëson, të bëjmë krahasime në mes të modeleve të sistemeve pensionale; *struktura e modeleve të sistemeve pensionale, obligimet e kontributdhënësve, kostot e sistemeve pensionale, përballueshmëria e rreziqeve të mundëshme, mënyra e qeverisjes dhe e menaxhimit, përfitimet pensionale, etj.*

Si përfundim, ky studim do t'i përkushtohet vërtetimit të hipotezës së parashtruar, e cila vë në dilemë qëndrueshmërinë e sistemit pensional, si model i vetëqëndrueshëm i cili operon në kushtet e tregut të lirë. Vërtetimi i hipotezës do të pasqyroj ndikimin e Sistemit pensional në stabilitetin e sistemit makroekonomik, zhvillimin e tregjeve financiare, punësim të qëndrueshëm dhe pensione të merituar.

1.1.1. Arsyet e përzgjedhjes së temës

Këtë temë e kam përzgjedhur, për disa arsye:

⁶ Bazuar në të dhënat e OECD-së, rezulton se fondet private të pensioneve në vendet e OECD-së kanë patur zhvlerësime të aseteve të tyre gjatë krizës së vitit 2008 mesatarisht 23 % të vlerës së aseteve të tyre

Së pari, për shkak se kam patur fatin të jam përfitues në edukim mbi procesin e zhvillimit të “Reformës së dytë pensionale në Evropë”, të organizuar në vitin 2002 nga Instituti i Bankes Botërore dhe OECD, gjë që më ka mundësuar kompletimin e njohurive teorike dhe praktike për të kontribuar në zhvillimin e Reformës së Sistemit pensional në Kosovë. Gjithashtu jam inkurajuar që të trajtoj këtë temë, sepse kam patur fatin të jam anëtar i Bordit Qeverisës të Fondit Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FP i TKPK) në mandatin e parë 4 vjeçar 2002- 2006, që nga dita e parë e themelimit të këtij fondi⁷.

Së dyti, kam punuar me ekspertë të shquar Botëror, të cilët kanë dhënë kontribut në implementimin e modeleve të sistemeve pensionale (shumështyllore) në Amerikën Latine (Çile) dhe në institucionet e ndryshme financiare globale, të cilët kanë dhënë kontribut të çmueshem në reformimin e Sistemit pensional në Kosovë.

Së treti, rëndësia e kësaj teme qëndron në faktin se, aktualisht lartësia e shumës së aseteve të Sistemit pensional në Kosovë, është përafërsisht sa lartësia e shumës së Buxhetit të Kosovës, ndërsa trendi i zhvillimit dhe i rritjes së shumës së aseteve të Sistemit Pensional janë duke u rritur me shkallë më të madhe (mesatarisht 8% në vit), se sa shkalla e rritjes së buxhetit të Kosovës (rreth 3%).

Së katërti, deri më tani janë bërë studime të pamjaftueshme të reformës së Sistemit Pensional në Kosovë dhe të matjes së efekteve të tij. Përmes këtij studimi synohet të pasqyrohet plotësimi i nevojave të kategorive të ndryshme të personave të moshuar (të cilat i ka plotësuar deri më tani Sistemi i vjetër Pensional dhe cilat i plotëson Sistemi i ri Pensional) dhe nevojat të kategorive të ndryshme të popullsisë që kanë mbetur pa u plotësuar. Kështu që deri më tash janë bërë “Studime të rastit” lidhur me reformën e Sistemit Pensional në Kosovë, por nuk janë bërë studime të thella të cilat e vlerësojnë

⁷ Në periudhën 2002-2006, isha anëtar i Bordit Qeverisës të TKPK, në këtë periudhë kishte ndodhur “Reformimi i dytë i sistemit pensional në Evropën Qendrore dhe Lindore”, të zhvilluar nga Banka Botërore dhe OECD, gjatë kësaj periudhe kam përfituar në ngritjen e kapaciteteve të mia profesionale përmes pjesëmarrjes në shumë seminare, konferenca dhe forume tjera të edukimit.

arsyeshmërinë e reformës së Sistemit Pensional në Kosovë, si dhe nuk janë bërë matje të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë. Kështu që mund të konstatojmë se aktualisht mungon një studim i tillë.

Së pesti, një studim i tillë, do të plotësoj njohuritë e të gjithë atyre, të cilët kanë nevojë të mësojnë, gjegjësisht të përfitojnë njohuri shtesë mbi; Sistemin Pensional të Kosovës para periudhës së tranzicionit, arsyen e shmangies përfundimtare të Sistemit Pensional PYGO, reformimin e Sistemit Pensional, modelimin e Sistemit të ri Pensional, respektimin e të drejtave themelore universale të njeriut, respektimin e të drejtës së pensionistëve për të trajtuar portfolion pensionale si pronë personale, sendërtimin e Sistemit të ri Pensional nën parimet e vetqëndrueshmërisë, rëndësinë e fondeve pensionale si institucione financiare, fuqinë financiare të fondeve pensionale në kuader të ekonomisë së Kosovës, rolin e Fondeve Pensionale në mirëqenien sociale dhe në stabilitetin makroekonomik, rolin e sistemit pensional në zhvillimin ekonomik dhe në zhvillimin e tregjeve të kapitalit financiar, etj.

Së gjashti, studimi i performancës së vazhdueshme të Sistemit pensional në Kosovë dhe përmirësimet e vazhdueshme, pasqyrojnë përshtatshmërinë dhe kualitetin e Sistemit të vjetër Pensional, krahasuar me Sistemin e ri Pensional, nga do të nxirren rekomandimet (në bazë të gjetjeve), për të cilat do të japim shpjegime se si i ka plotësuar Sistemi i ri pensional nevojat e kategorive të merituar të popullsisë së moshuar, të cilët përfitojnë pensione të merituar.

Së shtati, studimi i fenomenit të Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë dhe qëndrueshmërisë së tij, do të ndërlidhet me;

sfidat apo barrierat dhe zgjidhjet që janë krijuar në fushën e Sistemit Pensional të Kosovës, ambientin ekonomik,

rrugën nëpër të cilën duhet të shkohet me tutje (udhëkryqin në të cilin duhet të ndalemi dhe të hulumtojmë orientimin se kah duhet të shkohet më tutje; të ndalojmë në këtë gjendje, të kthehemi mbrapa, apo të kërkojmë një orientim tjetër alternativ).

Së teti, ky studim, do të jetë një material i cili do të mund të përdoret si ‘material kritik’ nga ana e: institucioneve respektive të cilat mirren me problematikën e pensioneve, institucioneve shkencore, shoqërisë civile e cila e ka këtë fushë interesimi apo veprimi, duke nxitur debat për të përkrahur apo kundërshtuar, gjë që do të nxitë hulumtimet apo kërkimet e vazhdueshme për të bërë zgjidhje sa më adekuate apo më cilësore, për përmirësimin e Sistemit Pensional në Kosovë.

Së nënti, përmes këtij studimi pretendohet të analizohen mënyrat e shfrytëzimit të mjeteve financiare të fondeve pensionale dhe të jepen alternativa inventive lidhur me te.

Pra, ky studim do të mund të përdoret si literaturë e nevojshme e studiuesve, të cilët në mënyrë të konkretizuar do të përfitojnë njohuri edukative mbi financat në fushën e pensioneve, gjë që me këtë studim pritet që të pasurohet cilësia e literaturës në kontekst të edukimit pensional në Kosovë.

Andaj, ky studim i cili do t’i ofrohet studiuesve të sistemit pensional (autoriteteve të cilat punojnë në sistemin pensional, autoriteteve të sistemit fiskal dhe financiar), të plotësoj njohuritë e tyre në formë të integruar mbi çështjet kyçe të Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë dhe të qëndrueshmërisë së saj, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë.

1.1.2. Konceptet kryesore të punimit

Problematika e punimit do të përqëndrohet në këto çështje, si vijon;

- Procesi i tranzicionit ekonomik në Kosovë- trajton; ndërtimin e sistemit të ri ekonomik, rimëkëmbjen ekonomike apo rregullimin makro-ekonomik, privatizimin dhe transformimin e pronës, politikat e liberalizimit tregtar, politikat monetare dhe kreditore, politikat buxhetore dhe fiskale, politikat e konkurrencës, politikat sociale si dhe reformimin e sistemit pensional në Kosovë.

- Reforma e sistemit pensional në Kosovë- përfshinë; bazën konceptuale të ndërtimit të sistemit të ri pensional në Kosovë, llojet e sistemeve pensionale në Botë, parimet e reformës së sistemit pensional në Kosovë, kornizën rregullative të sistemit pensional të Kosovës,

përparësitë dhe sfidat e funksionimit të modelit shumëshyrtor të sistemit pensional, trendi i zhvillimit të sistemit pensional, perspektiva e reformës së sistemit pensional⁸, etj.

- Qëndrueshmëria e sistemit pensional- Një ndër konceptet më të rëndësishme të studimit është; matja e qëndrueshmërisë së sistemit pensional në Kosovë dhe faktorët të cilët e kushtëzojnë atë, stabilitetin socio-ekonomik, zhvillimin makroekonomik (zbutjen e varfërisë), zhvillimin e tregjeve të kapitalit financiar, etj.

Ky studim njëherit do të *fokusohet në invencionin i cili përqëndrohet në; mënyrën e matjes së qëndrueshmërisë së sistemit pensional dhe në rekomandimet të cilat do të jepen për të bërë ndryshimet e nevojshme në sistemin pensional, në mënyrë që ai të bëhet sa; më kualitativ, më funksional, më i meritueshëm, më i drejtë dhe më gjithëpërfshirës.*

Rëndësia e studimit qëndron në; kontributin shkencor, rezultatet apo gjetjet (konkluzat) dhe në rekomandimet që do të nxirren nga teoritë dhe analizat, të cilat do të përshkruhen në këtë studim, në formë të përmbledhur.

Përfundimet që do të nxirren apo gjetjet, mund të shërbejnë për të nxitur debat të gjërë ekonomiko-shoqëror, lidhur me përparësitë dhe dobësitë e reformës së sistemit pensional, si një fushë e rëndësishme e ekonomisë. Nga përfundimet, do të përshkruhen nevojat për ndryshimin e mundshëm të; politikave të zhvillimit ekonomik, të procesit të reformës së Sistemit Pensional

(strukturës së skemave të Sistemit Pensional), kornizës rregullative, influencimit të faktorëve makroekonomik dhe social, të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe në standardin e mirëqenies sociale (përmes një “dialogu social cilësor”).

⁸ *Modeli i sistemit pensional në Kosovë* përbëhet prej tri shtyllave të sistemit pensional dhe të skemave pensionale si elemente të shtyllave pensionale; *Shtylla e parë* përbëhet nga *Komponenta e parë e Skemës së Pensioneve Bazë*, a) *Skema e pensioneve bazë të moshës*, b) *Skema e pensioneve Bazë kontributive* dhe c) *Skema Pensionale Invalidore*. *Shtylla e dytë* përbëhet nga *Komponenta e dytë e Fondit Pensional të Kursimeve të kontributeve pensionale të detyrueshme Individuale*. *Shtylla e tretë* përbëhet nga *Komponenta e tretë e Skemës së Fondeve Pensionale vullnetare*.

Implementimi i rezultateve të studimit, premtojnë përmirësim dhe orientim të drejtë për gjetjen e pikave të ekuilibrit afatgjatë të Sistemit pensional në Kosovë, të bazuar në faktorët ekonomik dhe social të përshtatur me nevojat sociale dhe kushtet e ekonomisë së tregut të lirë.

Përdorimi i citimeve në tekst, referencat, shtojcat, do të jenë pjesë plotësuese e studimit, të cilat do të shërbejnë për të bazuar çasjen shkencore të shtjellimit të problemit të studiuar.

1.1.3. Objektivat e studimit

Objektivat e studimit do të mundësojnë definimin e strukturës së faktorëve shkakorë dhe pasues, të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional në Kosovë. Për arritjen e këtij qëllimi është e nevojshme të përcaktohen objektivat në vijim;

- 1) shpjegimi i procesit të tranzicionit ekonomik në ndërlidhmëri me procesin e reformës së Sistemit pensional të Kosovës,
- 2) studimi i teorive, të cilat ndërlidhen me vetëqëndrueshmërinë e modelve të Sistemit Pensional,
- 3) vlerësimi i ndikimit të faktorëve makroekonomik dhe mikroekonomik në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional,
- 4) vlerësimi i përshtatshmërisë së Kornizës ligjore dhe zbatimi i saj në Sistemin Pensional në Kosovë,
- 5) definimi i rolit të qeverisjes dhe të menaxhimit në vendimarrjen politike të fondeve pensionale e cila ndikon në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional,
- 6) vlerësimi i menaxhimit të rreziqeve të Sistemit pensional,
- 7) studimi i funksionimit të tregut të kapitalit financiar ndërkombëtar,
- 8) analizimi i performancës aktuale të Sistemit pensional në Kosovë, krahasuar me sistemin paraprak dhe modelet e Sistemit Pensional në vendet në region,
- 9) vlerësimi i mbikqyrjes së Sistemit Pensional në Kosovë,

- 10) vlerësimi i rolit të teknologjisë informative në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional,
- 11) përcaktimi i trendit të zhvillimit të mëtejshëm të qëndrueshmërisë si dhe mundësitë e përmirësimit të mëtutjeshëm të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional.
- 12) nxjerrja e përfundimeve dhe rekomandimeve,
- 13) etj.

1.1.4. Qëllimi i studimit

Qëllimi themelor i këtij studimi, është përmbushja e standardeve akademike, për të kaluar me sukses edhe këtë sfidë të nivelit të studimeve. *Ky studim ka për qëllim matjen, vërtetimin e aftësisë së reformës së Sistemit Pensional në Kosovë, për të përballuar kërkesat për pagesën e pensioneve tani dhe në të ardhmen, apo për të vlerësuar arsyeshmërinë e reformës së sistemit pensional dhe matjen e qëndrueshmërisë së saj.*

Për arritjen e këtyre qëllimeve, është e nevojshme që të vlerësojmë gjendjen aktuale të Sistemit pensional në Kosovë, trendet e mëtejshme të zhvillimit dhe mundësitë e përmirësimit të tij.

Gërshetimi i njohurive teorike dhe të atyre praktike, do të mundësoj për të bërë një studim adekuat mbi arsyeshmërinë e reformës së Sistemit pensional në Kosovë dhe të qëndrueshmërisë së saj financiare, të cilat do të rezultojnë nga variablat makroekonomike.

Pra, synimi kryesor i këtij studimi, është punim i temës së doktoraturës, si studim i cili pretendon të përmbanë vlera akademike dhe profesionale në profilin e financave.

1.1.5. Burimet e studimit

Të dhënat e grumbulluara kanë përfshirë *totalin e operimeve të Sistemit Pensional të Kosovës për periudhën 2002-2014* me të gjitha variablat e modelit.

Këto të dhëna dytësore janë siguruar nga institucionet zyrtare përkatëse, të cilat janë të publikuara në dokumentet zyrtare dhe në web-faqet zyrtare të: *Trustit të Kursimeve*

Pensionale të Kosovës, të Fondit pensional Slloveno- Kosovar, të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve Bazë, Ministrisë së financave- Departamenti i Makroanalizave, Administratës Tatimore të Kosovës, Agjencioni i statistikave të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës, Bankave komerciale; Raiffaisen Bank, Pro Credit Bank, Turkish Enterprise Bank, Nova Ljublanska Banka, Banka Private e Binesit, Banka Kombëtare Tregtare, etj.

Plani i studimit përmban pozicionet e të dhënave, të cilat do të shërbejnë për të bërë *analizimet e nevojëshme* lidhur me arsyeshmërinë e reformës së Sistemit Pensional në Kosovë, konstatimin e gjendjes së tanishme, parashikimin e qëndrueshmërisë së saj, trendet e zhvillimit, nxjerrjen e përfundimeve dhe dhënjen e rekomandimeve.

Qëllimi i përpunimit të dhënave është sigurimi i treguesve që përmbajnë *variablat të pavarura dhe të varura* dhe relacionet e tyre shkak-pasojë, si dhe ndikimet e tyre në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional të Kosovës.

Nga analiza e të dhënave do të konstatohet se këto të dhëna janë përzgjedhur drejt, ndërsa relevanca e tyre do të shërbej për të zhvilluar analizën empirike, e cila do të vërtetohet hipotezën e parashtruar apo do ta hedhë poshtë.

1.1.6. Teza e punimit

Teza e përzgjedhur për studim synon të dëshmojë; se kemi identifikuar një problem të vlefshëm apo një çështje e cila deri më tani nuk është studiuar në mënyrë shkencore. Lidhur me evidencën e studimit të deri tashëm të kësaj çështjeje të rëndësishme, konsideroj se është e nevojëshme për t'i dhënë përgjigje adekuate dilemave rreth; *qëndrueshmërisë së reformës së sistemit pensional, efikasitetit të funksionimit të tij, investimeve në tregun e kapitalit financiar, stabilitetit financiar si dhe stabilitetit socio- ekonomik.*

Gjatë përcaktimit të tezës i kam kushtuar vëmendje të plotë formulimit preciz të çështjes, të cilën e kam studiuar, si dhe është një kontribut origjinal dhe i vlefshëm për të thelluar diturinë mbi fushën financiare, respektivisht në profilin e pensioneve.

Formulimi i tezës së përzgjedhur do të shërbej për të bërë analiza të detalizuara gjatë tërë rrjedhës së studimit, si dhe do të hapë dilema të tjera, të cilat do të studiohen në të ardhmen.

Strukturimi i studimit do të përqëndrohet në; *objektin e studimit, hipotezat, metodologjinë, strukturimin e temës, analizën empirike, gjetjet e arritura deri me tani, rezultatet finale të pritshme (saktësimi i hipotezave) dhe nxjerrja e rekomandimeve.*

1.1.7. Kontributi i punimit

Për të kontribuar në studimin e fushës së pensioneve, jam shërbyer me literaturë të përmbledhur dhe gjithëpërfshirëse, me të dhëna statistikore, analiza e raporte financiare, që ndërlidhet me temën e studiuar.

Punimi përmban; *kontribut origjinal të njohurive për zhvillimin teorik dhe për zbatim praktik. përzgjedhje adekuate të metodave të studimit, mënyrë të standardizuar të përshkrimit të problematikave të konstatuara, respektim të normave etike gjatë punës kërkimore, njohuri konkrete dhe universale mbi qëndrueshmërinë e reformës së Sistemit Pensional, analizë empirike, gjetje dhe rekomandimet.*

1.1.8. Pyetja kërkimore

Për të bërë këtë studim, janë parashtruar këto pyetjet kërkimore, të cilave do t’ju japim përgjigje argumentuese të zhvillimit të fenomenit, si vijon;

Si ka ndikuar reforma e Sistemit pensional në qëndrueshmërinë e tij, nën kushtet e ekonomisë së tregut të lirë?

Pyetjet kërkimore kanë për qëllim të mundësojnë matjen dhe krahasimin e qëndrueshmërisë së Sistemit të reformuar Pensional, në raport me ish Sistemin pensional PYGO në RSFJ, si dhe matjen e efikasitetit të funksionimit të Sistemit të reformuar pensional.

Pra, përmes këtyre pyetjeve kërkimore do të japim përgjigje, se çka mundëson ky studim, sa i rëndësishëm është ky studim, cili është theksi kryesor i studimit të qëndrueshmërisë

së Sistemit pensional në Kosovë, cilat dilema janë ngritur rreth tij, cilat janë eksperiencat e deritashme të zhvillimit të këtij sistemi dhe të sistemeve të ngjashme, cilat janë dobite që burojnë nga Sistemi i ri Pensional në Kosovë, etj.

Duke i dhënë përgjegje adekuate pyetjeve kërkimore, do të paraqesim implikimet e faktorëve kushtëzues të cilët janë të ndërlidhur me qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e funksionalitetit të Sistemit pensional në Kosovë.

1.1.9. Hipotezat

Për të vërtetuar, apo mohuar dilemat e parashtruara rreth arsyeshmerisë dhe qëndrueshmërisë së reformës së Sistemit Pensional në Kosovë, do të bëhen përpjekje për t'i dhënë përgjigje përmes vërtetimit apo hudhjes poshtë të këtyre dy hipotezave, duke përdorur hipotezën pohuese $H(0)$ dhe hipotezën Aletrnative $H(1)$ si më poshtë;

1. "Faktorët makroekonomik dhe mikroekonomik ndikojnë në masë të konsiderueshme në qëndrueshmërinë e Sistemit pensional të Kosovës.

Këto hipoteza do të vërtetohen në Kapitullin e Tetë përmes analizës empirike.

Si argumente kyçe për krijimin e hipotezave të punimit, janë marrë këto koncepte, të cilat mund të përmbliidhen në këto çështje, si vijon;

1. Reforma e sistemit ekonomik dhe reforma e sistemit pensional janë pjesë të procesit të tranzicionit, apo të ndërtimit të konceptit të ekonomisë së tregut të lirë.

2. Faktoret makroekonomik dhe mikroekonomik janë tregues të zhvillimit ekonomik.

3. Sistemi i ri Pensional e promovon *zhvillimin ekonomik*, përmes;

- *krijimit të fondeve financiare pensionale* (fiskalitetit, kursimeve të kontributeve pensionale dhe të investimeve të tyre),

- *zhvillimit të tregut të punës*, si dhe

- zhvillimit të tregjeve të kapitalit financiar.

4. Sistemi i ri Pensional duhet të mundësojë një *zgjidhje të përgjithshme*, që çon në krijimin e një *sistemi pensional të qëndrueshëm në periudhë afatgjatë*, që përballon *ndryshimet demografike dhe që nxit zhvillimin e ekonomisë së tregut të lirë*.

Në studimin tonë do të vërtetojmë qëndrueshmërinë e sistemit pensional, të cilin e kushtëzon koncepti i ekonomisë së tregut të lirë.

1.1.10. Debati aktual lidhur me tezen

Lidhur me zhvillimin e Sistemit pensional në RSFJ e veçanërisht në Kosovë janë zhvilluar debate të ndryshme që nga vitet e pas Luftës së Dytë Botërore deri më sot. Këto debate ishin zhvilluar lidhur me Sistemin PYGO (i cili bazohet në parimin “gjenerata kontribon për gjeneratën”) në RSFJ dhe Sistemin e reformuar pensional në Kosovë.

Çështjet kyçe në debat ndërlidheshin me mundësitë e evoluimit të Sistemi Pensional PYGO të cilat kishin për qëllim: *rregullimin e shpërndarjes së pensioneve, pronësinë e kontributeve pensionale, mënyrën e rregullimit të trashëgimisë ligjore të tyre, respektimin e të drejtave themelore të punonjësve, efikasitetin e funksionimit të sistemi pensional PYGO, fushën e sigurimeve sociale për të gjitha kategoritë e personave të moshuar që ishin në marrëdhënie të punës, stabilitetin ekonomiko-social, etj.*

Pas abrogimit të autonomisë së KSA Kosovës nga ana e Serbisë në vitin 1990, ishte transferuar Fondi Pensional i Kosovës në Serbi, mirëpo vlera e Fondit Pensional të Kosovës para integritit të tij të dhunshëm në Fondin pensional të Serbisë nuk ishte ekuivalentuar me ndonjë valutë të forte (në vitin 1990 në RSFJ kishte inflacion galopant dhe vlera e Fondit Pensional të Kosovës ishte e shprehur në dinarë të inflatuar), kështu që vlera e tij ishte zhvleftësuar tërësisht dhe lidhur me te janë paraqitur pretendime nga përfituesit e Fondit pensional të Kosovës.

Pas shkëputjes së Sistemit Pensional të Kosovës nga Sistemi Pensional i ish RSFJ, administrata e UNMIK-ut kishte bërë zgjidhje cilësore, duke zhvilluar Reformën e

Sistemit Pensional në Kosovë, përmes se ciles kishte marrë në mbrojtje të gjitha kategoritë e personave të moshuar, që kanë mbushur moshën prej 65 vjeç (të cilët i kishte kualifikuar si përfitues të pensioneve, pa dallim të përkatesisë gjinore) duke i përfshirë në Skemën bazë të pensioneve (mënyra e pensionit të parakohshëm për personat të cilëve iu mirret zotësia juridike për punë, apo në varësi të shkallës së invaliditetit, si dhe mundësia e blerjes së pensionit të parakohshëm), mirëpo si rezultat i këtij veprimi ishte shtruar dilema e: përfshirjes së dallueshme të ish të punësuarve para vitit 1990 dhe rirregullimi i Skemës bazike ngjajshëm me skemat pensionale në ish Republikat e ish RSFJ (duke iu pranuar përvojën e punës në kohëzgjatje minimale prej 15 vitesh, kategorizimi i kontributdhënësve në bazë të kualifikimeve profesionale dhe sipas shkallës së kontribuimit në Fondin Pensional të Kosovës të bëhet edhe shkallëzimi i përfituesve të Pensioneve Plotësuese, mundësia e blerjes së pensioneve nga ana e kontributdhënësve (ndryshimi i pragut të përvojës së përfituesve të pensioneve, që aktualisht është 15 vite përvojë deri në vitin 1999, duke e zbritur në 10 vite përvojë deri në vitin 1999 apo duke e mundësuar blerjen e përvojës së papërmbyshur gjatë viteve në punë), rregullimi i fushës së shitjes së pensioneve nga institucionet e autorizuara, përshtatshmeria e Sistemit të ri pensional në rastin e Kosovës, respektimi i të drejtave themelore universale të njeriut dhe respektimi i të drejtës së pronës-pensioneve, rimodelimi i pagesës së kontributeve pensionale në emër të punësuarve aktual (ndryshimi i kuotës së pagesës së kontributeve pensionale) në raport me pagën minimale në Kosovë.

Ka pasur debat lidhur me përshtatshmërinë e modelit shumëshytllor të reformës së Sistemit pensional dhe mundësinë e vetqëndrueshmërisë së tij, barazimin e kontributeve pensionale dhe funksionalitetin e entiteteve institucionale, mundësia cilësore e mbikqyrjes së tyre nga ana e BQK, sigurinë e aseteve financiare, infrastrukturën për përpunimin e të dhënave financiare dhe definimin e llogarive individuale në mënyrë transparente, ndikimin e reformës së Sistemit pensional në rritjen ekonomike, punësim, zhvillim të tregut financiar dhe stabilitet socio- ekonomik në Kosovë, nevojën për të bërë përmirësime të vazhdueshme

të Reformës Pensionale në Kosovë, duke bërë liberalizimin e organizimit të institucioneve pensionale të cilat grumbullojnë kursime pensionale të detyrueshme, në mënyrë që kontributorët të kenë të drejtë të zgjedhin, se ku duan të kenë llogarinë individuale, si dhe të kenë mundësi të zgjedhin mundësinë e investimit të mjeteve të tyre financiare, duke bartur vetë përgjegjësinë për kthimin e mjeteve dhe riskun eventual.

Gjithashtu është zhvilluar debati lidhur me ndryshimet ligjore të cilat mundësojnë përfshirjen e kategorive të personave të vetëpunësuar, bujqve, apo të gjithë ata persona të cilët në ndonjë formë të krijojnë të hyra financiare të raportuara ne ATK, për të paguar kontribute të nevojshme, në mënyrë që ata në të ardhmen të mos mbesin jashtë përfitimit nga sistemi pensional.

Është debatuar edhe mënyra e përfitimit të pensioneve për banorët e Kosovës të cilët kanë punuar në vendet e ndryshme të Botës dhe mundësitë e bashkëpunimit të Skemave pensionale të Kosovës me fondet pensionale jashtë vendit.

Debat i veçantë i është kushtuar luftës së informalitetit të punësuarëve për t'i detyruar punëdhënësit që t'i lajmërojnë punëtorët e tyre në ATK, ashtu që të mund të paguhen kontributet e detyrueshme pensionale, mënyra e kompenzimit financiar për trashëgimtarët ligjor të kontribuesve pensional në rast të vdekjes, lajmërimin në kohë të saktë mbi vdekjen e përfituesit të pensioneve në administratën përkatëse.

1.1.11. Zgjidhjet e pritshme të studimit të problemit

Nga ky studim priten të nxirren rezultatet të cilat identifikojnë faktorët shkakor të fenomenit, fuqinë e ndikimit të faktorëve shkakorë, efikasitetin e funksionimit të Sistemit pensional, qëndrueshmërinë e tij, pasojat apo rezultatet e tij.

Presim që përmes këtij studimi të vërtetohet:

- 1) Arsyeshmëria e reformimit të Sistemit Pensional.
- 2) Arsyeshmëria e modelimit të Sistemit pensional.
- 3) Efikasiteti i Sistemit pensional.

- 4) Qëndrueshmëria e Sistemit Pensional.
- 5) Zhvillimi i konkurrencës në fushën e Sistemit Pensional.
- 6) Nxitja e sektorit privat në zhvillimin e Skemave Pensionale.
- 7) Respektimi i të drejtave themelore universale të njeriut.
- 8) Ndikimi i Sistemit Pensional në zhvillimin ekonomik.
- 9) Ndikimi i Sistemit Pensional në zhvillimin e tregjeve të kapitalit financiar.
- 10) Ndikimi i Sistemit pensional në stabilitetin socio-ekonomik, etj.

Kështu që do të bëhet përpjekje për të dhënë përgjigje relevante ose zgjidhje të problemeve, të cilat do t'i hasim gjatë punës. Do të përpiqemi që problemet e gjetura të mos i lëmë në rrugë pa krye (pa nxjerrë rezultate konkrete), apo pa i përfshirë në studim, posaçërisht çështjet relevante të cilat janë bosht i temës që kërkojnë demonstrim apo zgjidhje të problemit.

Rezultatet e pritshme do të nxirren si konkluzione, duke u mbështetur në kapitujt e mëparshëm, të cilat do të përmbledhen në formë të; gjetjeve (përdorimi i teorisë në praktikën ekzistuese, zhvillimet praktike në këtë fushë, etj.) përfundimeve dhe të rekomandimeve si pjesë të kontributit studimor.

2. KAPITULLI II: METODOLOGJIA

Disejnim i studimit do të mbështetet në metodat adekuate, të cilat do të përdoren për të matur qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional në Kosovë. Andaj, bazuar në studimin konkret të kësaj teme e cila bazohet në: definimin e problemit, studimin teorik të problemit, gjendjen faktike apo praktike të funksionimit të Sistemit Pensional në Kosovë, Analizën empirike të problemit.

Baza metodologjike për studimin e problemit qëndron në: *çështjen për të cilën kërkohet zgjidhja, qasjen që duhet ndjekur, rezultatin e pritur, relevancën e rezultateve, masat shtesë që duhet ndërmarë nëse këto veprime nuk do të ishin të mjaftueshme si dhe alternativat e ofruara.*

2.1.1. Baza metodologjike, qasjet, instrumentet dhe të dhënat parësore e dytësore

Në studimin shkencor mbi arsyeshmërinë e Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë dhe mbi vlerësimin e qëndrueshmërisë së saj, janë përdorur konceptet bazë; *teoritë, hipotezat, variablat, të dhënat, matjet, analizat, etj.*

Duke përdorur teoritë respektive, është synuar të studiohen ndërlidhmëritë e: *koncepteve, veprimeve, nocioneve*, me qëllim të sigurimit të orientimeve ose udhëzimeve për të shpjeguar qartë funksionimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit Pensional në Kosovë.

Bazuar në saktësinë e parashikimeve teorike, është synuar të përdoret “hipoteza⁹”, si bazë për studim shkencor (si një pritje rreth vërtetimit të cilësisë së qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional) e cila më pas do të testohet duke përdorur variablat¹⁰ e pavarura si faktorë influencues (shkatar) në gjendjen (pasojat) e variablës së varuar.

Për të bërë një studim të tillë është e nevojshme të përfshihen të dhënat (të gjitha informatat), të cilat mblidhen, analizohen dhe përpunohen (duke iu nënshtruar analizës së përpunimit metodologjik, të cilat ndihmojnë për të shpjeguar problemin e studiuar),

⁹ Hipoteza shpreh marrëdhëniet në mes të variablave

¹⁰ Variablat janë; a) variabla të pavarura dhe b) variabla të varura

duke u bazuar në statistikat (të dhënat sekundare) e kryera mbi matjet historike të lëvizjeve të faktorëve makroekonomik dhe mikroekonomik, si faktorë influencues të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë¹¹.

Pra, metodologjia e përpunimit të të dhënave do të përqëndrohet në sigurimin e të dhënave sekundare, interpretimin e tyre, të cilat do të sigurohen nga institucionet respektive në Kosovë.

Metodologjia e përdorur bazohet në deduksionin, si një proces i cili mundëson që premiset e përgjithshme të përfundojnë në një premisë logjike (nga konstatimet e përgjithshme arrihet deri te konkluzionet e veçanta konkrete, apo nga shumë verifikime përkufizohet ndonjë verifikim i ri i cili rezulton nga vërtetësitë paraprake). Pra, kjo metodë mundëson, që përfundimi i përgjithshëm të qon në një përfundim të veçantë i cili mund të jetë: i pakundërshtueshëm (kategorik), i hamendësuar (hipotetik) dhe i dyzuar (disjunktive).

2.1.1. Qasjet metodologjike

Ekzistojnë dy qasje kryesore metodologjike:

Lidhur me këtë studim janë përdorur dy qasje metodologjike kryesore; a) Qasja metodologjike sasiore dhe b) Qasja metodologjike cilësore.

2.1.1.1. Qasja metodologjike sasiore

Është përdorur për përcaktimin e; të dhënave makroekonomike dhe mikroekonomike, mënyrën e grumbullimit të të dhënave, burimet e të dhënave, periudhën apo intervalin kohor, mënyrën e përpunimit, analizën e tyre, me qëllim të shpjegimit dhe interpretimit të ndërvarshmërisë së variablave të pavarura (treguesit makroekonomik, mikroekonomik) dhe me variablën e varur (pensionet). Përmes kësaj metode mund të shpjegojmë qartë definimin e pyetjes kërkimore, të ndërlidhur në mënyrë racionale me hipotezën dhe procedurën analitike të përpunimit të të dhënave statistikore. Kjo metodë ka shërbyer për të studiuar problemin e pensioneve, duke shfrytëzuar të dhënat, të cilat përcaktojnë

¹¹ Korrelacioni është madhësi statistikore i cili e paraqet relacionin mes dy variablave (variablave të pavarura ndaj variablave të varur), gjegjësisht lidhjen e shkak-pasojë të variablave të pavarura ndaj variablave të varur.

zhvillimin e procesit (përdorimi i serive kohore, të cilat kanë shërbyer për përkufizimin e trendit të zhvillimit). Përmes kësaj metode është bërë: *vrojtimi i ndryshimeve* (variacionet afatshkurtëra dhe afatgjata), *cikli i ndryshimeve* (variacionet e rregullta, të rastit, të çrregullta) etj. Kjo metodë ka shërbyer për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të bazuara në variablat ose instrumentet e dhëna si dhe për të bërë analiza të nevojshme statistikore.

Qasja e metodave kuantitative¹² mirret me përpunimin të dhënave numerike, të cilat janë zakonisht të prezantuara në trajtën e statistikave studimore¹³ të cilat varen nga: metodat, modeli kërkimor, mënyra analitike dhe mënyra e interpretimit. Qasja kuantitative shoqërohet me hipotezat që rrjedhin nga teoria, për të qenë në gjendje për të vlerësuar hipotezat e një fenomeni të caktuar. Metodatat e përdorura sipas Qasjes kuantitative prodhojnë rezultate, të cilat janë me të lehtë për t'u përmbledhur, krahasuar dhe të përgjithësohen.

Në kuadër të metodës cilësore janë përdorur edhe metoda tjera, si vijon: a) *metoda deduktive*, b) *metoda statistikore*, c) *metoda e analizës*, d) *metoda e parashikimit-regresionit*, etj.

a. *Metoda deduktive*- është shfrytëzuar gjatë studimit për t'ju çasur problemit nga makro analizat, për të ardhur deri te studimi dhe njohja e problemit të pensioneve në detaje. Kjo metodë paraqitet si çasje në tërësinë e problemit të pensioneve dhe të parimeve që shpjegojnë problemin e pensioneve. Metoda deduktive ka shërbyer për të shprehur të dhënat empirike me anën e një sistemi formal logjik të koncepteve të përdorura.

b. *Metoda statistikore*- është shfrytëzuar për përdorimin e të dhënave dytësore, për studimin e problemit të pensioneve. Kryesisht është përdorur përcaktimi i shkallës së ndikimit të faktorëve makroekonomik dhe mikroekonomik në sistemin pensional. Kjo

¹² Qasja kuantitative ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave të rastit dhe të strukturuar, të cilat përdoren duke ia përshtatur përvojave të ndryshme në kategori të paracaktuara.

¹³ Statistikat e nxjerra nga kërkimet sasiore mund të përdoren për të përcaktuar ekzistencën e marrëdhënieve shkak-pasojë.

metodë ka shërbyer edhe për studimin e nivelit të vërtetimit të ndryshimeve parametrike, që ndikojnë në efikasitetin, qëndrueshmërinë financiare të Sistemit Pensional si dhe në përdorimin e të dhënave për të ndërtuar modelin aktuarial¹⁴.

c. *Metoda e analizës*¹⁵ - është metodë e cila mirret me zërvendimin apo analizën e problemit, me qëllim të diagnostifikimit të tij dhe të parashikimit për zhvillimet e ardhshme. Lidhur me përdorimin e metodës së analizës janë shkruar teori të ndryshme, janë nxjerrë rregulla, si dhe janë përdorur instrumente të ndryshme për analiza. Përdorimi i metodës së analizës ka shërbyer për modelimin ekonometrik të problemit të studiuar. Kjo metodë është përdorur për simulimin e prognozimit, bazuar në variablat e pavarura të cilat janë të lidhura me variablën e varur (pensionet). Për të bërë analizat e nevojshme është përdorur modeli i regresionit linear, i ndërlidhur në mes të variablës së pavarur dhe të shumë variablave të varura të ekuacionit linear.

d. *Metoda e parashikimit apo regresionit*- është shërbyer me konceptet mbi supozimet, të mbështetura nga indikatorët numerik, të cilët shërbejnë për t'i bërë parashikimet e nevojshme afatshkurtëra apo afatgjata. Kjo metodë shërben për zhvillimin e procesit të planifikimit, duke u shërbyer me indikatorët historik dhe aktual, të cilët vihen në dispozicion për të bërë parashikimet e mundëshme. Kjo metodë shfrytëzon kapacitetet zhvilluese dhe të treguesve, të cilët shërbejnë për të matur efektivitetin e përdorimit të tyre gjatë parashikimit. Vendimet për parashikim bazohen në të dhënat të cilat rezultojnë nga matjet sasiore të parashikimit. Matjet sasiore zakonisht bazohen në modelet matematikore, siç janë: *modelet e serive kohore* (çdo një (1) vit, apo për 15 vitet e fundit), *modelet shkakore të variablave të pavarura, të cilat shërbejnë për të parashikuar zhvillimin e problemit apo të zhvillimit të variablës së varur*.

¹⁴ “Rregulla 15” e BQK mbi Financimin dhe Vlersimin aktuarial të Rregullimit Pensional me Benefit të Definuar.

¹⁵ Metodologjia e kërkimit është bërë në përputhje me modelin ekonometrik të serive kohore, e cila ka mundësuar analizimin e variablave të pavarura dhe ndikimin e tyre në variablën e varur. Kjo metodë ka shërbyer për të bërë analizimin e gjendjes aktuale, diagnostifikimin e gjendjes dhe parashikimin. Përmes metodës analitike planifikohet për të; *grumbulluar të dhënat sekondare, modeluar problemin (specifikimi i modelit ekonometrik), vlerësimin e problemit, testimin e problemit, testimin e hipotezave të parashtruara*.

Pra, Metoda e analizës së regresionit linear shërben për matjen e ndikimit të varaibleve të pavarura (faktorët shkaku- makroekonomik dhe mikroekonomik) në variablën e varur (pensionet), apo shpjegon ndikimin e faktorëve makroekonomik dhe mikroekonomik në Sistemin Pensional të Kosovës, si dhe në parashikimin e zhvillimit të trendeve makroekonomike e mikroekonomike në të ardhmën në Kosovë.

2.1.1.2.Qasja metodologjike cilësore

Është përdorur për të shpjeguar veçantitë e problemit të studiuar, duke bërë përshkrime dhe interpretime rreth problemit të studiuar, gjegjësisht për vlerësimin e koncepteve, të cilat ndihmojnë të kuptojmë fenomenet sociale në premisa natyrore, duke vënë theksin më së shumti në teoritë dhe eksperiencat e zhvillimit të sistemeve pensionale. Kjo metodë ka shërbyer për të klasifikuar të dhënat për studim, renditjen e tyre, kategorizimin dhe nxjerrjen e konkludimeve rreth studimit të Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë dhe qëndrueshmërisë së tij.

Në studimin e kësaj teme, pyetja kërkimore kërkon që të kuantifikohet dhe të matet qëndrueshmëria e Sistemit Pensional në Kosovë, gjë që përdorimi i qasjes së metodës kualitative mund të konsiderohet si një eksperiment i vërtetë, përmes së cilës mund të kontrollohet në mënyrë statistikore ndikimi i faktoreve makroekonomik dhe mikroekonomik në Sistemin Pensional.

Qasja sipas metodës kualitative- përmes së ciles sigurohet kuptimi nga prizmi historik, sqarimi i rastit studimor, objektet apo instrumentet e studimit, grumbullimi i të dhënave apo informacioneve me qëllim të përpunimit, analizimit¹⁶, krahasimit, duke u bazuar në rastin studimor.

Në kuadër të Metodës cilësore janë përdorur edhe metodat tjera: a) *Metoda empirike*,

¹⁶ Analiza është metoda e cila e balancon përshkrimin fenomenologjik me interpretim e qartë e të thellë kuptimor, duke mundësuar në formimin e qëndrimit përkatës.

Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave nga studiuesi, fillimisht nuk ka për qëllim të testoj hipotezat dhe të ndërtohen qëndrimet rreth analizës së të dhënave, por të reflektohen paragjykimet rreth të dhënave, përqëndrimin në kuptimin e thelbit të studimit, të modeleve, të kuptimeve (ideve, mendimeve,etj.).

b) Metoda historike, c) Metoda përshkruese, d) Metoda krahasuese, e) Metoda e korelacionit,

- a. *Metoda empirike*- Modelimi i problemit mbi bazë të dhënave empirike përbën një përmbledhje të koncepteve, duke i shprehur ato me parametra të matshëm, apo me rregullat të cilat shprehin marrëdhëniet midis vëzhgimeve të këtyre koncepteve.
- b. *Metoda historike*- ka shërbyer për përshkrimin historik të zhvillimit të procesit të pensioneve në Kosovë, burimet e të dhënave të cilat përdoren sipas metodës historike janë; burimet primare dhe skundare të fakteve apo argumenteve të cilat përshkruajnë veprimet që kanë ndodhur në të kaluarën.
- c. *Metoda përshkruese*- ka për qëllim grumbullimin e të dhënave mbi problemin, duke i përshkruar vetitë e veçanta të problemit. Kjo metodë përdoret për të përshkruar gjendjen ekzistuese, duke definuar strukturën e problemit, rangimin e variablave sipas relevances.
- d. *Metoda krahasuese*- ka shërbyer për krahasimin e zhvillimit të problemit të sistemit të pensioneve, nga fazat shfaqjes së tij deri më sot, mënyra e evoluimit dhe e dallimeve të zhvillimit të procesit të sistemit të pensioneve, duke krahasuar strukturën, vëllimin, intenzitetin si dhe nivelin e përmbushjes së nevojave të personave të moshuar dhe të pensionistëve. Kjo metodë nuk shpjegon shkakun e variablës së varur, por shërben për të shpjeguar dallimet në mes të grupit të variablave.
- e. *Metoda e korelacionit*- shërben për testimin e ndërvarësisë së dy apo më tepër variablave me qëllim të parashikimit të tyre.

Metodologjia e përdorur ka shërbyer për të bërë përshkrimin e problemit; analizën e të dhënave, përpunimin e tyre në modelin ekonometrik si dhe për të vërtetuar hipotezat e ngritura.

Njëherit metodat e përdorura kanë mundësuar që të bëhet një studim sistematik dhe analitik i problemit, me rregulla të qarta mbi përdorimin e informatave, të dhënave statistikore, fakteve dhe argumenteve, si dhe është ndjekur një numër hapash, me qëllim të përfitimit të rezultateve testuese, përmes korelacionit (në të cilin ndikojnë faktorët shkakor) duke dhënë rezultate pasuese. Kështu që, duke i përdorur këto metoda është

tentuar për t'u konstatuar gjendja e qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional, si rezultat i përdorimit të politikave ekonomike, në bazë të disa gjetjeve konkrete, të cilat dalin si rezultat i nevojës për të bërë përmirësime të vazhdueshme të Sistemit Pensional në Kosovë.

2.2. Kufizimet e studimit të problematikës

Gjatë realizimit të këtij studimi, nuk kemi hasur në ndonjë studim i cili e ka studiuar në mënyrë shkencore reformën e Sistemit Pensional të Kosovës dhe qëndrueshmërinë e saj. Andaj, bazuar në objektivat e këtij studimi, janë përcaktuar operimet e nevojshme dhe të dhënat përkatëse për këtë studim, të cilat janë gjetur si të pa grupuara dhe të pa sistemuara sipas serive të nevojshme kohore të studimit. Këto të dhëna si të tilla kanë paraqitur kufizime gjatë studimit.

Kufizime tjera të cilat janë shfaqur gjatë përdorimit të të dhënave, janë të dhënat e ndryshme mbi të njejtën kategori ekonomike (të cilat janë përpunuar nga dy e më tepër institucione, kanë rezultuar si të ndryshme). Andaj, punimi përmban kufizime shkencore si rezultat i të dhënave statistikore, por jo edhe metodologjike. Gjatë studimit kanë munguar të dhënat e detajuara dhe të përmbledhura të Fondit Pensional nga Shtylla e tretë e pensionave, gjegjësisht nga Fondi Pensional Slloveno- Kosovar, të cilat kanë qenë kufizim i studimit të plotë (ka munguar përfshirja e treguesve statistikor në studim). Mirëpo edhe mungesa e këtyre të dhënave nuk e lëndon përmbajtjen e studimit, sepse ky Fond Pensional merr pjesë afërsisht në tërësinë e operimeve të Sistemit Pensional të Kosovës me 0,6% të mjeteve financiare. Pra, kualiteti i studimit është i varur nga natyra, struktura dhe cilësia e të dhënave.

Për studimin e reformës së Sistemit pensional janë bërë shumë studime në Botë nga autorë të ndryshëm, të cilët e kanë studiuar këtë fushë, si dhe nga institucionet e ndryshme Botërore, të cilat e kanë për kompetencë që ta përcjellin dhe mbështesin zhvillimin ekonomik, stabilitetin financiar, shtimin e popullsisë, punësimin, mirëqenjen e njerëzve, etj. (Banka Botërore, FMN, OECD, e institucione të tjera). Përparësitë të cilat i

ofron literatura Botërore, janë shfrytëzuar gjatë studimit të tezës së shtjelluar në këtë punimin lidhur me; qëndrueshmërinë, stabilitetin dhe mënyrën e funksionimit të Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë, mirëpo nuk është gjetur literaturë përkatëse nga autorët shqiptarë.

Gjithashtu jashtë këtij studimi do të mbeten skemat e asistencës sociale, të cilat nuk janë pjesë e Sistemit Pensional të Kosovës. Arsyeja e përjashtimit të këtyre skemave është, se ato nuk janë të rregulluara me Ligjin mbi pensionet në Kosovë, por janë të rregulluara me ligje të veçanta dhe nuk trajtohen si fenomene të rregulluara brenda Sistemit Pensional të Kosovës.

2.3. Struktura e tezës së diplomës

Bazuar në përmbajtjen e studimit të kësaj teze, është bërë strukturimi i studimit si vijon;

1) *Kapitulli I: Hyrje*- në këtë kapitull është shqyrtuar problematika e studimit, duke dhënë sqarime mbi; natyrën e problemit dhe arsyetimin e përzgjedhjes së studimit të tij. Studimi fillon me definimin e koncepteteve kryesore në punim; përkufizimi i tezes, ndërtimi i hipotezës, përcaktimi i pyetjeve kërkimore, përcaktimi i objektivave të studimit, përshkrimi i kufizimeve të studimit, burimet e informatave, definimi i variablave kyçe në bazë të cilave është ndërtuar modeli ekonometrik, debati publik, përshkrimi i zgjidhjeve të pritshme.

2) *Kapitulli II: Metodologjia*- përshkruhen metodat cilësore dhe sasiore, të cilat janë përdorur gjatë studimit të problemit, të cilat kanë mundur që fenomeni të studiohet në mënyrë adekuate.

3) *Kapitulli i III: Diskutimi teorik i problemit*- shpjegon shqyrtimin e teorive të cilat janë përdorur gjatë studimit, duke u përqendruar në përmbledhjen e teorive bazë të literaturës. Shtjellimi i thelluar i literaturës është bërë duke u bazuar në diskutimin kritik të teorive mbi çështjen e pensioneve nga autorët e ndryshëm dhe nga shkollat e ndryshme. Kryesisht në këtë kapitull janë trajtuar teoritë mbi: ekonominë e tregut të lirë

apo tregjet spontane, reformën e sistemit pensional, qeverisjen, etikën dhe efikasitetin financiar, përgjegjësitë fiduciare të qeverisja korporative, transparencën financiare, natyrën e planeve të kontributeve pensionale, punësimin, qëndrueshmërinë, stabilitetin financiar, strategjitë e investimeve, menaxhimin e rrezikut dhe efikasitetin financiar.

4) *Kapitulli i IV: Kontesti historik i zhvillimit të fenomenit*- Në këtë kapitull është përshkruar procesi historik i evoluimit të Sistemit Pensional në Kosovë, procesi i tranzicionit ekonomik në Kosovë dhe ndërtimi i sistemit të ri ekonomik. Më tutje janë shqyrtuar politikat ekonomike, të cilat kanë qenë të nevojshme për reformimin e Sistemit Pensional. Është përshkruar baza konceptuale e ndërtimit të Sistemit të ri Pensional në Kosovë, parimet e reformës, korniza rregullative, përparësitë dhe sfidat e modelit shumëshytyllor, efikasiteti i funksionimit të tij, krahasimi i tij me Sistemet Pensionale të vendeve në region, zgjidhjet të cilat i ofron reforma në raport me nevojat për përfshirjen e të gjitha kategorive të personave në nevojë.

5) *Kapitulli V: Analiza e qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional të Kosovës*- këtu përshkruhen faktorët makroekonomik dhe mikroekonomik, të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional të Kosovës. Analiza e stabilitetit financiar të skemave pensionale e cila fokusohet në faktorët financiar të cilët ndikojnë në stabilitetin e skemave pensionale, duke i përfshirë; kontributorët, pagat, kontributet pensionale, pasuritë e fondeve pensionale, investimet, performancën e Fondeve Investuese, planet pensionale, buxhetin, pensionet e Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti, pensionet e Shtyllës së II-të dhe të III-të të financuara nga kontributet e definuara pensionale. Analiza financiare e qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional e cila në vete përmban rrjedhën e parasë (Cash flow), të hyrat e fondeve pensionale, shpenzimet e tyre, efektivitetin e funksionimit të fondeve pensionale, likuiditetin, profitabilitetin, mbikqyrjen, etj.

6) *Kapitulli i VI: Analiza empirike*- Në këtë kapitull është përshkruar; analiza statistikore përmes regresionit linear, përdorimi i të dhënave. Është shpjeguar metodologjia e kërkimit analitik dhe e definimit të variablave, paraqitja e tyre grafike. Testimi i hipotezës është bërë përmes testimit të stacionaritetit të variablave, nga janë nxjerrur rezultatet dhe përfundimet.

- 7) *Kapitulli i VII; Përfundimet dhe Rekomandimet*- Në këtë kapitull janë përmbledhur konkluzionet, të cilat burojnë nga studimi i shtjelluar dhe literatura e nevojëshme për studimin e fenomenit dhe janë dhënë rekomandimet.
- 8) *Lista e referencave, bibliografia*- Gjatë përmbledhjes së burimeve të studimit, është bërë grupimi i tyre në: burimet themelore (literatura) dhe burimet dytësore (raportet, biltenet, informatorët, etj.).
- 9) *Shtojcat*- Janë përmbledhur disa tabela, si dhe janë përshkruar metodat e testimit; “Least Squares”, “Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test”, “White Heteroskedasticity Test”, të modelit të regresionit linear përmes “Ramsey RESET Test”. Në fund është bërë prognozimi i zhvillimit të fenomenit të studiuar përmes testimit të kointegrimit (Testi Johansen i kointegrimit),

3. KAPITULLI III: DISKUTIMI TEORIK

3.1. Teoritë bazë për studimin e punimit

Sfondi teorik i tezës së studiuar, përmban një përshkrim të përgjithshëm të fushës së pensioneve dhe e vendos temën në kuadër të teorive të përpunuara deri më tani.

Gjatë studimit janë përmbledhur teoritë më të rëndësishme (në formë të librave, artikujve, raporteve hulumtuese, etj.) të autorëve të ndryshëm (vendorë dhe ndërkombëtarë), duke u përqëndruar kryesisht në rezultatet dhe përfundimet e tyre, të cilat krahasohen dhe vlerësohen me temën e studiuar.

Në këtë studim janë përfshirë hulumtimet më të reja, të botuara gjatë këtij dhjetëvjeçari.

Nga literatura e përdorur mund të konstatojmë, se në Botë është studiuar mjaft fusha e pensioneve, mirëpo nuk është studiuar mjaft Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë dhe qëndrueshmëria e saj. Andaj është e nevojshme që të qartësohet literatura e domosdoshme që do të përdoret gjatë shtjellimit të problemit të studiuar, në mënyrë që t'i ipet përgjigje pyetjeve të parashtruara. Gjatë punës kërkimore i është kushtuar rëndësi e veçantë bazës teorike, që ka të bëjë me;

- 1) Teoritë mbi ekonominë e tregut të lire apo tregjet spontane.
- 2) Teoritë mbi reformën e sistemit pensional.
- 3) Teoritë mbi qeverisjen.
- 4) Teoritë mbi etikën dhe efikasitetin financiar.
- 5) Teoritë mbi përgjegjësitë fiduciare në qeverisjen korporative.
- 6) Teoritë mbi transparencën financiare.
- 7) Teoritë mbi natyrën e planeve të kontributeve pensionale.
- 8) Teoritë mbi punësimin.
- 9) Teoritë mbi qëndrueshmërinë.
- 10) Teoritë mbi stabilitetin financiar.
- 11) Teoritë mbi strategjitë e investimeve.
- 12) Teoritë mbi efikasitetin dhe eficiencën financiare.

13) Teoritë mbi menaxhimin e rrezikut.

14) etj.

Përdorimi i literaturës është bërë, duke iu çasur teorive sipas autorëve dhe sipas shkollave mbi çështjet respektive, në mënyrë që të artikulohen qartë konceptet e studiuara deri më tani,

të cilat kanë krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e kuadrit konceptual të punimit.

Studimet teorike i kanë shërbyer procesit të reformës së Sistemit Pensional, duke ofruar njohuri mbi: modelimin e Sistemit Pensional, mënyrën e qeverisjes dhe të menaxhimit, mënyrën e kompletimit të kornizës rregullative, mënyrën e investimeve të mjeteve financiare të Fondeve Pensionale, mënyrën e tipizimit të planeve pensionale, mënyrën e mbikqyrjes dhe të kontrollit të tyre, etj.

3.2. Autorët bazë

Autorët bazë të cilët kanë dhënë kontribut në studimin e fushës së pensioneve, përmes; studimeve- hulumtimeve, debateve, opinioneve, raporteve, të cilat i kanë transmetuar mendimet e ndryshme teorike, kanë mundur qartësimin e koncepteve dhe mundësive për të bërë analiza të thella, për të arritur deri te përfundimet racionale.

Konceptet teorike të autorëve apo të shkencëtarëve të ndryshëm, janë përdorur varësisht nga konteksti teorik i fushës së studimit.

1. Autorët kryesorë të cilët kanë bërë studime të thelluara në fushën e pensioneve janë;

Aaron, H.J. (1999); Alberto R. (2004); Almeida H. (2001); Andenas, M. (2009), Ayala (1996); Andrew Schnackenberg (2012); Andrews S, A. (2000); Ashish Dafria (2002); Assel Izekenova (2012); Benjamin Klein (1981); Benartzi, S. (2001); Blake David (1988); Bodie, Z. (1991); Brealy, R. (2008); Campbell, J. (2002); Chamorro (1992); Cleary S. (1999), Chong, A. (2007); Du Plessis, J. (2011); Christopher J. Peters, (1997); Christopher A. Pissarides (2004); Cui, J, F de Jong, (2006); Daniel Friedmann (2001); David Blake

(2002); Gordon Smith (2002); Demarco G. (1999); Deloof, M. (2001); Dohmen, T. (2005); Donkers, B. (2013); Du Plessis, J. (2011); Edwards (1997); Estelle James (2002); Ernest J. Weinrib (2000); Felix Goltz (1998); Haindl Rondonelli (1996); Gersdorff V, H. (1997); Gramlich (1996); Goltz Felix (2009); Friedman (1996); Harry M. Markovitch (1959); Herbert A. Simon (1951); Hebbel Sch, K. (1999); Hereijgers Patrick (2013); Hollzmann (1981); Jensen M.C., (1986); Palacios (1995); James R. (2013); Jack Brennan (2002); Jeremy Waldron, (2001); Jim Naughton, (1995); Johan Maynard Keynes (2006); John Gubbles, David Snelbecker, Lena Zezulini (2005); Joseph Raz, (1986); Johson, Mitchell (1996); Joshua D. Rauh (2004); Kahneman, D. and A. Tversky (1984); Karl Brunner, (1978); Kaplan S. N.(2000); Kenneth I. Winston (1974); Kent Greenawalt (1997); Kopits George (1998); Kevin Dowd (2013); Lindeman D., Rutkowski M. and Sluchynskyy O. (2000); Matthew M. (2008); Michael C. Jensen (1976); Milton Friedman (1962); Mishkin, F. (2006); Moelmann, L. 2009); Musalem R. (2012); Myers S.C. (1998); Newton L. Bowers (1979); Nicholas Barr (2010); Oliver Hart (1988); Oliver Landmann (2004); Patrick P.C. (2013); Peter Westen, (1982); Richard Heinberg 2011; Robert Cooter (1991); Rofman (1997); Ronald Snell (2010); Ronald Dworkin, (1996); Schwarz (1998); Rutkovski, Fulltz (1992); Sanford J. Grossman (1986); Schnackenberg Andrew; (2012); Siegel, J. (2007); Stewart Fiona; (1981); Towers Watson (2013); Tversky, A. and D. Kahneman (1979); Valdes-Prieto and Queisser (1998); Van Rooij, M. (2007); William F. (1964); Watson, D. (2007). Zvi Bodie (1988).

2. Institucionet ndërkombëtare të cilat e kanë studiuar fushën e pensioneve janë;

Social Protection, Human Development Network, World Bank, IMF, ILO, OECD, Këshilli Evropian, Unioni Evropian, USAID

Përdorimi i këtyre teorive ka shërbyer për të bërë ndërlidhmërinë e teorive të skemave pensionale me problematikën e funksionimit praktik të skemave pensionale gjatë studimit të fushës së pensioneve.

3.3. Diskutimi kritik i shkollave dhe institucioneve të ndryshme teorike mbi sistemet pensionale

Diskutimi publik i shkollave teorike ka shërbyer për të dhënë kontribut mbi argumentimin e tezës mbi pensionet duke i zbërthyer;

- 1) Konceptet kryesore për studimin e çështjeve kyçe në punim.
- 2) Ndërlidhjen e literaturës me temën e studiuar.
- 3) Vertetimin e hipotezave në studim duke u shërbyer me literaturën respektive, si dhe kritikën rreth tyre.
- 4) Plotësimin e njohurive teorike rreth pyetjeve kërkimore.
- 5) Përzgjedhjen e metodave relevante gjatë studimit të tezës së parashtruar.
- 6) Modelin ekonometrik.
- 7) Përfundimet e nxjerrura nga studimi i tezës.

Pra, ky kapitull përfshin një diskutim kritik të shkollave të ndryshme teorike që ekzistojnë nëpër Botë, i cili ka shërbyer për të krijuar qasje të drejtë dhe profesionale lidhur me problemin e parashtruar.

1. Shkollat të cilat janë marrur me zhvillimin e reformave të sistemit pensional

- University of Chicago ,Chicago, USA.
- Cambridge University, Cambridge, UK.
- Oxford University, Oxford, UK.
- University of Saarland, Saarbrücken, Germany.
- Catholic University, Santiago, Chile.
- Oslo University.
- The Urban Institute, Washington, D.C., USA.
- Office of the Plenipotentiary of Social Security Reform, Warsaw, Poland.
- Etj.

2. Shkollat të cilat janë marrur me matjen e qëndrueshmërisë së sistemeve shoqërore

- Harvard University.

- Global institute of sustainability, Arizona State University, USA.
- U.S. Agency for International Development Center for Development Information and Evaluation.
- Auckland University of Technology.
- University of Waikato.
- etj.

3. *Institucionet relevante te cilat jane marrë me studimin e sistemeve pensionale*

- The World Bank.
- International Monetary Found.
- Central Bank of Chile, Santijago, Chile.
- OECD, Development Centre Study, Paris (OECD).
- Etj.

3.4. Analiza e thelluar teorike e punimit të tezës

Konteksti teorik i studimit mbështetet në teoritë bazë mbi; *barazinë dhe të drejtat themelore të njeriut (e drejta e prones, liritë për mbrojtjen e dinjitetit, pacenueshmërinë, punën, mirëqenien, etj.), ekonominë e tregut të lirë, reformën e sistemit pensional dhe në stabilitetin e qëndrueshmërinë ekonomike, etj.*

Ndërsa teoritë të cilat janë përdorur gjatë studimit janë si vijon: *teoritë mbi qeverisjen, teoritë mbi etikën dhe efikasitetin financiar, teoritë mbi përgjegjësitë fiduciare në qeverisjen korporative, teoritë mbi transparencën financiare, teoritë mbi natyrën e planeve të kontributeve pensionale, teoritë mbi punësimin, teoritë mbi qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar, teoritë mbi strategjitë e investimeve dhe të efikasitetit financiar, teoritë mbi menaxhimin e rrezikut, etj.*

3.4.1. Teoritë mbi ekonominë e tregut të lirë apo tregjet spontane

Teoritë bazë të cilat janë përdorur për ndërtimin e modelit të sistemit pensional shumëshytyllor, ishin nga grupi i ekonomistëve të shquar të quajtur “Chicago Boys”¹⁷, të cilët ishin trajnuar në Departamentin e Ekonomisë së Universitetit të Çikagos nën udheheqjen e ekonomistit të shquar Milton Friedman dhe Arnold Harberger (1970 dhe '80) e kishin formuar degën tyre në departamentin e ekonomisë në Universitetin katolik Papnor të Kilit. Ata me teoritë e tyre liberale mbi ekonominë, kishin ndikuar në transformimin e ekonomisë së Kilit, duke e bërë ekonominë më të mirë në Amerikën Latine. Pikënisja e transformimit të ekonomisë fillonte nga niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, shkalla e lartë e papunësisë, gjë që kritikët e ekonomisë ia atribuojnë këtë gjendje politikave të zbatuara deri atëhere. Kështu që laureati për “Çmimin Nobel” Amartya Sen kishte argumentuar se këto politika ishin të destinuara me qëllim për t'i shërbyer interesave të korporatave amerikane në kurriz të popullsisë së Amerikës Latine.

Teoritë e tyre mbi liberalizimin e gjerë të tregut, privatizimin dhe politikat tjera mbi reformën e sistemit ekonomiko-social gjatë sundimit të gjeneralit Augusto Pinochet (1975), ishin treguar të suksesshme nën kushtet kur shkalla e inflacionit ishte shumë e lartë dhe politikat recesioniste në Botë kishin ndikuar që të shkaktohet një depresion ekonomik në Kili.

Andaj, teoritë mbi ekonominë e tregut të lirë apo tregjet spontane, të cilat i plotësojnë nevojat e konsumatorëve të bazuara në doktrinën “Laissez faire”, të cilat definojnë shkëmbimin e lirë të mallërave, realizimin e fitimeve, vetëqëndrueshmërinë e subjekteve ekonomike në ekonominë e tregut të lirë, ishin shfrytëzuar si model për të bërë reformën e sistemit ekonomik dhe në veçanti të Sistemit pensional në Kosovë.

¹⁷ “Djemtë e Çikagos” të trajnuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA (program i parë i SHBA-ve për zhvillim ekonomik ndërkombëtar, ishte financuar nga Fondacioni Ford dhe Fondacioni Rockefeller), ishin angazhuar për të ndikuar në të menduarit kilian mbi ekonominë liberale përmes “Programit për Zhvillim Ekonomik” të quajtur “El ladrillo” apo “tulla” dhe nëpërmjet programit “Point Katër”.

Koncepti i teorisë së ekonomisë liberale e trajton individin si të lirë¹⁸ të punoj, të prodhoj, të konsumoj dhe të investoj në mënyrën të cilën ai vetë e përzgjedhë.

Gjatë tranzicionit në Kosovë, ishte mbështetur koncepti i ekonomisë së tregut të lirë, si koncept i përshtatshëm që kishte nxitur zhvillimin e sektorit privat, duke krijuar konceptin e vetëqëndrueshmërisë edhe të Sistemit pensional.

3.4.2. Teoritë mbi Reformën e Sistemit Pensional

Teoritë mbi reformën e Sistemit Pensional mbështeten kryesisht në studimet rreth skemave të vjetra të Sistemit Pensional, të cilat kanë qenë të bazuara në Parimin e Solidaritetit apo në parimin Pay- as- you- go (PAYGO), ku gjenerata e re e punësuar ka paguar kontribute pensionale për gjeneratën e moshuar që ka përfituar pension (modeli njësjtyllor)¹⁹, si dhe në teoritë e reja të cilat bazohen në konceptin e ekonomisë liberale (modeli shumësjtyllor).

Me dështimin e skemave të modelit PAYGO janë bërë përpjekje nga qeveritë e ndryshme në Botë që të bëhet reformimi i sistemit pensional, i cili kishte nevojë me qenë i vetëqëndrueshëm.

Teoritë të cilat janë marrë me studimin e këtyre modeleve, kanë shërbyer për të organizuar Sistemin Pensional në Kosovë dhe për të vendosur rregullat e funksionimit të Sistemit Pensional, si vijon;

Teoritë lidhur me Modelin e Sistemit PAYGO²⁰ - Teoritë të cilat e studiojnë procesin e sistemit të pensioneve, ku të punësuarit paguajnë kontribute sot, në mënyrë që personat e moshuar (që i kanë mbushur vitet për pensionim) të përfitojnë pension sot.

¹⁸ Në një shoqëri të tillë e cila bazohet në të drejtën e plotë mbi pronën private (pronën private e përkufizon si të shenjët), e ecila e përkufizon lirinë maksimale mbi lëvizjen e; *fuqisë punetore, të kapitalit dhe të mallrave, të cilat lëvizin lirshëm në nivel kombëtar.*

¹⁹ Kjo skemë ka rezultuar e pa qëndrueshme, sepse të hyrat e kësaj skeme në periudhat aftgjata kanë patur tendencë të rënies, krahasuar me të dalurat që kanë pasur tendencë të rritjes. Kështu që këto skema në periudhat aftgjata nuk kanë qenë likuide dhe si të tilla kanë dështuar.

²⁰ Koncepti i sistemit të vjetër PAYG kishte ngritur shumë debate profesionale mbi: parimin e solidaritetit, sistemet pensionale publike, mundësinë e përballimit të ndryshimeve demografike aktuale (hyrjen e tyre në

Teoritë lidhur me Modelin e Amerikës Latine apo Modelin e OECD- Teoritë të cilat studiojnë procesin pensional, në të cilin punëtorët vendosin se si do të investohen kontributet e kursimeve të tyre pensionale, ndërsa sipas modelit të OECD (2005)²¹ punëtorët apo sindikatat vendosin mënyrën e përfaqësimit dhe të kontrollit të investimeve strategjike në ndonjë entitet apo fond financiar.

Teoritë lidhur me Modelin Suedez- Këto teori bazohen në llogaritë e imagjinuara të punëtorëve, të mbështetura në llogaritë e fondeve reale nga kursimet dhe investimet e tyre. Plani i Kontributeve të imagjinuara është një plan i kredituar individual i punëtorit, që përmban kontributet e kursyera plus interesi, të përfaqësuara nga Holzmann, Robert and Hinz, Richard (February 18, 2005)²²

Literatura e përdorur është përzgjedhur për studimin sa më adekuat të temës, e cila është përqëndruar në teoritë bazë të sistemeve pensionale, teoritë të ndërlidhura me ekonominë e tregut të lirë²³ dhe njohuritë mbi respektimin e të drejtave themelore të njeriut²⁴.

Reformat e Sistemit Pensional²⁵ me autorët kryesorë Rotmans, Loorbach (2000), (2006) janë pjesë e reformave ekonomike, në veçanti janë pjesë e zhvillimit të konceptit "neoliberal" të zhvilluar nga Campbell dhe Pedersen (2001), që ka përfshirë shumë vende të Botës.²⁶ Andaj, teoritë e përzgjedhura me autorët kryesorë Sen (1985, 1992) dhe Sachs (2001), Layard (2005), të cilat i kemi përdorur gjatë studimit të fushës së pensioneve, konsideroj se janë me të rëndësishme dhe më të dobishme, për hulumtimin e problemit

tregun e punës dhe të plakjes), natyrën e financimit, kapacitetet financiare, kërkesat për pensione, trendet e rritjes apo të rënies së kontributeve të paguara në fondin pensional, qëndrueshmëria e sistemit pensional, etj.

²¹ OECD (Organisation for Economic Co-operation and Development). Pensions at a Glance, Public Policies across OECD Countries (2005 Edition).

²² Old-Age Income Support in the Twenty-first Century: An International Perspective on Pension Systems and Reform. The World Bank.

²³ Teoritë të cilat i plotësojnë nevojat e konsumatorëve duke u bazuar në doktrinën "Laissez faire", e cila preferon shkëmbimin e lirë të mallrave dhe të realizimit të fitimeve.

²⁴ "Karta Universale mbi të drejtat dhe liritë e njeriut"- Respektimi i parimit të mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, është bazë e të gjitha të drejtave dhe liritë themelore të njeriut, i cili e garanton të drejtën e secilit individ për jetë.

²⁵ Ndër teoritë e rëndësishme në studimin e reformës së sistemit pensional ka zënë vend Teoria e Tranzicionit.

²⁶ Fillimisht këto reforma kishin gjetur terren të përshtatshëm për zbatim në Chile dhe në Britani (1970 dhe 1980).

të studiuar (në Mbretërinë e Bashkuar, të cilat kanë dhënë kontribut në këtë fushë si Blake dhe Board (2000) si dhe Thomas dhe Tonks (2001), të cilat fokusohen në funksionimin e skemave pensionale në Botë²⁷.

3.4.3. Teoritë mbi qeverisjen

Shumë studime janë marrur me matjen e efikasitetit të qeverisjes së Fondeve Pensionale²⁸, në veçanti mbi qeverisjen korporative, e cila ka tërhequr vëmendjen e shumë teoricienëve si James Buchanan (fituesi i çmimit Nobel 1986) të sistemeve pensionale, fokusi i të cilëve ka qenë ngritja besueshmërisë dhe të kualitetit të qeverisjes me skemat pensionale të zhvilluara nga Besley dhe Prat (2005), Carmichael dhe Palacios (2003), Ambachtsheer (2001) brenda sistemeve pensionale²⁹.

Teoritë më të shumta të zhvilluara nga Cicotello (1996), Droms dhe Walker (2001), Grinblatt dhe Titman (1994), Gallagher dhe Martin (2005), dhe Cheong (2007), të cilat e kanë studiuar matjen e efikasitetit të qeverisjes korporative, janë fokusuar në ndikimin e madhësisë së fondeve pensionale, sasië së portfoliove individuale të kontributorëve pensional, lartësisë së vlerës së aseteve investive, lartësisë së shpenzimeve, etj.³⁰ Teoritë mbi Qeverisjen korporative me autor Healey (1992), që nga mesi i viteve 1990 ishin fokusuar edhe në studimin e efikasitetit të qeverisjes korporative apo politikëbërse³¹, ndër studiuesit më të njohur ishin Eijffinger dhe Shi (2007), të cilët kanë dhënë kontribut në teoritë mbi qeverisjen e Sistemeve Pensionale, duke u përqëndruar më tepër në

²⁷ Teoritë mbi barazinë dhe të drejtat e njeriut (studimet mbi varfërinë dhe zhvillimin e pabarabartë) studiojnë sjelljet e njerëzve dhe aplikimi i tyre në shkencat sociale (mirëqenia, shëndeti dhe perspektiva e lumturisë). Janë përdorur edhe studimet e Fondeve Pensionale private në Mbretërinë e Bashkuar, këto studime ishin përqendruar në investimet dhe kapitalizimet e tyre, si dhe shpërndarjen e kontributeve pas zbritjes së taksave të menaxhimit (këto fonde kanë operuar në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë dhe kanë qenë të vetëqëndrueshme).

²⁸ Teoria mbi vendimmarrjen individuale për zgjedhjen e fondeve publike mbi bazë të konceptit të përmbajtjes politike, argumenton se këto fonde janë efikase dhe se qeveritë janë rregullatorët të cilët i përcaktojnë rregullat mbi funksionimin e fondeve pensionale, duke iu mundësuar njerëzve për të marrë atë që ata duan.

²⁹ Qeverisja korporative si përcaktues të rëndësishëm të efikasitetit dhe të qëndrueshmërisë së fondeve të pensioneve.

³⁰ Keta teoricienë i kanë studiuar marrëdhëniet në mes të madhësisë së fondeve pensionale dhe të efikasitetit të qeverisjes. Teoricienët të cilët janë marrur me matjen e efikasitetit të qeverisjes korporative në kushtet e rrezikut të portfolios individuale në raport me madhësinë e fondeve pensionale. ndërsa teoricienët kontradiktor të kësaj çështje ishin; Malhotra dhe McLeod (2000).

³¹ Teoritë mbi qeverisjen institucionale (analiza mbi pjesëmarrjen e palëve të interesuara).

teoritë mbi krizën e Sistemeve Pensionale në Bashkimin Evropian (sukesein e qeverisjen e ndërlidhin me kualitetin e përdorimit të rregullatorëve ligjorë).³²

Ndër teoriticiet më të njohur të politikave ekonomike ishin edhe Grindle dhe Tomas (1991), Nelson (1990 dhe Roderik (1994), Tommasi dhe Velasco (1995), të cilët kanë bërë punë të konsiderueshme në propozimin e disajnit të politikave ekonomike të reformës makroekonomike dhe të politikave tregtare, duke përmbledhur faktorët më problematik të cilët mund të lëndojnë sistemet pensionale, siç janë: informimi, preferencat, besueshmëria, varshmëria e interesave grupore, pengesat të tjera të reformës, etj.

3.4.4. Teoritë mbi etikën dhe efikasitetin financiar

Teoriticiet Clark dhe Urwin (2007) OECD (2007) studiojnë edhe rolin e etikës financiare në qeverisjen e Fondeve Pensionale, të bazuar në standardet e pranueshme etike, që lidhen me besimin ndaj organit qeverisës dhe gjatë vendimmarrjes.³³

Teoriticiet e kanë studiuar edhe statusin e personave të besueshëm “trustee”, të cilët kryesisht emërohen për qeverisjen e fondeve pensionale (është e nevojshme të përkufizohen atributet e një personi “trustee” i cili me sjelljen e vet etike krijon besim te palët që i përfaqëson).

Gjithashtu teoriticiet i kanë kushtuar rëndësi të veçantë studimit të rregulloreve respektive, të cilat i japin politikëbërësve kompetenca për zhvillimin e politikave të fondeve pensionale. Lidhur me studimin e sjelljes etike të personave të besueshëm, të cilët qeverisin me fondet pensionale (duke përdorur njohuritë profesionale në mënyrë etike) është marrë teoritici Gifford (2004). Ai i ka kushtuar rëndësi të veçantë *teorisë së qeverisjes dhe menaxhimit të fondeve pensionale, duke vënë theksin në minimizimin e kostove, në raport me rreziqet brenda pragjeve të përcaktuara që më parë* (përpilimi i

³² Keta teoriticiet sugjerojnë se qeverisja korporative efikase bazohet në; ligjet mbi pensionet, licencimin, qeverisjen, kufizimet e mjeteve, dhënien e informacioneve shpjeguese informacioneve financiare dhe garancive.

³³ Marrja e vendimeve mbi optimale komprometon operimet financiare.

politikave mbi funksionimin e fondeve pensionale; administrimin, investimet, marketingun, etj.) *me qëllim të përmirësimit të efikasitetit.*

Sipas teoriticintëve Dulebohn (1995), Stanko (2002), Cinca, Mal Morinero dhe Garcia 2002; Barros dhe Garcia (2006), Bikker dhe Dreu (2009), OECD (2009), sjellja etike në fushën e pensioneve, kontribuon në *teorinë mbi maksimizimin e mirëqenies së përfituesit përmes përmirësimit të vazhdueshëm të qeverisjes dhe të performancës më të mirë të investimeve, e cila ndikon në rritjen e efikasitetit të investimeve*³⁴.

Lidhur me *etikën financiare mbi investimet financiare në tregun e kapitalit financiar*, kontribut kanë dhënë Black dhe Scholes (1970) dhe Miller dhe Modigliani (1985), të cilët e kishin zhvilluar *teorinë e etikës mbi financat moderne* në veprën "Teorema", ndërsa Robert W. Kolb (1994) e kishte zhvilluar *teorinë e sjelljeve racionale si pjesë e etikës financiare* në veprën e vet "Implikimet etike të Financave", kurse Horrigan (1987, 1997) ishte përqëndruar në *idetë teorike mbi vendimmarrjen etike në kushtet e financës moderne, të bazuara në parimet morale*. Edhe teoriticianti Niall Ferguson (2008)³⁵ kishte dhënë kontribut në *teoritë e etikës financiare lidhur me kolateralin e letrave me vlerë dhe derivateve të shkatërruara gjatë krizës së fundit financiare të vitit 2008*.

3.4.5. Teoritë mbi përgjegjësitë fiduciare në qeverisjen korporative

Lidhur me përkufizimin e përgjegjësisë fiduciare, mënyrës së funksionimit të saj, mënyrës së kompletimit të rregullimit normativ si dhe mënyrës së përdorimit të saj, janë dhënë shumë mendime nga ana e teoriticientëve të ndryshëm Botëror. Këto teori kanë buruar kryesisht nga nevoja për të rregulluar autoritetin e përgjegjësisë të personat dhe institucionet përfaqësuese, cilët kanë përfaqësuar interesat e personave apo institucioneve që iu ka munguar aftësia profesionale për të realizuar interesat e veta më mirë (në mënyrë më profesionale).

³⁴ Studimet mbi performancën qeverisëse të fondeve pensionale, vlerësimit të rezultateve për efikasitetin e qeverisjes, janë bërë përmes metodës së analizës së raporteve financiare, si dhe përmes metodës së krahasimit të treguesve të tregut. Gjatë krizës financiare të vitit 2008 është vërejtur, se sa ishte e rëndësishme sjellja etike e kompanisë Lehman Brothers.

³⁵ Niall Ferguson (2008) e kishte shpikur termin "Planeti i Financave".

Lidhur me përgjegjësitë e personave të besuar dhe të qeverisjes korporative, kanë dhënë kontribut me teoritë e veta Sir Adrian Cadbury (Raporti Cadbury, 1992,UK) si dhe James Wolfensohn, ish president i Bankes Botërore. Teoritë e marrëdhënieve qeverisëse (parimeve të Qeverisjes Korporative të OECD-së), transparencës dhe përgjegjësisë i ofrojnë mundësitë për t'i arritur caqet të cilat janë në interes të fondit pensional, të cilat ofrojnë një qeverisje efektive rreth përdorimit më efikas të burimeve financiare.

Përgjegjësia fiduciare përcakton mënyrën e përfaqësimit: (1) të palës së përfaqësuar, (2) të qeverisjes dhe të kontrollit të pasurisë së palës së përfaqësuar.

Pra, teoritë mbi përgjegjësinë fiduciare janë bazuar në potencialin e pasurive për mbështetje, përfaqësim dhe kryerje të detyrave në interes të palëve të përfaqësuar me ndershmëri, maturi, zell e përkushtim (në mirëbesim). *Teoria kritike mbi kryerjen e detyrave me përgjegjësi fiduciare*, ka për qëllim për të shmangur kurthet që lidhen me konceptin ligjor që rregullon të drejtën mbi qeverisjen me pronën dhe përfaqësimin personal të drejtës pronësore, të prekshme ose të paprekshme e cila do të qeveriset në mirëbesim. Përshkrimi i të drejtës së përfaqësimit në “Teorinë e të drejtave pronësore” është bërë nga disa teoritikë; Ronald Dworkin, Kenneth I. Winston, Benjamin Klein, Keith B. Leffler, Peter Westen, Sanford Grossman (1986), Oliver Hart dhe John Moore (1988,1990), Robert Cooter, Bradley J. Freedman, Daniel Friedmann, D. Gordon Smith etj., të cilët i ilustrojnë njohuritë e tyre themelore të teorive mbi të drejtat pronësore dhe rregullimin e rolit të detyrës fiduciare.³⁶

3.4.6. Teoritë mbi transparencën financiare

Deri më tani janë dhënë shumë teori rreth transparencës dhe matjes së transparencës si dhe të faktorëve që e kushtëzojnë atë. Teoritikët më të njohur të cilët e kanë studjuar këtë fenomen janë: Bernanke & Mishkin (1997); Bini, Smaghi dhe Gros (2001); Fracasso,

³⁶ Oliver Hart, Firms, Contracts, and Financial Structure 23 (1995) (hereinafter “Hart, Firms”); Sanford J. Grossman & Oliver D. Hart, *The Costs and Benefits of Ownership: A Theory of Vertical and Lateral Integration*, 94 J. Pol. Econ. 691, 692 (1986); Oliver Hart & John Moore, *Property Rights and the Nature of the Firm*, 98 J. Pol. Econ. 1119 (1990) (hereinafter “Hart & Moore, Property Rights”); Oliver Hart & John Moore, *Incomplete Contracts and Renegotiation*, 56 Econometrica 755 (1988).

Genberg dhe Wyplosz (2003); Fry, Julius, Mahadeva, Roger dhe Sterne (2000); Geraats (2002), ndërsa mendime rreth transparencës dhe kompleksitetit të saj, kanë dhënë edhe Lamming (2004), Morris dhe Shin (1997), Winkler (2000)³⁷, të cilët janë përqendruar në fenomenin e krizave financiare nën këndvështrimin e problemeve të asimetrisë së informacionit, të cilat kishin reprodukuar çrregullime në tregjet financiare (përkeqësim i një sërë treguesish financiarë). Mirëpo këto teori nuk kanë arritur që të bëjnë dallimin në mes të masave të pavarura të veprimeve financiare dhe të transparencës. Gjithashtu Ackoff (1989) është shërbyer me proceset interpolative dhe probabile të komunikimit, ndërsa Habermas (1998) është kufizuar në matjen e transparencës duke përdorur; kontabilitetin, komunikimin masiv, studimin e kuptueshëm të çështjeve tematike, shprehjen e ideve, si dhe duke pasqyruar gjendjet nga studimet apo raportet, analizat e aktiviteteteve të monitoruara dhe përfaqësimet, etj.

3.4.7. Teoritë mbi natyrën e planeve të kontributeve pensionale

Teoritë të cilat janë zhvilluar rreth Planeve Pensionale, kanë për qëllim thjeshtësimin e formulave, të cilat korrespondojnë me specifikimin e kontributeve individuale. Lidhur me këtë, kanë dhënë kontribut shumë teoriticien si; Richard K. Kischuk dhe Mr. Harry Sarason (1997), në diskutimin e tyre me titull "The Dynamics of Pension Funding." Kurse Drs. Bowers, Hickman dhe Nesbitt kanë përdorur modelet matematikore për të analizuar rrjedhën e Planeve Pensionale.

Ndërsa John E. Pennisten dhe I. R. dative kanë zhvilluar teoritë e tyre mbi përdorimin e metodave mbi Planet Pensionale gjatë gjenerimit të planeve pensionale, në diskutimin me titull "*Levels of Contributions under Different Funding Methods*". Mr. Pennisten ka bërë studime të vazhdueshme, duke bërë modifikimet e nevojshme me qëllim të sqarimit të

³⁷ Teoriticienët e njohur mbi transparencën financiare; Bernanke & Mishkin (1997); Bini-Smaghi & Gros (2001); Fracasso, Genberg, & Wyplosz (2003); Fry, Julius, Mahadeva, Roger, & Sterne (2000); Geraats (2002).

diferencës së kontributeve, kthimeve dhe kostos deri në periudhën e maturimit të plotë të pensioneve. Më tutje vërejtjet e Mr. Pennisten's ishin përqendruar në kërkesat e pensionistëve, në relacion me kontributet e popullatës aktive në punë.

Gjatë studimeve të planeve pensionale janë përdorur "*Teoritë e modeleve ekonomike*" dhe të "*Teoritë e modeleve pensionale*" nga Cui, de Jong, dhe Ujoré (2005) dhe Cui, de Jong (2006).

Grupi i teoritientëve nga Newton L. Bowers, JR., James C. Hickman, and Cecil J. Nesbitt e Mr. Trowbridge janë përqendruar në '*Teoritë për modelimin Planeve pensione në ambinetin dinamik të pensioneve*', kështu që këtë teori me tutje e kishte zhvilluar Cecil J. Nesbitt në diskutimin e tij me titull, "*Exploration of Pension Funding in Case of Exact Vesting*," (1978), ndërsa Mr. Trowbridge teoritë e modelimit i kishte studiuar përmes "*actuarial mathematics*" duke përdorur formulat matematikore me qëllim që të sqaroj shkallën e probabilitetit të zhvillimit të planeve pensionale.

Në literaturën ekonomike janë studiuar dobite dhe rreziqet e Planeve Pensionale përmes teorive të zhvilluara nga; Cui (2005), Doskeland dhe Nordahl (2008) dhe Teulings dhe de Vries (2006)³⁸, të cilët argumentojnë mirë rolin e *Teorisë së Dobive të Pritshme* të zhvilluar nga Tversky dhe Kahneman (1979, 1992), Cui, J, F de Jong dhe E. Ponds (2005), duke përdorur teoritë relative të probabilitetit aktual, i cili korrespondon me rezultatet e pritshme të pensionistëve të cilat përputhen në mnyrë sa më të saktë me preferencat individuale,³⁹ më tutje këtë teori e kishin zhvilluar Von Neumann dhe Morgenstern (1953).

3.4.8. Teoritë mbi punësimin

Teoritë më të njohura mbi punësimin grupohen në dy grupe të mëdha, siç janë;

Në grupin e parë bëjnë pjesë; *Teoritë neoliberales mbi punësimin* dhe

³⁸ Teorite e zhvilluara mbi Planet pensionale.

³⁹ The value of intergenerational transfers within funded pension schemes. (Netspar).

Në grupin e dytë bëjnë pjesë *Teoritë Neokeynsiane mbi punësimin*.

Teoritë neoliberales mbi punësimin, të prira nga Robert Lukas i Universitetit të Çikagos (Lucas and Tomas, 1981) e kishte përdorur modelin teorik mbi punësimin, të mbështetur në “Teorinë e ekuilibrit të pritjeve racionale në makroekonomi”. Modeli i teorive neoliberales përbehet nga dy tipare kyçe;

Roli i pritjeve racionale mbështetet në planifikimin e parashikimeve të cilat i përdorin të gjitha informacionet në dispozicion, si dhe ato të mundshme, për të bërë parashikime sa më reale.

Gjithashtu ky model i teorive përqëndrohet në teorinë e ekuilibrit, të bazuar në potencialet e punësimit dhe të nevojave për punë.

Teoria e ekuilibrit është huazuar nga modeli neoklasik, ku variablat e punësimit janë të luhatshme, si rezultat i tregut të punës dhe të punësimit. Modeli bazë i teorisë së ekuilibrit të pritjeve, i nënshtrohet informacioneve mbi zhvillimet e tregut të punës dhe rishikimet mbi luhatjet e mundshme të parashikimeve të tyre. Si rrjedhojë, teoria e ekuilibrit të pritjeve racionale e empirike është bërë pjesë e rëndësishme e sistemit makroekonomik, në veçanti e punësimit.

*Teoria Neokeynsiane*⁴⁰ e punësimit është e prirë nga Modigliani, James Buchanan, George Mason James (1986), Baker (1992) etj.

Këto teori ndryshe quhen “*Teoritë e kontraktimit*”, që janë të lidhura me sistemin makroekonomik. *Teoria e kontraktimit* fillon nga Tregu i Punës dhe modeli neoklasik i ndërhyrjes së dorës së shtetit në ekonomi. Kjo teori pohon se pagat fiksohen nga kontratat në fillim të një periudhe, ndërsa çmimet e të mirave materiale mund të ndryshohen brenda një periudhe.

Kështu që kjo teori i ngre efektet e ndryshimit të përkohshëm të një variable, e cila është përcaktuar që më parë me kontratë, si rrjedhojë del se, kur njëra variabël rritet në mënyrë të paparashikuar, atëherë punësimi është i rregulluar me kontratë.

⁴⁰ Mark Skousen “Dissent on Keynes” (1992)

3.4.9. Teoritë mbi qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar

Teoritë mbi qëndrueshmërinë e sistemeve ekonomike dhe shoqërore, bazohen kryesisht në fuqinë apo aftësinë e subjekteve ekonomike, ashtu që në mënyrë të pavarur të sigurojnë të hyra për stabilitet dhe mbijetesë. Lidhur me studimin e qëndrueshmërisë së sistemeve financiare janë dhënë shumë ide e teori, të cilat përdoren gjatë perpilimit të politikave financiare, sepse ato kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në funksionimin efikas të sistemeve financiare, e në veçanti edhe të Sistemit Pensionale. Kështu që lidhur me këtë, janë dhënë mendime të ndryshme nga teoriticienët; Estelle James nga “Banka Botërore” dhe Sarah Brooks nga “Universiteti Duke” në SHBA, në studimin me titull “The Political Economy of Structural Pension Reform” të botuar në “Course on Pension Reform 2nd Generation and Implementation Issues” Volume II, 2002 Warsaw, Poland, të botuar nga “World Bank Institute”, ku shprehen se *“Shumë politika që janë të dëshirueshme nuk kanë arsye të implementohen. Kjo diskrapancë në mes të ekonomisë dhe politikës, udhëhiqet së bashku nga ekonomistët dhe shkencëtarët e politikave, të cilët kanë filluar të mendojnë për reformën e Sistemit Pensional. Autorët e këtyre teorive, gjithashtu kanë bërë punë të konsiderueshme në politikat ekonomike të reformës makroekonomike dhe të politikave tregtare, duke përmbledhur faktorët e tillë, siç janë: informacioni jo i plotë, koha mospërputhjes së preferencave, problemi i besueshmërisë, mënyra e varshmërisë dhe interesat grupore, si pengesat më të mëdha të reformës. Këtë teori e kanë zhvilluar Grindle dhe Tomas (1991), Nelson (1990, 1994), Roderik (1994), Tommasi dhe Velasco (1995). Këtu është bërë relativisht më pak punë në politikat ekonomike të reformës sektoriale për të cilat kishte dhënë kontribut Nelson (1997), Estelle James (1986, 1993, 1989)”⁴¹.*

Gjatë këtij studimi janë shfrytëzuar edhe njohuritë e teoriticienëve të ndryshëm mbi qëndrueshmërinë e Sistemeve Ekonomike, siç janë: *Teoritë mbi pasqyrat e bilancit nëpërmjet të Vlerave Neto Pozitive të huamarrësve* nga Bernanke dhe Gertler (1990), që e

⁴¹ Estelle James nga Banka Botërore & Sarah Brooks nga Duke University, “The Political Economy of Structural Pension Reform” published in “Course on Pension Reform 2nd Generation & Implementation Issues” Volume II, 2002 Warsaw, Poland, by World Bank Institute.

kishte definuar ndjeshmërinë financiare, si një situatë në të cilën potenciali i huamarrësve ndikon në shëndetshmërinë e sistemeve ekonomike.⁴²

Ndërsa *Crockett* (1997) e kishte definuar jostabilitetin financiar (në të cilin performanca ekonomike) dëmtohet kryesisht nga fluktuacioni i çmimeve të pasurive financiare, apo nga aftësia e ndërmjetësuesve financiar, për të përmbushur obligimet e tyre kontraktuale.

Mishkini (1999) duke u fokusuar në rolin e informatave asimetrike, e kishte pasqyruar ndikimin e tyre në jostabilitetin financiar, si një shpërprerje të efijencies së sistemit financiar të fondit të alokimeve, përmes mënyrave të zgjedhura të përkeqësimit negativ dhe rrezikut moral.

Më tutje Bernanke dhe Gertler (2000) e kishin definuar jostabilitetin financiar si një sinonim, me të cilin paqëndrueshmëria e çmimit të pasurive, përcaktohet në bazë të tendencës për të arritur çmimin më të lartë nga niveli i tij fundamental, përmes “dhunës në formë aksidentale” apo ndonje lëvizjeje të papritshme.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (2003) në një mënyrë tjetër fokusohet në mënyrat e ndryshme të ndërhyrjeve në sistemin financiar, duke u fokusuar në periudhat e paqëndrueshmërisë financiare, që do të jenë periudha të rënda të ndërprerjeve të suksesit në tregun financiar, përmes ndërhyrjes dhe përmirësimit të transferimit të rrezikut dhe të alokimit të likudimit të kredive në periudhat më premtuese, apo duke bërë reduktimin e aktiviteteve reale.

Ferguson (2003) në një mënyrë tjetër e bën definimin e paqëndrueshmërisë financiare, si një situatë e cila karakterizohet nga kriteret themelore.⁴³

Tabela e përmbledhjes së teorive mbi qëndrueshmërinë e sistemeve ekonomiko-shoqërore.

⁴² Situatat e tilla shkaktojnë shpenzime të larta dhe e dëmtojnë performancën e investimeve.

⁴³ BOT Symposium 2004- Monetary Policy and Financial Stability: Finding the Right Balance under Inflation Targeting* Thammarak Moenjok, Warangkana Imudom, Siripim Vimolchalao, Monetary Policy Group, September 2004, Thailand.

Qasja në fenomenet ekonomiko-shoqërore	Autorët	Koha
Equity and Human Rights (e.g. poverty studies and unequal development)	Sen (1985, 1992), Sachs (2001)	Since mid-1980s
Capital Stock (e.g. Social Capital, Environmental capital equity and cities' footprint)	Coleman (1988), Putnam (1993), Rees and Wackernagel (1996)	Since late 1980s
Institutional Theory and Governance (e.g. participation and stakeholder analysis)	Chambers (1992) Healey (1992)	Since early 1990s
Business and Corporate studies (e.g. Triple Bottom Line, Corporate Social Responsibility)	Elkington (1994)	Since mid-1990s
Behavioural and Social Sciences (Well-being, health and happiness perspective)	Layard (2005)	Since late 1990s
Transition Theory	Rotmans, Loorbach <i>et al.</i> (2006)	2000s

Tabela Nr. 1. Hulumtimi teorik qasjet për qëndrueshmërinë sociale⁴⁴

3.4.10. Teoritë mbi stabilitetin financiar

Një nga teoriticienët e teorisë së stabilitetit financiar është *Crockett (1997)*, i cili e kishte definuar jostabilitetin financiar, duke e studiuar ndërtimin e strukturës së performances ekonomike. Ai kryesisht e shpjegon teorinë e stabilitetit financiar duke u bazuar në ndikimet të cilat mund të kenë fluktuacione të çmimeve të pasurive financiare apo nga aftësia e ndërmjetësuesve financiar për të përmbushur obligimet e tyre kontraktuale.

Gjithashtu edhe *Mishkini (1999)* duke u fokusuar në rolin e informatave asimetrike e kishte definuar teorinë e tij mbi stabilitetin financiar. Ai e shpjegon stabilitetin financiar si një përputhje të efijencës së sistemit financiar të fondit financiar gjatë alokimeve financiare, përmes mënyrave të zgjedhura të përmirësimit të rrjedhave pozitive, në raport me rrezikun moral.

Lidhur me teoritë e stabilitetit financiar kishin dhënë mendim *Bernanke dhe Gertler (2000)*, duke e definuar stabilitetin financiar, si një sinonim me të cilin ndërtohet

⁴⁴ Dr Andrea Colantonio and Prof. Tim Dixon. Urban social sustainability: North - South perspectives. Oxford Institute for Sustainable Development (OISD). UN-Habitat 4th World Urban Forum, 3-6 November 2008, Nanjing, China

qëndrueshmëria e çmimeve të pasurive, nën kushte normale të funksionimit të tregut si dhe nën kushtet e ndonjë përmbysjeje të papritshme.

Me problematikën e stabilitetit financiar është marrë edhe *Fondi Monetar Ndërkombëtar (2003)*, i cili në një mënyrë fokusohet në *tipet e ndryshme të ndërhyrjeve në sistemin financiar, duke u marrë me periudhat e paqëndrueshmërisë financiare që do të jenë periudha të ndërprerjeve të rënda të tregut financiar, sepse aftësitë e sistemit ofrojnë shërbime të pagesave sipas çmimeve të transferimit të rrezikut dhe të alokimit të likudimit të kredive i cili tregohet se është i pa aftë dhe për pasojë qon në një reduktim të aktivitetit real.*

3.4.11. Teoritë mbi strategjitë e investimeve dhe të efikasitetit financiar

Teoritë mbi strategjitë e investimeve nga autorë të ndryshëm Asebedo dhe Grable (2004), Markese (2000), Stanko (2002) nga OECD (2009)⁴⁵, theksojnë se Fondet Pensionale duhet t'i përmbahen parimeve (Stanko, 2002) të shkruara në formë të një manuali të qartë mbi investimet e Fondeve Pensionale (Asebedo dhe Grable, 2004).⁴⁶

Janë zhvilluar teori të ndryshme mbi konceptet e investimeve (*koncepti konzervativ dhe koncepti profitabil*), teknikat e investimeve (*respektivisht të diversifikimit të investimeve*)⁴⁷, ndër më autorët më të njohur është *Markese (2000)*, i cili ka shpjeguar se Fondet Pensionale që *investojnë në shumë klasë të kapitalit financiar, dhe në derivatet e tyre*, kryejnë investime më të sigurta dhe më profitabile.

Teorenticenti financiar *Hebb (2006)* angazhohet për të dhënë kontribut në minimizimin e rrezikut, përmes ndërtimit të strategjisë së shmangies së investimeve afatgjate.

⁴⁵ Kanë të bëjnë me strategjinë e investimeve në tregjet e kapitalit financiar, që një investitor bën në portofolin e investimeve.

⁴⁶ Norma e kthimeve nga investimet e fondeve pensionale, janë të varura nga menaxhimi aktiv i portofoleve të investimeve.

⁴⁷ Shpjegohet rëndësia e diversifikimit të investimeve, të cilat çojnë në përfitimet e kthimeve mesatare nga investimet, duke minimizuar humbjet gjatë periudhave të investimeve në tregun e kapitalit financiar.

3.4.12. Teoritë mbi menaxhimin e rrezikut

Keto teori mirren me menaxhimin e rriskut financiar të Fondet Pensionale, te cilat fokusohen në një qasje proaktive ndaj humbjeve, të cilat janë trajtuar nga; *Thompson (2008), Odundo (2008). Brunner, Hinz dhe Rocha (2008).*

Sipas teorisë së Davis (2000) mbi menaxhimin e rrezikut financiar, *përqëndrohet në studimin e fondeve pensionale me fokus në sigurimin e menaxhimit të duhur të rrezikut, për të siguruar pensione të garantuara për përfituesit e pensioneve.* Për ta bërë këtë, fondet pensionale duhet të zhvillojnë politika të duhura të menaxhimit të rrezikut, të cilat mbrojnë normën e zëvendësimit, sigurinë e investimeve dhe rreziqet e bazuara në kohë të tilla (inflacioni).

Sipas Galer (2009), menaxhimi i rrezikut te fondet pensionale duhet të lidhet direkt me objektivat e portofolios dhe duhet të mbajë një ekuilibër mes aktiveve dhe të detyrimeve në kuadrin e financimit, imunizimit dhe përdorimit të letrave me vlerë, si dhe te derivateve financiare.

3.5. Përmbledhja teorike për të argumentuar tezën

Ndërlidhmëria e teorisë me problematikën e Sistemeve Pensionale, gërsheton; *njohuritë nga teoritë themelore mbi Sistemet Pensionale dhe zhvillimin praktik të skemave pensionale, qëndrueshmërinë e tyre apo ndjeshmërinë e funksionimit të tyre, procesin e evoluimit, adaptimet e nevojshme të kornizës rregullative, kompleksitetin dhe sofistikimin e sistemeve pensionale, etj.*

Literatura e përdorur permban teoritë bazë të studimit, të cilat kanë përmbledhur një bashkësi hipotezash dhe konceptesh, përmes të cilave synojnë të shpjegojnë dukuritë që lidhen me fushën e pensioneve, duke specifikuar çartë raportin ndërmjet çështjeve konceptuale. Përmes literaturës së përdorur është arritur qëllimi përfundimtar i studimit, i cili është mbështetur në teoritë respektive të fushës së pensioneve, duke filluar nga; *shkaqet, gjeneza e tyre, evoluimi, gjendja aktuale, trendet dhe parashikimet.* Në literaturën e përdorur janë shfrytëzuar teoritë të cilat kanë shjerguar ose përshkruar zhvillimet në fushën e sistemeve pensionale ndërkombëtare, në njësitë e këtij sistemi, në proceset dhe në strukturën e tij. Kështu që teoritë e studiara dhe të përdorura në studim, kanë ndihmuar për të ndërtuar një mendim logjik dhe racional. Pra, përdorimi i këtyre

teorive në studim kanë pasur karakter reflektiv, duke mundësuar realizmin i tyre praktik, në studimin e tezës së studiuar.⁴⁸

⁴⁸ Shumica e vende anetare te OECD-së, me ekonomitë e tyre të organizuara sipas konceptit të tregut të lirë dhe të vendeve në zhvillim ishin përballuar me vështirësi financiare rreth shpagimit të pensioneve, keshtu qe ishin detyruar të bëjnë reforma të sistemit pensional, me qellim të përballimit të gjendjes financiare.

4. KAPITULLI IV: KONTEKSTI HISTORIK

4.1.Procesi i tranzicionit ekonomik në Kosovë

Kosova ishte pjesë përbërëse e Federatës Jugosllave deri në vitin 1999. Në vitin 1999 Kosova ishte çliruar nga okupimi i pushtetit serb dhe nga kjo kohë kishte filluar një epokë e re për Kosovën dhe qytetarët e saj. Pas luftës së lavdishme të UÇK-së në vitin 1999 dhe pas intervenimit të forcave ushtarake të Aleancës Veri-Atlantike të NATO-s ndaj forcave serbe, në Kosovë ishte vendosuar administrimi i përkohëshëm nga ana e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (misioni i veçantë UNMIK). Administrata e UNMIK-ut kishte në kompetencë për të qeverisur me të gjitha resoret e sistemit; politik, ekonomik e shoqëror. Kështu që UNMIK-u gjatë periudhës së qeverisjes me sistemin ekonomik në Kosovë, kishte filluar Reformimin e Sistemit Ekonomik e Social, duke përfshirë institucionet relevante shoqërore- ekonomike (si alternativë e mirëfilltë për zhvillim ekonomik dhe përkujdesje sociale), të përcjellura me infrastrukturë ligjore dhe mekanizma tjerë implementues⁴⁹. Pra, kishte ndryshuar koncepti thelbësor i sistemit ekonomik, ishte braktisur koncepti i socializmit vetëqeverisës dhe ishte aplikuar koncepti i organizimit të ekonomisë së tregut të lirë.

Reformimi i sistemit ekonomik ishte fokusuar në: 1) Implementimin e konceptit të liberalizimit të tregut⁵⁰, 2) Zhvillimin e konceptit të ndërmarrësisë, 3) Privatizimin e pronës shoqërore dhe publike, 4) Sundimin e ligjit, 5) Vendosjen e drejtësisë sociale, 6) Integrimin në trendet e globale të ekonomisë, etj.

Si rezultat i transformimeve të mëdha që kishin ndodhur në sistemin ekonomik të Kosovës nga ristrukturimi dhe derregullimi i ekonomisë, ishin grumbulluar shumë probleme të cilat kërkonin zgjidhje urgjente dhe të vazhdueshme.

⁴⁹ Kishte filluar ndryshimin e konfiguracionit të ambientit ekonomik dhe të marrëdhënieve ekonomike rajonale dhe ndërkombëtare.

⁵⁰ Kosova ishte orientuar për ndërtimin e sistemit të ri ekonomik, sipas kërkesave për liberalizim ekonomik të tregut, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për integrimin e ekonomisë, stimulimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e investimeve të përbashkëta me partnerët e jashtëm.

Andaj, bartësit e zhvillimit të procesit të reformës ekonomike në Kosovë gjatë procesit të tranzicionit, kishin përcaktuar disa objektiva: 1) Ndërtimin e sistemit të ri ekonomik, 2) Rimëkëmbjen ekonomike, 3) Zhvillimin e procesit të privatizimit dhe të transformimit të pronës shoqërore dhe publike, 4) Integrimin rajonal, 5) Rregullimin e inxhinieringut të sistemit social, 6) Vendosjen e asistencës teknike, etj.

4.1.1. Sistemi i ri ekonomik

Koncepti i sistemit të ri ekonomik kishte për qëllim braktisjen definitive të konceptit të sistemit të socializmit vetëqeverisës dhe implementimin e konceptit të ekonomisë së tregut të lirë⁵¹, gjë që kishte parashtruar nevojën për adaptim sa më efikas të ekonomisë së vendit, në funksion të lirisë së operimeve në treg.

Koncepti i sistemit të ri ekonomik në Kosovë, kishte për synim promovimin e funksionimit të tregut të lirë dhe të demokracisë politike. Liberalizimi i tregut shihej si faktor rregullues dhe krijues i mundësive për të zhvilluar konceptin e vetëqëndrueshmërisë ekonomike, ku operatorët ekonomik mund të hyjnë lirshëm në treg nën kushtet e konkurrencës së lirë dhe shpërblehen sipas veprimeve të tregut.

Ndërsa demokracia ishte kuptuar si një mekanizëm i dobishëm, për ndërtimin e një sistemi më të përshtatshëm, i cili do të mbronte në mënyrë efikase të drejtat natyrale të njeriut, gjegjësisht liritë e njerëzve dhe do t'i parandalonte abuzimet në politikë, shoqëri dhe ekonomi.

Promovimi i lirisë nga Milton Friedman (1962)⁵² ekonomike dhe politike, ishte kuptuar si një koncept nxitës i të gjithë organizimave në jetën ekonomike, politike e shoqërore për të krijuar vlera materiale, shpirtërore, me qëllim të rritjes së dobisë shoqërore.

⁵¹ Derisa liria nënkuptonte mundësinë e veprimit të çdo kujt, që të përcaktohet për një zgjidhje pa e penguar dikend tjetër, atëherë ajo e obligon çdo pjesmarrës në shoqëri të respektojë të tjeret. Nga kjo rezulton se, demokracia kuptohet si një formë liberale e qeverisjes me popull, nga populli, për popullin, ashtu që të ndikohet në organizimin e shoqërisë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes përfaqësuesve, duke minimizuar rreziqet që vijnë nga dora e fortë e një individi apo grupi politik.

⁵² Milton Friedman "Kapitalizmi dhe Liria" është botuar për herë të parë, në vitin 1962

Ndërtimi i sistemit të ri ekonomik kaloi nëpër fazën e tranzicionit në Kosovë i cili kishte filluar me vendosjen e parimeve themelore për garantimin e lirive njerëzore dhe të zhvillimit të demokracisë, duke u nisur nga: zhvillimi i iniciativës së lirë private, transformimi i procesit të arsimit, mënyra e informimit, si dhe aktivizimi i një numri organizmesh qeveritar dhe joqeveritar, etj.

Bazuar në përvojën e zhvillimit të tranzicionit në vendet ish socialiste, rezultoi se rezistenca ndaj ndryshimeve sistemore ishte inercion dhe paraqiste pengesë të madhe për ndryshime kualitative. Me këtë inercion ishte ballafaquar edhe Kosova, gjë që këto procese fillimisht pengoheshin fuqishëm nga ish të punësuarit në sistemin e RSFJ për të bërë ndryshime të nevojshme.

Këto pengesa shfaqeshin gjatë ndërtimit të sistemit të ri ekonomik, të cilat rezultojnë nga: rutina e krijuar nga sistemi i vjetër, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, struktura e pavolitshme ekonomike, pronësia e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, struktura e ndërmarrjeve të cilat kishin prapambetje tekniko-teknologjike (dëmtimi i infrastrukturës ekonomike), niveli i ulët i iniciativës private, lidhjet e dobëta biznesore me tregjet ndërkombëtare, tendenca për ripërtitjen e lidhjeve me tregjet tradicionale, problemet e shtuara sociale, etj.

Procesi i ristrukturimit përcillej me nevojën për derregullimin e ekonomisë sipas Milton Friedman (1977)⁵³, e cila do t' i përshtatej kushteve të tregut të lirë, në anën tjetër shteti përballej me nevojën për asistencë sociale, sepse shkalla e papunësisë ishte mbi 50%.

Vështirësitë ekonomike e sociale kërkonin përsheptimin e proceseve të tranzicionit. Kështu që prioritetet politike ishin orientuar në mbështetjen e ekonomisë familjare dhe të sforcimit të përpjekjeve për mbështetjen e NVM-ve nga komuniteti i biznesit privat, si faktorë për zhvillim, punësim dhe mbrojtje sociale, të cilët do të influencojnë shpejtimin procesit të tranzicionit dhe të normalizimit të jetës në Kosovë.

⁵³ “E vetmja mënyrë që është zbuluar deri më sot, për të pasur bashkëpunim në mes të njerëzve në mënyrë të vullnetshme, është përmes tregut të lirë”. Ky është vendi ku realizohet maksimalisht liria e njeriut.

Kosova kishte strukturë të pavolitshme ekonomike, e cila ishte e përqëndruar kryesisht në industrinë bazike dhe të energjetikës, me pjesëmarrje të vogël të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat ishin kryesisht pjesë e industrisë së lehtë dhe të bujqësisë.

Ndërsa si pasojë e ndërprerjes së ciklit të investimeve në ekonomi, gjatë periudhës 1990-1999 shumë ndërmarrje ishin dëmtuar fizikisht, si dhe ishin vjetëruar moralisht (prapambetja teknologjike)⁵⁴, ishte bërë riorientimi i tregjeve, ishte ndryshuar konjunktura e mallrave në treg, të cilat prodhoheshin në Kosovë (ishte bërë ndryshimi i kërkesave të tregut), gjë që këta faktorë e kishin vështirësuar procesin e ringjalljes, apo të ristrukturimit të ekonomisë ekzistuese.

Pra, në kushtet e tranzicionit në Kosovë, roli i shtetit ishte përqëndruar në rregullimin bashkëkohor makro-ekonomik⁵⁵, me qëllim që të sigurohet stabiliteti socio-ekonomik dhe ndërtimi i perspektivës zhvillimore⁵⁶.

4.1.2. Rimëkëmbja ekonomike apo rregullimi makro- ekonomik

Koncepti i rimëkëmbjes ekonomike ishte i orientuar në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, të cilat kishin për qëllim nxitjen e zhvillimit të prodhimtarisë vendore dhe hapjen ndaj ndikimeve të tregut të jashtëm, me tendencë se ato do të nxisin investimet e jashtme dhe transferin tekniko-teknologjik, si mundësi të valorizimit të potencialeve të brendshme, si dhe të integriteteve ndërkombëtare.

Qëllimet themelore të rregullimit makroekonomik në Kosovë ishin: *rimëkëmbja e zhvillimit ekonomik, konsolidimi i tregut në kushtet e tranzicionit, mbrojtja sociale, stabiliteti financiar, konsolidimi i buxhetit, stabiliteti fiskal, bilanci tregtar, bilanci i pagesave, etj.*

⁵⁴ Procesi i gjatë i përdorimit të teknikes dhe të teknologjisë në mënyrë neglizhente (përdorimi teknologjik dhe mirëmbajtja jo adekuate, amortizimi tejkalon investimet gjate periudhes 1990-99).

⁵⁵ Stabilizimi i valutës nacionale, kursi devizor, rregullimi i marrëdhënieve ekonomike me botën e jashtme, sendërtimi i politikës regjionale, sendërtimi i politikës agrare, asaj ekologjike dhe financat publike.

⁵⁶ Ndërtimi i tregut integral (tregu i mallrave dhe shërbimeve, tregu të punës dhe tregu financiar) dhe të institucioneve respektive.

Rregullimi i Sistemit ekonomik në Kosovë ishte përqendruar në mbështetjen e profileve të politikave, të modeleve, të cilat kishin ndikim në faktorët makro-ekonomik; *në shfrytëzimin dhe përpunimin e burimeve natyrore, punësim, eksport, konsumin e brendshëm, investime, etj.*

Gjithashtu ishte rregulluar ambienti i konkurrencës, shërbimit doganor, riorganizimi i sistemit fiskal, riorganizimi i infrastrukturës përcjellëse të operimeve tregtare, etj.

Instrumenet e përdorura për rimëkëmbjen ekonomike dhe rregullimin e sistemit makroekonomik ishin; politikat e liberalizimit, politikat monetare dhe kreditore, politikat buxhetore dhe fiskale, politikat e konkurrencës, politikat mbi privatizimin dhe transformimin e pronës si dhe politikat sociale.

4.1.2.1. Politika e liberalizimit të tregut

Politikat e liberalizimit të tregut, rezultojnë me liberalizim të çmimeve, të pagave, të cilat shfaqen përmes diferencave në përfitime, ndikojnë drejtëpërsedrejt në diferencimet e standardit jetësor dhe të statusit shoqëror. Me politikat e liberalizimit të tregut të brendshëm, krijohen pozitat konkurruese të operatorëve ekonomik në tregun e mallërave dhe të shërbimeve si dhe konkurrenca e të punësuarëve, në tregun e punës nëpërmjet faktorëve të tregut.

4.1.2.2. Politikat monetare dhe kreditore

Politikat monetare dhe kreditore përbëjnë boshtin kryesor për krijimin e stabilitetit makroekonomik në ekonominë e Kosovës. Synimi i politikave monetare ishte sforcimi i agregatëve monetar, përmes të cilëve ruhet stabiliteti monetar (ruhet ekuilibri në tregun e parasë)⁵⁷, si faktor kushtzues i konsolidimit të bilancit tregtar, të bilancit të pagesave

⁵⁷ Gjate periudhes së tranzicionit Kosova fillimisht e kishte përdorur valutën e Markës Gjermane (DM), ndërsa që nga viti 2000 e kishte adoptuar Euron si valutë, në vend të Markes Gjermane. Kosova gjatë periudhës së tranzicionit zbaton politikë të mbajtjes së kursit real të valutës Euro në përdorim dhe të rezervës devizore, me qëllim të ruajtjes së konvertibilitetit valutë.

dhe të servisimit të borxheve të jashtme, rregullimit të ecurisë së përgjithshme të çmimeve dhe të inflacionit.

Ndërsa politikat kreditore ishin në funksion të liberalizimit të kushteve kreditore nga ana e bankave komerciale, apo të ndërmjetësuesve financiar, të cilët kishin për synim mbështetjen e operatorëve ekonomik. Pra, politikat monetare dhe kreditore ishin nxitës dhe kushtëzues i zhvillimit të ekonomisë së tregut për të gjithë akterët ekonomik.

4.1.2.3. Politikat buxhetore dhe fiskale

Politikat buxhetore harmonizohen me politikat fiskale, për të krijuar parakushtet e volitshme për zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e stabilitetit social. Gjatë përpilimit të politikave buxhetore, kujdes i veçantë i kushtohej eliminimit të faktorëve të cilët kanë ndikime inflatore (financimi i deficitit buxhetor), ndikojnë në plotësimin e kërkesave, gjegjësisht nevojave strategjike të ekonomisë, popullsisë dhe të institucioneve shtetërore.

4.1.2.4. Politika e konkurrencës dhe ambientit të ri ekonomik

Krijimi i konkurrencës së brendshme dhe i ambientit të ri ekonomik, janë faktorë kushtëzues për nxitjen e zhvillimit ekonomik. Bazuar në strukturën ekzistuese të ekonomisë së Kosovës, si dhe në konsekuencat të cilat mund t'i bartë ajo, si rezultat i zhvillimit të konkurrencës së brendshme dhe të jashtme në tregun e Kosovës, janë përpiluar politikat e konkurrencës⁵⁸, të cilat kanë pasur ndikim në zhvillimin ekonomik, efikasitetin e tregut, mbrojtjen e tregut nga ndikimi monopolist i konkurrencës⁵⁹, mbrojtjen e konsumatorëve, etj.

⁵⁸ Konkurrenca në tregun e brendshëm të Kosovës nxitet nëpërmjet derregullimit të; monopoleve natyrore, pronës publike, fenomenit të bankrotit, kufizimeve buxhetore dhe financiare, etj.

⁵⁹ Rëndësi të veçantë kanë politikat të cilat ndikojnë në normativizimin e mundësisë së ndërhyrjes së pa lejueshme te agjentëve ekonomik në treg, përmes monopolit, kartelit, dumpingut, apo formave tjera të ndërhyrjes në treg.

4.1.2.5. Politikat mbi privatizimin dhe transformimin e pronës

Procesi i privatizimit (Robert Devlin, 1996)⁶⁰ ishte një sfidë e madhe për rimëkëmbjen e ekonomisë, sepse ishte proces i cili përcillej me shumë vështirësi, që kishte për synim rregullimin e; *statusit të pronës shoqërore dhe publike, mënyrës së qeverisjes së pronës para privatizimit, modelit të privatizimit, mënyrës së zhvillimit të procesit të privatizimit, procedurave të privatizimit, mbrojtjes nga tendencat e pushtetarëve për përvetësim dhe keqpërdorim të pronës në proces të privatizimit (privilegjimi i blerësve nga ana e strukturave burokratike), korrupsionit, etj.*

4.1.2.6. Politikat sociale

Reformat shoqërore dhe ekonomike në Kosovë, kishin marrë kahje të padëshirueshme, ngase mungonte hartimi i programit social, në nivel kombëtar. Andaj, ishte e nevojshme që të përpiloheshin politikat sociale, të cilat kishin rëndësi të madhe për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik në kushtet e tranzicionit, duke përfshirë mbrojtjen e tërë popullsisë e cila kishte mbetur jashtë vendeve të punës, kontigjentit të popullsisë së re aktive të pa punësuar, kontigjentit të popullsisë së të varfërve, etj.

Politika sociale kishte për qëllim; *të sigurojë parakushte për punësim të ri, mbrojtje sociale, rikualifikim të papunëve, mbështetje të biznesit të vogël (individual), mbështetje materiale dhe institucionale të reformës sociale*, e cila tentonte të sigurojë çvendosjen e funksionit social nga ndërmarrjet, OJQ-të dhe në institucionet e shtetit.

4.2. Historiku i zhvillimit të Sistemit Pensional në Kosovë

Vështruar nga aspekti historik, Kosova kishte mbetur pjesë territoriale e RSF të Jugosllavisë që nga viti 1912 (pa vullnetin e popullit shqiptar), ndërsa iu kishte aneksuar federatës Jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore, e cila administrohej si njësi e veçantë e RSFJ (Kosova administrohej me legjislacionin e atëhershëm të RSFJ).

⁶⁰ Privatizimi i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore-shtetërore duhet të nisët nga fakti i verifikuar në ekonomitë perëndimore, se të ardhurat e shtetit janë më të mëdha nga tatimet që paguajnë ndërmarrjet e privatizuara, sesa profiti që realizon nga ndërmarrjet shtetërore.

Sistemi i Sigurimit Pensional në Kosovë kishte filluar të organizohej që nga viti 1945, me rastin e nxjerrjes së akteve të para ligjore, që rregullonin këtë sferë shoqërore⁶¹.

Pas këtij ligji, ishin nxjerrë edhe shumë akte tjera normative, me të cilat ishte zgjeruar korniza ligjore mbi sigurimet për kategoritë e ndryshme shoqërore.

Me ndryshimet kushtetuese në RSF të Jugosllavisë, kishte ndryshuar edhe koncepti i sigurimeve pensionale dhe shëndetësore. Kështu që në vitin 1965 ishte miratuar “Ligji mbi sigurimin pensional” si dhe ishte bërë ndryshimi dhe plotësimi i “Ligjit mbi sigurimet shëndetësore”. Sipas legjislacionit të atëhershëm, ishte përkufizuar mënyra e formimit të Fondit të Përbashket Pensional, i cili qeverisej nga autoritetet shtetërore, me të siguroheshin të gjithë shtetasit për kujdesin bazik shëndetësor, ndërsa ky fond financohej nga burimet financiare; buxheti shtetëror dhe plotësohej edhe nga kontributet pensionale, të cilat paguheshin nga të ardhurat personale të punësuarëve (TAP).

Që nga viti 1966 deri në vitin 1974 në Kosovë kishte funksionuar Sistemi Pensional i Kosovës (Enti Pensional i Kosovës) si pjesë integruese e Sistemit Pensional të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Ky sistem ishte i bazuar në principin PAYG (pay-as-you-go, apo gjenerata paguan për gjeneratën).

Me Kushtetuten e vitit 1974 ishte bërë ndryshimi i organizimit dhe emërimit të institucioneve pensionale në Sistemin Pensional të RSFJ. Përmes këtij riorganizimi të Sistemit Pensional në RSFJ, ishte bërë decentralizimi i Fondeve Pensionale të Republikave dhe të Krahinave Autonome të RSFJ. Kështu që nga viti 1974 Krahina Socialiste Autonome e Kosovës e kishte Fondin e vet Pensional⁶², i cili ishte i organizuar përmes Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit për Shëndetësi, Mbrojtje Sociale dhe Sigurim Pensional të KSA Kosovës (BVI-SHMSSP), i cili bënte;

- Sigurimin pensional apo rregullimin e pensionit të pleqërisë dhe
- Sigurimin invalidor apo rregullimin e pensionit invalidor.

⁶¹ Ligjin mbi rregullimin e gjykatave për sigurime shoqërore/në Maj 1945

⁶² Ligji themelor i RSFJ për rregullimin e Sistemit Pensional dhe Invalidor.

Në ish Sistemin Pensional të KSA Kosovës, kontributorët kanë paguar kontribute pensionale në Fondin Pensional (BVI SPI), të cilat nuk ishin mbajtur në llogaritë e definuara individuale (portfolio individuale), por këto kontribute kanë qenë anonime, ndërsa shpërndarja e tyre është bërë në bazë të kriterëve të rregulluara me ligj (lartësia e të ardhurave personale, kualifikimi profesional dhe përvoja), të cilat kanë shërbyer për shkallëzimin e përfitimit të pensioneve.

Sistemi pensional i RSFJ në vitin 1987 e kishte numrin e përfituesve më të madh, se sa numrin e kontributdhënësve pensional, apo shuma e përfitimeve pensionale ishte katër fish më e lartë, se sa shuma e të hyrave në Fondin Pensional nga kontributet pensionale. Kështu që proporcioni në mes të të hyrave financiare nga kontributdhënësit, në raport me të dalurat financiare të destinuara për pagesën e përfitimeve pensionale ishte 1 me 3 dhe kishte tendencë të keqësimit të mëtejme në 1 me 4). Në këtë mënyrë ky sistem kishte filluar të operoj me deficit financiar, të cilin e mbulonte shteti nga buxheti shtetror, pra sistemi pensional i RSFJ ishte bërë një nga shkaktarët e krizës ekonomike në RSFJ.

Me abrogimin⁶³ e autonomisë politike të Kosovës, të cilën e kishte bërë Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë më 23 Mars 1989, të gjitha kompetencat politike të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës⁶⁴ i kishte marrë me dhunë policore Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë, duke i mohuar atributet e autonomisë politike të KSA Kosovës (si subjekt përbërës i RSFJ). Të gjitha kompetencat e KSA të Kosovës ishin koncentruar dhe centralizuar në institucionet e Republikës së Serbisë.

Në vitin 1990 Kuvendi i RS Serbisë e kishte nxjerrë “Ligjin mbi masat e përkohshme administrative në ndërmarrjet dhe institucionet e Kosovës”. Popullata shqiptare në KSA të Kosovës e kishte kundërshtuar abrogimin e autonomisë politike të KSA Kosovës (popullata shqiptare e Kosovës nuk e kishte pranuar këtë gjendje diskriminuese) dhe kishte ndërmarrë aktivitete të ndryshme politike dhe jopolitike, për të ndryshuar këtë

⁶³ Abrogim- mohim i së drejtës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës si njësi konstituive e RSFJ duke i kufizuar të gjitha kompetencat politike të saj brendafederatës.

⁶⁴ Krahina Socialiste Autonome e Kosovës (KSA e Kosovës).

gjendje. Si pasojë e zbatimit të këtij ligji diskriminues të RS të Serbisë ndaj shqiptarëve, punëtorët shqiptarë e kishin humbur të drejtën për punë, për përfitim nga sigurimi pensional dhe shëndetësor, si dhe për të kontribuar në Fondin Pensional të Kosovës⁶⁵.

Në vitin 1992 Sistemi Pensional i Kosoves⁶⁶ ishte integruar dhunshëm në Sistemin Pensional të RS Serbisë (Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Serbisë). Nga kjo kohë punonjësit shqiptarë kishin mbetur pa mbrojtje pensionale.⁶⁷ Pra, më 01/06/1992 ishte suprimuar autonomia e Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit të Sigurimit Pensional të Kosovës (Fondit Pensional të Kosovës), e cila ishte integruar me dhunë në Fondin Pensional të Serbisë. Kështu që në Kosovë kishte ndodhur shpërbërja e funksionimit të Sistemit Pensional të Kosovës (me vendim të Kuvendit të RS të Serbisë) dhe mjetet financiare që ishin pronë e Fondit Pensional të Kosovës ishin përvetësuar nga Fondi Pensional i Serbisë, ndërsa Fondi Pensional i Kosovës ishte zhvendosur në Beograd (autoritetet e KSA Kosovës nuk kishin më qasje në këtë fond).

Pra, gjatë periudhës 1990-1999, popullata shqiptare e Kosovës, krahas represioneve të ndryshme që kishte përjetuar nga autoritetet shtetërore serbe, ishte diskriminuar edhe përmes privimit të së drejtës për sigurime shëndetësore dhe sigurime të tjera për jetë (të cilave iu mohoheshin drejta themelore për përkujdesje shëndetësore dhe mbrojtje shoqërore). Si rezultat i këtyre “masave administrative” që kishte aplikuar Kuvendi i RS Serbisë (nga viti 1990 deri në vitin 1999) në institucionet dhe ndërmarrjet e KSA Kosovës, rreth 100,000 përfitues shqiptar të pensioneve (ishin pensionist kosovar deri në vitin 1989) kishin mbetur pa përfituar pensione dhe përkrahje tjera sociale, ndërsa një numër i vogël i kontribuesve kishin arritur që të përfitojnë pension.

⁶⁵ BSPK- Gurethemeli i sindikalizmit demokratik në Kosovë, Prishtinë 2006- f.52.

⁶⁶ Fondi Pensional i Kosoves në vitin 1992 kishte rreth 240,000,000.00 DM, të cilat ishin transferuar dhunshëm në Fondin Pensional të Serbisë.

⁶⁷ Udhekryqet e pensionistëve të Kosoves- e drejta për pensionin e përfituar është e pa kontestueshme, Prishtinë 2010, f. 17., gjë që në vitin (2010) thuhet se ishin 76.000 pensionist shqiptarë, përfitues të pensioneve: *përfituesit e pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor dhe pensionit familjar*.

4.3. Sistemi i ri Pensional në Kosovë

Që nga viti 1998 deri ne vitin 2002, kosovarët e moshuar nuk kishin marrë pensione, dhe të punësuarit nuk kishin kontribuar në asnjë Sistem Pensional, sepse funksionimi i Sistemit të Pensioneve të RSFJ ishte bllokuar nga ana e RS Serbisë.

Gjithashtu punëtorëve shqiptar qe i kishin plotësuar kushtet për të përfituar pensione, iu kishte pa mundur përfitimi i pensioneve, kështu që ishte paraqitur nevoja e krijimit të një sistemi të ri të pensioneve në Kosovë (administraten e UNMIK-ut) për të mbrojtur kategorinë e personave të moshuar.

Në vitin 2001 UNMIK-u e kishte nxjerrur Rregulloren 2001/5 për organizimin e Sistemit të ri Pensional me modelin e ri të Sistemit Pensional. Kështu filloi shkëputja e Sistemit pensional të Kosovës nga ish Sistemi i vjetër Pensional i RSFJ (sistemit pensional PAYG)⁶⁸.

Sistemi i ri Pensional i Kosovës ishte dizajnuar si model që siguron pensione të qëndrueshme në të ardhmen (të kënaqë nevojat e pensionistëve të ardhëshëm)⁶⁹.

Sistemi i ri Pensional premtonte zgjidhje të përgjithshme në periudha afatgjate, mundësi për të përballuar ndryshimet demografike dhe të nxit zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Sistemi i ri Pensional kishte filluar të implementohet në vitin 2002 dhe kishte pasur për synim që të mbulojë të gjithë banorët rezident të Kosovës, të cilët e kishin arritur moshën e pleqërisë prej 65 vjetësh, ndërsa ishte planifikuar që ata të përfitonin fillimisht nga 28 Euro në muaj⁷⁰.

Sistemi i ri Pensional synon të funksionojë si stabilizator socio-ekonomik që promovon zhvillimin ekonomik, mundëson themelimin e Fondeve Pensionale dhe administrimin e kursimeve të kontributeve pensionale, investon mjetet financiare të Fondeve Pensionale

⁶⁸ Ishte skemë e paqëndrueshme financiare dhe që kishte ofruar mbulim shumë të ulët të popullatës me pension, kështu që vetëm 1/3 e popullsisë kishte mundur të kualifikohet për të përfituar pension

⁶⁹ Rregullorja 2001/35, UNMIK

⁷⁰ Grupi i eksperteve te Kosoves e kishte dhene propozimin qe lartesia e pensionit te mbuloje shporten minimale te konsumit qe ne vitin 2002 ishte 1,85 DM per individ per nje dite (30x 1,85= 55,50 DM)

(për të realizuar kthime nga investimet), siguron pensione te merituar, promovon zhvillimin e tregut të punës, si dhe të tregjeve të kapitalit financiar, do të jetë i aftë për të përballojë ndryshimet e papritura nga ndikimi i variablave ekonomike dhe demografike, si dhe të përballojë turbullirat në mjedisin politik dhe ndikimet e jashtme financiare.

4.3.1. Shkaqet e reformës së Sistemit Pensional

Shkaqet të cilat kishin ndikuar ne reformimin e Sistemit Pensional të Kosovës, mund të jenë si në vijim:

Shkaku i parë- i reformës së Sistemit Pensional ishte *konteksti politik*, i cili kishte rezultuar me integrimin e dhunshëm të Sistemit Pensional të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Sistemit Pensional të Republikës Socialiste të Serbisë.

Shkaku i dytë- ishte *shkëputja e sistemit politik të Kosovës nga RS e Serbisë*, bashkë me te edhe shkëputja e Sistemit Pensional të Kosovës nga Sistemi Pensional i RS Serbisë, duke e shmangur përfundimisht praktikën e ish Sistemit Pensional të RSFJ, apo Sistemin Pensional PAYG.

Shkaku i tretë- ishte disajnimi i modelit të Reformës së Sistemit të ri Pensional të Kosovës, sipas praktikave më të avancuara në vendet e ndryshme të Botës, të bazuar në mendimet dhe në rekomandimet e autoriteteve të Bankës Botërore (të ekspertëve të Institutit të Bankës Botërore- “Reformës Pensionale të gjeneratës së dytë”) dhe të OECD.

Shkaku i katërt- është hulumtimi i perspektivës së zgjidhjeve të reja për përmirësimin e mëtejshmë të Sistemit Pensional, në mënyrë që ai të bëhet sa më funksional dhe me i qëndrueshëm.

Shkaku i pestë- është standardizimi i Sistemit Pensional të Kosovës me sistemet pensionale të vendeve të Unionit Evropian, si dhe pjesëmarrja në tregjet e zhvilluara të kapitalit financiar.

Analizimi i shkaqeve në studim, ka për qëllim të ndriqojë faktorët të cilët e kishin kushtëzuar prishjen e Sistemit të vjetër Pensional, dhe të faktorëve të cilët ndikojnë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së Sistemit të ri Pensional.

4.3.2. Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë

Pas vitit 1999, në Kosovë ishte vendosur Misioni i OKB në bazë të “Rezolutës 1244”, i quajtur UNMIK, si administratë e përkohshme e cila kishte për detyrë, që ndër të tjera të organizojë edhe Sistemin Ekonomik të Kosovës me konceptin e ekonomisë së tregut të lirë.

Kështu që autoritetet kompetente të UNMIK-ut, kishin ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të organizuar Sistemin Pensional në Kosovë.

Sistemi i ri Pensional në Kosovë është ndërtuar mbi bazën e një filozofie sipas Estella James, World Bank dhe Sarah Brooks (Duke University, 2001), e cila është përdorur dhe ka dhënë prova të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në vendet e Amerikës Latine, në veçanti në Chile (1981), Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar⁷¹.

Thelbi i kësaj filozofie është ndërtimi i Sistemit Pensional, si entitet financiar i pavarur, jo profitabil, i themeluar për të; *rregulluar mbledhjen e kontributeve të kursyera në mënyrë të detyrueshme dhe vullnetare, administruar kontributet pensionale individuale të definuara, ruajtur vlerën e kontributeve pensionale (portfolios individuale), qeverisur në mënyrë të matur, të kujdeseshme, të besueshme dhe profesionale, menaxhuar me kujdes dhe pergjegjësi të lartë profesionale deri në momentin e përfitimit të pensioneve nga pronarët e portfoliove- përfituesit pensional.*

Bartës i disejnimit të Sistemit të ri Pensional në Kosovë ishte USAID sipas John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulín (2007), i cili kishte angazhuar këshilltarët e vet

⁷¹ Estella James (World Bank) & Sarah Brooks (Duke University); The political Economy of Structural Pension Reform, 2001.

profesional (Barents Group), gjithashtu në këtë proces ishin përfshirë edhe përfaqësuesit (ekspertët) e UNMIK-ut, të UE, FMN, Bankës Botërore, DFID dhe të ILO.⁷²

Paras se të vendoset se si të organizohet Sistemi Pensional, janë zhvilluar shumë konsultime, debate rreth modelit, reformës së organizimit të Sistemit Pensional, i cili do të zhvillohej në Kosovë, ashtu që pas shqyrtimit të shumë variantave rreth modelimit të Sistemit të ri Pensionale ishte konkluduar se::

Së pari- ishte e nevojshme të bëhet një prerje e plotë financiare e Sistemit të vjetër Pensional të Kosovës, e cila në vitin 2001 kishte rezultuar me gjendje boshe (zero), sepse Fondi i vjetër Pensional ishte transferuar në Serbi dhe ishte përvetësuar nga ana e Serbisë, ndërsa gjendja e transferuar e mjeteve financiare të Fondit Pensional të Kosovës ishte e pa njohur për autoritetet e UNMIK dhe të IPVQ të Kosovës. Kështu që Serbia i kishte bllokuar këto mjete financiare, nuk përgjigjej dhe nuk bashkëpunonte me UNMIK-un për ta kthyer këtë fond në Kosovë. Andaj, kjo çështje kishte mbetur si variant i ardhshëm për negociim të autoriteteve politike të Kosovës me autoritetet përkatëse të Serbisë, në mënyrë që të kërreshin ato mjete financiare në Kosovë dhe shfrytëzimi i tyre të destinohet për shpërgimin e pensioneve për përfituesit e merituar.

Së dyti- pikënisja e implementimit të Sistemit të ri Pensional në Kosovë të fillon në vitin 2002 nga niveli zero, por që do të ndihmohet fillimisht nga USAID, për të mbuluar shpenzimet themelore të ngritjes së kapaciteteve të Fondeve të reja Pensionale në Kosovë.

Se treti, Sistemi i reformuar Pensional ishte disajnuar në bazë të praktikave më të mira, të cilat ishin aplikuar në vendet e ndryshme të Botës.

Bazuar në Rregulloren 2001/35, ishte modeluar Sistemi pensional i Kosovës. Autoritetet e UNMIK-ut kishin marrë vendim për të implementuar Rregulloren mbi pensionet në

⁷² John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin: The Kosovo Pension Reform- Achievements and Lessons, April 2007, p.7

Kosovë, duke themeluar skemat pensionale si komponenta të Sistemit Pensional në Kosovë (sistem i reformuar dhe i përshtatur me parimet e ekonomisë së tregut të lirë).

Reforma e sistemit pensional (John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin , 2007)⁷³ në Kosovë fillon në vitin 2002, me aplikimin e Rregullores mbi Pensionet Nr 2001/35 nga UNIMK-u, e cila e ka definuar Sistemin Pensional si Sistem Pensional me model Shumë Shtyllor (të komponuar nga tri shtylla⁷⁴), si dhe e ka ridefinuar moshën për të fituar të drejtën për pension (65 vjet moshë për të dy gjinitë).

4.3.3. Qëllimet themelore të reformës së Sistemit Pensional në Kosovë

Qëllimet themelore të Reformës së Sistemit Pensional në Kosovë janë:

Shmangja e sistemit të vjetër PYGO

Krijimi i Sistemit të ri të Pensioneve, që e mbulon të gjithë popullsinë e moshuar të Kosovës e cila mbush moshën 65 vjet jetë.

Adresimi i nevojave e të gjitha grupeve të popullsisë.

Zgjidhja e përgjithshme që e bën sistemin pensional të qëndrueshëm në periudha afatgjate (që përballon ndryshimet demografike dhe që nxit zhvillimin e ekonomisë së tregut).

Adresimi i shqetësimeve etnike (lejohen të marrin pjesë në Sistemin e ri Pensional të gjithë qytetarët rezident të Kosovës në kushte të barabarta, pavarësisht nga përkatësia etnike).

Promovimi i zhvillimit ekonomik (promovimi i investimeve të kursimeve të kontributeve pensionale, promovimi i zhvillimit të tregut të punës, promovimi i zhvillimit të tregjeve të kapitalit financiar).

⁷³ John Gubbels, David Snelbecker, Lena Zezulin “The Kosovo Pension Reform: Achievements and Lessons, April 2007

⁷⁴ Ndryshimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë me Rregulloren mbi pensionet Nr. 2005/20.

Parandalimi i rënies së papritur të të Ardhurave të Individëve pas daljes në pension, në ish Sistemin e vjetër të Pensioneve të KSA Kosovës.

Parandalimi i rënies të papritur të të Ardhurave të Individëve dhe varfërimit të vazhdueshëm të tyre, pas mbushjes së moshës (65 vjeqare) së pleqërisë.

etj.

4.3.4. Baza konceptuale e ndërtimit të Sistemit Pensional në Kosovë

Baza konceptuale e ndërtimit të Sistemit Pensional në Kosovë, mbështetet në;

- *braktisjen përfundimtare të sistemit të vjetër pensional PAYG,*
- *ndërtimin e Sistemit të ri Pensional (modeli shumë shtyllor),*
- *standardizimin e modelit të Sistemit të ri Pensional, krahasuar me modelet më të avancuara në vendet e OECD,*
- *respektimin e të drejtave themelore universale të njeriut,*
- *mbulueshmërinë e barabartë të gjithë banorëve rezident të Kosovës, duke adresuar plotësimin e nevojave për të gjitha grupet e popullsisë, përfshirë të gjitha grupet etnike të Kosovës.*
- *përfshirjen e gjërë të popullatës dhe të kontribuesve të detyrueshem e vullnetar, për të përfituar pensione nga komponentet e Skemave Pensionale private dhe publike, përmes politikave të Fondeve Pensionale dhe të detyrimeve buxhetore,*
- *qasjen e barabartë për të gjithë banorët rezident të Kosovës, të cilët e mbërrijnë moshën e pleqërisë 65 vjeqare, të cilëve iu mundësohet që të përfitojnë pensione nga të gjitha skemat pensionale, nëse ata kanë bërë derdhje të kontributeteve të tyre pensionale në skemat pensionale përkatëse (Fondet Pensionale),*
- *respektimin e të drejtës së pronës- pensioneve,*
- *synimin për zbutjen e varfërisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve, që ndërlidhen me mbështetjen sociale në Kosovë,*

- *vetëqëndrueshmërinë ekonomike dhe në stabilitetin financiar të Sistemit Pensional (të hyrat nga kontributet e definuara individuale dhe me kosto efektive, përfitimet nga investimet sipas lartësisë së shumës së portfolios individuale dhe të gjendjes kualitative për pagesën e pensioneve),*
- *stabilitetin makroekonomik dhe socio-ekonomik,*
- *shëndetshmërinë financiare, sigurinë dhe likuiditetin e mjaftueshëm financiar,*
- *përgjegjësia profesionale në administrim të saktë dhe koordinim të operimeve të nevojshme financiare, raportimeve lidhur me gjendjen e aseteve pensionale,*
- *barazzimin e të dhënave lidhur me derdhjen e kontributeve pensionale me bizneset, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Bankën Qendrore të Kosovës,*
- *administrimin efikas dhe përpunimin e të dhënave lidhur me kursimet e kontributeve pensionale, llogarive individuale dhe i pensioneve, për të gjithë përfituesit e pensioneve të merituar,*
- *kursimin e kontributeve pensionale të identifikuar në portofoliot individuale të kontributorëve,*
- *besueshmërinë e lartë të publikut në Sistemin Pensional, të shprehur përmes rritjes së vazhdueshme të kursimeve të kontributeve pensionale,*
- *qasjen e kujdesshme e Fondeve Pensionale në investimin e mjeteve të tyre, bën që rreziku i likuiditetit të jetë i ulët,*
- *ndershmërinë e lartë të qeverisjes me asetet e Sistemit pensional,*
- *përkushtimin e organeve qeverisëse të Sistemit Pensional të Kosovës në përpilimin e politikave respektive, me qëllim të realizimit të objektivave lidhur me ruajtjen e stabilitetit financiar të Fondeve Pensionale,*
- *përfaqësimin profesional në organet qeverisëse dhe mbrojtja e interesave të kontributorëve me qëllim të uljes së rrezikut sistematik të ndërlidhur me mbajtjen e llogarive individuale të kontributorëve pensional, si një siguri dhe garancion për sigurimin e kursimeve të kontributeve pensionale,*
- *sigurimin e aseteve të Fondeve Pensionale në kompanitë e sigurimit, me qëllim të rritjes së nivelit sa më të lartë të sigurimit të kursimeve pensionale, si një masë e*

domosdoshme për të mbajtur besimin e publikut për sigurinë e kursimeve të kontributeve pensionale,

- *përgjegjësinë fiduciare të organeve qeverisëse të Fondeve Pensionale apo përgjegjshmëria e autoriteteve qeverisëse dhe të menaxhimit, në lidhje me klualitetin e politikbërjes dhe ekzekutimin e vendimeve të nevojshme për zhvillimin e skemave pensionale, duke e ruajtur apo sforcuar e stabilitetin financiar,*
- *mbrojtjen nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme, ndërlidhet me krizat politike dhe ekonomike, të cilat mund të lëndojnë integritetin financiar të Sistemit Pensional dhe të ekonomisë në përgjithësi, si rreziqe potenciale, të cilat mund të vijnë nga zvogëlimi i rritjes ekonomike, mbështetjes së kufizuar të sistemit financiar, kulturës së pamjaftueshme për menaxhimin e rrezikut në institucionet financiare dhe në agentët e tjerë ekonomik, veçanërisht rrezikun e kursit të këmbimit dhe të likuiditetit, si dhe mundësitë e kufizuara që kanë autoritet publike për të aplikuar masa financiare anti-krizë, e të ngjashme në vend,*
- *përgatitjen dhe përshtatjen e infrastrukturës financiare,*
- *mbikqyrjen sistematike nga institucioni financiar rregullator dhe mbikqyrës (Banka Qendrore e Kosovës), duke rishikuar nevojën për funksionim sa më eficient ndërinstitutional dhe për të bërë mbikqyrje “ex-ante” dhe ndërhyrje “ex-post”,*
- *kompletimin e kuadrit ligjor, për të përmbushur kushtet e operimeve të përshtatshme me kapital financiar dhe të likuiditetit, për të ruajtur gjendjen e synuar të bilancit, si dhe të marrëdhënieve që rregullojnë qeverisjen dhe menaxhimin e Sistemit Pensional,*
- *promovimin e zhvillimit ekonomik nga ana e Stistemi Pensional, shumën e kursimeve të kontributeve pensionale, investimin e aseteve të Fondeve Pensionale, shkallën e të punësuarëve, lëvizjet në tregun e punës, potencialin financiar të akumuluar të Fondeve Pensionale, mundësitë për zhvillimin ekonomik të vendit, etj.,*
- *promovimin e zhvillimit të tregjeve të kapitalit financiar,*
- *racionalizimin (minimizimin) e shpenzimeve operationale dhe të menaxhimit,*
- *kapitalizimin e aseteve përmes investimeve direkte në tregjet e kapitalit financiar,*

- *krijimin e portfoliove të definuara individuale të kontributorëve pensional,*
- *shpagimin e anuiteteve pensionale,*
- *shmangien e rreziqeve e financiare,*
- *pavarësinë e entiteteve pensionale,*
- *transparencën- përballë publikut, kontributoreve, perfituesve të pensioneve dhe autoriteteve politikbërëse, institucioneve të ndryshme private dhe publike, bëhet komunikimi efektiv, i besueshëm dhe i ndërsjellët,*
- *ndikueshmërinë në sistemin makroekonomik përballë ndryshimeve demografike, në punësim, në të ardhura personale, konsum, etj., në periudha afat gjata,*
- *rivlerësimin e objektivave dhe formave të zhvillimit të veprimtarisë financiare të Sistemit Pensional në të ardhmen, me qëllim të sigurimit të ruajtjes së vlerës kualitative të aseteve pensionale, si dhe të kapitalizimit të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm,*
- *përmirësimin e vazhdueshëm të funksionalizimit të Sistemit Pensional.*
- *etj.*

Dizajnimi apo modelimi i strukturës së sistemit pensional (Chlon- Dominczak, 2003)⁷⁵ në Kosovë është bërë mbi bazën konceptuale e cila në vete përmban: cilësitë e modelit, mënyrën e rregullimit ligjor dhe kornizën e akteve tjera normative, infrastrukturen e përpunimit të dhënave (TI), të cilat e bëjnë këtë sistem funksional, të qëndrueshëm dhe të sigurtë.

4.4. Skemat pensionale në Kosovë

Dizajnimi i strukturës së Sistemit Pensional në Kosovë, është bazuar në modelet e skemave pensionale shumë shtyllore, të cilat janë dëshmuar si të vetëqëndrueshme dhe si

⁷⁵ Chlon- Dominczak. "Funded Pensions in Transition Economies in Europe and Central Asia: Design and Experience." International Federation of Pension Funds Association (FIAP) and World Bank, 2003.

faktorë të ndërtimit të stabilitetit ekonomiko-social në vendet e Amerikës Latine, kryesisht në Çile (Rafael Rofman and Leonardo Lucchetti, 2006),⁷⁶

Kështu që premtimet bazë të ndërtimit të modelit të ri të Sistemit Pensional në Kosovë, kanë qenë të bazuara në;

- stabilitetin e skemave pensionale,
- stabilitetin socio-ekonomik,
- definimin e portfoliove individuale me status juridik të pronave individuale,
- perfitimin e pensioneve të merituar,
- qëndrueshmërinë e sistemit pensional,
- etj.

Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë, rezultoi me modelin shumë shtyllor, i cili përmban në vete dy Fonde Pensionale dhe një Vijë Buxhetore;

Shtylla e parë- Vija buxhetore apo *jo Fonde financiare* (Carmichael, Jeffrey dhe Palacios, Robert, 2003)⁷⁷.

Shtylla e dytë- Fondet Pensionale të detyrueshme (mandatore).

Shtylla e tretë- Fondet Pensionale suplementare (vullnetare).

4.4.1. Shtylla e parë e Skemës së Pensioneve Bazë

Kjo skemë ka fillua nga 01.07.2002 e bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 e rregulluar me Ligjin Nr. 2002/1 për Pensionet Bazike të Moshës dhe Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës. Me vonë ishte rirregulluar me Ligjin Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të financuara nga Shteti. Ligji mbi Skemat Pensionale ishte plotësuar me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-168 dhe me Rregulloren Nr.2005/20, të

⁷⁶ Rafael Rofman and Leonardo Lucchetti "Pension Systems in Latin America" Concepts and Measurements of Coverage, November 2006.

⁷⁷ Carmichael, Jeffrey and Palacios, Robert. "A Framework for Public Pension Fund Management." Paper presented to 2nd Public Pension Fund Management Conference. World Bank, Washington, DC, May 5-7, 2003.

cilat e kishin rregulluar funksionimin e Skemës së Pensioneve Bazë në Kosovë, duke përfshirë;

- burimin e financimit nga buxheti i Kosovës,
- nivelin e benificionit,
- moshën e përfituesit (qytetarit rezident të Kosovës) i cili përfiton Pension Bazë,
- datën e fillimit të pagesave të Pensioneve Bazë,
- kushtet e ndërprerjes së përfitimit të Pensionit Bazë,
- etj.

Shtylla e parë e pensioneve i përmbanë këto skema të Sistemit Pensional (me Ligjin Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti të datës 06 maj 2014 ishte bërë plotësimi i skemave pensionale) si vijon;

- Pensionet bazike të moshës.
- Pensionet kontribut paguese të moshës (kontributorët të cilët kanë paguar kontribute në periudhën gjatë punës, së paku 15 vite para vitit 1999 në Fondin e vjetër Pensional të Kosovës- RSFJ).
- Pensionet e aftësisë së kufizuar.
- Pensionet e parakohshme.
- Pensionet familjare dhe
- Pensionet invalidore të punës⁷⁸.

Shtylla e parë financohet nga buxheti i Kosovës dhe i mbulon të gjithë banorët rezident të Kosovës (pa dallim të gjinisë, fesë, nacionalitetit, apo pikëpamjeve politike), të cilët e mbushin moshën prej 65 vjetëve⁷⁹, apo që i përmbushin kushtet e lartëpërmendura (nga 1-6) për të përfituar Pensionin bazë.

⁷⁸ Ligji Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti

⁷⁹ Fillimisht me Rregulloren mbi pensionet 2001/35 kjo Skemë Pensionale i mbulonte vetëm personat rezident të Kosovës, të cilët e kishin arritur moshën e pleqërisë prej 65 vjetëve

Skema e Pensionit Bazë në Kosovë financohet nga të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Kosovës⁸⁰.

Shuma financiare e cila financon Pensionet Bazë, alokohet në Buxhetin e Shtetit, duke u bazuar në kapacitetin aktual të Buxhetit të Shtetit, i cili varet nga të hyrat buxhetore, për të bërë mbulimin e nevojave të përfituesve pensional, në lartësinë e shportës së konsumit individual.

Lartësia e Pensioneve Bazë është direkt e lidhur me shkallën e zhvillimit të ekonomisë (përderisa të ngritet niveli i zhvillimit ekonomik, të hyrat buxhetore do të rriten dhe bashkë me të, do të rritet edhe shkalla e pensioneve).

Lidhur me lartësinë e pagesës së Pensioneve bazë dhe për të përfshirë grupet përfituese për të gjitha grup- moshat, vendosë Kuvendi i Kosovës.

4.4.1.1. Skemat e Pensioneve Bazë të moshës

Me këtë Skemë pensionale mbulohen të gjithë qytetarët rezident të Kosovës, të cilët e kanë mbushur moshën e pleqërisë prej 65 vjeteve, pa kurrfarë kushtesh tjera.

Qellimi i kësaj Skeme pensionale është ruajtja e stabilitetit ekonomiko-social në vend, duke participuar në mbulimin e shpenzimeve jetësore që lidhen me Shportën e Konsumit Individual.

Departamenti i Pensioneve (DP) në MPMS, në kuadër të veprimtarisë së vetë, zbaton dhe operacionalizon politikat e Ministrisë së punës dhe Mirëqenies Sociale(MPMS), nga sfera e Shtyllës së Parë të Sistemit Pensional të Kosovës, që kanë të bëjnë me; administrimin, planifikimin, koordinimin, e skemave pensionale të financuara nga shteti, dhe menaxhon Sigurimin Pensional dhe invalidor sipas Konventave ndërkombëtare.

⁸⁰ Skemës Bazë nuk i është shtuar ndonjë lloj, apo shkallë tatimore në paga, që të financoj benefitet e Pensionit bazë, por Pensionet bazë financohen prej një spektri të gjërë të tatimeve në Kosovë.

4.4.1.2. Skema e pensioneve Bazë kontributive

Kjo skemë bazohet në Vendimin e Qeverisë Nr. 13/277, të Urdhëresës Administrative Nr.11/2007, të plotësuar me Urdhëresën Administrative Nr.15/2009, me qëllim që përfituesit e Pensionit Bazë, të cilët kanë paguar kontributet për sigurim pensional e invalidor sipas dispozitave ligjore të ish sistemit të RSFJ-së për më tepër se 15 vite (deri me 31.12.1998), do të kenë një shtesë lineare prej 65 €. Kjo skemë ka filluar të zbatohet prej 01.01.2008.

4.4.1.3. Skema Pensionale Invalidore dhe skemat tjera pensionale të Shtyllës së Parë të Pensioneve

Shfrytëzues të drejtave për përfitimin e Pensionit Invalidor nga Skema pensionale Invalidore, janë personat të cilët e kanë humbur aftësinë për punë, si pasojë e ndonjë lëndimi apo sëmundje, e cila iu kufizon të drejtën për punë⁸¹.

Kjo Skemë Pensionale është rregulluar me Ligjin Nr. 04/l-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të sponzoruar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ky ligj përcakton kriteret për përfitimin e pensionit dhe ushtrimin e kësaj të drejte për shtetasit e Republikës së Kosovës, por edhe për shtetasit e huaj, sipas marrëveshjeve dy palëshe të sigurimeve sociale, ndërmjet Kosovës dhe shteteve përkatëse.

Duke u bazuar në standardin e ulët jetësor të pensionistëve në Kosovë, janë bërë përpjekje që përmes këtij ligji të zbuten problemet sociale dhe të varfërisë, apo të zhdukjes së varfërisë së skajshme.

Të hyrat financiare në Sistemin Pensional krijohen nga burime të ndryshme financiare (fiskale).

⁸¹ Pensionet invalidore të punës (në rastet kur kontribuesit lëndohen në vendin e punës, apo fitojnë sëmundje profesionale.)

Pra, në shtyllën e parë të Pensioneve Bazë dhe të ish kontributdhënësve, të hyrat financiare krijohen nga të hyrat e përgjithshme buxhetore,

Politikëbërjen për financimin e këtyre llojeve të pensioneve e bëjnë organet qeveritare të Kosovës.

4.4.2. Shtylla e dytë e Sistemit Pensional- Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Shtylla e dytë financohet nga kursimet e detyrueshme të kontributeve pensionale në Fondin Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FP TKPK) (janë kontribute individuale të definuara, të administruara në portfolion individuale të kontributorit).

Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës është themeluar si Shtylla e dytë e Sistemit të ri Pensional në Kosovë. Ky Fond Pensional është institucion financiar, i themeluar në Dhjetor të vitit 2001 në bazë të Rregullores 2001/35, ndërsa ka filluar të operojë si Fond Pensional nga 1 Gushti i vitit 2002, duke administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë.

FP i TKPK, është institucion i krijuar sipas modelit të kontributeve pensionale individuale të definuara, që nënkupton se secili kontribues kursen për pension në një llogari personale.

Në këtë Fond Pensional mbahen kursimet e kontributeve pensionale në llogaritë e definuara individuale, të cilat janë të paprekshme apo të pa tjetërsueshme nga të tjerët. Administrimi i këtyre llogarive individuale është përgjegjësi ligjore e Fondit Pensional të TKPK. Kursimet e grumbulluar në llogaritë apo portfoliot individuale, janë pronë e pronarit të llogarisë, por mandati i këtyre kursimeve është specifik, ato mund të përdoren vetëm për shpagimin e pensioneve kur i punësuari pensionohet (në moshën 65 vjeqare). Pensioni i tij do të varet nga shuma e akumuluar në llogarinë e tij individuale gjatë tërë historisë së tij të punës.

Kompetencat e Fondit Pensional të TKPK janë përkufizuar fillimisht me Rregulloren 2001/35 e më vonë me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë, duke i përcaktuar të drejtat e Fondit Pensional, duke përfshirë edhe obligimet e tij ndaj kontributorëve dhe ndaj palëve të treta.

Qeverisja e Fondit Pensional të TKPK bëhet nga anëtarët e Bordit të TKPK, të cilët e qeverisin atë me; maturi, përgjegjësi të lartë profesionale- fiduciare, ndërsa menaxhimi bëhet nga personeli, i cili disponon me kapacitete të larta profesionale dhe përgjegjësi të lartë në punë. Është përgjegjësi primare e FP të TKPK, të sigurojë që mjetet financiare të Fondit Pensional janë të investuara në mënyrë të sigurtë dhe se gjenerojnë kthime adekuate për kontributorët pjesëmarrës.

Kjo skemë e Sistemit Pensional është konfiguruar në atë mënyrë që, të menaxhohet me kosto shumë të ulët të menaxhimit, transparencë të lartë, saktësi shumë të lartë dhe qëndrueshmëri e stabilitet afatgjatë.

Mënyra e financimit të Fondit Pensional ishte e rregulluar me Rregullorën 2001/35 e më vonë me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë nga kontributet mujore të detyrueshme: ku të punësuarit do të kontribojnë 5% të pagës apo të kompenzimeve financiare të tyre dhe punëdhënësit janë të detyrueshëm që të shoqërojnë këtë pagesë të kontributeve me pagesën e kontributeve të tjera, në lartësi 5% prej pagës apo të kompenzimit, në llogarinë individuale të punëmarrësit.

Fondi Pensional i TKPK, është institucion i pavarur i Kuvendit të Kosovës, aktivitetin e tij të përgjithshëm e mbikëqyr Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Pra, Fondi Pensional i TKPK është entitet tërësisht i pavarur nga Qeveria dhe mjetet e tij janë plotësisht të ndara dhe të pavaruara nga financat e Buxhetit të Kosovës.

Administrata Tatimore është përgjegjëse për mbledhjen, procesimin dhe raportimin e kontributeve pensionale, duke e bërë të zbritshme % e kontributeve nga baza e tatimit, si mekanizëm i regjistrimit më të lehtë dhe më të thjeshtë të raportimit. Administrata

Tatimore i mbledh dhe i proceson këto të dhëna, monitoron përmbajtshmërinë, i barazon pagesat, dhe i dërgon këto informata FP të TKPK.

Punëdhënësit kryejnë pagesat e kontributeve pensionale për të gjithë punëtorët e tyre çdo muaj përmes rrjetit të bankave komerciale në Kosovë dhe njëkohësisht i raportojnë FP të TKPK lidhur me pagesën.




Fig. Nr.1. Skema e funksionimit të Fondit Pensional të TKPK

Pasi të bëhet pagesa, banka komerciale dërgon të hollat në llogarinë e Fondit Pensional në BQK (Banka Qendrore e Kosovës), kështu të gjitha kontributet e mbledhura transferohen nga llogaria në BQK në llogarinë e FP të TKPK si menaxhuese të mjeteve, përgjegjësia e së cilës është t'i; administroj, ruaj, investoj këto mjete.

Pjesa dërrmuese e aseteve të sistemit pensional menaxhohet nga Fondi pensional - "Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK)". Mjetet nën menaxhim të TKPK, në fund të periudhës së tremujorit të tretë të vitit 2014, tejkaluan shifrën €1,038 miliardë, ndërsa pjesa e rritur e mjeteve nën menaxhim ishte ndikuar më shumë nga kontributet e reja

(€33 mln) dhe pjesa tjetër nga kthimi nga investimet (€14 mln). Në anën tjetër Fondi Pensional i TKPK shpagoi pensione në shumë prej €3.04 mln, ndalesat për tarifën menaxhuese ishte €1.36 mln dhe refondimet ishin €0.12 mln, duke iu zbritur kështu mjeteve nën menaxhim rreth €4.53 mln.⁸²

Mjetet e FP të TKPK investohen te Menaxhuesit e Mjeteve në tregun e kapitalit financiar, të cilat pritet të kapitalizohen dhe kthimet nga investimet shpërndahen proporcionalisht nëpër llogaritë individuale të kontribuesve, pas zbritjes së shpenzimeve administrative.⁸³

Sistemi i ri Pensional i Kosovës është më transparent, se sa ish sistemi pensional i RSFJ, sepse iu lejon të gjithë pjesëmarrësve në mënyrë të qartë të informohen lidhur me administrimin dhe akumulimin e kontributeve pensionale.

Kuvendi i Kosovës e bën aprovimin e lartësisë së tarifës së taksës operacionale (shpenzimet operacionale), e cila përdoret për administrimin e Llogarive Individuale nga ana e Fondit Pensional të TKPK.⁸⁴ Ndërsa shpenzimet e menaxhimit i përfshijnë shpenzimet në lidhje me investimin e mjeteve pensionale, ngarkimet e transferimit, tarifat e menaxhimit të mjeteve dhe tarifat e performancës nga fondet e pjesëmarrësit, etj.

FP TKPK i informon në mënyrë periodike kontributorët (pronarët e llogarive individuale), duke iu shpërndarë pasqyrat e llogarive individuale, në mënyrë që ata të mund t'i monitorojnë kontributet e tyre, shpenzimet administrative, dhe kapitalizimet nga investimet.

Rregullorja mbi pensionet e obligon Bordin Qeverisë të FP të TKPK të bënë sigurimin e mjeteve financiare, duke përfshirë edhe sigurimin fiduciar për; Mjetet e FP të TKPK, Sigurimin e anëtareve të Bordit Qeverisë, me kompanitë e sigurimeve të licencuara në

⁸² [www.kpst.org/English/Documentet/ for Annual Reports](http://www.kpst.org/English/Documentet/for%20Annual%20Reports)

⁸³ Shpenzimet e taksës së administrimit është 0.60%, këtë tarifë e aprovon Kuvendi i Kosoves (nga 1 janari 2012)

⁸⁴ Taksa operacionale (për vitin 2015) është 0.085 %, për menaxhimin e llogarive individuale të FP i TKPK. Taksat e tilla paraprakisht vlerësohen, dhe gjatë vitit në vijim shërbejnë për llogaritjen e çmimit të njësisë.

Kosovë ose në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

Ky fond disponon me një Sistem Pensional të avancuar të Teknologjisë Informative dhe bën përpunimin e të dhënave lidhur me kontot Individuale në mënyrë të përpikët, kështu që çdo pjesëmarrës mund të kontrollojë llogarinë e vet individuale në çdo moment.

4.4.3. Shtylla e tretë e Skemës së Fondeve Pensionale Suplementare

Shtylla e tretë financohet nga kursimet vullnetare të kontributeve pensionale në Fondin Pensional Suplementar të Kursimeve Pensionale (janë kursime të kontributeve individuale të definuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve).

Shtylla e tretë e Sistemit Pensional të Kosovës është Skema vullnetare e pensioneve, që është rregulluar me Rregulloren 2001/35, me Rregulloren 2005/20 dhe me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i cili e ka rregulluar mënyrën e funksionimit të Fondeve Pensionale Suplementare të punëdhënësit dhe të Fondeve Pensionale Suplementare Individuale.

Me këto rregullore e ligje është bërë liberalizimi i tregut të pensioneve në Kosovë, gjë që ka mundësuar zhvillimin e konkurrencës, përmirësimin e shërbimeve, ashtu që është mundësuar që secili qytetar apo kontributorë të vendosë të kontribuojë, aty ku dëshirojnë të kursejë kontributet e veta pensionale, për të përfituar pension gjatë pleqërisë së tij.

Ligji mbi Fondet Pensionale të Kosovës siguron se, Fondet Pensionale Suplementare janë të organizuara mirë dhe janë të sigurta, të financuara në mënyrë adekuate dhe transparente.

Fondet Suplementare të Pensioneve përkrahen nga shteti përmes lehtësirave tatimore për punëdhënësin dhe të punësuarit që kursejnë në këtë skemë. Skemat vullnetare të pensioneve janë një zgjedhje alternative e bizneseve dhe e institucioneve të ndryshme financiare, financohen nga kontributet vullnetare të punëdhënësve dhe të individëve.

Fondet Pensionale të cilat operojnë sipas Skemës së Shtyllës së tretë, e bëjnë Sigurimin Suplementar të Pensioneve, duke i lehtësuar llojet e tjera të sigurimit pensional dhe i transferuar përgjegjësitë, për të siguruar pension adekuat mbi punëdhënësit dhe të punësuarit.

Licensimin dhe monitorimin e skemave vullnetare e bën Departamenti i Pensioneve të BQK. Kështu që Fondi Slloveno- Kosovar i Pensioneve ishte licensuar dhe kishte operuar në Kosovë që nga viti 2006, fillimisht si anëtar i “Prva Group” të Sllovenisë⁸⁵, të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës për të menaxhuar Fondin Suplementar Pensional, i cili aktualisht është ofertues i vetëm i pensioneve vullnetare në Kosovë. Fondi Slloveno- Kosovar i Pensioneve⁸⁶ ka mbi 4000 klientë të cilët kursejnë për pensionin e tyre, më shumë se 100 kompani që paguajnë për punëtorët e tyre si pjesë e paketës së beneficioneve për ta dhe çdo muaj paguan pensione për klientët e tij, ku pensioni i tyre është mbi mesataren e rrogës në Kosovë.

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve arriti që falë seriozitetit në menaxhimin e mjeteve të kontribuesve, përkushtimit dhe efikasitetit në punë, edhe përkundër lëvizjeve negative dhe zhvillimeve në tregun botëror gjatë vitit të fundit, të sigurojë kthim pozitiv për klientët e tij

për vitin 2011 me një kthim pozitiv prej 3.93%, që do të thotë që me performancën e tij ka tejkaluar të gjitha fondet pensionale në regjion.

Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve synon të jetë një faktor i rëndësishëm në sistemin financiar, në tregun pensional si dhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të Tregut të Kapitalit Financiar në Kosovë. Me qëllim të kontribuimit të mëtutjeshëm në përmirësimin e gjendjes ekonomike në vend, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve mbështet hapjen e

⁸⁵ Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve është anëtar i Prva Group, grupacion Slloven që njihet si ndër kompanitë më të mëdha të Evropës Juglindore për sigurime pensionale si obligative ashtu edhe vullnetare.

⁸⁶ Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve- Prva Group veprimtarinë e saj e shtrin në shumë vende të Evropës Juglindore dhe në tri prej tyre operon në shtyllën e dytë (obligative), ka 321,864 të siguruar rreth 372.4 milion EUR mjete nën menaxhim dhe ka 33.05 milion EUR kapital.

tregut të letrave me vlerë në Kosovë dhe do të vazhdojë me blerjen e tyre edhe në të ardhmen, duke dhënë kështu kontributin e vet në zhvillimin dhe zgjerimin e tregut të kapitalit. Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve filloi të investoj në letrat me vlerë të Republikës së Kosovës. Në ankandin e rradhës së muajit Maj 2012, Fondi është njëri ndër blerësit e bonove tre-mujore të emetuara nga Republika e Kosovës.

Skema e kursimeve pensionale vullnetare, është skemë liberale, e cila nuk e kufizon lartësinë e shkallës së kontributeve në Fondin Pensional Suplementar. Pagesa e kontributeve pensionale në llogarinë e punonjësit bëhet, 10 % nga paga bruto e punëtorit dhe +10 % mbi pagën bruto të punëtorit, të paguara nga ana e punëdhënësit, i cili mund ta deklarojë shumën e paguar të kontributeve pensionale në Fondin Pensional si shumë e akredituar e tatimit. Kontributet pensionale të paguara në skemat suplementare të pensioneve janë të liruara nga të gjitha format e tatimeve, përfshirë këtu edhe tatimin mbi të ardhurat e korporatave. Gjithashtu Fondet e Pensioneve Suplementare janë të liruara nga tatimet në të ardhurat e realizuara nga investimi i mjeteve dhe në fitimet kapitale.

Këto lehtësira tatimore mundësojnë realizim edhe më të lartë të ardhurave nga investimi i këtyre mjeteve për të gjithë kontributorët si perfitues nga fondi pensional suplementar.

Te gjitha mjetet e grumbulluara në llogarinë individuale të kontributorit të kursimeve pensionale, i takojnë vetëm të siguruarit, pa marrë parasysh se, një pjesë e kontributeve apo tërësisht kontributet janë paguar nga punëdhënësi.

Planet pensionale menaxhohen (administrohen) nga Fondet Pensionale Suplementare, institutuconet apo kompanitë e specializuara për pensione.

Sigurimi suplementar pensional do të jetë përgjegjësi e punëdhënësve dhe e punëtorëve të vet.

Sigurimi pensional mund të integrohet në bonusin e punëdhënësit dhe mund të jetë një element i motivimit për punëtorët, si një shtesë e rrogës.

Për të gjithë klientët e tij, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve mundëson kyçjen në llogari individuale ku secili personalisht mund të përcjellë mjetet e tij të investuara si dhe të informohet në çdo kohë me vlerën e aksioneve, duke ofruar kështu përkushtim të vazhdueshëm për transparencë dhe llogaridhënie.

Duke pasur paraysh që fondet pensionale në vendet e zhvilluara janë investitori kryesorë në tregjet e kapitalit, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve do të vazhdojë të luaj rol in e tij në zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu, duke rritur kështu vazhdimisht investimet në letrat me vlerë të emetuar nga Republika e Kosovës.

5. KAPITULI V: NDIKIMI I FAKTORËVE MAKROEKONOMIK DHE MIKROEKONOMIK NË QËNDRUESHMËRINË E SISTEMIT PENSIONAL

5.1.Liria ekonomike si faktor i qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë

Zbatimi i konceptit të ekonomisë së tregut të lirë në Kosovë e parashtrohet nevojën për adaptim sa më efikas të ekonomisë së vendit, në funksion të lirisë së operimeve në treg. Përmes promovimit të konceptit të lirisë dhe të demokracisë politike, synohet të bëhet zhvillimi ekonomik në Kosovë. Derisa “liria” nënkupton mundësinë e veprimit të çdo kujt, që të përcaktohet për një zgjedhje, duke mos i penguar të tjerët (Adrian Civici, 2015), por i obligon njëherit të gjithë pjesëmarrësit të respektojnë secilin pjesëmarrës në shoqëri.⁸⁷ Nga kjo rezulton se, demokracia është formë liberale e qeverisjes me popull, nga populli, për popullin, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes përfaqësuesve që ndikojnë në organizimin e shoqërisë, duke minimizuar rreziqet që vijnë nga dora e fortë e një individi apo nga ndonjë grup politik.

Pra, demokracia është sistemi më i përshtatshëm për të mbrojtur të drejtat natyrore të njeriut, gjegjësisht lirinë e njerëzve dhe synon t'i parandalon abuzimet në politikë, shoqëri dhe ekonomi.

Liria në ekonomi (Milton Friedman, 1962)⁸⁸ e nxitë interesin e të gjithëve për organizimin e jetës ekonomike, e cila krijon dobinë shoqërore, që rezulton nga bashkëveprimi i shoqërisë në përgjithësi, duke e përcjellë dhe korrigjuar mënyrën e veprimit të personave të ngarkuar me përgjegjësi shoqërore.

Pra, në kushtet e ekonomisë së tregut të lirë dhe të krijimit të mundësive për të hyrë operatorët ekonomik lirshëm në treg nën kushtet e konkurrencës së lirë, është zhvilluar koncepti i vetëqëndrueshmërisë ekonomike. Ky koncept i kishte shërbyer politikëbërësve të sistemit ekonomik që të zhvillojnë Reformën e Sistemit Pensional në Kosovë.

⁸⁷ Adrian Civici “Friderich Hayek- liberalizimi përballë etatizmit”, Universiteti Europian i Tiranës- Fondacioni për liri ekonomike, Tiranë, 2015, f. 51.

⁸⁸ Milton Friedman “Kapitalizmi dhe Liria” është botuar së pari herë, në vitin 1962

Andaj, vetëqëndrueshmëria e sistemit pensional, është një nga cilësitë e pavarësisë së sistemit pensional, i cili mund të sigurojë ekistencën e vet dhe mund të mirëmbahet vet në të ardhmen, pa ndihmën e akterëve të tjerë.

Vetëqëndrueshmëria e sistemit pensional, garanton një shkallë më të lartë të kualitetit të sistemit pensional, sidomos kur sistemi pensional arrin shkallë të lartë të efikasitetit dhe të efijencës së veprimit (duke shmangur varësinë e vet nga jashtë).

Bazuar në teoritë mbi ekonominë e tregut të lirë, të cilat trajtojnë tregjet spontane, apo i plotësojnë nevojat e konsumatorëve mbi bazë të doktrinës “Laissez faire” (bëhet shkëmbimi i lirë i mallrave dhe realizimi i fitimeve, mbi principin e vetëqëndrueshmërisë, i bënë më kokurrenente subjektet ekonomike në treg).

Qëndrueshmëria e Sistemit Pensional varet kryesisht nga kualiteti i vetëqëndrueshmërisë së fondeve pensionale.

Koncepti i qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë, rezulton nga modeli i cili është bazuar në teoritë dhe praktikat më të avancuara botërore të funksionimit të skemave pensionale.

Pra, qëndrueshmëria (Central Bank of Hungary, 2005)⁸⁹ e Sistemi Pensional në Kosovë është komponentë⁹⁰ e ndërtimit të qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe të atij makroekonomik në Kosovë.

Sistemi Pensional bëhet edhe më kualitativ, kur faktorët jo të matshëm (principet e qeverisjes dhe të menaxhimit (Turner. R.K, 1993)⁹¹ të skemave pensionale) rregullohen me akte të përgjithëshme juridike dhe mbikqyren në mënyrë permanente nga Banka

⁸⁹ Central Bank of Hungary. “The Sustainability of the Hungarian Pension System: A Reassessment,” Occasional Papers, No. 40, 2005.

⁹⁰ Natyra e komponenteve të skemave pensionale, të cilat përmbajnë në vete; *të hyrat nga kontributet e definuara pensionale, të detyrueshme apo vullnetare dhe publike, investimet dhe kthimet nga investimet, si dhe komponentat e shpenzimeve (operacionale, menaxhuese)*, bëjnë që sistemi pensional të përmbajë komponenta kualitative dhe të qëndrueshme.

⁹¹ Turner. R.K, Sustainability: Principles and practice, in R. K. Turner (Ed.), Sustainable Environmental Economics and Management: Principles and Practice, London: Belhaven Press, 1993.

Qendrore e Kosovës, duke e shtuar efikasitetin e funksionalizimit të skemave pensionale në Kosovë.

Pra, Sistemi Pensional në Kosovë është i qëndrueshëm⁹², sepse shfaqë aftësi për të qenë rezistent ndaj goditjeve, të cilat shkaktohen nga ambienti ekonomik i brendshëm apo i jashtëm, duke ruajtur shkallën e likuiditetit (duke i përballuar obligimet financiare; shpërndarjen e pensioneve apo anuiteteve pensionale, mbulimin e shpenzimeve të ndryshme, etj.), ekuilibrit, gjegjësisht stabilitetit afatgjatë, duke iu shmangur kolapseve të gjeneruara nga krizat ekonomike.

Qëndrueshmëria e sistemit pensional kushtëzohet nga: *a) Faktorët e matshëm dhe b) Faktorët jo të matshëm.*

5.2. Faktorët mikroekonomik dhe makroekonomik

Faktorët mikroekonomik dhe makroekonomik grupohen sipas ndikimit në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional në;

- 1) Faktorët e pamatshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.
- 2) Faktorët e pamatshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.
- 3) Faktorët e matshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.
- 4) Faktorët të matshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.

⁹² Qëndrueshmëria financiare e sistemit pensional e pasqyron situatën financiare e cila mundëson knaqjen e nevojave të përfituesve të pensioneve përmes subvencionimit nga buxheti shtetëror, apo kursimet e kontributeve pensionale nga llogarite individuale.

5.2.1. Faktorët e pamatshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional

Faktorët e pamatshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional janë; Korniza ligjore, Politikat ekonomike, Mbikqyrja, Ndikimet e jashtme ekonomike.

5.2.1.1. Korniza ligjore

Korniza ligjore e cila rregullon Sistemin Pensional në Kosovë është dizajnuar në atë mënyrë që të rregullojë; *qëllimin, funksionimin, mbikqyrjen dhe vlerësimin e Sistemit Pensional*, si dhe të eliminojë sfidat e mundëshme, të cilat mund të pengojnë zhvillimin e efikasitetit të Sistemit Pensional në Kosovë. Kështu që dizajnimi i kornizës ligjore ndikon në nxitjen e zhvillimit të Sistemit Pensional, si dhe në stabilitetin socio-ekonomik. Rregullimi i stabilitetit të Sistemit Pensional në Kosovë është bërë mbi bazë të përvetësimit, adaptimit të kornizës ligjore përkatëse⁹³ të sistemeve të ngjajëshme në Botë, të cilat kanë dhënë prova të dobishme mbi funksionimin dhe stabilitetin socio-ekonomik. Është kompletuar korniza ligjore duke nxjerrë ligje përkatëse, në harmoni me direktivat e institucioneve ndërkombëtare (BE, OECD, WB, FMN, OBT, ILO, etj.) të cilat kanë për qëllim ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik dhe reduktimin e pengesave sociale në Kosovë.

Sistemi Pensional në Kosove funksionon në bazë të Ligjit Nr. 04/L-101 dhe plotësimit të tij me ndryshimet në Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe me Ligjin Nr. 05/L-116.

Gjithashtu Sistemi Pensional përdor legjislacionin sekondar në formë të rregulloreve dhe të udhëzimeve administrative: *një seri e rregulloreve për pensionet të BQK dhe të*

⁹³ Ligji nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115 dhe ligjin nr. 04/L-168.

Ligji nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës

Ligji nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës

Ligji nr. 04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës

Ligji nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave

Ligji nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale

udhëzimeve administrative të Administratës Tatimore të Kosovës për mënyrën e deklarimit, kontribuimit, korrigjimit dhe tatimit të kontributeve pensionale.

Sundimi i ligjit në Kosovë mundëson mobilizimin e kapitalit të sektorit privat dhe publik përmes; *rritjes së shkallës së investimeve, rritjes së shkallës së punësimit, rritjes së shkallës së të ardhurave, rritjes së standardit të mirëqenies njerezore, gjegjësisht të krijimit të një Sistemi socio- ekonomik të qëndrueshëm.*

5.2.1.2. Politikat ekonomike dhe sociale

Politikat ekonomike dhe sociale në Kosovë kanë për qëllim zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social i cili rregullohet përmes mekanizmave ekonomik dhe social. Realizimi i konceptit neo-liberal mbi zhvillimin e ekonomisë (ekonomisë së tregut të lirë), është përqëndruar në rritjen ekonomike dhe prodhimin e sigurisë sociale (përmes rritjes së standardit jetësor), duke i përkushtuar rëndësi të veçantë faktorëve makroekonomik; *punësimit, prodhimit, investimeve, privatizimit, konsumit, etj.*, të cilët ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe në stabilitetin e situatës sociale.

Pra, një sërë politikash ekonomike (politikat fiskale, financiare, tregtare, investive) e sociale përbëhen nga një tërësi instrumentash që synojnë rregullimin e gjendjes së treguesve makroekonomik, të cilët konsistojnë në ndërhyrjen e qeverisë për t'u përballuar me të hyrat financiare dhe me shpenzimet e shtetit, të cilat administrohen përmes sistemit fiskal.

5.2.1.3. Mbikqyrja e Sistemit Pensional

Banka Qendrore e Kosovës është autoritet mbikqyrës i Sistemit Pensional të Kosovës, e cila mund të ndërmerr një apo më shumë veprime lidhur me mbikqyrjen e operimeve të Sistemit Pensional në Kosovë (fondeve pensionale, sponzoruesve të fondeve pensionale, siguruesve të pensioneve individuale, mbajtësve të mjeteve pensionale apo menaxhuesve të mjeteve pensionale si dhe cili do subjekt i ndërlidhur në sistemin pensional).

Autorizimet dhe përgjegjësitë e Bankës Qendrore të Kosovës për mbikqyrjen e Fondeve Pensionale në Kosovë nderlidhen me përkufizimin e së drejtës për; *licencim, pezullim, revokim të licencave, rishikim të raporteve vjetore të siguruesve të pensioneve, nxjerrje të rregulloreve në përputhje me kërkesat dhe Ligjin mbi pensionet si dhe për rregullimin e lidhjeve apo raporteve të fondeve pensionale me institucionet tjera financiare në Kosovë dhe jasht vendit (bankat, kompanitë e sigurimit, apo operatorët “ofrues të pensioneve”, operatorët tjerë ekonomik).*

Mbikqyrja e fondeve pensionale mbi transaksionet e realizuara⁹⁴ nga ana e BQK-së, ka të bëjë me ekzaminimin e; *qeverisjes, ecurive financiare, të administrimit e të tjera*⁹⁵.

Andaj, mbikqyrja e Fondeve Pensionale është e rëndësishme dhe është në interes të sistemit financiar, sepse mundëson: *funksionim më efikas të Fondeve Pensionale, zbatim të harmonizuar të rregullave financiare, mbrojtje substanciale të integritetit insitucional të Fondeve Pensionale.* Pra, mbikqyrja e Fondeve Pensionale ndikon në; *a) mbrojtjen e fondeve pensionale nga rreziqet e mundëshme; b) mbrojtjen e kontributorëve dhe të sistemit financiar (duke e bërë të mundur përmbushjen e detyrimeve që kanë marrur përsipër); c) promovimin e krijimit të një sistemi të shëndoshë financiar dhe të buxhetit publik; d) përmirësimin e transparencës (duke i bërë publike të hyrat financiare, shpenzimet financiare, gjendjen financiare për publikun); e) efektivitetin e funksionimit të Sistemit Pensional (duke parandaluar abuzimin e pushtetit dhe duke rregulluar sistemin e llogaridhënies); f) zvogëlimin e mundësive për abuzime, shtrembërime (përmes rritjes së shkallës së; përmirësimeve operacionale, efikasitetit, përdorimit të burimeve financiare, shpenzimeve, funksionimit të Sistemit Pensional); g) zhvillimin e mënyrave të ndryshme profesionale për të bërë ekspertizë dhe vlerësime të performancës së Sistemit Pensional.*

BQK mbikqyrë respektimin e të drejtave të kontributorëve gjatë likuidimit të fondeve pensionale,⁹⁶ mbrojtjen nga abuzimi me Fondet Pensionale.

⁹⁴ Rregullën 5 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Raportimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës të datës 25 Korrik 2002

⁹⁵ Ligji nr. 03/I-161 Ligji për tatimin në të ardhurat personale

⁹⁶ Rregulla 21 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Shuarjen e Fondit të Pensionit të dates 23 Tetor 2002

5.2.1.4. Ndikimet e jashtme globale në Sistemit Pensional të Kosovës

Gjendja e zhvillimit ekonomik, këmbimit tregtar, investimeve, tregut të punës, kushëtzohet mjaft nga ndikimet e jashtme, qoftë të prosperitetit ekonomik apo të një krize ekonomike. Kriza globale financiare e vitit 2008, kishte pasur ndikim të konsiderueshëm ndaj Fondeve Pensionale në Kosovë⁹⁷ (kishte ndikuar në zhvlerësim prej 32% të vlerës së investuar të aseteve financiare në tregun e kapitalit financiar nga ana e Fondit Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Pasi që Fondet Pensionale të Kosovës janë të detyruara që të zbatojnë rregullat e OECD mbi mënyrën e funksionimit të Fondeve Pensionale, e në veçanti lidhur me investimet në Tregjet e Kapitalit Financiar Global sipas John Rogers (1995) (ato detyrimisht duhet të investojnë shumën prej 65% të aseteve në tregjet e jashtme globale, ndërsa vetëm 35% mund t'i investojnë në tregun financiar të vendit, nga ato 5% të aseteve mund të investohen në para të gatshme- në bankat komerciale vendore dhe 30 % në bonde qeveritare apo letra me vlerë në formë fletobligacionesh).⁹⁸

Kështu që pos krizave të ndryshme që mund të kenë ndikim të jashtëm në sistemin makroekonomik, që ndërlidhen me operimet e Sistemit Pensional të Kosovës në tregun e kapitalit financiar global (si dhe me zhvillimet financiare në tregun global), ndikim të ndieshëm mund të paraqet edhe shkalla e inflacionit në zonën e investimeve (reflektohet në mënyrë të drejtëpërsëdrejtë në Sistemit Financiar). Dilemat lidhur me faktin se, sa do t'iu rezistojë Reforma e Sistemit Pensional ndikimeve të jashtme, do të varet shumë nga shkalla e impenjimit dhe e ndërvlerësimit të Sistemit Pensional të Kosovës me faktorët makroekonomik ndërkombëtar. Andaj, trajtimi i faktorëve të jashtëm gjatë krijimit të

... Në rast të dyshimit të ndonjë abuzimi organizon hetim të posaçshëm, e mbikqyrë rregullimin e marrëdhënieve të jashtme të Fondeve Pensionale, sidomos mënyrën e përzgjedhjes së institucioneve investuese (performancën e tyre). Mbeshtetë ngritjen e kapaciteteve të vazhdueshme profesionale, vlerëson parashikimet e zhvillimeve të ardhshme dhe rezultatet e pritura të Fondeve Pensionale si dhe i mbështetë përmirësimet e vazhdueshme të tyre.

⁹⁷ Fondi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës kishte investuar 95% të aseteve në tregun e kapitalit financiar global në vitin 2008- 2009.

⁹⁸ John Rogers- Director, Investment Service; NAPF Guide; Investment Management Trustees` Pocket Guide, Launched in 1995, UK

natyrës së politikave ekonomike, është gjithnjë preokupim i politikëbërësve (gjë që shpesh justifikohet si veprim i kushtëzuar nga faktorët ekonomik global).

5.2.2. Faktorët e pamatshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional

Faktorët e pamatshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional janë: Qeverisja dhe menaxhimi, Informacioni dhe transparenca, Ndikimi i teknologjisë informative në Sistemin Pensional, Automatizimi i aktualizimeve kryesore në ueb-faqe, Marketingu.

5.2.2.1. Qeverisja dhe menaxhimi i Sistemit Pensional

"Qëndrueshmëria është aftësia e një organizate për të vazhduar aktivitetet e saj në një kohë të pacaktuar, duke marrë në konsideratë ndikimin e faktorëve shkaktar në natyrën shoqërore dhe njerëzore" (Francesco Perrini, Antonio Tencati , G. Pivato,2006)⁹⁹

Qeverisja apo politikëbërja është aktiviteti qenësor i funksionimit të Fondeve Pensionale. Politikat të cilat i zhvillon një Fond Pensional, njëherit ato janë instrumente të cilat shërbejnë për të realizuar planet e synuara, me qëllim të ndërtimit të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional të Kosovës në periudha afatgjate.¹⁰⁰

Natyra e politikave ekonomike, të cilat përdoren gjatë operimit të Sistemit Pensional, përshkruhen si përmbledhje e koncepteve normative, të cilat bazohen në mishërimin e mënyrave të operimeve të ndryshme, si dhe të teorive alternative mbi funksionimin e sistemeve pensionale.

⁹⁹ Francesco Perrini, Antonio Tencati , G. Pivato' Management Department (IEGI), Bocconi University, and Corporate Finance and Real Estate Department, SDA Bocconi School of Management, Bocconi University, Milan, Italy2SPACE – European Research Centre on Risk, Security, Occupational Health and Safety,, Environment and Crisis Management,
G. Pivato' Management Department (IEGI),, Bocconi University, Milan, Italy Sustainability and Stakeholder Management: the Need for New Corporate Performance Evaluation and Reporting Systems; Business Strategy and the Environment, Bus. Strat. Env. 15, 296–308 (2006), Published online in Wiley InterScience (www.interscience.wiley.com)

¹⁰⁰ Rregullorja Nr. 2001/35 mbi Pensionet ne Kosove; UNMIK/Reg/ 22 December 2001

Tipi i disajnuar i Sistemit Pensional në Kosovë e kushtëzon natyrën e politikave ekonomike, që kanë të bëjnë me; *kursimet pensionale individuale me pronar të identifikuar, të cilët kursejnë në periudhat e ndryshme jetësore, duke krijuar të ardhura në periudha të ndryshme kohore, me qëllim që në të ardhmen të mos bëhen barrë financiare e sistemit ekonomiko- social të vendit.*

Faktorët kryesorë të cilët përcaktojnë bazën e një qeverisje të mirë politike, janë: a) *Natyra e Sistemit Pensional, b) Performanca profesionale e organeve qeverisëse, c) Infrastruktura ligjore e cila e rregullon mënyrën e funksionimit të Fondeve Pensionale, ç) Burimet e informacionit, d) Teknika e teknologjia e përpunimit të informatave, dh) Baza e sigurisë së informatave.*

Politikat e qeverisjes dhe të menaxhimit të Fondeve Pensionale bazohen në; a) *Orientimet e operimeve të Sistemit Pensional, b) Planet, c) Prioritetet, ç) Kompetencat, d) Potencialet zhvilluese, etj.*

Natyra e politikave ekonomike varet nga; a) *Ndërlikueshmëria e operimeve, b) Llojet e operimeve, c) Potencialet njerezore në disponim, ç) Potencialet ekonomike, d) Principet e operimeve, dh) Instrumentet apo rregullatoret operuese, e) Momentet e operimit, etj.*

Ndërlikueshmëria e operimeve të Sistemit Pensional, varet nga struktura dhe funksionaliteti i tij, llojet e operimeve, të cilat vehen në kombinim, në varësi nga potencialet njerezore në disponim dhe nga potencialet ekonomike.

Parimet themelore të reformës së Sistemit Pensional në Kosovë mbi qeverisjen, kanë të bëjnë me: 1) *Përgjegjësinë fiduciare, 2) Përkufizimin e qartë të objektivave qeverisëse, 3) Përkufizimin e roleve dhe përgjegjësi, 4) Matjen e performancës së organeve qeverisëse, 5) Ndërtimin e qasjes në informata, 6) Menaxhimin e riskut qeverisë, 7) Mbikqyrjen, 8) Transparencën dhe kontabilitetin, 9) Rregullimin e kodit të udhëheqjes dhe të konfliktit të interesit, 10) Rishikimin e qeverisjes.*¹⁰¹

¹⁰¹ Reforma e Pensioneve e UNMIK-ut- Përmbledhje; Dokument me Nr. AS/CFA/ 21 Ferbruary 2002

Këto parime janë përdorur në krijimin e politikave ekonomike të Sistemit Pensional në Kosovë, të cilat kanë shërbyer për definimin, ngritjen e përgjegjësisë, transparencën dhe shtimin e kujdesit gjatë qeverisjes së Sistemit Pensional. Kështu që këto parime janë bërë komponenta përbërëse të politikave ekonomike, të cilat i kanë përforcuar faktorët shkaktues të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë.

Vuarja në dilemë e qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional të Kosovës, apo relativizimi i mundësisë së lëndimit, përmirësimit të qëndrueshmërisë së tij (Hal Swerissen, 2007)¹⁰², ndërlikohet me natyrën e politikave ekonomike, të cilat aplikohen gjatë qeverisjes, të cilat duhet t'i nënshtrohen planifikimit të vetëzhvillimit dhe të zhvillimit të procesve socio-ekonomike, në mënyrë që përmes politikave ekonomike përkatëse, të ndërtohet struktura e qëndrueshmërisë së tij, brenda sistemit makroekonomik.

Esenca e trajtimit të politikave ekonomike në Sistemin Pensional në Kosovë, është fokusuar në ndërtimin e qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional, i cili konsiston në *përgjegjësinë fiduciare të anëtarëve të organeve qeverisëse*, të përkufizuar si status „Trustee“ me aktet ligjore.¹⁰³

Përmes rezultateve të analizave mbi ndikueshmërinë e politikave në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional në Kosovë, është bërë interpretimi i; *përmbajtjes së tyre, ndryshimeve praktike, krahasuar me rregullat standarde dhe teorike, të cilat shërbejnë për diagnostifikimin e kualitetit të qëndrueshmërisë, mirëmbajtjes së saj, nxitjes së ndikimeve pozitive në periudha afatgjate, përmirësimeve të nevojshme të vazhdueshme* (Estelle James, Sarah Brooks, 2003)¹⁰⁴

Kështu që, bazuar në modelin e disjenimit, kompetencat, përgjegjësitë e Sistemit Pensional në Kosovë, bëhen testimi i qëndrueshmërisë së tij, duke shqyrtuar faktorët

¹⁰² Hal Swerissen, Faculty of Health Sciences, La Trobe University; Understanding the Sustainability of Health Programs and Organisational Change, A Paper for the Victorian Quality Council, June 2007

¹⁰³ Canadian Association of Pension Supervisory Authorities; Guideline Nr.4; Pension Plan Governance Guidelines and Self- Assessment questionnaire, October 24, 2004

¹⁰⁴ Estelle James (World Bank) and Sarah Brooks (Duke University); The political Economy of Structural Pension Reform, 2003.

themelorë shkaksorë, të cilët i përbëjnë komponentat e strukturës së qendrueshmërisë së Sistemit Pensional, si vijon: a) Konfiguracioni i sistemit pensional, b) Rregullatoret ligjor, c) Plani pensional, ç) Kompetencat e organeve qeverisese, d) Performancat e organeve qeverisese, dh) Politikat makroekonomike, e) Faktoret ekstern, f) Sistemi i informatave.

Andaj, është e nevojshme që në mënyrë permanente të bëhen rishikimet dhe vlerësimet, në bazë të gjendjes kontabël dhe të planit zhvillimor. Ndryshimet e mundëshme, të cilat paraqiten gjatë vlerësimit, analizohen dhe lidhur me to, ndërtohen gjykimet, të cilat pasqyrojnë ecurinë, se nga kanë rezultuar ato dhe mbi atë bazë ndërmirren vendimet për zhvillimin e politikave për periudhat e ardhëshme, që mund të afektojnë pozitivisht Fondet Pensionale.

5.2.2.2. Informacioni dhe transparencia¹⁰⁵

Asimetria e informacionit financiar, shkakton shfaqjen e fluskave spekulative, krijimin e panikut financiar, kolapsin financiar, falimentimin e sistemeve financiare, etj. Andaj, si rrjedhojë e asimetrisë financiare shfaqen *fluskat spekulative*, të cilat i dëmtojnë rëndë sistemet financiare.¹⁰⁶ Pra, sistemi pensional dhe të gjithë akterët që ndërlidhen me të, duhet të jenë transparent, sepse lëndimi i Sistemit Pensional, në thelb i lëndon interesat jetike të Sistemit Financiar dhe të kontributorëve individual. Andaj, qëllimi i transparencës është zhvillimi i dukshëm, i saktë dhe i vërtetë i operimeve financiare në

¹⁰⁵ Fjala transparencë (Trans·par·ent- **adjective** \tran(t)s- 'per-ənt që do të thotë “gjendje për t’u parë lehtë, apo të vërehet qartë ose në mënyrë të kuptuar: e ndershme dhe e hapur: e pa fshehtë”). Fjala transparencë i ka rrënjët nga fjala latine, e cila përbëhet nga dy fjalë “trans”, që do të thotë “të gjithë” ose “mbi” dhe *parens-* që është prapashtesë e fjalës “transparent”, për ndryshe fjala *transparencë* rrjedhë prej fjalës latine “*appareo*” që do të thotë “të bëhen të dukshme” apo “to appear” që do të thotë “për të dalë në dritë”. Pra, transparencia e paraqet ndritshmërinë që transmetohet, për të bërë të dukshëm zhvillimin e proceseve, në mënyrë që ato të kuptohen lehtësisht, apo të shihen në mënyrë të sigurtë dhe të mjaftueshme për të mos pasqyruar ndonjë mashtrim.

¹⁰⁶ Fluska të njohura gjatë historisë janë: fluska financiare Wall Street më 1929, fluska e pasurive në Japoni në vitet 1980, shfryrja e fluskës “dot.com” në 2000-2001, fluska e Enronit 2002 dhe kolapsit të Worldcom në 2002, fluska e falimentimeve të Bears Stearns, Lehman Brothers e Aig (kriza kredive për shtëpi në SHBA), fluska e Wall Street e vitit 2007-2008. Pasqyron qartë efektet e krizës, ku fondet e pensioneve të vendeve të OECD-së kanë pesuar ndryshime të vlerës se aseteteve financiare duke ulur vlerën e aksioneve nga 50% në fund të vitit 2007, në 41% në Dhjetor të vitit 2008. Ndër fondet e pensioneve më të mëdha që kishin pësuar humbje gjatë krizës është edhe CalPERS 47 (California Public Employees' Retirement System), ku vlera e aksioneve të tij kishte rënë rreth 30% 48 % të vlerës së aksioneve apo rreth 100 miliardë dollarë gjatë vitit 2008.

interes të publikut, për të maksimizuar vërtetësinë ekonomike, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe të qëndrueshmërisë ekonomike të Sistemit Pensional.

Institucionet publike janë të obliguara që të udhëheqin evidencën zyrtare dhe të rregullt, në formë të; *raporteve, regjistrave, komunikatave ose ngjashëm, përkitazi me kërkesat, veprimet, procedurat dhe vendimet ligjore.*

Transparenca e Fondeve Pensionale përqëndrohet në; *dhënien e informacioneve shpjeguese, qartësimin e operimeve, saktësimin e operimeve, etj. Andaj, transparenca është e definuar si zhvillim kualitativ i publikimit të informatave të cilat përpunohen në mënyrë; të vërtetë, konsistente, në kohë të caktuar dhe të saktë.*

Transparenca ka për qëllim, të pasqyrojë transaksionet financiare të sakta, të cilat mund t'i nënshtrohen kontrollit të pavarur, me qëllim të krijimit dhe rritjes së besueshmërisë. Sa më e lartë që të jetë shkalla e kontrollit të politikës monetare, aq më e lartë do të jetë shkalla e transparencës financiare.

Autoritetet përgjegjëse të zhvillimit të politikave ekonomike-publike, janë të obliguar që të shfrytëzojnë praktikën më të mirë të zhvillimit të demokracisë për ngritjen e strukturave ekonomike, të cilat sigurojnë vazhdimësi dhe sukses të bazuar mbi lirinë e tregut dhe mbi transparencën ekonomike.

Liria e tregut dhe transparenca janë dy mekanizma që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Liria ekonomike vjen si pasojë e lirisë dhe demokracisë shoqërore, por jo edhe të anarkisë. Anarkia është abuzim me lirinë dhe manifestohet përmes tiranisë dhe spekulimeve.

Sipas Herbert H. Werlin (2007)¹⁰⁷ i cili thotë se... *“E keqja e madhe në demokraci është tirania e shumicës, e partisë në pushtet, që e ushtron me forcë pushtetin ose bën mashtrime. Në këtë mënyrë demokracia liberale shëndërrohet në demokraci të kufizuar”.*

¹⁰⁷Herbert H. Werlin ” Is Lord Acton Right? Rethinking Corruption, Democracy, and Political Power, What is democracy?”, 2007.

Pra, demokracia në mungesë të transparencës shëndërrohet në anarki, tirani e shumë çka tjetër që cenon të drejtat themelore individuale. Anarkia luftohet me ligje dhe rregulla, duke vendosur principe dhe mekanizma të transparencës, të cilat mundësojnë afarizëm të dukshëm, të qartë dhe orientues për zhvillim të mëtejshëm.

Një nga format e komunikimit të veçantë është edukimi i publikut, i cili mund të bëhet në formë të drejtëpërdrejtë dhe përmes mediave.

Transparenca e ngritë nivelin e përgjegjësisë për informim dhe raportim. Transparenca në Sistemin Pensional të Kosovës fillon nga përzgjedhja e stafit qeverisës dhe e stafit menaxhues konform kërkesave ligjore për profesionalizëm, ndershmëri dhe besueshmëri.

Transparenca e mundëson zvogëlimin e shanseve për mashtrime apo skandale korporative dhe shërben për përmirësimin e veprimeve ekonomike të Sistemit Pensional, efikasitetit të operimeve dhe në vendim- marrje si dhe në mbrojtje të reputacionit.

Si rezultat i zhvillimit të procesit të transparencës, është llogaridhënia, e cila pasqyron përdorimin efikas të burimeve publike dhe private në sistemin financiar, në veçanti në Sistemin Pensional (përdorimi i parave të kontributorëve, të taksapaguesve dhe mbrojtja e interesave të pensionerëve apo të përfituesve të pensioneve) të rregulluar me ligj.

Pra, përmirësimi në vetqëndrueshmërinë e Sistemit Pensional, çon drejt rritjes së qëndrueshmërisë së sektorit financiar (sistemin bankar, sistemin i sigurimeve dhe sistemin pensional), përmes përmirësimit të qasjes transparente në sistemin financiar dhe në investime, duke rritur besueshmërinë për institucionet financiare, institucionet tregtare të ekuiteteteve vendore apo të huaja, gjegjësisht të investitorëve të kapitalit financiar, të cilët krijojnë kthime në të mirë të Fondit Pensional, gjegjësisht kontributorëve.

Komunikimi më i shpeshtë dhe më funksional, bëhet përmes formës elektronike, apo përmes web- faqes, në të cilën publikohen informatat relevante të Sistemit Pensional; *raportet, dokumentet e auditimit, informatat lidhur me tregun e investimeve, qasjet në llogaritë individuale, informatorët periodik, rregullat dhe ligjet gjegjëse me të cilat shërbehen entitetet e Sistemit Pensional, informatat mbi aktivitetet e institucioneve pensionale, komunikatat për shtyp, pasqyrat e llogarive individuale, etj.* Te gjitha informatat publikohen në gjuhët e kontributorëve të komuniteteve; *në gjuhën shqipe, serbe, angleze si dhe në gjuhën turke.*

Të gjitha llojet e publikimeve, synojnë arritjen e një niveli të lartë të transparencës së Fondeve Pensionale, para kontributorëve dhe të palëve të interesit, në mënyrë që ata të informohen, me mënyrën e administrimit të Fondeve Pensionale dhe me rregullat e aplikueshme të qeverisjes, organizimit të brendshëm të Fondeve Pensionale.¹⁰⁸

Informacioni periodik¹⁰⁹ - Fondet Pensionale kanë detyrim themelor për të publikuar; deklaratat zyrtare të bërë nga personat përgjegjës të Fondeve pensionale raportet financiare vjetore, raportet financiare të audituara, raportet e administrimit, etj.

Raportet financiare¹¹⁰ të përgatitura sipas standardeve të përcaktuara të kontabilitetit pasqyrojnë gjendjen e vërtetë dhe të drejtë të aseteve, detyrimeve, pozitës financiare, fitimeve dhe humbjeve të fondeve pensionale.¹¹¹ Ato përgatiten në mënyrë profesionale, duke pasqyruar saktë ecuritë periodike financiare, ndërsa raportet e auditimit përmbajnë vështrimin kritik mbi mënyrën e evidentimit, procesimit të dhënave dhe respektimit të ligjeve në fuqi.

Fondet Pensionale i bëjnë publike të dhënat dhe treguesit më të rëndësishëm të aktiviteteve investuese dhe operacionale, si: *çmimi i aksionit, performanca investuese, numri i kontribuesve, mjetet nën menaxhim, performanca e menaxhuesve të mjeteve, alokimi i mjeteve, pensionet e shpaguara, njoftimet rreth eTrusti-t e të tjera informacione me rëndësi për kontribuesit, etj.* Gjithashtu Fondet Pensionale bëjnë mirëmbajtjen e;

¹⁰⁸ <http://al.ejo-online.eu/460/marredheniet-publike/e-drejta-e-informimit-ne-realitetin-shqiptar>

¹⁰⁹ Rregullores së Prospektit, Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 809/2004 e 29 Prillit 2004.

¹¹⁰ Rregulla 16 e BQK, mbi Vlerën e Kontributeve të Pensionit

¹¹¹ Rregulla 5 e BQK, Lista e Taksave dhe Shërbimeve Financiare, Raportet tremujore

publikimeve, broshurave, formularëve të disponueshem për publikun, publikimin e raporteve statistikore dhe të dhënave tjera numerike për të prezentuar progresin, si rezultat i implementimit të programeve të ndryshme në lidhje me shërbimet e operimeve, dhënien e informatave shtesë, publikimin e aktiviteteve rreth ngritjes së vetëdijes së publikut dhe aktiviteteve tjera të jashtme, udhëzimin e publikut, e informata te tjera relevante.¹¹²

5.2.2.3. Ndikimi i teknologjisë informative në Sistemin Pensional

Bazuar në modelin e skemës pensionale, është bërë modelimi i sistemit të Teknologjisë Informative për përpunimin e të dhënave, roli i të cilit është kyç në funksionimin efikas të skemave pensionale, sepse ai mundëson futjen, përpunimin e të dhënave në sistem, azhurnimin e rrjedhës financiare gjatë tërë periudhës kohore. Andaj, sistemi i teknologjise informative e paraqet komponentën më të ndieshme të qëndrueshmërisë së sistemit pensional dhe si i tillë është disejnuar që të ruhet në mënyrë të sigurtë dhe të përballojë goditjet apo fatkeqsitë e mundëshme.¹¹³

Perdorimi i pajisjeve hardwerike dhe softwerike¹¹⁴ mundësojnë bartjen shumë më të shpejtë dhe të sigurtë të të dhënave, përmes krijimit të linjës së dedikuar ndërmjet dy qendrave, dhe sigurimit të linjës së internetit me shpejtësi shumë të lartë bëhet bartja e rreth 2.7 milionë pagesave në sistemin e TI, dhe 14 milionë transaksioneve individuale.

Sistemit aktual i Teknologjisë Informative mundëson publikimin e të dhënave në internet (përmes ueb-faqes) te Fondeve Pensionale dhe mundëson komunikimin e drejtëpërdrejtë me kontribuuesit dhe publikun (në të gjenden informacionet e nevojshme dhe

¹¹² Në bazë të Rregullës 5 të BQK-së (Lista e Aseteve, Blerja dhe Shitja, Barazimet), buletini tremujor është botim i rregullt i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), emërtohet "Trustorja".

¹¹³ Faza e parë ishte dakordimi për specifikacionet dhe pritshmëritë, faza e dytë dorëzimi i softuerit me specifikacionet e kërkuara dhe trajnimi bazik për stafin përgjegjës dhe faza e tretë do të jetë migrimi i të dhënave, testimi dhe riparimi i problemeve eventuale.

¹¹⁴ Testimi do të provonte nëse i gjithë aktivitetit ditor i TKPK-së do të funksionojë normalisht gjatë simulimit të tij në ambientin rezervë. Të gjithë serverët, dhe aplikacionet që përdoren në baza ditore nga klientët (testi kishte qene me sukses të plotë). Asnjë proces që përcakton veprimtarinë ditore të FKPK-së nuk kishte hasur në pengesa gjatë testimit.

aktualizimet e tyre; llogaritë e kontributorëve, kontributet, investimet, kthimet nga investimet, shpenzimet, të dhënat krahasuese të performancës së Fondeve Pensionale, të dhëna shtesë në baza historike, etj.

Krijimi i zyrës rezervë të Teknologjisë Informatike e kompletuar me të gjitha pajisjet e nevojshme harduerike e softwer-ike, e cila do të jetë në gatishmëri për të akomoduar stafin kyç të Sistemit Pensional, në rast të ndodhjes së ndonjë fatkeqësie natyrore ose njerëzore, apo të pamundësimit të aktiviteteve ditore në zyrat qendrore të Sistemit Pensional, duke ofruar shërbime nga zyra rezervë (përgatitja e hapësirave rezervë, lidhjes me linjë të veçantë të internetit të zyrës qendrore me zyrën rezervë dhe transferimi i të gjitha të dhënave nga serverët qendrorë tek serverët rezervë).

Rëndësia e ruajtjes së informatave në serverë dhe ambiente rezervë jashtë vendit, në hapsira shumë të sigurt ofron një siguri shumë të lartë në ruajtjen dhe vazhdimin e punës, në rast të fatkeqësive të mëdha brenda një periudhe prej 24 orësh.

5.2.2.4. Marketingu

Me qëllim të promovimit të Sistemit të ri Pensional në Kosovë, është bërë informimi i kontributorëve (punëdhënësve, punëmarrësve dhe të fuqisë së aftë për punë që është potencial i tregut të punës) mbi funksionalizimin e sistemit të ri pensional (edukimi i nevojshëm i kontributorëve), lansimin e shërbimeve të sistemit pensional në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe on-line¹¹⁵.

Janë bërë promovime të vazhdueshme, për përdorimin e këtyre produkteve, në veçanti për të kontrolluar gjendjen e llogarisë individuale të kursimeve pensionale, verifikimin e përcaktimit të trashëgimtarëve ligjor, aplikimin për pension nga shtëpia, si dhe postimi i kërkesave të ndryshme direkt nga llogaria.

¹¹⁵ Është mundur informimi elektronik mbi funksionalitetin e përgjithshëm të fondeve pensionale (shërbimet on line; pasqyrat vjetore, të dhënat e ndryshme, vegëzat me qëllim të kontaktimit të kontribuesve për korrigjimin ose gjetjen e adresave të tyre të sakta, si dhe mundësitë tjera kontaktuese).

Është bërë promovimi i aktiviteteve aktuale dhe informimi sa më transparent i kontribuesve dhe i publikut, përmes fletushkave të shpërndara në dorë dhe në formë elektronike të komunikimit, si dhe është shtuar mundësia e ofrimit të shërbimeve on-line, përmes së cilit mund të kontrollohet llogaria në internet, si dhe ofrohen shërbime tjera që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të komunikimit me kontribuesit, dhe publikun e gjerë.

5.2.3. Faktorët e matshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional

Faktorët e matshëm makroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional janë; *Popullsia, Punësimi, Papunesia, Informaliteti, Varferia, BPV, Konsumi, Inflacioni*.

5.2.3.1. Potenciali human

Sipas regjistrimit të popullsisë i cili ishte bërë në vitin 1981, Kosova kishte 1.584.000 banorë.

Në Kosovë kanë ndodhur shumë lëvizje të popullsisë gjatë periudhës 1990- 1999, sidomos në vitin 1999, gjatë luftës në Kosovë, kosovarët (shqiptarët) ishin dëbuar me dhunë policore nga pushteti Serb, i cili e kishte bërë dëbimin masiv të shqiptarëve jashtë vendit, kështu që pushteti serb e kishte penguar rritjen e pritshme të popullsisë (me gjithë shtimin natyror prej 12,7 për 1.000 banorë)¹¹⁶.

Ndërsa sipas vlerësimit të vitit 2011 numri i popullsisë ishte 1.733.872 banorë¹¹⁷, (burime tjera vlerësojnë se numri e popullsisë është 2.200.000 banorë).

¹¹⁶ https://www.google.com/?gws_rd=ssl#q=popullsia+e+kosoves

¹¹⁷ Janë marrë për përdorim të dhënat statistikore mbi popullsinë të vitit 2011, sepse në këtë vit është bërë regjistrimi zyrtar i popullsisë. Nga ky regjistrim rezulton se popullsia e Kosovës përbëhet kryesisht nga komuniteti etnik shqiptar, që sipas burimeve formon 88% deri në 92 % të banorëve (sipas vlerësimeve të Agjencise së Statistikave të Kosovës, shqiptarët përbëjnë 88% të popullsisë).

Sipas “Vlerësimit të popullsisë për vitin 2015” numri i popullsisë rezidente në Kosovë ishte 1,771,604 banorë rezident. Sipas të dhënave nga ASK-së numri i lindjeve për vitin 2016 ishte gjithsej 30,331 lindje në Kosovë, ndersa numri i vdekjeve ishte prej 9,245 vdekje. Shtimi natyror i popullsisë së Kosovës gjatë vitit 2016 ishte rritur për 20,867 banorë, mirëpo për shkak të emigrimit të 22,012 banorëve rezidentë nga Kosova, numri i tërësishëm i popullsisë ishte zvogëluar për 926 banorë. Kështu që popullsia në Kosovë në vitin 2016 vlerësohet të jetë 1,783,531 banorë rezident.

Kosova e ka popullatën shumë të re, me moshën mesatare prej 25,9 vjeç,

Struktura e popullsisë sipas moshës është si vijon; 70% e popullsisë janë nën moshën 30 vjeçare; 33% i përkasin moshave 0-14 vjeçare dhe vetëm; 6% janë mbi 65 vjeçare.

Në Kosovë dendësia e popullsisë në vitet e 90-ta kishte arritur në rreth 300 banorë në 1 km² (B/Km²), gati si në shtetet më të dendura të Evropës (Beneluksit).

Lëvizjet natyrore të popullsisë, 2003-2017		
Variablat për 1.000 banorë		
Nataliteti 16,3	Mortaliteti 3,6	Shtimi natyror 12,7
Viti	Nr i popullsisë	
2003	2 016 000	
2004	2 041 000	
2005	2 070 000	
2006	2 100 000	
2007	2 126 000	
2008	2102000	
2009	2190000	
2010	2.208.107	
2011	1.733.872	
2012	1.815.606	
2013	1.820.631	
2014	1.804.944	
2015	1.771.604	
2016	1.783.531	
2017	1.798.506	

Tabela Nr.2. Lëvizjet natyrore të popullsisë në Kosovë gjatë periudhës 2003- 2017¹¹⁸

¹¹⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës

Nga tabela shihet se shtimi mesatar vjetor në Kosovë është 12,7%, gjë që vërehet se ka rënie të vazhdueshme të shtimit natyror, ndërsa lindshmëria është 16,3‰, kurse vdekshmëria 3,6‰.

Shpërndarja sipas moshës	
Mosha	Përqindja (%)
0-14 vjet	33 %
15-64 vjet	61 %
65 - 65+ vjet	6 %

Tabela. Nr.3. Shpërndarja sipas moshës ¹¹⁹

Nga tabela e mësipërme shihet se 61% e popullatës në Kosovë i takojnë grup-moshës 14 deri në 64 vjet, ndërsa vetëm 6% të popullsisë i takojnë grup-moshës 65 vjeqare dhe mbi të.

Jetëgjatësia mesatare	
Gjinia	Vite
Femra	71
Meshkuj	67
Mesatarja e dy gjinive	69

Tabela Nr.4. Jetëgjatësia mesatare në Kosovë
Jetëgjatësia mesatare e mashkujve është 67 vjet, ndërsa e femrave është afro 71 vjet, ndërsa mesatarja e jetëgjatësisë në Kosovë është 69 vjet.

Numri i fëmijëve, nxënësve dhe i studentëve			
Niveli arsimor	Gjithsej	Femra	Meshkuj
Parafillor	25.721	12.361	13.390
Fillor	322.864	154.873	167.991
I mesëm	74.635	32.807	41.828
Fillor special	703	267	436
I mesëm special	94	36	58
Universitar	28.707	15.453	13.254
Gjithsej	452.724	215.797	236.95

Tabela. Nr. 5. Numri i fëmijëve, nxënësve dhe i studentëve ¹²⁰

¹¹⁹ <http://www.ks-gov.net/esk/>

¹²⁰ https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia_e_Kosov%C3%ABs

Nga tabela shihet se kontigjenti i ri popullsisë¹²¹ i cili prej vitit në vit hyn në tregun e punës përbëhet nga kategoria e nxënësve të cilët e mbarojnë shkollën e mesme dhe universitetin, që sillet rreth 30.000 persona aktiv për punë.

Kosova dallohet për pjesmarrje të lartë të popullsisë aktive në tregun e punës, në raport me shkallën e absorbimit të saj në punë, për shkak nivelit të ultë të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

5.2.3.1.1. Punësimi

Në vitin 2017 në Tregun e punës së Kosovës kishte 325.261 punëkërkues, kështu që nën kushtet e zhvillimit ekonomik që kishte Kosova, ishte vështirë që “Tregu i punës” të absorboj këtë potencial punëkërkuesish, si dhe personat të tjerë që futeshin në treg të punës për çdo vit.

Tregu i punës në Kosovë karakterizohet, si treg kryesisht me fuqi të re të punës, sepse një e treta e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare dhe mbi 50% e popullsisë është mbi moshën 24 vjeçare.

Numri i popullsisë në moshë pune (63.1%), të cilët nuk janë ekonomikisht aktiv¹²² dhe numri i personave joaktiv¹²³ (59.5 %) përfshinë 708,436 persona.

Bazuar në statistikat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rezulton se *në Kosovë hyjnë për së pari herë në tregun e punës rreth 25,000 persona të rinjë, që hyjnë në kategorinë e fuqisë së aftë punëtore, ndërsa personat që arrijnë moshën për pension për një vit sillet rreth 8,000 persona.*

Pra, numri i personave që dalin nga fuqia punëtore apo që pensionohen është shumë më i vogël, në krahasim me personat që hyjnë në treg të punës.

¹²¹ Struktura ekonomike e popullsisë e tregon raportin e popullsisë aktive dhe jo aktive, si dhe shpërndarjen e popullsisë aktive sipas veprimtarive.

¹²² Persona ekonomikisht aktiv konsiderohen ata që e kanë një vend pune, ose e kërkojnë një vend pune të tillë.

¹²³ Persona joaktivë janë ata që nuk duan të punësohen, ose kanë hequr dorë nga kërkimi i vendeve të punës.

Ndërsa brenda një viti në Kosovë punësohen përafërsisht 8000 deri 9000 persona, të cilët dalin nga tregu i punës në Kosovë.

Në bazë të statistikave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2017, vërehet se një përqindje shumë e lartë e popullsisë së moshës së punësimit është e pa punë, si dhe shumica e të papunësuarave që janë në fuqi joaktive nuk janë duke kërkuar punë.

Konsiderohet se, dy të tretat e popullsisë së Kosovës është në moshë pune (15-24 vjeç), gjë që papunësia e tyre konsiderohet se është shumë e lartë dhe paraqet vështirësi për punësim, sepse këta persona nuk kanë arsimim adekuat dhe nuk përfitojnë trajnime të nevojshme sipas kërkesave të tregut të punës.

Vitet	Numri i të punësuarëve sipas viteve 2010-2017
2010	249756
2011	255562
2012	261892
2013	281388
2014	290055
2015	296900
2016	286,848
2017	323,689

Tabela Nr. 6. Numri i të punësuarëve në Kosovë gjatë periudhës 2010-2017¹²⁴.

Bazuar në të dhënat e FP te TKPK në vitin 2017 ishin 352,849 kontribues aktiv në FP te TKPK (punëmarrës dhe të vetëpunësuar), gjë që rezulton se 26.9% e popullsisë aktive për punë në Kosovë ishte e punësuar në mënyrë formale, ndërsa 3% e popullsisë së punësuar ishte punësuar në mënyrë informale ($26,9\%+3\%= 29,9\%$ shkalla e papunësisë në Kosovë).

Si rezultat i zhvillimit të ulët të ekonomisë, numri i të punësuarëve të rinjë brenda një viti është (i vogël) prej 7,000- 13,000 të punësuar të rinjë.

¹²⁴ Rezultatet e ASK-së në vitin 2017

Shkalla e pjesëmarrjes së popullsisë¹²⁵ në fuqinë punëtore në Kosovë është (483,193 persona) 40.5 %, prej tyre punojnë 338,364 persona apo 70%, e të papunë janë vetëm 144,829 persona apo 29,9%.¹²⁶ Gjithashtu llogariten si persona të punësuar edhe personat të cilët janë të aftë për punë, por që punojnë në vende të paqëndrueshme të punës (16.8%).

Pjesmarrja e lartë e papunësisë, rezulton nga trendi respektiv i zhvillimit ekonomik dhe nga struktura e saj, e cila shumë pak është e orientuar në zhvillimin e bujqësisë dhe të industrisë.

Gjithashtu edhe struktura e arsimit të popullsisë, është në raport të zhdrejtë me: nevojat e tregut të punës, trendin e industrializimit, urbanizimin, dhe me trendin e migrimit të popullsisë në vendet e Evropës.

Shkalla e papunësisë në regjion në vitin 2013 ishte, në; IRFJ të Maqedonisë prej 31,2%, në Kosovë ishte prej 30,9 %, në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte 27,5%, në Serbi ishte 23,1%, në Mal të Zi ishte 19,7%, në Shqipëri ishte 17,7 %, në 28 vendet e EU ishte 10,5 %.¹²⁷

Pra, sa më e lartë të jetë shkalla e papunësisë, aq më e lartë është shkalla e varfërisë.¹²⁸

Shkalla e punësimit në vitin 2013 regjion ishte; në Kosovë 28,4%, në Bosnjë e Hercegovinë 31,6%, në IRFJ të Maqedonisë 44,0%, në Serbi 46,4%, në Mal të Zi 47,4%, në Shqipëri 50,5% ndërsa në 28 vendet e EU 64,1%.

¹²⁵ Rezultatet e ASK-së në vitin 2013 mbi vlerësimin e popullsisë: popullsia bazë + nataliteti - mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm apo $P_n + (N-M) + (I-E)$ P_n -Numri i banorëve të përlllogaritur për vitin e dhënë (2013) N -Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2014 M -Numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2014 I - Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2014 E -Emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2014.

¹²⁶ Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës rezulton se shkalla e papunësisë së fuqisë punëtore në Kosovë është 29,9%.

¹²⁷ Krahasimi i statistikave kyçe të punësimit mes vendeve në regjion. Shkalla e papunësisë në vitin 2015 në Greqi dhe në Spanjë ishte rreth 25%, ndërsa në Gjermani ishte vetëm 5%.

¹²⁸ Sipas Bankës Botërore varfëria në Kosovë përfshinë; rreth 29 për qind të popullsisë jetojnë në varfëri të përgjithshme dhe 8 për qind e popullsisë jetojnë në varfëri ekstreme. Shumica e përfituesve nga pagesat e ndihmës sociale në Kosovë e zvogëlojnë nivelin e varfërisë së tyre, por këto pagesa janë të pamjaftueshme për t'i ngritur mirëqenën e popullatës së varfër mbi linjën e varfërisë. Në vitin 2010, Pensioni bazë në Kosovë ishte 45 euro në muaj, pothuaj i barabartë me linjën e varfërisë prej 46.50 euro. Shkallët e varfërisë janë më të ulëta tek ekonomitë.

Shkalla e punësimit				Vitet		
Shtetet	2000	2005	2006	2007	2008	2009
EU-27	62.2	63.5	64.5	65.4	65.9	64.6
Kroacia	51.3	55,0	55.6	57.1	57.8	56.6
Islanda	83.3	83.8	84.6	85.1	83.6	78.3
Mali i Zi	38.5	40.9	41,0	49.2	50.8	48.7
Maqedonia	40.3	37.9	39.6	40.7	41.9	43.3
Turqia	48.9	44.4	44.6	44.6	44.9	44.3
Shqipëria	55.1	49.7	46.2	56.4	53.8	53.4
Bosnja e Hercegovina	:	:	35,0	36.8	40.7	40.1
Serbia	59.2	51,0	49.9	51.5	53.7	50.4
Kosova	:	28.5	28.7	26.2	24.1	26.1


Tabela Nr. 7.Shkalla e punësimit nga viti 2000 deri 2009 ne shtetet e Eu dhe të disa vendeve të Europes.*Burimi: Eurostat, 2010

Duke u bazuar në parashikimet për zhvillimin e shkallës së shtimit të popullsisë sipas grup-moshave, vimë deri te parashikimi i nivelit total të popullsisë për vitet në vijim 2011-2061, se numri i popullsisë në vitin 2061 do të shënojë rënie për 2%. Nga ky parashikim rezulton se, grup-mosha prej 0-14 vitesh pritët të zvogëlohet prej 56%, grup- mosha prej 15-64 vitesh do të zvogëlohet prej 12%, ndërsa gup-mosha mbi 65 vitesh pritët të4 fishohet.

Vitet	Popullsia sipas moshes				Popullsia sipas moshes ne %			
	Gjithesejt	0-14	15-64	65-	Gjithesejt	0-14	15-64	65-
2011	1,780,021	495,101	1,162,044	122,876	100	27,8	65,3	69
2021	1,883,805	406,059	1,301,556	176,190	100	21,6	69,1	94
2031	1,931,957	371,065	1,308,534	252,385	100	19,2	67,7	13,1
2041	1,923,175	313,466	1,262,015	347,693	100	16,3	65,6	18,1
2051	1,859,447	256,760	1,177,814	424,872	100	13,8	63,3	22,8
2061	1,743,470	215,907	1,022,265	505,299	100	12,4	58,6	290

Tabela . Nr.8. Popullsia sipas moshës¹²⁹ (Burimi: ASK-së “Projektimi i Popullsisë së Kosovës 2011-2061)

¹²⁹ Vlerësimi i popullsisë është marrë nga publikimi i ASK-së “Projektimi i Popullsisë së Kosovës 2011-2061” bazuar në midpoint medium variant.



Grafiku. Nr.1. Grafiku i paraqitjes së popullsisë (0-14, 15-64 dhe 65+vite) për periudhën 2011-2061,

5.2.3.2. Bruto Produkti Vendor

Qëllimi kryesor i vendit është zhvillimi ekonomik, i cili pasqyrohet me rritje të; Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), të rritjes ekonomike¹³⁰, të punësimit, të zvogëlimit të papunisë¹³¹ dhe të zhvillimit të cikleve efikase të ekonomisë, në veçanti të investimeve, të prodhimit, eksportit, etj. Rritja ekonomike kryesisht kushtëzohet nga; *rritja e konsumit, rritja e investimeve dhe rritja e eksportit në përgjithësi.*

Vitet	Mjetet neto nën menaxhim	BPV e Kosovës	Mjetet neto kundrejt BPV
2010	488,568,540	4,396,102,010	11.1%
2011	588,169,206	4,814,502,011	12.2%
2012	739,753,940	5,058,802,012	14.6%
2013	913,182,738	5,326,602,013	17.1%
2014	1,087,760,598	5,453,700,000	19.9%
2015	1,229,333,328	5,807,000,000	21.2%
2016	1,417,970,874	6,070,200,000	23.4%
2017	1,634,648,056	6,282,200,000	26.0%

Tabela. Nr.9. Mjetet nën menaxhim të FP të KPK kundrejt BPV vjetor të Kosovës gjatë periudhës 2010-2017.¹³²

Andaj, politikëbërësit makroekonomik i kushtojnë rëndësi të veçantë politikave mbi të ardhurat¹³³ në relacion me pagat dhe çmimet, duke përdorur instrumentet e politikave

¹³⁰ Rritja ekonomike e paraqet normën e zhvillimit (rritjen e kufirit të mundësive të prodhimit të ekonomise), në raport me numrin e popullsisë (për të plotësuar nevojat e konsumit).

¹³¹ Punësimi dhe papunësia janë të ndërlidhura me shkallën e zhvillimit ekonomik dhe me lëvizjet midis kërkesës dhe ofertës në treg. Shkalla e punësimit ndikon drejtpërsëdrejtë në mirëqenjen sociale dhe stabilitetin socio-ekonomik të vendit. Punësimi reflektohet në: krijimin e të ardhurave personale, fleksibilitetin apo ngurtësimin e tyre.

¹³² Raporti vjetor 2014; Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

monetare dhe fiskale¹³⁴, përmes të cilave synohet të ndikohet në kontrollimin e rritjes së pagave dhe në kontrollimin e inflacionit. Ndikueshmëria e natyrës së politikave makroekonomike në sistemin pensional në Kosovë ndërlidhet me: 1) *Demografinë*, 2) *Të ardhurat personale*, 3) *Shëndetin*, 4) *Punësimin*, 5) *Papunësinë*, 6) *Inflacionin*, 7) *Zhvillimin e tregut të kapitalit financiar*, 7) *Përshtatshmërinë e investimeve*, 8) *Likuiditetin, etj.*¹³⁵

Kosova ka rritje të ulët të PBB prej viti në vit, ndërsa numri i të papunësuarëve është rreth 39,5%¹³⁶, shkalla e varfërisë është rreth 47%, kështu që mirëqenja e popullatës së Kosovës është në nivel të ulët të standardit jetësor. Në strukturën e ekonomisë së Kosovës dominon sektori i tregtisë dhe i shërbimeve, kështu që me këtë strukturë të zhvillimit ekonomik, Kosova nuk ka arritë që të krijoj një zhvillim të theksuar ekonomik, i cili do të reflektohej në; *të hyrat buxhetore të Kosovës, në punësim, në mirëqenie. Konsumi* ishte rritur në vitin 2015 me një normë reale mesatare prej 5.4%, ndërsa konsumi për kokë banori ishte rritur mesatarisht me 3.2%, ndërsa shtimi i popullsisë ishte rritur me një normë prej 1.6%. Rritja e konsumit ishte ndikuar kryesisht nga rritja e; *pagave* (në sektorin privat dhe kryesisht të sektorit publik), *remitancave nga Bota e jashtme*¹³⁷ si dhe *të ardhurave të tjera financiare*¹³⁸.

¹³³ Politika Fiskale: a) Alokimi i rezervave shoqërore, b) Shpërndarjen e të ardhurave të shoqërisë, c) Stabilizimi i faktorëve me ndikim mbi inflacionin, papunësinë dhe rritjen ekonomike.

¹³⁴ Instrumentet e *Politikës fiskale*; tatimet, taksat, akcizat, shpenzimet qeveritare); *Instrumentet e politikës monetare*; interesi, kreditimi, depozitimi, pagesat, oferta dhe kërkesa për fonde në treg (“Hua për bankat e nivelit të dytë”) apo “Marrëveshje për riblerjeje” etj. 3) *Instrumentet e Politikës së të ardhurave*; pagat, çmimet, etj.

¹³⁵ Rregullorja Nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë; UNMIK/Reg/ 22 December 2001

¹³⁶ Norma e papunësisë në Kosovë e tejkalon shifrën prej 39,5% të fuqisë punëtore të pa punësuar.

¹³⁷ Sipas raportit të publikuar nga UNDP në vitin 2012, shuma totale e të hyrave të remitancave në Kosovë ka shënuar rënie prej 14 për qind në mes të vitit 2010 dhe 2011, nga 442 milionë euro në 379.6 milionë euro. Mirëpo varësia e financimit të konsumit privat nga remitenca mbetet ende e madhe, sepse mbi 25% e amvisërive në Kosovë pranojnë remitenca.

¹³⁸ Burimet e financimit të konsumit janë kreditë e lëshuara në ekonomi dhe për konsum familjar.

Raporti ndërmjet Konsumit dhe PBB është duke u zvogëluar, kryesisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të investimeve.¹³⁹ Investimet pritet të japin kontribut të rëndësishëm gjatë periudhës së ardhshme në: rritjen ekonomike, punësim, konsum dhe në shpenzime.

Deficiti në bilancin e tregtisë me sektorin e jashtëm vazhdon të jetë një kontribuues negativ për rritjen ekonomike në vend.

Shkalla e likuiditetit dhe kapitalizimit, si dhe cilësia e portofolios kreditore mbeten në nivel të kënaqshëm, ndërsa niveli i zgjerimit të këtij sektorit përmes aktivitetit kreditor ka shënuar ngadalësim të lehtë.

Pra, ekonomia e Kosovës gjendet para një dileme, se çfarë politikash makroekonomike duhet të ndjek, në mënyrë që të zgjerojë potencialin e prodhimit si faktor kyç i zhvillimit ekonomik, punësimit dhe i ngritjes së standardit jetësor të popullsisë së Kosovës.

5.2.3.3. Konsumi

Konsumi i përgjithshëm në vitin 2017 krahasuar me vitin 2010, ka një rritje prej 82.77%. Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare në vitin 2017 ishte shpenzuar për ushqim (42%) dhe për banim (29%). Bazuar në pritjet që konsumi privat, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale në vitin 2018 prej 3.5 %.

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Konsumi i përgjithshëm sipas viteve 2010-2017 (në Milion €)	1.937	1.928	2.292	2.382	2.471	2.461	2.321	2.340

Tabela Nr. 10. Konsumi i përgjithshëm për periudhen 2010- 2017

5.2.3.4. Inflacioni

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni mujor i matur në shtator 2018 nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.1%. Shkalla vjetore e inflacionit

¹³⁹ Investimet në Kosovë kontribuojnë në Rritjen vjetore të PBB-së prej 2% dhe përbën rreth 35% të PBB-së. *Investimet publike* janë në rritje progresive, ku vetëm investimet kapitale deri në gjysmën e vitit 2012 shënuan normë vjetore të rritjes prej 32.4%; ndërsa investimet private kishin vazhduar të kenë rolin e tyre pozitiv (megjithëse konsiderohet se i mungon efienca) dhe përbëjnë në mënyrë konstante rreth 22% të PBB-së,

ishte 1.4%, ndërsa Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte më i lartë për 1.4% në muajin shtator 2018, krahasuar me muajin shtator të vitit 2017. Inflacioni në Kosovë në vitin 2017 ishte prej 1.5 %, ndërsa në vitin 2018 parashikohet prej rreth 1.6 %.

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Norma e inflacionit	3,5	7,3	2,5	1,8	0,4	-0,5	0.1	1.5

Tabela Nr. 11. Shkalla e inflacionit në Kosovë gjatë periudhës 2010-2017

5.2.4. Faktorët e matshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional

Faktorët e matshëm mikroekonomik të cilët ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional janë; *Kontributorët, Pagat (Rrjedha financiare, Të hyrat financiare, Shpenzimet), Kapitalizimet, Investimet (Kthimet), Rreziqet, Pensionet.*

5.2.4.1. Kontigjenti i kontributorëve

Numri i tërësishëm i kontribuesve të cilët kishin hapur llogari individuale në periudhën 2002 deri në vitin 2017 ishte 591,527 llogarimbajtës. Në vitin 2017 ishin 352,849 kontribues aktiv.

Llogaritë individuale në Fondet Pensionale krijohen në bazë të kontributeve të paguara nga punëdhësit dhe kontribuesit individual (mjetet pensionale të alokuara në llogaritë individuale, janë pronë e përfituesve pensional), kthimet nga investimet, duke i zbritur shpenzimet administrative.

Skemat e Fondeve Pensionale në Kosovë janë të financuara nga kontributet e definuara individuale (ku kontributet e secilit punonjës akumulohen në konton apo portfolion individuale të kontribuesit përkatës, me qëllim të ruajtjes, kapitalizimit dhe të përfitimit të pensionit të merituar).

Në Sistemin Pensional të Kosovës, gjegjesisht në Shtyllën e parë, llogaritë individuale për përfituesit e pensioneve menaxhohen nga ana e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të cilat financohen nga vija buxhetore e Kosovës.

Në bazë të Ligjit mbi pensionet,¹⁴⁰ në Shtyllën e dytë dhe të tretë të Sistemit Pensional në Kosovë, llogaritë individuale të kontributorëve menaxhohen nga ana e Fondeve Pensionale.

Numri i llogarimbajtësve në fund të vitit sipas viteve 2010-2017	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	344063	384533	418,063	447,259	476,559	507,963	541,923	591,527

Tabela Nr.12. Numri i llogarimbajtësve që nga themelimi i TKPK (periudha 2010-2017).

Llogari të reja të hapura gjatë vitit sipas viteve 2010-2017	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	23,782	30,161	28,179	29,097	25,897	31,404	34,018	49,688

Tabela Nr.13. Numri i llogarive të reja të hapura në TKPK sipas viteve 2010-2017.

Nga tabela e mësipërme shihet se në vitin 2017 ishin hapur në TKPK 49,688 llogari të reja.

Numri i kontribuesve aktiv në TKPK gjatë periudhës 2017 ishte prej 352,849 kontribues¹⁴¹.

Numri i kontribuesve aktiv gjatë vitit sipas viteve 2010-2017	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	249,756	255,562	261,892	277,305	285,914	297,466	312,672	352,849

Tabela Nr.14. Numri i kontributorëve në TKPK gjatë periudhës 2010-2017¹⁴²

¹⁴⁰ Ligji nr. 04/l-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe Ligji nr. 04/l-101, rregullon llogaritë individuale të fondet pensionale të Kosovës, të cilat janë të definuara dhe mjetet apo kontributet të cilat rrjedhin në to, janë pronë e pronarëve të llogarive individuale.

¹⁴¹ Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të konkluduar, nëse ndryshimi i numrit të kontribuesve aktiv vjen për shkak të rritjes apo zvogëlimit të punësimit, qoftë sezonal apo për shkak të rritjes, respektivisht rënies së informalitetit në punësim.

Numri i kontributoreve aktiv në TKPK, në vitin 2017 ishte 352,849 kontribues, të cilët kishin hapur llogari individuale në FP të TKPK.

Mosha mesatare e kontributorëve në vitin 2017 ishte 33 vjeç për të punësuarit, ndërsa 39 vjeç për të vetëpunësuarit.

5.2.4.2. Lartësia e kontributeve

Niveli i kontributeve pensionale të detyrueshme nga paga e punonjësve për Shtyllën e Dytë dhe niveli i kontributeve pensionale vullnetare në Shtyllën e Tretë, e shprehë ngarkesën e kontributdhënësve pensional, që obligohen të paguajnë në Fondet përkatëse Pensionale.

Punëmarrësit obligohen detyrimisht të paguajnë 5% kontribute pensionale nga lartësia e pagës së tyre, në llogarinë e tyre individuale dhe punëdhënësit obligohen të paguajnë 5% të lartësisë së pagës së punëmarrësit në llogarinë e punëmarrësit¹⁴³, ndërsa në mënyrë vullnetare punëmarrësi dhe punëdhënësi mund të paguaj deri në plus 5% në llogarinë e punëmarrësit.

Lartësia e pagesës së kontributeve në vendet në rajon ndryshon prej vendi në vend, kështu që; në Kroaci punonjësit paguajnë në emër të kontributeve 20% të pagës së tyre, në Rumani paguajnë 16%, në Maqedoni 21,20 % dhe në Bullgari punonjësit paguajnë 22,30%¹⁴⁴.

Përcaktimi i lartësisë së pagesës së kursimeve pensionale, rregullohet për të siguruar shuma më të larta të kontributeve pensionale në portfoliot individuale të kontributorëve, ashtu që të sigurohen edhe pensione më kualitative.

¹⁴² Burimi: Raporti vjetor 2017 nga TKPK

¹⁴³ Te Skema e pensioneve suplementare, lartësia e pagesës së kursimeve pensionale bëhet në mënyrë vullnetare (Kontributi mujor minimal i paraparë në Planin pensional të fondit pensional është: a) Për të punësuarit jo më pak se 30 Euro në muaj (me kontribute bashkërisht nga punëdhënësi dhe i punësuarit, b) Për jo të punësuarit jo më pak se 20 Euro në muaj).

¹⁴⁴ Fondi i kursimeve pensionale të Kosovës ‘Raporti Vjetor 2012, Prishtinë, 2013

Për të përfituar më shumë siguri pas pensionimit, është e nevojshme që të bëhen sa më shumë kursime të kontributeve pensionale gjatë tërë jetës, gjegjësisht gjatë tërë kohës së punës, ashtu kontributori mund të përgatis planin pensional. Për shembull, nëse supozohet se një person i cili punësohet në moshën 25 vjeqare, ai nëse kontribuon gjatë 40 vjetëve të punësimit të tij me shumën mesatare ligjore ($40 \times 12 = 480$ muaj $\times 30$ euro / muaj / $= 14,400$ euro) dhe nëse ato kursimet pensionale kapitalizohen në treg, përmes investimeve me çmimin e aksionit të investimeve me një normë konstante prej 0,4% në muaj, atëherë ai do të ketë një bilanc të akumuluar në llogarinë e tij prej 20,160 €¹⁴⁵ (kur ai ta mbushë moshën 65 vjeqare, apo të pensionohet).

Ndërsa me kursime më të ulëta se 25,000 € të grumbulluara në portfolion individuale (në moshën kur kontribuesi i mbushë 65 vjet apo pensionohet) do të mjaftonin për të blerë një pension minimal.

Andaj, është me rëndësi të qartësohet se, sa më herët që kontributorët pensional fillojnë të kursejnë kontribute pensionale në llogaritë e tyre individuale dhe sa më të larta të jenë shumat e kursimeve, do të përfitojnë portfolio më të pasur, të cilat do të shërbejnë për të përfituar siguri më të madhe pensionale.

5.2.4.3. Kontribuimi i rregullt

Që nga themelimi i FP të TKPK deri në vitin 2017 janë arkëtur kontribute pensionale në shumën prej 1,420.000.000 €, ndërsa 1,298.100.000 € vazhdojnë të jenë nën neto menaxhim, sepse 124.000.000 € janë kontribute të tërhequra me rastin e pagesave të benefiteve pensionale ose të refondimeve (119.902.201€ kontribute të shpaguara + 4,097.799€ refondime).

Gjatë vitit 2017, kontributet e arkëtuara ishin 159.757.519 € (nga të cilat punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit), gjë që kishin shënuar rritje për 5.4% krahasuar me vitin paraprak.

¹⁴⁵ Raporti Vjetor 2014; Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kontributet e të vetëpunësuarëve shënojnë rritje, për shkak se ndryshimi në legjislacion ka bërë lidhjen e kontributeve minimale të vetëpunësuarëve, me pagën minimale të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, sipas rekomandimit të Këshillit Ekonomik Social të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Një numër shumë i madh i të vetëpunësuarëve (mbi gjysma) paguajnë vetëm minimumin e kërkuar të kontributeve pensionale të përcaktuar me Ligjin mbi pensionet, gjë që kontributorët rrezikojnë të mos kursejnë kontribute të mjaftueshme për pensionimin e tyre. Numri i punëdhënësve aktivë prej 28,685 kontributorëve, që kishin kontribuar gjatë vitit 2017 kishte pasur rritje për 6.0%, krahasuar me vitin paraprak 2016. Numri i punëdhënësve që ishin pasivizuar¹⁴⁶ në vitin 2017 ishte prej 3,840 kontributorëve, gjë që kishte shënuar rritje prej 1.7% krahasuar me vitin 2016.

Vlera mesatare e kursimeve të akumuluar nëpër llogaritë individuale të kontributorëve në të gjitha llogaritë e Fondit Pensional të TKPK në fund të 2017-s ishte 3,003 Euro.

Nga të dhënat e FP të TKPK rezulton se në vitin 2017, të vetëpunësuarit në 10.4% të rasteve kanë paguar më pak se sa minimumi i kërkuar me ligj (€130 apo €170, varësisht se a janë kontributor me moshë deri në 35 vjeç apo mbi 35 vjeç).

¹⁴⁶ Punëdhënës që pasivizohen FKPK-ja i konsideron bizneset ose institucionet ose organizatat të cilat kanë kontribuar për punonjës gjatë vitit paraprak por jo edhe në vitin e raportimit.

Viti	Kontributet vjetore të arkëtuara	Kontributet vjetore të shpaguara	Kontributet totale nën menaxhim
2002	€ 8,607,166	€ 0	€ 8,607,166
2003	€ 29,022,645	-€ 48	€ 29,022,597
2004	€ 44,405,108	-€ 108,526	€ 29,022,597
2005	€ 51,723,234	-€ 370,408	€ 51,352,826
2006	€ 56,667,095	-€ 370,408	€ 55,544,179
2007	€ 63,809,652	-€ 1,691,646	€ 62,118,006
2008	€ 72,775,328	-€ 3,160,117	€ 69,615,211
2009	€ 82,757,959	-€ 4,917,711	€ 77,840,248
2010	€ 94,648,860	-€ 5,089,983	€ 89,558,877
2011	€ 108,027,702	-€ 8,161,101	€ 99,866,601
2012	€ 113,038,633	-€ 11,184,031	€ 101,854,602
2013	€ 119,100,000	-€ 11,100,000	€ 1,087,760,598
2014	€ 128,700,000	-€ 13,400,000	€ 115,300,000
2015	€137,519,615	€19,299,443	€ 1,229,333,328
2016	€151,503,736	€19,208,575	€ 1,417,970,874
2017	€159,757,519	€27,739,647	€ 1,634,648,056
Totali	1,422.064.252	119.902.201	

Tabela.Nr.15. Kontributet e arkëtuara, të shpaguara dhe nën menaxhim në FP të TKPK gjatë periudhës 2002-2017

5.2.4.4. Të hyrat nga kontributet vullnetare dhe të hyrat tjera

Të hyrat e shtyllës së dytë dhe të tretë që financojnë Skemën e kursimeve të detyrueshme pensionale dhe ate vullnetare, krijohen nga kursimet e kontributeve të detyrueshme dhe vullnetare. Këto fonde karakterizohen me trendin e rritjes së aseteve pensionale dhe të instrumenteve financiare, të cilat janë të klasifikuara si: *mjete, detyrime apo ekuitete në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës*.¹⁴⁷

5.2.4.5. Barazimi i kontributeve¹⁴⁸

Në vitin 2017 mjetet e kontributeve të arkëtuara por të pabarazuara kishte mbërritur në shumën prej €10.8 mln.

¹⁴⁷ Mjetet financiare dhe detyrimet financiare përfshijnë: *investimet, paranë dhe ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet*.

¹⁴⁸ RV 2017, FP TKPK

Arsyet e mosbarazimit (mos alokimit) të kontributeve vazhdojnë të mbesin të njëjta si për nga numri ashtu edhe nga madhësia, si: a) €1.36 mln për mosdorëzim të raporteve të kontributeve nga punëdhënësit; b) €0.68 mln për raporte në mospërputhje me pagesat; c) €0.02 mln për pagesa që nuk iu është identifikuar punëdhënësi; dhe d) €0.23 mln për detaje (Numri personal / Emri) jovalide të kontribuuesve të raportuar (2016 përkatësisht: €6.12 mln; €2.17 mln; €0.64 mln; dhe €0.52 mln).

Në vitin 2017 FP i TKPK kishte filluar të implementoj ndryshimet ligjore, të cilat e autorizojnë FP të TKPK që të bëj likuidimin e kontributeve¹⁴⁹, të cilat nuk janë barazuar për 6 vitet e fundit.

Raportimi i pagesave në emër të kontributorëve bëhet në bazë të obligimit ligjor për punëdhënësit, të cilët përmes raportimit të rregullt ndikojnë në efikasitetin apo neglizhimin e barazimit të kontributeve.¹⁵⁰

FP i TKPK në vitin 2017 i kishte kthyer në ATK 7.030.000 € kontribute, që bashkë me kthimin nga investimet në vlerë prej 2,950,000 €, ishin kthyer totalisht 9.980,000€. Pas transferimit të këtyre mjeteve në FKPK ngelën të pabarazuara vetëm 0.18% e mjeteve për periudhat nën 6 vjet (ose €2.29 mln. kontribute).

Krahasimi i Sistemit të ri Pensional në Kosovë me sistemet pensionale të vendeve në regjion
Sistemi Pensional i Kosovës në vete përmbanë fonde pensionale me kontribute të definuara, sikurse që janë edhe fondet pensionale të regjionit në Maqedoni, Kroaci, Bullgari dhe Rumani.

¹⁴⁹ FP i TKPK ka bërë përpjekje për të gjetur informacionet lidhur me rastet e pabarazimit të kontributeve, sic janë: punëdhënësit nuk i kanë ruajtur informacionet individuale të pagesave ose i kanë paguar me të dhëna të gabuara, bizneset e kanë mbyllur ose ndryshuar aktivitetin, dhe/ose kanë paguar gabimisht tatimet e gjopa si kontribute pensionale.


FP i TKPK iu ka ruajtur kontribuesve të drejtën që kurdo që sigurojnë informacione për këto kontribute do të rimburohen me vlerën e kontributimit, duke ia shtuar edhe mesatarën e kthimit nga investimet e FP të TKPK-së për periudhën prej momentit të transferimit të tyre në ATK.

¹⁵⁰ Ligji Nr. 04/l-168 ndryshon dhe plotëson Ligjin Nr. 04/l -101 për Fondet pensionale të Kosovës, me qëllim të posaçshëm për shfrytëzimin e shumës së kontributeve të pabarazuara nga ana e Qeverisë së Kosovës deri në momentin kur nuk identifikohen pronarët e tyre.

Shteti	Shtylla I e Detyrueshme			Shtylla II e Detyrueshme			
	Sistemi	Financimi Kryesor	Norma e Kontributit	Sistemi	Financimi Kryesor	Norma e Kontributit	Gjithsej
Kosovë	PAYG	Buxheti Shtetëror	-	I investuar	Kontributet pensionale	5%	5%
Bullgari	PAYG	Kontributet pensionale	14%	I investuar	Kontributet pensionale	5%	19%
Kroaci	PAYG	Kontributet pensionale	15%	I investuar	Kontributet pensionale	5%	20%
Maqedoni	PAYG	Kontributet pensionale	12.4%	I investuar	Kontributet pensionale	6.7%	19%

Tabela.Nr.16. Normat e kontributeve te punonjesve ne regjion qe i ngarkohen pages bruto.(*Burimi: <http://www.mapas.gov.mk>

Sistemi Pensional tre shtyllësh i kontributeve pensionale në Kosovë, është i ngjashëm me vendet e regjionit.



Grafiku. Nr.2. Grafikoni i kontributeve të shtyllës së parë dhe të dytë të vendeve të regjionit.

Hungaria e kishte këtë model të sistemit pensional qysh nga viti 1998, por ajo kishte bërë kthim në sistemin e mëparmë në vitin 2011, me qëllim që të mbulojë deficitin buxhetor, duke nacionalizuar kështu rreth 14 miliardë dollarë të grumbulluara nga kursimet pensionale të rreth 3 milionë kontribuuesve te Sistemit Pensional Pay As You Go.

Shteti	Mjetet nën Menaxhim	Kontribuues	Filluar	Norma e kontribuimit te punonjesve
Kosovë	€ 739,753,940	418 064	2002	5%
Bullgari	€ 2,916,762,823	3 239 401	2001	22,30%
Kroaci	€ 6,737,773,203	1 652 802	2002	20%
Maqedoni	€ 179,848,960	323 480	2005	21,20%
Rumani	2,197,215,747	5 772 514	2007	16%

Tabela. Nr.17.Të dhënat kryesore për fondet e definuara dhe të obligueshme në regjion (2002-2007)¹⁵¹

¹⁵¹ www.mapas.gov.mk, www.regos.hr, www.hanfa.hr, www.fsc.bg, www.csspp.ro

5.2.4.6. Shpërndarja e kontributit të punonjësve në regjion

Norma e kontributit pensional që i ngarkohet Të Ardhurave të Punësuarve (TAP) në Kosovë, gjatë vitit 2012 ishte më e ulëta në gjithë regjionin.

Në Sistemin Pensional të Kosovës, të punësuarit aktual nuk kontribuojnë fare nga kontributet e tyre pensionale, për të financuar pensionistët aktual¹⁵².

Shteti	Shtylla I	Shtylla II	Gjithësejt
Kosove	-	5%	5%
Kroaci	15%	5%	20%
Rumani	5,5%	10,5%	16%
Maqedoni	13,78%	7,42%	21,20%
Bullgari	17,30%	5,00%	22,30%

Tabela. Nr.18. Nr. Normat e kontribuimit të punonjësve në Kosovë dhe regjion¹⁵³

5.2.5. Rrogat

Rrogat mesatare në Kosovë, të cilat janë paguar në vitin 2010 në shumen prej 285 euro, ato në vitin 2017 kanë arritur lartësinë e pagesës prej 454 euro.

Rroga minimale në Kosovë aktualisht është kategorizuar, për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare është 130 euro dhe për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare është 170 euro.

Në varësi nga lartësia e rrogës rritet edhe baza për llogaritjen e kontributeve pensionale, gjegjësisht rritet shuma e kursimeve në llogaritë individuale të kontributorëve.

Gjatë vitit 2017 nga të gjithë kontributorët, vetëm 3.8% e të punësuarve i kishin deklaruar rrogat prej 130 Euro dhe kishin kontribuar aq sa lejon minimumi ligjor, ndërsa pjesa e kontributorëve prej 2.92% kishin deklaruar rrogë nën 130 euro, duke kontribuar nën minimumin ligjor.

¹⁵² Që nga viti 1999- 2002, nuk ka patur Skemë Pensionale në Kosovë e cila pat financuar përfituesit e pensioneve (ish të punësuarëve deri 1999), por që nga viti 2002 ka filluar funksionimi i Skemes Bazë të pensioneve nga Buxheti i Kosovës.

¹⁵³ www.mapas.gov.mk, www.fsc.bg, www.ijf.hr, www.csspp.ro

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Pagat neto mesatare sipas viteve 2010-2017	285	343	353	356	408	441	449	454

Tabela Nr.19. Rrogat neto mesatare në Kosovë gjatë periudhës 2010-2017

5.2.6. Investimet e pasurive të Fondeve Pensionale

Një nga detyrat themelore të anëtarëve të Bordit Qeverisës të Fondit Pensional, është investimi i mjeteve të Fondit Pensional në tregun e kapitalit financiar. Kështu që, për zhvillimin e çdo aktiviteti të investimeve, është e nevojshme që paraprakisht të bëhet përpilimi dhe rishikimi i politikave operuese¹⁵⁴, gjegjësisht i investimeve financiare. Implementimi i politikave dhe parimeve të reja investuese, të aplikuara nga ana e Bordit Qeverisës të Fondit Pensional, përcillet me investime konkrete në tregun e kapitalit financiar.

Qëllimi parësor i politikave investive, është rritja e diversifikimit të investimeve, kryesisht të mjeteve në instrumentet financiare, si dhe rritja e numrit të fondeve investuese, me qëllim të reduktimit të luhatshmërive investuese, për të përmbushur qëllimin kryesor të sigurisë së investimeve, në mënyrë që plasmanet e tyre, të përputheshin me synimet e reja investuese.¹⁵⁵

Investimi i mjeteve të Fondeve Pensionale bëhet në klasët e ndryshme të mjeteve financiare, që përfshijnë; *Aksionet, Bondet, Paratë e gatshme dhe instrumentet e kthimit absolut*.

Me operimet investive të Sistemit Pensional në Kosovë merren; Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Fondi Pensional Slloveno- Kosovar. Përcaktimi i investimeve të Fondeve Pensionale varet nga politikat investive, të cilat i zbatojnë Bordet Qeverisëse të Fondeve Pensionale. Pra, Bordi Qeverisës është kompetent për të bërë orientimin e investimeve (sipas OECD, 2002)¹⁵⁶, duke u bazuar në “Manualin e investimeve” dhe në Rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës si dhe të Ligjit mbi

¹⁵⁴ Investimet e mjeteve financiare udhëheqen nga politikat investive të bazuara në Manualin e investimeve të FP të TKPK.


¹⁵⁵ Raporti vjetor i Fondit Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2014.

¹⁵⁶ OECD “Guidelines on Pension Fund Asset Management”, 2002.

pensionet. Investimet e mjeteve financiare të Fondeve Pensionale bartin në vete një shkallë të rrezikut. Për të zvogëluar shkallën e rrezikut të investimeve, Bordi Qeverisës zhvillon politika të matura, të kujdesshme, të cilat në vete përmbajnë koncepte konzervative dhe agresive të investimeve.


Në fund të vitit 2017 mjetet nën menaxhim të FP të TKPK kishin arritur vlerën prej 1,637.400.000 €, të cilat ishin të shpërndara si në vijim: 1,478.100.000 € ishin të investuara në tregjet financiare globale përmes fondeve investuese, 95.000.000 € ishin të investuara në fletobligacione të Kosovës 50.600.000 € ishin të afatizuara në bankat komerciale në Kosovë (BKT, NLB, TEB dhe BPB, ndërsa 13.700.000 € ishin të painvestuara në BQK.

Fondet Pensionale i menaxhojnë mjetet e grumbulluara në llogaritë individuale dhe të ardhurat e realizuara nga investimi i këtyre mjeteve i derdhen proporcionalisht në llogaritë individuale të anëtarëve të fondit.



Grafiku Nr.3. Çmimi i akcionit të mjeteve të investuara të TKPK gjatë periudhës 2002-2017¹⁵⁷.

¹⁵⁷ <http://www.trusti.org/index.php/sq/mjetet-nen-menaxhim-qe-fkpk-ja-ka-sipas-viteve>



Grafiku Nr.4. Kthimet nga investimet sipas Raportit vjetor të vitit 2017 të TKPK.

5.2.6.1. Principet e investimeve

Bordi Qeverisës i Fondit Pensional i definon principet e investimeve¹⁵⁸ në përputhje me principet e perkufizuara në Ligjin mbi pensionet në Kosovë, të cilat përcaktojnë: 1) *Mënyrën e plotësimit të kushteve ligjore për investime*, 2) *Klasët e aseteve në të cilat mund të investohen mjetet pensionale*, 3) *Kushtet e përgjdhjes së; Aset menaxherëve, Kustodianëve, Siguruesve fiduciar, Hedge Fondeve, si palë përgjegjëse për sigurimin dhe realizimin e investimeve*, 4) *Procedurat e marrjes së vendimeve*, 5) *Metoda e rishikimit*.

Politikat investive të përpiluara nga ana e Bordit Qeverisës bazohen në principet investive të cilat ndërtohen mbi bazë të këtyre kritereve:

- 1) Sigurimi i pasurive pensionale.
- 2) Diversifikimi i investimeve.
- 3) Maksimizimi i kthimeve, në raport me sigurinë e mjeteve pensionale.
- 4) Mbajtja e likuiditetit të mjaftueshëm.¹⁵⁹

¹⁵⁸ <http://trusti.org/index.php/sq/politika-e-investimeve>

Manuali i Investimeve përcakton një pako të parimeve dhe politikave udhëzuese, të cilat krijojnë një kornizë objektive dhe transparente për vendimmarrje të qëndrueshme, dhe të cilat mundësojnë përmbushjen efektive të të gjitha funksioneve investuese dhe përbëhet nga: Deklarata e Parimeve të Investimeve, Udhëzuesi i Politikës së Investimeve dhe Dokumenti i Implementimit të Investimeve. Është miratuar nga Bordi Drejtues i FKPK-së më 13 dhjetor 2013, ndërsa rishikimi i fundit është i datës 11 shtator 2014. Është i harmonizuar me Ligjin Nr. 04/L-101 për pensionet në Kosovë dhe ndryshimin e këtij ligji me Ligjin 04/L-168.

¹⁵⁹ Likuiditeti e paraqet mjaftueshmerinë e kapitalit apo të aseteve, krahasuar me shpenzimet totale dhe të tërheqjeve të anuiteteve pensionale.

Bordi Qeverisës i Fondit Pensional, në mënyrë që të rrisë shkallën e kujdesit për mjetet e investuara, e cakton Komisionin për investime, i cili ka për kompetencë të; *vlërëson përshtatshmërinë e investimeve, nevojën për diversifikim, përshtatshmërinë dhe përgjdhjen e Menaxhuesve të Pasurive të Fondeve Pensionale, definimin e parimeve të investimeve, etj.*

Gjithashtu Komisioni investues shqyrton; *politikën investive në fuqi dhe propozimet për ndryshimin e saj, bën vlerësimin e alokimit aktual të Mjeteve të investuara, bën monitorimin e investimeve aktuale, bën rishikimin e performancës së investimeve, vlerëson rreziqet të cilat mund të shfaqen nga Fondet e përzgjedhura, i raporton Bordit Qeverisës formalisht, lidhur me investimet direkte dhe indirekte të mjeteve financiare dhe për tregtimin e tyre në tregje të rregulluara.*

Politikat investuese të Bordeve Qeverisëse të Fondeve Pensionale, zakonisht bazohen në principet e investimeve, të cilat janë:

- 1) Të bazuara në konceptet konzervatore, me qëllim të ruajtjes së vlerës së mjeteve financiare, investimeve kualitative dhe të mbrojtjes nga rreziqet të cilat i përcjellin investimet.
- 1) Të orientuara në tregjet e jashtme të kapitalit financiar, të cilat shërbejnë me konceptin e diversifikimit të mjeteve.
- 2) Investimeve të bazuara në konceptin e tregjeve financiare joanonime.
- 3) Të përpiluara për të mundësuar një ekuilibër në mes të interesit të kontribuesve, që janë afër pensionimit dhe të atyre që kanë në disponim shumë vite, për të kursyer përpara se të pensionohen.
- 4) Te disejnuara me fizibilitet dhe volitshmëri të portofoliove të përfituesve të kontributeve, për të përdorur afatin kohor dhe profilin e riskut më të përshtatshëm, për secilën grupmoshë të kontribuesve.
- 5) Të disejnuara për të prodhuar portfolio individuale të përfituesve të kontributeve, për të ofruar një kombinim të mbrojtjes dhe të rritjes në vlerë të Mjeteve

financiare, të kursyera në formë kontributesh, me qëllim që në afat të gjatë të arrihet mundësia për blerjen e anuiteteve pensionale.

Investimet e kursimeve pensionale bëhen në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi pensionet, me qëllim të rritjes së fitimit në investim, në interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve.

Deklarata e re e Parimeve Investuese¹⁶⁰ bazohet në objektivin kryesor afatgjatë të investimeve të FP të TKPK- që është:

- 1) Të ruajë vlerën e kontributeve në terma nominal dhe real.
- 2) Të rrisë vlerën e kontribuesve në terma nominal dhe real.

Objektivi i Manualit të investimeve të FP të TKPK, është të ofrojë sa më shumë mbrojtje, kur tregjet janë në rënie apo kur ato kanë luhatshmëri dhe të përfitojë rezultatet e synuara respektive nga tregjet financiare.

Investimet e mjeteve financiare të kursimeve pensionale, investohen në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi pensionet, me qëllim të rritjes së fitimit në investim, në interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve.

Investimet në tregjet globale financiare bëhen me qëllim të realizimit të kthimeve nga investimet, duke i bartur risqet financiare.

Politikat investuese kanë për qëllim diversifikimin e mjeteve pensionale nëpër klasët e mjeteve dhe shkallët e alokimit të tyre, ndikojnë drejtëpërsëdrejti në kualitetin e kthimeve nga investimet, të cilat refletohen në portfoliot individuale të kontributorëve.

Nevoja për ekuilibrim në alokimin e mjeteve financiare në; *para të gatshme, aksione dhe fletëobligacione*, kushtëzohen nga normën e kthimeve, e cila synohet të jetë sa më lartë.

¹⁶⁰ Parimet dhe politikat e investimeve, të përpiluara nga ana e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) bazohen në Manualin e investimeve, Rishikimi i fundit: 26 gusht 2015.

Politika e investimeve kërkon që mjetet e investuara (qoftë direkt ose indirekt) të jenë të diversifikuara mirë përgjatë emetuesve dhe klasave të asetëve, si dhe përgjatë qasjes investuese të instrumenteve për investime në “Pellgjet e Hapura të Kapitalit Financiar”.

Si mënyrë më efektive për menaxhim të risqeve direkte, politikëbërësit gjatë përpilimit të politikave investuese vendosin kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente të klasave të caktuara të asetëve (kryesisht ato shpërndahen në këto proporcione; në aksione 20%; në klasët mikse të asetëve 40%; në fletobligacione 30%; tregje të parasë dhe bono thesari të Kosovës: 10%); si dhe kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente me qasje të caktuar investuese (me kthim të caktuar drejtimor, kthim pa përshtatje për risk: 35%, me target risku, menaxhim risku, kthim absolut 40%; dhe me të ardhura 25%).

5.2.6.2. Orientimi i investimeve në Tregun e Kapitalit Financiar

Investimi i mjeteve financiare të Fondeve Pensionale, bëhet kryesisht në tregjet e kapitalit financiar global, duke investuar në instrumente financiare, që menaxhohen nga institucionet e specializuara për investime në tregjet e kapitalit financiar global.

Investimet e disponueshme për shitje- Mjetet e investuara në fondet e përbashkëta të hapura në formë të sigurimeve, të cilat janë në pronësi të Fondeve Pensionale të Kosovës, janë të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Këto investime fillimisht llogariten sipas kostos, që pasqyron vlerën e tregut, e cila i përfshinë tarifat e blerjes së sigurimeve dhe benefiteve, të cilat lidhen me investimin. Këto investime llogariten si vlera të matura në datën e raportimit, të cilat përfshijnë vlerën e tregut, në bazë të çmimit mbizotërues të rimbursimit të investimeve, përfshihet në llogarinë e fitimit apo të humbjes.

Investimet e mbajtura deri në maturim- përfaqësohen nga depozitat me pagesa fikse, apo janë të përcaktuara dhe me datë fikse të maturimit (një vit), për të cilat Fondet Pensionale kanë për qëllim dhe mundësi për t'i mbajtur deri në maturim. Investimet e mbajtura deri në maturim, i paraqesin afatizimet në bankat vendore, të cilat fitojnë

norma të interesit prej 4.8% deri 5.5%. Interesi kalkulohet në baza akruale te arkëtimit, i cili reflektohet në të hyra tjera të arkëtueshme (sipas OECD, 2002).¹⁶¹

Fitimi i realizuar nga investimet i takon kontributorëve pensional 100% e dhe në fund të çdo muaji iu shpërndahet atyre në llogaritë individuale.

Investimi i mjeteve pensionale nga ana e Bordit Qeverisës i bazuar në parimet e investimeve të kujdesshme, të paracaktuara me ligj, kishte për qëllim, ruajtjen dhe rritjen e vlerës së kursimeve të kontributorëve kosovarë në periudha afatgjata, për t'iu mundësuar atyre ofrimin e pensionit sa më të mirë të mundshëm, me një shkallë sa më të ulët të rrezikut, në pajtim me Rregullën 9 (mbi investimet e mjeteve të Fondeve Pensionale), duke investuar:

deri 10% të mjeteve në depozitët bankar në Tregun kosovar dhe atë kryesisht në bankat ku themeluesit janë të huaj.

90% të mjeteve financiare janë investuar në letrat me vlerë, të emetuara nga kompanitë më të fuqishme në vendet anëtare të OECD-së (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik).

Komisioni investues i Fondit Pensional, ka kontroll mbi vendimet për investime dhe anëtarët e Bordit Qeverisës mbajnë përgjegjësi fiduciare mbi investimet në dispozicion (duke përfshirë zgjedhjen e opcioneve për investime dhe të ofrimit të shërbimeve), duke marrë përsipër rrezikun dhe përfitimet e investimeve që ata zgjedhin (shëndetshmërinë e Aset Menaxherëve, Zonën e operimit të Aset Menaxherëve, normën e kthimeve, koston e shërbimeve, vlerën e tanishme të detyrimeve, etj).

5.2.6.3. Shpërndarja e investimeve në Tregun e Kapitalit Financiar

Diversifikimi i mjeteve financiare të investuara nga ana e Fondit Pensional të TKPK në Tregun e Kapitalit Financiar Global, në vitin 2014 kishte një performancë të shkëlqyeshme investuese.

¹⁶¹ OECD 'Guidelines on Pension Fund Asset Management, 2002

Këto investime ishin të dominuara nga investimet në *tregun e aksioneve*¹⁶² dhe në *bonot investuese*, të ndikuara nga kombinimet më pak të favorshme me *bono shtetërore*, të cilat kishin ndikuar në uljen e normës së kthimit.

Pos diversifikimit të investimeve në klasët e asetëve investuese, si princip i investimeve që përdoret nga politikëbërësit është shpërndarja gjeografike e investimeve, kështu që *€54.7 mln ishin investimet në fletobligacionet e Kosovës* në fund të vitit 2014 nga ana e Fondit Pensional të TKPK, ndërsa shumicën e mjeteve financiare e kishte investuar përmes Fondeve të Hapura Investuese, të cilat menaxhohen nga kompani të specializuara që operojnë në Tregjet Globale Financiare.

Qellimi i diversifikimit të mjeteve financiare të politikëbërësve të investimeve nga ana e Bordit Qeverises të FP të TKPK, ishte investimi në instrumente likuide dhe të mirë divesifikuara (në derivate të investimeve të asetëve), të cilat duhet të kenë performancë të kënaqëshme në investime dhe të jenë Menaxher të Fondeve Investuese me përvojë të mjaftueshme në industri.¹⁶³

Shpërndarja e mjeteve sipas shtrirjes gjeografike të Tregjeve të Kapitalit Financiar Global, është e përqëndruar në tregjet e Euro Zonës dhe të Zonës së Dollarit, por jo edhe në tregjet e Zonave me rrezikshmëri të lartë investuese.

Bazuar në analizën e investimeve direkte dhe në plasmanet indirekte përmes fondeve të hapura, shihet se në fund të vitit 2012, mjetet ishin të investuara në instrumente

¹⁶² Investim i dominuar prej aksioneve, me pjesëmarrje prej ¼ të totalit të investimeve, si vijon; Fondi i aksioneve i Nordea 1-GSEF impresionoi me performancën tremujore prej 15.17%, e ndjekur nga fondet e përqendruara po në aksione të Pictet (+13.26%) e KBI (+11.67%), dhe fondi i dominuar prej aksioneve por me ¼ në bono i AXA WFOI (+9.24%). Fondet e aksioneve të Tobam (+5.08%) dhe Vanguard (+4.52%) ishin me performancë të kënaqshme, ndërsa fondet që përmbanin bono në portofolet investuese: Nordea 1-SRF (+4.25%), AXA GILB (+3.43%) dhe Alceda (+1.61%) u ndikuan nga kombinimet më pak të favorshme me bono shtetërore që ulën normat e kthimit. I vetmi fond me performancë negative, edhe pse në masë simbolike (-0.05%), ishte ai i Schroders me pozicionim të plotë në tregun e bonove. Në këtë periudhë kishte një normë rekorde të interesit (+2.29), për shkak se FP i TKPK-ja po investon më shumë mjete në fletobligacione të Thesarit të Kosovës me afat maturimi mbi 12 muaj, që kanë edhe norma më të larta të interesit.

¹⁶³ Investimet bëhen në pajtim me Ligjin mbi Fondet Pensionale dhe me politikën investuese të FP të TKPK, dhe Aset menaxherët e fondeve investuese përvojë të mjaftueshme në industrinë e investimeve në tregun e kapitalit financiar perzgjedhen të bëjnë investimet në tregun e kapitalit financiar.

financiare me valutë: USD 37.1%, EUR 29.1%, GBP 15.8% dhe të tjera 18.0% (kryesisht në CAD, AUD dhe JPY).

Struktura e mjeteve të investuara të fondeve pensionale në vitin 2017, përbëheshin; 53.5% në multi asete, 37.1% në aksione, 5.2% të investuara në Thesarin e Kosovës, 2.6% depozitat me afat në bankat lokale, 0.4% nga paraja e gatshme, dhe në derivatet neto 1.2%.

Në fillim të vitit 2017 Politikat Investuese të fondeve pensionale të Kosovës ishin orientuar që t'i investojnë deri në 90,2 % të mjeteve në fonde të indeksuara¹⁶⁴ të aksioneve, 5,8% ishin të investuara në fletobligacione të Kosovës dhe 4 % në bankat komerciale të Kosovës.

Pra, duke u shërbyer me politikat e tilla të investimeve të mjeteve pensionale nga ana e Bordit Qeverisës, menaxhohet risku monetar në mënyrë direkte dhe indirekte.

5.2.6.4. Instrumentet për investime të hapura

Bordi Qeverisës i Fondit Pensional gjatë kryerjes së detyrave të tij fiduciare, mund të përcakton se investimet optimale (për një pjesë të mjeteve pensionale, apo për të gjitha mjetet pensionale të fondit) të investohen përmes Instrumentit për Investime të Hapura¹⁶⁵.

Institucioni i cili përdor Instrumentet për Investime të Hapura (IIH), të cilat përdoren për investime të mjeteve të Fondeve Pensionale, duhet të jenë të licencuara nga Autoriteti i Tregut të Kapitalit Financiar të një shteti anëtar të OBZHE-së (OECD), në vendin ku e ka selinë institucioni, apo nga BQK, si Autoritet Kompetent i Tregut të Kapitalit Financiar në Kosovë.

¹⁶⁴ Fonde të hapura me bono dhe kthim absolut, apo investimi në: *fonde të aksioneve me qasje ndaj atyre që ofrojnë dividendë; fonde të aksioneve me targetim, menaxhim të riskut ose me kthim absolut; fonde me multi asete me targetim, menaxhim të riskut ose me kthim absolut.*

¹⁶⁵ Fondi Pensional zgjedh një apo më shumë instrumente për investime të hapura përmes konkursit ndërkombëtar.

Bordi Qeverisës i Fondit Pensional, i shqyrton marrëveshjet për mbajtje të instrumenteve për investime të hapura, të shfrytëzuara për investimet e Fondit Pensional dhe vendosë që, ato të jenë të përshtatshme për ruajtjen e mjeteve pensionale të Fondit Pensional.

Bordi Qeverisës vlerëson se, duhet të ketë një ekuilibër midis interesave të kontribuesve që së shpejti do të dalin në pension, të cilët kanë shumë pak tolerancë për rrezik, dhe të atyre që do të kontribuojnë për një kohë të gjatë deri në pensionim.

Bordi Qeverisës mbanë një qëndrim të bazuar mbi parimin e investimeve të kujdesshme¹⁶⁶ (konzervative) për kthimet e mundshme nga tregjet e kapitalit financiar.

5.2.6.5. Kriteret e investimeve

Kriteret themelore të investimeve të Fondeve Pensionale janë të përcaktuara me Ligjin mbi pensionet¹⁶⁷, i cili perkufizon; 1) *Diversifikimin e efektshëm i mjeteve financiare në një numër klasash, me qëllim që të shpërndahet risku në mes të klasave të mjeteve, duke përdorur fondet e përbashkëta.* 2) *Klasat e mjeteve në të cilat të investohet përfshijnë aksionet, bonot, paranë e gatshme* (Jack Brennan: Chairman & CEO, The Vanguard Group with Marta McCave, 2002)¹⁶⁸ 3) *Investimet në instrumentet e kthimit absolut, duke mbajtur gjithnjë në mendje profilin e grupmohave të kontribuesve.* 4) *Llogaritë dhe detyrimet ndaj kontribuesve duhet të jenë të denominuara në Euro, edhe pse kjo nuk duhet t'i kufizojë investimet vetëm në instrumente të denominuara në Euro.* 5) *Mbajtja e ekuilibrit në mes të interesit të kontribuesve që pritët të pensionohen në një të ardhme të afërt dhe të atyre që qëndrojnë më larg pensionimit.* 6) *Mbajtja e kostove operacionale të ulëta, pa e kompromentuar cilësinë e shërbimeve ndaj kontribuesve.*

¹⁶⁶ Parimet mbi baraspeshimin e investimeve në vendosjen e kufijve të shpërndarjes së investimeve i orientojnë investimet; prej 40% të investimeve orientohe në instrumente që tregtojnë aksione dhe 60% të investimeve orientohe në instrumente me kthim absolut.

¹⁶⁷ Ligji Nr. 04/L-101 për pensionet në Kosovë dhe ndryshimin e këtij ligji me Ligjin 04/L-168.

¹⁶⁸ Jack Brennan: Chairman & CEO, The Vanguard Group with Marta McCave „Straight talk on Investing“ John Wiley & Sons, Inc. Hoboken New Jersey, 2002 USA

5.2.6.6. Rreziku i investimeve

Rreziku i investimeve sipas Elez Osmani, Rozafa Ristani (2013)¹⁶⁹ e paraqet pasigurinë në realizimin e objektivave, që manifestohet përmes luhatjeve në treg, të cilat mund të shkaktojnë humbje apo fitim. Investimet zakonisht përcillen me një shkallë të pasigurisë. Pasiguria e paraqet situatën e cila krijohet nga investimet e zhvilluara, por të cilat nuk mund të sigurojnë paraprakisht rezultatin e pritur, kështu që investitori nuk është i sigurtë për rezultatin që do ta merr, apo ta parashikojë, ndërsa mund të pres rezultatet e mundshme, të cilat mund të ndodhin.

Investimi në tregun e kapitalit financiar e merr përsipër rrezikun, me shpresë që të realizojë normë të konsiderueshme të kthimit.

Çdo investim bartë në vete një shkallë të rrezikut investiv, kështu që ato në vazhdimësi shoqërohen me ecuritë e investimeve, të cilat duhet të maten, të vlerësohen në mënyrë permanente, ashtu që të mund të manaxhohen në mënyrë sa më efikase faktorët kyç të rreziqeve. Ato mund të zvogëlohen, si dhe mund të shmangen, sidomos kur bëhet vlerësimi i matur i investimeve dhe i zhvillimit të operimeve të tregut financiar.

Për të menaxhuar sa më mirë rrezikun investiv, është me rëndësi që të identifikohen; *llojet e rreziqeve dhe faktorët e rreziqeve.*

Në periudhën afatgjatë të investimeve, investimet në aksione mund të gjenerojnë kthime më të larta se sa bonot, apo paraja e gatshme, gjegjësisht instrumentet me kthim absolut. Andaj, politikëbërësit e fondeve pensionale, i marrin parasysh rreziqet e mundshme, që rezultojnë nga politikat, të cilat rekomandojnë diversifikim sipas Harry M. Markovitch (1959)¹⁷⁰ sa më të mirë të orientimit të investimeve në instrumentet financiare, të treguara në tregjet e kapitalit financiar ndërkombëtar. Diversifikimi i investimeve financiare, mundëson minimizimin e ekspozimit ndaj rreziqeve të ndryshme, të cilat

¹⁶⁹ Elez Osmani, Rozafa Ristani, “Tregjet dhe institucionet financiare, Instituti për kërkime shkencore dhe zhvillim”, Botimi i dytë, Shkodër, 2013.

¹⁷⁰ Harry M. Markovitch, Portfolio Selection, Efficient Diversification of Investments (New York; John Wiley and Sons, Inc., 1959)

mund të ndikojnë në vlerën e aseteve të Fondit Pensional. Kështu që Fondet Pensionale janë të interesuara, që mjetet e tyre financiare të investohen nga ana e Aset menaxherëve në; *ekuitete, derivatet financiare, bono, për të gjeneruar të ardhura si dhe për t'i reduktuar kostot ose rrezikun e përgjithshëm të Fondit Pensional.*

Luhatjet në treg ndikojnë në investimet themelore dhe mund të rezultojë me lëvizje jopërpjesëtimore të përfitimeve nga investimet.

Kur Fondet Pensionale investojnë në tregjet e reja, ato bartin rreziqe shtesë, për shkak të praktikave më pak të zhvilluara të tregut dhe i nënshtrohen luhatjeve më të mëdha të çmimeve dhe të përfitimeve.

Edhe shkallët e tarifave investuese kanë ndikim në vlerën e të ardhurave nga investimet. Andaj, ekziston mundësia që shkallët tarifore të ndikojnë në zvogëlimin apo rritjen e kapitalizimeve nga investimet, të cilat pritet që të gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme, për t'i mbuluar këto tarifa.¹⁷¹

5.2.6.7. Ekspozimi ndaj rrezikut përmes investimeve direkte dhe indirekte

Mjetet e Fondit Pensional të TKPK janë të investuara përmes instrumenteve me maturitet dhe të investime të hapura, të cilat tregtojnë me klasa të ndryshme të aseteve dhe përdorin politika të ndryshme të investimit dhe të rrezikut.

Mjetet e FP të TKPK i ekspozohen rreziqeve të ndryshme për investimet indirekte, varësisht nga mjetet e investuara me maturitet apo në një instrument për investime të hapura.

Të gjitha investimet, direkte dhe indirekte që i ekspozohen rrezikut të mjeteve të Fondit Pensional të TKPK më 31 dhjetor 2014 ishin të investuara në keto valuta, si në vijim: në USD 42.7%; EUR 23.2%; GBP 12.5%; JPY 4.2%; AUD 2.8%; të tjera 14.6%.

¹⁷¹ BNY MELLON Global real return fund (eur), Informata Kyçe për Investitorin

Pjesa e mjeteve te investuara jasht Euro Zones (jo në Euro) dhe të pa siguruara nga "Headging Fond" ishte 4.1% e mjeteve të FP TKPK.

Klasa e asetëve e investuar në; aksione ishte 66.7%; borxh thesaresh ishte 21.6%; borxh korporatash ishte 11.9% (Para e gatshme ishte 3.6%).

Fondet Pensionale në Kosovë i përshtasin politikat qeverisëse me tregun e kapitalit financiar dhe me potencialet e veta financiare në disponim, ndërmarrin aktivitete për orinetimin e investimeve në mënyrë sa më adekuate, me qëllim të formimit të strukturës sa më të mirë të portofolios së investimeve.

5.2.6.8. Vlerësimi i funksionit të rrezikut

Vlerësimi i funksionit të rrezikut të instrumenteve financiare mbulon një pjesë të mjeteve të Fondeve Pensionale, sepse pjesa dërrmuese e investimeve janë të investuara përmes instrumenteve të hapura, që nënkupton se menaxhimi i rrezikut bëhet në baza ditore (i është besuar menaxhuesve të instrumenteve për investime të hapura).

Kur identifikohen rreziqet nga ana e Bordit Qeverisës apo nga ana e menaxhmentit të Fondit Pensional, bëhet analizimi i ndikimeve të mundshme që mund të kenë në Fondin Pensional, (matet potenciali i tyre dhe merren vendime për të reaguar ndaj tyre) dhe ndërmirren veprimet e nevojshme.

Varësisht nga natyra e rreziqeve dhe impakteve të tyre, politikbëresit apo menaxhuesit ndërmarrin veprime për të; *evituar rreziqet, minimizuar ato, mbajtjen nën kontroll të rreziqeve, shmangjen e rreziqeve, transferimin e rreziqeve te palët e treta, etj.*

Njohja, vlerësimi dhe manaxhimi i rreziqeve, përdorimi i teknikave adekuate të manaxhimit të rrezikut, është detyrë permanente e Fondeve Pensionale. Pra, parandalimi i rreziqeve dhe kontrollimi i tyre nga fondet pensionale, të cilat në këtë mënyrë ndikonjnë në krijimin e stabilitetit të tyre dhe shërbejnë për të ndërtuar qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.

5.2.6.9. Menaxhimi i rreziqeve

Bordi Qeverisës i kushton rëndësi të veçantë zgjedhjes së Aset Menaxherëve të investimeve dhe alokimit të investimeve.

Fondet Pensionale i kushtojnë rëndësi të veçantë menaxhimit të rreziqeve. Ato përpiqen të grumbullojnë sa më shumë informacione për çdo treg të kapitalit financiar, si dhe për tregtimet finaciare në ato tregje, në varësi të llojit të klasëve të aseteve të cilat tregtohen në ato tregje. Pra, Fondet Pensionale përpiqen të përcaktojë pikët e besueshmërisë për investime, duke përdorur informacione përkatëse, për të përcaktuar shkallën e rrezikut në përputhje me potencialet investuese si dhe i kushtojnë rëndësi të veçantë; *planifikimit të investimeve, përgjedhjes së Aset menaxhereve, përzgjedhjes së Kustodianëve, implementimit të kontratave investuese, zhvillimit të hulumtimeve rreth vlerësimit të riskut të investimeve, përkufizimit të risqeve, procesit të administrimit të hyrave financiare-investimeve, procedurave të kontrollit të rreziqeve, si dhe të rishikimit të politikave investuese*. Varësisht nga llojet e paraqitura të rreziqeve, bëhet reagimi ndaj tyre nga ana e Fondeve Pensionale. Vlerësimi i rreziqeve nga ana e Bordit Qeverisës dhe nga ana e menaxhmentit të Fondit Pensional, mundëson përdorimin adekuat të veprimeve, në mënyrë që ato të minimizohen apo të evitohen tërësisht. Rreziqet të cilat i takojnë operimeve të brendshme, më lehtë mund të menaxhohen, përmes vëmendjes së përkushtuar, kujdesit të shtuar, nevojës për të evituar riskun, apo duke mënjanuar efektet e zgjedhjes së keqe. Synim kryesor i Fondeve Pensionale është vendosja e parimeve, të cilat kanë për qëllim mënjanimin e ndikimeve të faktorëve të rrezikut në investime, qoftë si përcaktim joadekuat i organeve politikbërëse të fondeve pensionale, qoftë si përzgjedhje e keqe e principeve të oprimeve, apo të involvimit të heshtur të rrezikut të ndërgjegjës.

Fondet Pensionale të Kosovës nuk merren me nënëshkrimin e “kontratave në avancë” (forward contracts), shkëmbime të siguracioneve (swaps) ose derivateve tjera (derivatives) për të minimizuar rreziqet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, sepse një kompetencë të tillë të menaxhimit të rreziqeve e marrin Aset Menaxherët, të cilët mirren

me investime në instrumente të caktuara në tregjet e hapura, varësisht nga: *politikat e tyre investive, performanca e tyre, plasmanet në kuadër të portfolios së investimeve të tyre, korrelacionit në mes të dy instrumenteve për investime të hapura, etj.*

Prandaj, duke qenë se rreziqet monitorohen nga ana e Menaxhuesve të Instrumenteve për Investime të Hapura, detyrë e Bordit Qeverisës të Fondit Pensional mbetet që të bëhen analiza të sensitivitetit të riskut të çmimit dhe të risqeve të performancës.

Gjatë procesit të përpilimit të politikave investuese, një nga detyrimet themelore të Fondeve Pensionale ndaj kontributorëve, është ruajtja e vlerës reale të kursimeve të kontributeve pensionale (ruajtja e njëjtë e vlerës reale financiare me vlerën neto të mjeteve financiare të kontributorëve), pra nuk duhet të paraqitet ndonjë problem rreth kualitetit të portfolios financiare individuale, për përfitimin e benefiteve financiare në të ardhmen.

Fondet Pensionale si dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale nuk bëjnë vlerësime aktuale të gjendjes së mjeteve financiare, duke përdorur ndonjë instrument financiar, por përmes menaxhimit të rrezikut financiar nga ana e Fondeve Pensionale, ruhet vlera reale e mjeteve financiare në dispozicion.

Vlerësimi i rrezikut të instrumenteve financiare të mjeteve të Fondeve Pensionale të cilat janë të investuara në “Pellgjet e Hapura të Tregut Financiar”, kryesisht vlerësimi i riskut bëhet në baza ditore dhe i besohet Aset Menaxherëve, të cilët bëjnë menaxhimin e këtyre instrumenteve.

Kështu që mjetet financiare të Fondeve Pensionale i ekspozohen drejtëpërsëdrejti vetëm një numri të vogël të rreziqeve (kryesisht rrezikut të çmimit) dhe atë vetëm me një pjesë të kufizuar të mjeteve.¹⁷²

Në përputhje me manualin për investime dhe në bazë të Ligjit mbi pensionet, organet qeverisëse të Fondeve Pensionale marrin vendime për rritjen ose zvogëlimin e

¹⁷² Risqet synon t'i menaxhojë Bordi Qeverisës i FP të TKPK përmes politikës së investimeve.

ekspozimit të investimeve financiare ndaj rrezikut të ndonjë instrumenti të caktuar për investime të hapura (varësisht nga performanca dhe plasmanet e instrumentit investiv).

Fondet Pensionale përmes politikave investuese, për çdo tre muaj analizojnë pajtueshmërinë e investimeve direkte, por edhe të investimeve indirekte të portofoliove të instrumenteve për investime të hapura, po ashtu bëhet vlerësimi i rrezikut dhe luhatshmërisë së investimeve direkte dhe indirekte.

Të gjeturat nga monitorimi tre mujor i investimeve të mjeteve financiare në Tregjet e Hapura të Ekuiteteve, shqyrtohen nga Komisioni i investimeve i Bordit Qeverisës të Fondit Pensional të TKPK, dhe shërbejnë si ndihmë në vendimmarrje lidhur me ato investime.

5.2.6.10. Faktorët e rrezikut

Faktorët e rrezikut ndikojnë drejtëpërsëdrejti në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e Fondeve Pensionale, të cilët mund të jenë; a) plotësisht të menxhueshëm dhe b) më pak të menaxhueshëm.

Kategoritë e rreziqeve të cilat janë plotësisht të parashikueshme dhe të menaxhueshme, të cilat vijnë si pasojë e; qeverisjes profesionale të mjeteve financiare, menaxhimit efikas të investimeve.

Gjatë përpilimit të politikave investive nga ana e politikëbërësve për investimin e mjeteve të Fondeve Pensionale, zakonisht mirren parasysh këto kategori të rreziqeve, të cilat janë plotësisht të menaxhueshme, por që mund t'i rrezikojnë investimet, si vijon:

1) *Rreziku i reputacionit*- ndërlidhet me; transparencën e Fondeve Pensionale, ndershmërinë dhe maturinë e anëtarëve të Bordit Qeverisës të Fondit Pensional, shkallën e profesionalizmit të anëtarëve të Bordit Qeverisës dhe të menaxhmentit, efikasitetit të operimeve administrative, përpikshmërisë apo saktësisë së përpunimit të të dhënave, respektimit të standardeve të larta të përgjegjësisë dhe të besueshmërisë, ndërtohet reputacioni i Fondit Pensional.

Andaj, detyrë e Bordit Qeverisës është; krijimi dhe ruajtja e emrit të mirë, të besueshëm dhe të një profili të imazhit të mirë profesional, për Fondin Pensional.

Fondi Pensional gjatë periudhës së operimit të vet, bën vlerësimin e brendshëm mbi përdorimin e procedurave të qarta, për të mundësuar mbikqyrje transparente të vazhdueshme, duke ofruar shërbime profesionale të standardit të lartë.

2) *Rreziku nga ndjekja e indeksit* - Fondi Pensional nuk pritet të ndjek ose përsëris me saktësi të përsosur performancën e Indeksit gjatë gjithë kohës. Gjithsesi, Fondi Pensional pritet të krijojë kthime nga investimi (më parë zbriten shpenzimet), të cilat korrespondojnë me çmimin e investimeve, duke e pasqyruar performancën e Indeksit.

3) *Rreziku i vlerësimit*- gjykohet të jetë konstatuar nga auditoret e jashtëm, të cilët bëjnë auditimin e investimeve të Fondeve Pensionale, apo nga institucionet mbikqyrëse të Bankës Qendrore të Kosovës, por mund të bëhet edhe nga palët tjera rregullatore (të specializuara) të vlerësimit të investimeve. Menaxhmenti i Fondit Pensional, ka për obligim që të shqyrtojë çdo informacion në dispozicion dhe të rishikon vlerësimin e këtij rreziku (ndryshe quhet risku i palës tjetër i cili shfrytëzohet nga Fondet Pensionale për investime).

4) *Rreziku operacional/nga palët e treta*- Operacionet e Fondit Pensional varen nga palët e treta dhe ai mund të pësojë ndërprerje ose humbje në rastin e dështimit të tyre.¹⁷³

5) *Rreziku nga kundërpala*- Fondi Pensional mund të pësojë humbje, në rastin e një mospagese të një kundërpale me të cilën janë kryer transaksione të caktuara, gjë që rezulton me rënie të vlerave neto të mjeteve të Fondit Pensional.¹⁷⁴

Bordi Qeverisës ka për detyrë të anagazhon auditorin e jashtëm, për të bërë vlerësimet profesionale të funksionimit të Fondit Pensional. Auditori i jep vlerësimet mbi rrezikun e palës tjetër, (përmes auditimeve të jashtme të Fondeve Pensionale për investime, që i bëjnë palëve të tjera). Bordi Qeverisës pritet që të shqyrtojë informacionin në dispozicion dhe të shfrytëzojë çdo burim tjetër, i cili mund të ndihmojë në vlerësimin e këtij rreziku.

6) *Rreziku i lidhur me menaxhimin diskrecional*- Aset Menaxheret i zbatojnë

¹⁷³ Schroders, Informata Kyçe për Investitorin

¹⁷⁴ Nordea Investment Funds S.A, Informata Kyçe për Investitorin

strategjitë e investimit të mjeteve financiare të Fondit Pensional, duke e bërë diversifikimin e mirë të investimit të mjeteve financiare në tregun e kapitalit financiar, për të realizuar sa më shumë përfitim.¹⁷⁵

7) *Rreziku nga derivativët*- Derivativët përdoren për të ngritur, ulur apo ruajtur nivelin e rrezikut të investimeve të Fondit pensional. Strategjia e cila ndiqet nga Fondi Pensional, mund të mos rezultojë në humbje të konsiderueshme.

8) *Rreziku i biznesit*- paraqet investimin e mjeteve financiare në të gjithë titujt financiarë, të cilët pritet që të reuzlojnë me kthime nga investimet. Këto investime në vete përmbajnë rrezikshmëri të pritshme. Rrezikshmëria e investimeve të mjeteve financiare të Fondit Pensionale mund të shfaqet në dy mënyra:

Si mjete financiare të izoluara apo të veçuara (ka të bëjë me riskun, që do të përballojë investitori, kur investon vetëm në një klasë të aseteve financiare dhe merrren në konsideratë vetëm flukset e pritshme prej tij) dhe si mjete financiare të një portofolios (portofoliot e mëdha kanë një sasi rreziku, i cili mund të eliminohet me krijimin e një portofolio të diversifikuar mirë), merren në konsideratë flukset e pritshme të kombinuara të çdonjërit prej mjeteve të portofolios. Pra, pjesa e rrezikut të biznesit mund të minimizohet apo të eliminohet përmes diversifikimit të mjeteve financiare.

9) *Rreziku i likuiditetit*- vlerësohet nga ana e menaxhmentit të Fondeve Pensionale dhe menaxhohet në bazë të të dhënave sipas principit ex-ante (para ngjarjes)¹⁷⁶, pasi që Fondet Pensionale investojnë në Fonde të Përbashkëta, të cilat disponojnë me shkallë të lartë të likuiditetit.

10) *Rreziku kreditor*- e shpreh humbjen e vlerës së aseteve financiare të Fondit Pensional, në rast kur një klient ose palë tjetër nuk i kryen detyrimet e tij kontraktuale, të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut kreditor dhe i nënshtrohen klasifikimit të rejtingut. Asetet e investuara të FP të TKPK në Bondet Qeveritare të Qeverisë së Kosovës nuk i nënshtrohen klasifikimit të rejtingut (këto letra me vlerë klasifikohen në kategorinë më të lartë të sigurisë). Bordi Qeverisë së Fondit Pensional e shqyrton rregullisht

¹⁷⁵ TOBAM anti benchmark world equity fund, Informata Kyçe për Investitorin

¹⁷⁶ <https://en.wikipedia.org/wiki/Ex-ante>

përshtatshmërinë e mundësive për investime brenda Kosovës, në përputhje me udhëzuesin e investimeve në fuqi dhe me legjislacionin përkatës. Fondi Pensional demonstroi standarde të larta të cilësisë në sektorin e investimeve, bazuar në procedurat e investimit dhe në konsistencën e përzgjedhjes së performancës së Aset menaxherëve.¹⁷⁷

11) *Rreziku kreditor/ABS/MBS*- Letrat me vlerë, të mbështetura me hipotekë ose mjete, mund të mos marrin në mënyrë të plotë sasi të cilat huamarrësit themelor iu detyrohen.

12) *Rreziku kreditor/letrat me vlerë për borxhe*- Emetuesi i letrave me vlerë mund të mos jetë në gjendje, të plotësojë detyrimet e tij, për t'i kryer në kohën e duhur pagesat e interesave dhe kryegjësë. Kjo do të ndikojë në vlerësimin e kredisë së këtyre letrave me vlerë.

13) *Rreziku i kredisë/shkalla e mos-investimit*- Letrat me vlerë të shkallës së mos-investimit, në përgjithësi, japin rendimente më të larta se sa letrat me vlerë të investimit dhe i nënshtrohen një tregu më të madh të rrezikut të kredisë dhe të mospërmbushjes. *Kategoria e rreziqeve të cilat janë më pak të parashikueshme dhe të menaxhueshme* vijnë nga; *zhvillimi i tregut të tregut të tregut, ecuritë e sistemit financiar, zhvillimi i krizave politike, etj.*), por mund të parashikohen rrjedhat e mundëshme të proceseve të cilat kanë ndikim në treg.¹⁷⁸ Zgjedhja dhe alokimi i investimeve bëhet për t'i menaxhuar mjetet e Fondeve Pensionale, me qëllim të përfitimit sa më të lartë dhe të evitimit maksimal të rreziqeve.

14) *Rreziku ekonomik*- rezulton nga rënia ekonomike ose nga shkaktohet tjerë ekonomik, të cilët ndikojnë në uljen e vlerës së investimeve, duke reduktuar mundësitë për fitime nga investimet.

¹⁷⁷ AXA World Funds, Informata kyçe për Investitorin

¹⁷⁸ Lëvizjet e tregjeve financiare globale në vitin (2015) kanë ndikuar në stagnimin e ritmit të rritjes së pasurive të Fondeve Pensionale në Kosovë, kryesisht për shkak të politikave ekonomike mbi zhvillimin ekonomik, të cilin e ndikonte ekonomia e SHBA-së në ekonominë e BE, të cilat fillimisht ishin shumë atraktive për investime në instrumente financiare, gjegjësisht në akcione të Zonës së Tregut të Dollarit (tregu global i aksioneve ishte me bilanc pozitiv), por klima e përgjithshme në Zonën e Dollarit dhe në Euro Zonën solli stagnim për investitorët, ndërsa në anën tjetër tregu global i bonove, shënoi rritje në normat e interesit. Gjithashtu "Krisa greke" kishte ndikim të fuqishëm në Zonën e BE, sidomos tregu i kapitalit financiar i Euro Zonës ishte lëkundur mjaft, sepse ishte vënë në pikëpyetje e ardhmja e monedhës së përbashkët Euro, si pasojë e rrezikut të mundshëm të daljes së Greqisë nga Eurozona.

15) *Rreziku nga inflacioni*- buron nga rritja e çmimeve të produkteve apo shërbimeve dhe si të tilla sjellin reduktimin e fuqisë blerëse dhe të normës reale të kthimit nga investimet. Gjatë 5 viteve të fundit, inflacioni në Kosovë ka shënuar një mesatare prej 4.4%, (ku dy pikat më të larta të inflacionit janë arritur në vitin 2008 me shkallë mesatare vjetore prej 9.4% dhe në vitin 2011 me 7.3%), kryesisht për shkak të ngritjes së çmimeve të naftës dhe ushqimit (buka dhe drithërat) në tregun ndërkombëtar, si dhe si pasojë e rritjes së pagave në sektorin publik, të cilat e kanë nxitur konsumin. Norma mesatare vjetore e inflacionit e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit në Kosovë deri në qershor 2014 ishte 0.3% te zhvlerësimit të Euros, kundrejt inflacionit prej 2.7% që ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2013¹⁷⁹. Pavarësisht nivelit të ulët të inflacionit të Euros, konsumatorët në Kosovë në vitin 2014 janë përballur me ngritje të vazhdueshme të çmimeve të konsumit dhe me ulje të standardit jetësor¹⁸⁰.

Vështruar në aspektin ekonomik, inflacioni dhe lëvizja e çmimeve në vitin 2014 kishte patur ndikim në; *punësim, të adhura, konsum, standardin jetësor dhe përgjithësisht në ekonominë e Kosovës*. Mirëpo, fondet pensionale i orientojnë investimet në tregjet e kapitalit financiar, të cilat gjenerojnë kthime më të larta, me qëllim të arritjes së përballimit të inflacionit, duke zvogëluar shkallën e riskut të tregut. Pra, ndërtimi i strategjive mbi përballimin e riskut investiv, orientimi i arsyeshëm i investimeve në zonat investive, diversifikimi i investimeve, përzgjedhja e Aset menaxhereve, mundësojnë tejkalimin e rrezikut nga inflacioni, (duke ofruar mbrojtje indirekte nga inflacioni).

16) *Rreziku i tregut*- Çdo investim i cili synon të realizojë kthime, merr përsipër një rrezik të tregut, sepse nuk mund të izolohet plotësisht nga rreziku i tregut dhe luhatjet e tregut. Sa më i madh të jetë diversifikimi i mjeteve investive në tregjet e ndryshme, aq më

¹⁷⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar “Indeksin e Çmimeve të Konsumit” (IÇK) për muajin Qershor 2014.

¹⁸⁰ Ngritja e vazhdueshme e çmimeve të konsumit dhe ulja e standardit jetësor në Kosovë kishte rezultuar, për shkak të importit të produkteve nga vendet e regjionit, që krahas tyre ishte importuar edhe inflacioni, i cili kishte qenë deri në 3%. Kjo normë e inflacionit ishte një goditje e madhe në indikatorët kyç të stabilitetit socio-ekonomik, veçmas kishte ndikuar në varfërimin e shportës së konsumatorit të Kosovës.

shumë do të ndihmonte në mbrojtjen nga rreziku i tregut¹⁸¹, i cili mundëson normë të kthimit më të sigurtë. Rreziku i tregut shpesh ndërlidhet me faktorë që e influencojnë tregun e kapitalit financiar, siç mund të jenë; *lufta, inflacioni, krizat ekonomike, etj.* Për të matur shkallën e riskut të tregut është e nevojshme që të përdoret Modeli CAPM (Modeli i Vënies së Çmimit të Mjeteve Kapitale – CAPM, sipas William F. Sharpe (1964)¹⁸² i cili analizon lidhjen e ndërsjellët në mes të shkallës së rrezikut dhe normës së kthimit.

17) *Rreziku i normës së interesit*- lidhet me lëvizjet e tregut, të cilat mund të ndikojnë në rritjen apo uljen e normës së interesit, e cila sjellë një rënie apo rritje në vlerën e investimit. Ky rrezik lidhet me vlerën reale të rrjedhave të ardhshme të parasë nga instrumentet financiare dhe ndryshon për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregjet e kapitalit financiar. Fondet Pensionale kanë investime direkte, që mbahen deri në maturim dhe në depozita bankare me normë fikse të interesit, apo nuk kanë investime direkte në siguracione me norma të ndryshueshme të interesit. Vlera e rregullt e tregut apo flukset e ardhshme të parasë të një instrumenti financiar, luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregun financiar. Rreziku i normave të interesit vjen nga vlera reale, ose vlera e rrjedhave të ardhshme të parasë të një instrumenti financiar, i cili ndryshon për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregjet e kapitalit financiar.

Menaxhmenti i Fondit Pensional është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit neto të rrezikut të normave të interesit. Ai i vendosë kufijtë për të reduktuar potencialin e mospërputhjes së normave të interesit.

18) *Rreziku nga berza*- Vlera e investimeve mund të ulet apo ngrihet dhe mund të lëndohet shuma e parave të investuara.¹⁸³

19) *Rreziku i çmimit*- vazhdon të jetë faktori më i rëndësishëm i rrezikut direkt të

¹⁸¹ Bordi Qeverisës i FP të TKPK i kushton rëndësi të veçante diversifikimit të investimeve, të cilat ndërlidhen me menaxhimin e riskut të tregut, si një mundësi për disjimin e strategjisë së investimeve; *alokimit të mjeteve, përzgjedhjes së fondeve të përbashkëta, përcaktimin për shtimin ose zvogëlimin e investimeve në një fond ose klasë të caktuar të mjeteve, duke vendosur një kufi i epërm te investimit të mjeteve financiare, që mund të investohen në fonde të përbashkëta të cilat nuk janë të denominuara në Euro ose që nuk janë të lidhura për Euro.*

¹⁸² William F. Sharpe "Capital Asset Prices: A theory of market equilibrium under conditions of risk" – *The Journal of Finance*, September 1964

¹⁸³ Institutional Euro-Hedged Shares of Vanguard Global Stock Index Fund. Informata Kyçe për Investitorin

aseteve të investuara të Fondeve Pensionale, kështu që investitorët synojnë ta menaxhojnë këtë rrezik, duke i shpërndarë mjetet e investuara në instrumente të ndryshme për investime të hapura. Përmes analizës së ndjeshmërisë së ndryshimit të çmimit të investimeve¹⁸⁴ në instrumente të hapura, si dhe të çmimit të aksioneve në kuadër të instrumenteve të hapura, pasqyrohet rreziku i drejtëpërdrejtë i investimeve, që ndikon në vlerën e asetëve neto të kontributeve pensionale. Vlera e rregullt e tregut apo flukset e ardhshme të parasë të një instrumenti financiar luhaten, për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut¹⁸⁵, andaj detyrë e politikëbërësve të Fondeve Pensionale është përpilimi i politikave të kujdesshme dhe të matura, që janë të lidhura me reagimin e tregut financiar dhe të rrezikut të çmimit të tregut. Sipas FP të TKPK çmimet e instrumenteve për investime të hapura në fillim të vitit 2014 sikur të ishin 5% më të larta në datën e raportimit, atëherë mjetet neto të pjesëmarrësve do të rriteshin me 51,186,216 euro. Vlera e aksioneve të mjeteve të Fondit Pensional të TKPK në portofolet e instrumenteve për investime të hapura, në vitin 2014 ishte 725,587,238 Euro, ose 66.7% e mjeteve, ndërsa në vitin 2013 vlera e aksioneve ishte 404,325,510 Euro ose 44.3%. Rreziku i çmimit të aksioneve në portofoliot e instrumenteve për investime të hapura ishte shumë më i ulët, se sa rreziku direkt i çmimeve të instrumenteve për investime të hapura, pasi që ndikimi në datën e raportimit (i rritjes prej 5% në çmimin e aksioneve) në këto investime indirekte, do të bënte që mjetet neto të rriten me 36,279,889 Euro, ndërsa në vitin 2013 rreziku i çmimit të aksioneve do të ndikonte të rriteshin me 19,305,378 Euro.

20) *Rreziku i monedhës*- Vlera e rregullt e tregut, apo e flukseve të ardhshme të parasë të një instrumenti financiar, luhatet për shkak të ndryshimeve në kurset e huaja të këmbimit. Rreziku specifik i valutës ka të bëjë me vendosjen e kufirit të epërm të mjeteve financiare që mund të investohen në Fonde të Përbashkëta, të cilat nuk janë të denominuara në Euro ose që nuk janë të lidhura për Euro. Të gjitha investimet e Fondeve

¹⁸⁴ Shkalla e ekspozimit të riskut të tregut varet nga; a) potencialet financiare të fondeve pensionale, b) orientimi tyre në tregjet financiare, c) pjesëmarrja në tregjet financiare, ç) instrumente financiare në disponim, etj., e cila shprehet në mënyrë cilësore dhe sasiore (me fjalë dhe me shifra).

¹⁸⁵ Ndryshimi i çmimit të tregut të ekuivalenteve ose mallrave

Pensionale në instrumente për investime të hapura, janë në valutën Euro apo të denominuara në Euro, si dhe janë të mbrojtura përmes kontratave në avancë për këmbim valutor, me qëllim për të minimizuar rrezikun valutor. Rritja apo ulja e vlerës së Dollarit Amerikan kundrejt Euros, do të kishte rezultuar në rritje apo ulje të ardhurave në Euro. Për menaxhimin e rrezikut valutor në instrumentet për investime të hapura, politika e investimeve të Fondit Pensional të TKPK lejon që maksimumi prej 10% të mjeteve, të jenë të investuara në instrumente jo të denominuara në Euro.

21) *Rreziku nga kursi i këmbimit të valutës (deri në 100% të mjeteve)*- E përfaqëson rrezikun e rënies nën shkallën normale të këmbimit të investimeve, në krahasim me monedhën referencë, me të cilën shërbehet Fondit Pensional, i cili mund të rezultojë me rënie të dukshme të Vlerës Neto të Investimeve.

22) *Rreziku nga valuta/klasa e mbrojtur e aksioneve*- Ndryshimet në normat e kursit të këmbimit ndikojnë në rikthimin e investimit. Qëllimi i kësaj klase të mbrojtur të aksioneve në Euro, është ofrimi i rikthimit të investimeve të Fondit Pensional, duke reduktuar efektet e luhatjeve të kursit të këmbimit midis Euros dhe Dollarit Amerikan (si valutë bazë e Fondit Pensional).

23) *Rreziku nga vendi apo rreziku politik*- Mjetet e Fondit Pensional mund t'i nënshtrohen pasigurive, siç janë ndryshimet e; 1) *Politikave qeveritare të një vendi*; 2) *Tatimeve*; 3) *Kufizimeve në investime të huaja*; 4) *Vendimeve valutore*; 5) *Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, të cilat së bashku me fatkeqësitë natyrore dhe trazirat politike mund të dobësojnë tregjet e aksioneve të një vendi*.

Gjithashtu rreziku nga ngjarjet e paparashikueshme (ndodhite natyrore, ngjarje politike, etj) ndikojnë në zhvlerësime të mjeteve financiare të investuara në tregjet e kapitalit financiar.

5.2.6.11. Matja e performances së Fondeve Investuese

Në mënyrë që të menaxhohen sa më mirë faktorët e rrezikut të *investimeve të mjeteve financiare të Fondeve Pensionale*, bëhet matja e performancës së *“Menaxhuesve të pasurive”* (Asset managers) në periudha sa më të shkurtëra kohore. Kështu që Fondi Pensional i

TKPK bën matjen e performancës në periudha tre mujore të “Menaxhuesve të pasurive”, duke regjistruar shkallën e pozitivitetit apo të negativitetit të plasmaneve,

Performanca e investimeve të FP të TKPK-së për vitin 2017 ishte në nivel të mirë të shprehur në terma të vlerës nominale, sepse kthimi bruto i investimeve ishte 102.600.000 € ose kishte shënuar rritje prej 6.5% të çmimit të njësisë, që është ekuivalente me një performancë bruto prej 6.8% (duke i zbritur tarifat e ngarkuara për investime dhe operacione, del se performanca neto e FP të TKPKsë dhe rritja e çmimit të njësisë ishte 6.5% për vitin.

Në vitin 2017 tregu i aksioneve kishte regjistruar rritje të forta. Të gjitha fondet e përbashkëta të angazhuara nga FP i TKPK kishin performancë pozitive; përveç fondit të sapo angazhuar të tregut të parasë (Amundi 3m-I) që performoi me -0.19%, por që ishte angazhuar si një alternativë e mbajtjes së mjeteve në llogarinë e BQK-së, që ngarkonte tarifa negative të interesit (prej -0.40%). Performanca pozitive e fondit në aksione; Vanguard GSIF kishte kontribuar me 56.7% në performancën e përgjithshme bruto të FP të TKPK, ndërsa të gjitha fondet e tjera investuese (përfshirë edhe investimet në Kosovë) kishin kontribuar me 43.3% në performancën e përgjithshme (më të dalluarat ishin tri fondet e multi-aseteve: *Nordea SRF me alokim mesatar prej 15.6% dhe me kontribuim prej 10.0%; BNP Paribas PDD me alokim mesatar prej 5.3% dhe me kontribuim prej 7.8%; dhe Schroders GDG me alokim mesatar prej 5.1% dhe kontribuim prej 6.2%.*

Investimet në Kosovë (në thesar dhe depozita) gjeneruan 2.000.000 € ose me 1.9% të kthimit bruto për vitin prej 102.600.000 €. Kjo u arrit duke pasur një alokim të kombinuar mesatar prej 7.3% të mjeteve¹⁸⁶

Menaxhimi i faktorëve të rriskut ndaj investimeve të mjeteve finaciare të Fondeve Pensionale, bëhet përmes matjes së performancës së “Menaxhuesve të aseteve” në

¹⁸⁶ <http://www.trusti.org/index.php/sq/mjetet-nen-menaxhim-qe-fkpk-ja-ka-sipas-viteve>

periudha të shkurtëra kohore¹⁸⁷, duke regjistruar shkallën e pozitivitetit apo të negativitetit të plasmaneve¹⁸⁸.

5.2.6.12. Performanca investuese e Fondeve Pensionale në regjion

Në vitin 2012 FP i TKPK-ja kishte një kthim neto nga investimet prej 7.96%, krahasuar me vendet e rajonit kjo performancë e investimeve ishte më e mirë, se sa performanca investuese mesatare e fondeve pensionale në regjion. Norma e kthimeve të investimeve pensionale të Fondeve Pensionale në vitin 2012 ishte si vijon; Kosovë ishte 7.96%, Rumani ishte prej 6.71%, në Bullgari ishte 7.39%, në Maqedoni 8.43% në Kroaci me 12.34% .

¹⁸⁷ Matja e performances së aset menaxhereve nga ana e FP te TKPK bëhet në këtë mënyrë;

a) *Te dhënat hyrëse* (Nuk ka shpenzime të interesit, nuk ka borxh; Shpenzimet e interesit të lidhura me të ardhurat operative negative; Nuk ka shpenzime të interesit, borxhi pasqyrohet në bilanc për periudhat e mëparme;

- Përshkruhet fitimi aktual para interesit dhe taksave (EBIT) në vlerën përkatëse.

- Përshkruhen shpenzimet aktuale të interesit në vlerën përkatëse.

- Përshkruhen shpenzimet e mbajtjes së mjeteve të vitit aktual në vlerën përkatëse

- Përshkruhen normat e bonove të qeverisë në periudhat e tanishme dhe afatgjate në %


b) *Te dhenat dalese*; a) Raporti i mbulimit të interesit në %, b) Bondet e vlerësuara në kategorinë përkatëse, c)

Vlerësimi i shkallës së shpërndarjes në %, d) Kostoja e parashikuar e borxhit në%

Në përgjithësi, përdorimi i të ardhurave operative (EBIT) reflekton fuqinë e fitimeve afatgjate të Aset menaxherit, në raport me shpenzimet e nevojshme.

¹⁸⁸ Në TM2 te viti 2015 performancën negative më të lartë e kishte fondi i Tobam (-4.91%), i cili rezulton të kishte më së shumti plasmanë në Evropë dhe Azi, të cilat ishin edhe vatrën kryesore të krizës këtë tremujor (Greqia, për shkak të problemit me borxhin, dhe Kina me shitjen masive të aksioneve nga rënia e besueshmërisë së investitorëve). Fondet e tjera (kryesisht) me përqendrim në aksione si: Nordea GSEF (-3.75%), KBI DPD (-3.13%), dhe Pictet (-2.68%) ishin edhe më të prekura nga zhvlerësimi dhe ishin të ndikuara edhe nga pozicionimi i tyre gjeografik i shpërndarjes valutore të investimeve. Investimet në Kanada dhe Australi kanë njohur humbje shtesë këtë tremujor, për shkak të zhvlerësimi të fortë të valutave.

Performanca e fondeve të tjera investuese ishte: Vanguard (-0.77%), Schroders (-0.51%), BNY Mellon (-2.15%), AXA WFOI (-0.98%) dhe AXA GILB (-2.59%). Vetëm Schroders (-0.56%) dhe Tobam (-0.08%) kishin performancë negative për gjysmëvitin e parë të vitit, ndërsa të gjitha fondet e tjera ishin në terren pozitiv.



Grafiku Nr.5. Performanca investuese e FKPK-së dhe fondeve pensionale në regjion.

Nga grafiku shihet se, Sistemit Pensional i Kosovës ka performancë të lartë, krahasuar me vendet në regjion.

Pra, Reforma e Sistemit Pensional në Kosovë ka ndikuar kryesisht në ndërtimin e sistemit pensional tërësisht jo solidar kundrejt; (a) të varfërve, (b) atyre që kanë përvojë të punës në sistemin PAYGO, dhe (c) të paaftëve për punë.

Reformimi i Sistemit Pensional në Kosovë ka krijuar përparësi të shumta: (a) është më i aftë të përballojë plakjen eventuale të popullsisë, (b) ofron norma më të mira të kthimit nga kontributet pensionale, (c) heq disa prej deformimeve të tregut të punës, (d) redukton politizimin e sistemit pensional dhe (e) heq pasiguritë fiskale kur numri i pensionistëve rritet kundrejt numrit të kontribuuesve.

Bazuar në matjen e performances së Sistemeve pensionale në regjion, rezulton se niveli i kualitetit (bazuar në efektivitetin dhe efikasitetin) të Sistemit Pensional në Kosovë është më i larti në regjion.

Modeli i menaxhimit efikas të Sistemit Pensional në Kosovë, ka ndikuar në; *respektimin e procedurave ligjore, përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit organizativ, reduktimin e shpenzimeve të përgjithshme, rritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit, rritjen e shkallës së likuiditetit dhe të solventitetit (rritja e aftësisë për shpagimin e anuiteteve pensionale ndaj*

kontributoreve pensional, besimi ndaj kontributoreve, sigurimi i mjaftueshmërisë së kapitalit për të përmbushur obligimet financiare), reagimi fleksibil dhe i shpejtë ndaj kërkesave të reja ndaj kontributorëve dhe të palëve të treta, përmirësimit të vazhdueshëm të performances.

5.3. Faktorët e stabilitetit financiar

Vetëqëndrueshmëria financiare e Fondeve Pensionale bazohet në rrjedhën financiare e cila gjeneron të hyra të vazhdueshme më të medha, se sa të dalurat e vazhdueshme, të grumbulluara nga; kursimet e kontributeve pensionale, nga investimet (norma e kthimit nga investimet, shpagimi i pensioneve, shpenzimet operationale dhe menaxhuese.

Ndërsa qëndrueshmëria e pozicionit të Vijës Buxhetore për Pensionet Bazë, varet nga shkalla e zhvillimit ekonomik, demografisë (*shtimit të popullsisë, punësimit, plakjes së popullsisë*), *kostos së shportës individuale të konsumit, stabilitetit financiar (inflacionit)* si dhe të pjesëmarrjes financiare të pensioneve në Buxhetin e Shtetit.

Pasqyrimi i qëndrueshmërisë financiare varet nga; burimet financiare, instrumentet financiare, indikatorët financiar, si vijon:

- 1) *Mjaftueshmëria e kapitalit.*
- 2) *Cilësia e aseteve (Investimet).*
- 3) *Profitabiliteti (Fitimi/humbja).*
- 4) *Likuiditeti.*

Në Sistemin Pensional të Kosovës, pasuritë e Fondeve Pensionale kanë natyrë të ndryshme dhe dallojnë sipas origjinës së të hyrave financiare. Andaj, objekt studimor i analizës financiare¹⁸⁹ është pasqyrim i gjendjes financiare, në të cilën gjendet Sistemi Pensional i Kosovës.

¹⁸⁹ Gjatë analizës financiare të Sistemit Pensional përdoren të dhënat mbi operimet financiare; të hyrat, investimet, shpenzimet (raportet, pasqyrat financiare).

Analiza financiare ka për qëllim të vlerësojë mjaftueshmërinë e kapitalit financiar i cili duhet të mbulojë shpenzimet e tërësishme dhe të mundësojë identifikimin e anëve të dobëta dhe të forta të Sistemit Pensional të Kosovës.

Analiza financiare shfrytëzon pasqyrat financiare dhe raportet financiare, për të siguruar informata të nevojshme në lidhje me: *pasuritë, detyrimet, ekuitetet, të ardhurat, shpenzimet.*

Gjithashtu analiza financiare shërben për të vlersuar se, cila është pika kritike dhe e ndjeshme e operimit të Fondeve Pensionale.

Pos pasqyrave financiare gjatë analizës financiare përdoren edhe raportet financiare, të cilat mundësojnë interpretimin e rrjedhës financiare; *menaxhimin e mjeteve financiare, borxhet, rentabilitetin, likuiditetin e vlerës së Fondeve Pensionale.*

5.3.1. Mjaftueshmëria financiare e Fondeve Pensionale

Mjaftueshmëria financiare e Fondeve Pensionale e paraqet potencialin financiar të; vijës buxhetore, kontributeve pensionale, mjeteve financiare të grumbulluara në fondet pensionale, mjetve financiare të investuara në tregun e kapitalit financiar, të normës së kthimeve nga investimet, etj. në raport me detyrimet (pensionet, shpenzimet e tërësishme, etj.).

Mjaftueshmëria financiare shprehet përmes;

- 1) Parasë në dorë dhe në banka,
- 2) Parasë në banka,
- 3) Çertifikatave të depozitimit.

Pra, mjaftueshmëria financiare iu mundëson Fondeve Pensionale të krijojnë një situatë të volitshme të krijimit të hyrave normale, për të operuar me përmbushjen e obligimeve të ndryshme financiare, apo për të vazhduar afarizmin e qëndrueshëm financiar, duke mos krijuar pakësim të pasurive, në mënyrë që të mos rrezikohet likuiditeti financiar.

5.3.1.1. Mjetet financiare nën menaxhim

Mjetet financiare nën menaxhim të Sistemit Pensional të Kosovës, janë të koncentruara në tri shtylla të Sistemit Pensional;

*Shtylla e parë*¹⁹⁰ - financohet nga buxheti i Kosovës dhe gjeneron pensione për Skemën e pensioneve bazë, apo i gjeneron pensionet e moshës.

VITI	Buxheti i shpenzuar vjetor per shpagimin e Shtylles se I te Pnsioneve Baze
2002	17.874.763,00
2003	44.459.960,00
2004	54.912.599,00
2005	59.313.333,00
2006	63.766.380,00
2007	63.133.100,00
2008	65.641.485,00
2009	73.603.960,00
2010	63.640.920,00
2011	61.196.210,00
2012	69.208.570,00
2013	87.340.090,00
2014	108.199.460,00
2015	120.456.558,00
2016	117.600.660,00
2017	113.979.075,00

Tabela Nr.20. Mjetet nën menaxhim të Shtylles së I-Pensionet e skemes bazë¹⁹¹ (¹⁹²Burimi; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve).

*Shtylla e dytë*¹⁹³ - financohet nga kursimet e kontributeve të detyrueshme pensionale, të cilat grumbullohen në Fondin Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, gjeneron pensione të merituar.

¹⁹⁰ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve

¹⁹¹ Skema e pensioneve bazë ka filluar nga muaji Gusht i vitit 2002. Përfituesit e pensioneve kanë qenë të gjithë qytetarët resident të Kosovës, të cilët kanë ofruar një dëshmi se kanë lindur dhe kanë jetuar së paku dy muaj në Kosovë, kështu që numri i përfituesve ka ndryshuar prej muaji në muaj (si në hyrje të përfituesve, ashtu edhe në largim nga lista, në veçanti ka patur shumë vonesa në çlajmërimin e përfituesve të vdekur dhe të abuzuesve të pandershëm), gjithashtu problem i veçantë kanë qenë edhe përfituesit pensional, të cilët nuk janë lajmëruar në qendrat pensionale sipas kohës së përcaktuar, kështu që ata janë pezulluar përkohësisht nga listat e përfituesve (të cilët pas lajmërimit në Institucionet Pensionale ata janë futur prap në listat e përfituesve). Kështu që dëbimi i përfituesve për t' u lajmëruar në Institucionet Pensionale dhe pastrimi i listave të përfituesve të skemës bazë është duke vazhduar në vijim.

¹⁹² Në tabele është pasqyruar shuma mujore dhe buxheti i shpenzuar vjetor gjatë periudhës 2002-2014, sipas viteve.

Nga tabela shihet se mjetet nën menaxhim të FP të TKPK në vitin 2017 ishin 1,634,6480,56 €, të cilat burojnë nga kontributet e grumbulluara gjatë periudhës 2002-2017 në shumën prej 1,422.200.000 € (kontribute të arkëtuara qysh prej themelimit). Aktualisht 1,298.100.000 € nga shuma e kontributeve pensionale vazhdojnë të jenë nën menaxhim, sepse nga shuma totale e kontributeve të grumbulluara janë tërhequr në emër shpagimit të anuiteteve pensionale dhe të refondimeve (2002-2017) në shumën prej 124.100.000 €.

Data	Mjetet (neto) nën menaxhim
31.12.2017	€ 1,634,6480,56
31.12.2016	€ 1,417,970,874
31.12.2015	€ 1,229,333,328
31.12.2014	€ 1,087,760,598
31.12.2013	€ 913,182,738
31.12.2012	€ 739,753,940
31.12.2011	€ 595,384,324
31.12.2010	€ 495,273,000
31.12.2009	€ 380,704,774
31.12.2008	€ 255,742,981
31.12.2007	€ 279,579,860
31.12.2006	€ 215,103,575
31.12.2005	€ 145,808,692
31.12.2004	€ 84,803,347
31.12.2003	€ 37,832,687

Tabela. Nr.21. Mjetet nën menaxhim te Fondit Pensional Trusti i Kursimeve Pensionale te Kosoves (2002-2017)¹⁹⁴

*Shtylla e tretë*¹⁹⁵ financohet nga kursimet e kontributeve pensionale vullnetare, zhvillon pensione suplementare të stimuluar nga lehtësimet tatimore. Kjo shtyllë përbehet nga Fondi Pensional vullnetar apo Fondi Slloveno Kosovar.

Mjetet nën menaxhim të *Shtyllës së tretë* të cilat menaxhohen nga Fondi Slloveno-Kosovar marrin pjesë në tërësinë e mjeteve të Fondeve Pensionale me 0,6%. Në Fondin Pensional Suplementar janë regjistruar një numër i vogël i kontribuesve vullnetar, me trend të rritjes së mëtejme.

5.3.1.2. Profitabiliteti i fondeve pensionale

Profitabiliteti e paraqet raportin në mes të Shpenzimeve ndaj të hyrave Bruto/ Totali i Taksave (taksat për pagesën e shërbimeve të; Kujdestarëve të Aseteve Pensionale, Menaxhuesve të

¹⁹³ <http://www.trusti.org/index.php/sq/mjetet-nen-menaxhim-qe-fkpk-ja-ka-sipas-viteve>

¹⁹⁴ <http://www.trusti.org/index.php/sq/mjetet-nen-menaxhim-qe-fkpk-ja-ka-sipas-viteve>

¹⁹⁵ http://fondipensional.com/sistemi_pensional_main.html

Mjeteve Pensionale, Brokerëve dhe të Dilerëve të Sigurimeve, Këshilltarëve juridik dhe të Këshilltarëve Financiar dhe Investiv, e të tjerëve).

Profitabiliteti i mat efektet e kombinuara të likuiditetit, gjegjësisht të menaxhimit të mjeteve financiare dhe të borxhit në rezultatin e Fondit Pensional.

Faktorët të cilët ndikojnë në shkallën e profitabilitetit të Fondeve Pensionale janë; *madhësia e fondeve pensionale, pronësia e mjeteve financiare, koncentrimi i tregut të investimeve (orientimi i investimeve në zonat investuese, produktet investuese, etj.), norma e kthimit, performanca e aset menaxhereve të investimeve, shpenzimet e fondit pensional, efikasiteti i qeverisjes dhe i menaxhmentit (politikat investuese), etj.*¹⁹⁶

Pra, vetëqëndrueshmëria e fondeve pensionale kushtëzohet nga; *arkëtimi i sasisë së kursimeve të kontributeve pensionale, shuma e mjeteve të grumbulluara në fondin pensional, të hyrat nga investimet e kontributeve (kthimet nga investimet), shpenzimet e fondit pensional (shpenzimet operacionale, shpenzimet investuese, shpenzimet tjera).*

Të ardhurat bruto përbëhen nga kthimet e investimeve, gjegjësisht nga instrumentet financiare, përkatësisht interesi nga depozitat në baza akruale.

Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese ne FP te TKPK	
Kontributet e pranuar të pjesëmarrësve	159,757,519
Tërheqjet e kursimeve	(- 27,590,720)
Refondimet	(- 591,804)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet financuese	131,574,995

Tabela Nr.22. Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese ne FP te TKPK gjate vitit 2017

Nga tabela e mësipërme shihet se nga kontributet vjetore të arkëtuara në vitin 2017 (në shumën prej 159,575,519 Euro) nga ato mbulohen detyrimet vjetore në formë të tërheqjeve nga kursimet

(-27,590,720 Euro) si dhe bëhen refondimet vjetore (-591,804 Euro), ndërsa rrjedha neto e parasë vjetore nga aktivitetet financuese mbetet në shumën prej 131,574,995 Euro.

¹⁹⁶ Efikasiteti i menaxhimit brenda periudhave të ndryshme, bëhet duke e bërë krahasimin e menaxhimit të tashëm me menaxhimin e mëparshëm, apo me menaxhimin e institucioneve të ngjashme në periudhën e njëjtë të operimit.

	Kontributet e Pjesëmarrësve	Fitimet e Mbajtura	Gjithsej
Më 1 Janar 2016	1,043,128,879	194,962,853	1,238,091,732
Kontributet	152,278,668	-	152,278,668
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(16,014,169)	(3,194,406)	(19,208,575)
Riblerjet si pasojë e refondimeve	(1,747,575)	(147,310)	(1,894,885)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	58,237,271	58,237,271
Më 31 Dhjetor 2016	1,177,645,803	249,858,408	1,427,504,211
Kontributet	160,375,531	-	160,375,531
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(22,083,346)	(5,656,301)	(27,739,647)
Riblerjet si pasojë e kthimit të mjeteve të paalokuara	(7,026,365)	(2,941,618)	(9,967,983)
Riblerjet si pasojë e refundimeve	(626,576)	(15,128)	(641,704)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	95,268,997	95,268,997
Më 31 Dhjetor 2017	1,308,285,047	336,514,358	1,644,799,405

Tabela Nr.23. Fitimet e mbajtura të FP të TKPK (2017)

Nga tabela shihet se kontributet e arkëtuara në FP të TKPK që nga viti 2002 deri më 31 Dhjetor 2017 ishin në shumën prej 1,308,285,047€, ndërsa fitimet e realizuara nga investimet e tyre në tregun e kapitalit financiar ishin në shumën prej 336,514,358€, gjë që shuma e përgjithshme e mjeteve nën menaxhim të FP të TKPK ishte prej 1,644,799,405€.

Pra, vetëqëndrueshmëria e fondeve pensionale të bazuara në kursimet e kontributeve pensionale, kushtëzohet nga profitabiliteti i tyre¹⁹⁷ dhe aftësia e likuiditetit të tyre,¹⁹⁸ për të vendosur ekuilibrin në mes të kohëzgjatjes së operacioneve për t'u financuar dhe kohëzgjatjes së burimeve korresponduese për të paguar obligimet.

5.3.1.3. Rrjedha e parasë (Cash flow)

Pasqyra e rrjedhës së parasë (cash flow) sipas Myers dhe Majluf (1984) pasqyron aktivitetet mbi; operimet me grumbullimin e kontributeve pensionale, investimet dhe kthimet e tyre, shpenzimet e tërësishme (shpagimi i anuiteteve pensionale, shpenzimet

¹⁹⁷ Profitabiliteti i fondeve pensionale, të cilat bazohen në kursimet e kontributeve pensionale, pasqyron raportin në mes të hyrave financiare dhe të shpenzimeve të tërësishme (aftësia e fondeve pensionale që të krijojnë kthime financiare nga investimet, me lartësi të normës së kthimeve, e cila mundëson mbulimin e shpenzimeve të tërësishme nga neto kapitalizimet).

¹⁹⁸ Likuiditeti i një fondi pensional i referohet aftësisë së tij, për të shlyer detyrimet afatshkurtra kur ato maturohen, nga burimet e financimit të akumuluar më parë apo të njëjtës kohëzgjatje.

mbi koston e menaxhimit të mjeteve financiare të fondeve pensionale, shpenzimet operacionale, etj)¹⁹⁹

Teoria e rrjedhës së parasë se lirë sipas Jensenit (1986)²⁰⁰, shpjegon se sa më shumë që rriten aktivet investuese, aq më shumë duhet të vëhet kontroll në aktivet e lira, për të realizuar aktivitete fitimprurëse, në interes të Fondeve Pensionale. Andaj, detyrë e Fondeve Pensionale është që të vënë nën kontroll permanent aktivet investuese, në mënyrë që të ruajnë sasinë dhe vlerën e parave në dispozicion, si dhe për të marrur vendime sa më të kujdesëshme, lidhur me qeverisjen e tyre (me qëllim që fondet pensionale të marrin vendime të matura rreth investimeve, duke e ulur shkallën e rrezikut të investimeve përmes përzgjedhjes së politikave të kujdesëshme investive).²⁰¹

Andaj, përmes “Bilancit të gjendjes” pasqyrohet gjendja e mjeteve xhiruese, të cilat tregojnë shkallën e likuiditetit të Fondeve Pensionale,

(pasqyrohen pasuritë e Fondit Pensional në një anë dhe detyrimet anën tjetër, apo pasuritë neto të Fondeve Pensionale, nga vërehet shëndetshmeria financiare e Fondeve Pensionale- sasia e parasë së gatshme).

Vetëqëndrueshmëria e Fondeve Pensionale pasqyrohet përmes Bilancit të suksesit, i cili pasqyron shtimin e pasurive apo zhvlerësimin e tyre (kthimet nga investimet e mjeteve financiare të Fondeve Pensionale, si dhe shpenzimet e tërësishme. Pra, përmes Bilancit të suksesit të Fondeve Pensionale pasqyrohet raporti i të hyrave dhe të dalurave (duke e përmbledhur rezultatin afarist të Fondeve Pensionale).

¹⁹⁹ Rrjedha e parase (cash flow) shërben për të krijuar shkallë të nevojshme të likuiditetit dhe mundësi të nevojshme për të ndërmarrë investime në të ardhmen (gjegjesisht investimet në likuiditete shihen si një mundësi e krijimit të vlerës neto positive nga kthimet), duke zvogëluar sa më shumë borxhet.

²⁰⁰ Sa më shumë që rriten aktivet investuese, aq më shumë duhet të vëhet kontroll në aktivet e lira, për të realizuar aktivitete fitimprurëse, në interes të mbajtësve të mjeteve financiare, gjegjesisht në interes të mbajtësve të akcioneve.

²⁰¹ Sipas Teorise Pecking Order investitorët i financojnë investimet e tyre në radhë të parë nga fitimet e pashpërndara, pastaj me borxh të sigurtë dhe në fund me anë të borxhit me risk.

5.3.1.4. Të hyrat e FP të TKPK

Nëse i vështrojmë të hyrat e tërësishme të FP të TKPK (i cili është fondi kyq i Sistemit Pensional të Kosovës), atëherë do të shohim se në vitin 2017 kontributet vjetore të arkëtuara në FP të TKPK dhe të hyrat të tjera ishin në shumën prej 18,243,910 Euro, ndërsa detyrimet vjetore ishin në shumën prej **10,886,818 Euro**. Kështu që të hyrat nga kontributet, vazhduan të jenë dukshëm më të larta se sa të dalurat vjetore.

5.3.1.5. Shpenzimet investuese të FP të TKPK

Shpenzimet investuese përfshijnë: *tarifat që mbajnë menaxhuesit e fondeve për investimin e mjeteve dhe qasjen në tregjet financiare; tarifat e BQK-së për transferimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve; dhe shpenzimet e tjera për brokerët dhe kujdestarët e mjeteve.*

Shpenzimet për investime të FP të TKPK në vitin 2017 përbënin 82.8% të shpenzimeve, apo shprehur në vlerë nominale arritën 5,704,214€. Zakonisht fondet investuese i ngarkojnë investimet mesatarisht mbi 1% të vlerës së mjeteve të investuara për menaxhimin e fondeve, ndërsa FP i TKPK kishte ka arritur që përmes marrëveshjeve individuale dhe selektimeve të matura të perfitojë ulje prej 0.393% nga fondet investuese për pagesën e tarifave investive për mjetet e investuara²⁰².

Me rritjen e mjeteve financiare nën menaxhim, rriten edhe shpenzimet investuese në vlerë nominale²⁰³ të cilat sillen rreth 0.40% , në emër të shpenzimeve investive ndaj Fondeve Investuese.²⁰⁴

²⁰² Tarifa operacionale e FKPK-së, tashmë prej 0.081% vjetore, vazhdon të jetë më e ulët krahasuar me të gjithë operatorët e ngjashëm në rajon por është edhe ndër më të ulëtat globalisht.

²⁰³ Aset menaxheret (Fondet investuese) aktiv, të cilët realizojnë investime, hulumtime dhe transaksione ditore, kanë shpenzime më të mëdha dhe për këtë i ngarkojnë Fondet Pensionale apo fondet tjera financiare me tarifa investuese më të larta. Ndërsa fondet investuese, të cilat ndjekin një indeks të caktuar në bursat e tregut të kapitalit financiar, ato i ngarkojnë fondet pensionale, gjegjësisht fondet financiare me tarifa investive më të ulëta. Aset menaxheret apo Fondet investuese i ngarkojnë tarifat menaxhuese për investimin e mjeteve, varësisht (dhe kryesisht) prej pozicionit të tyre që ato i mbajnë në treg.

²⁰⁴ Këto tarifa i percaktojnë Aset menaxheret përmes formës së negociimit me fondet pensionale, apo fondet financiare, varësisht nga pozita e tyre në treg, apo varësisht nga qasja e tyre në tregjet financiare me kosto më të ulët se sa do të kishte me investime direkte (edhe pse investimet direkte nuk lejohen me ligjin aktual).

Nga analiza e shpenzimeve investive rezulton se, shkalla e shpenzimeve investive nuk e përparon vetvetiu efikasitetin e investimeve të Fondeve Pensionale, por është vetëm një faktor përcaktues i tyre.

Pra, në këtë mënyrë shohim se FP i TKPK operon me një realizim optimal të tarifës menaxhuese, e cila e ngarkon FP te TKPK.

5.3.1.6. Shpenzimet e menaxhimit të FP të TKPK

Tarifat e taksës së menaxhimit të Fondeve Pensionale në Kosovë gjate vitit 2014²⁰⁵ vehen në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës²⁰⁶.

FP i TKPK për çdo vit kërkon nga Kuvendi i Kosovës, të definon lartësinë e tarifës së taksës së menaxhimit, e cila në fillim ishte 1% e mjeteve nën menaxhim, e cila më vonë tarifa e saj ishte ulur nga viti në vit. Kështu që për vitin 2015 ajo tashmë është ulur në 0.40% për aktivitetet investuese të mjeteve nën menaxhim²⁰⁷.

Njëkohësisht Kuvendi i Kosovës kishte vendosur, që tarifa për aktivitetet operacionale të jetë 0.085%, e ulur nga 0.13% krahasuar me taksën e aplikuar në vitin 2014²⁰⁸.

5.3.1.7. Shpenzimet operacionale të FP të TKPK

Shpenzimet operacionale përfshijnë, ato shpenzime të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë për investimet, të cilat përbëhen prej; *kompensimeve, shtypjes dhe postimit të pasqyrave të llogarive, qirasë së zyrës, dhe shpenzimeve të tjera për operim, shpenzimet e operimeve të organeve qeverisëse dhe menaxhuese të FP te TKPK.*

Për vitin 2017 shpenzimet operacionale të FP te TKPK ishin 1,181,697€ dhe përbënin 17.2% të totalit të shpenzimeve të FP te TKPK.²⁰⁹

²⁰⁵ Rregullorja Nr.5 e BQK, mbi raportet dhe informatat

²⁰⁶ Ne vitin 2002, ishte viti fillestar i implementimit të Sistemit Pensional në Kosovë. Në këtë vit tarifa e taksës së menaxhimit ishte 1%, e vendosuar nga ana e Perfaqesuesit të autorizuar të Shtyllës së IV të UNMIK

²⁰⁷ FP i TKPK synon që përmes vetëdisiplinës dhe të vetiniciativës ta bëjë rregullimin e tarifës së taksës së menaxhimit dhe atë ia propozon Kuvendit të Kosovës për miratim.

²⁰⁸ Tarifa operacionale e FP të TKPK-së do të jetë ndër më të ulëtat në gjitha vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe më gjerë.

5.3.1.8. Tarifat menaxhuese në regjion

Te Fondet Pensionale rëndësi të madhe ka lartësia e kontributeve pensionale, me të cilën ngarkohet çdo e ardhur personale në bazë të përcaktimit të Ligjit mbi pensionet në Kosovë.

Lartësia e kontributeve pensionale ndikon drejtëpërsëdrejti në bilancin e llogarisë individuale të kontribuesve, në kohën kur ata pensionohen.

Tarifat e menaxhimit të pasurive të fondeve pensionale përcaktohen me Ligjin mbi pensionet, ndërsa lartësia e tyre përcaktohet nga Fondet pensionale, ndërsa aprovimin e tyre e bën Kuvendi i Kosovës.

Krahas tarifës menaxhuese në regjion, janë prezente edhe taksat në kontribuim dhe për largim nga Fondi Pensional.

Shembull: FP i TKPK nuk i ngarkon kontribuesit me taksa tjera, pos taksës menaxhuese, dhe kjo bën që Fondi Pensional i TKPK t'i ketë taksat e përgjithshme më të ulëta.

Shteti	Taksa ne kontribute	Taksa Menaxhuese	Taksa Dalese	Total ngarkesa
Kosove	-	0,60%	-	3,90 Euro
Kroaci	0,50-0,80%	0,45%	0,80%	12,74 Euro
Rumani	2,50%	0,60%	5,00%	23,35 Euro
Maqedoni	4,00%	0.60 %	15 Euro	57,23 Euro
Bullgari	5,00%	1,00%	10 Euro	66, 18 Euro

Tabela. Nr.24. Normat e taksave të ngarkuara në Kosovë dhe rajon²¹⁰

5.3.1.9. Likuiditeti i Fondeve Pensionale në Kosovë

Likuiditeti përfshinë në vete:

- 1) Rrjedha Neto e Parasë nga Operacionet,
- 2) Paraja Neto nga Aktivitetet Investive,

²⁰⁹ Shpenzimet operacionale financojnë të gjitha shpenzimet e Bordit Qeverisë dhe shpenzimet tjera profesionale.

²¹⁰ www.mapas.gov.mk, www.apapr.ro,
www.rmfi.hr, www.pbzco.fond.hr,
www.azfond.hr, www.erstepilavi.hr

- 3) Paraja neto nga aktivitetet financuese,
- 4) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit.

Analiza e raporteve financiare e Fondeve Pensionale, përbën një metodë të përshtatshme, për të analizuar pasqyrat financiare të Fondeve Pensionale, sepse ato llogariten lehtë dhe mundësojnë krahasime të lehta. Bazuar në raportet përkatëse, rezultatet mund të krahasohen më lehtë, brenda periudhave të caktuara. Krahasimet e tilla ndihmojnë të dallohen pozicionet brenda veprimtarisë dhe për të vërtetuar tendencat që zhvillohen.

Paaftësia e fondeve pensionale të modelit PYGO për t'u përballur me vështirësitë që sjellë modeli i sistemit pensional PAYGO, shpie në kufizimet të cilat rrjedhin nga operimet financiare të fluksit të kontributeve pensionale në njërin anë dhe mundësinë për të mbuluar shpenzimet e nevojshme dhe për të shpërguar pensionet në anën tjetër. Pra, raportet e likuiditetit, tregojnë aftësinë e Fondeve Pensionale për të përballuar detyrimet afatshkurtëra, gjegjësisht e paraqesin aftësinë e Fondeve Pensionale për të shlyer të gjitha detyrimet që kanë afat maturimi më të madh se një vit nëpërmjet flukseve hyrëse të parasë, të gjeneruara nga aktivitetet operative.

$$\text{Shkalla e mbulimit të likuiditetit} = \frac{\text{Totali i detyrimeve per 30 ditet e ardheshme}}{\text{Sasia e tërësishme e aseteve}}$$

Sipas Myers e Majluf (1990) likuiditeti i Fondeve Pensionale e pasqyron mundësinë e shlyerjes së të gjitha detyrimeve për një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë në të ardhmen.²¹¹ Kjo gjendje i bën Fondet Pensionale në Kosovë, të ndjehen të sigurt në të ardhmen. Te Fondet Pensionale në Kosovë konstatohet shkallë e lartë e likuiditetit, e cila shprehet përmes raportit të aktiveve aktuale dhe detyrimeve afatgjata (tregojnë shkallën e eficiencës së përdorimit të aktiveve nga ana e Fondeve Pensionale, se sa lehtë ato mund t'i përdorin paratë e gatshme në llogari, për mbulimin e shpenzimeve aktuale). Ndërsa sipas James Tobin (1958) likuiditeti i Fondeve Pensionale²¹² në Kosovë ruhet nëpërmjet

²¹¹ Likuiditeti iu mundëson aksionarëve, që të krijojnë vlera për aksionerët dhe e jep mundësinë të shfrytëzohen oportunitetet investuese në të ardhmen, kur kostot janë shumë më të ulëta se sa të hyrat.

²¹² James Tobin "Liquidity preference as Behavior Towards Risk", The Review of Economic Studies, XXV (February 1958)

shumave të caktuara të parave, të cilat ruhen në llogaritë e Bankës Qendrore të Kosovës²¹³, me qëllim të shfrytëzimit në afat sa më të shkurtër për shpagimin e anuiteteve pensionale dhe të pagimit të shpenzimeve për; *tarifat menaxhuese, shpenzimet operationale, refondimet, etj.*

	Afatshkurtër Deri 1 vit	Afatmesëm 1-7 vjet
Mjetet financiare		
Paraja në bankë	13,667,252	-
Investimet e disponueshme për shitje	-	1,478,150,510
Investimet e mbajtura deri në maturim	51,826,755	43,218,385
Depozitat	37,490,865	13,088,546
Kontributet dhe të arkëtueshmet e tjera	18,243,910	-
Totali 1	121,228,782	1,534,457,441
Detyrimet financiare		
Llogaritë e pagueshme	10,886,818	-
Totali 2	10,886,818	-
Hendeku i maturimit	110,341,964	1,534,457,441

Tabela Nr.25. Maturimet kontraktuale të mbetura të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FP të TKPK (2017).

Të gjitha investimet përmes instrumenteve për “investime të hapura” mund të paguhën brenda 1 deri 10 ditëve, dhe të gjitha investimet e mjeteve të FP të TKPK-së në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës kanë një afat të maturimit prej më pak se dy vjetëve nga data e raportimit.

$$\text{Hendeku i maturimit} = \text{Mjetet financiare} - \text{Detyrimet financiare} = 121,228,782 - 10,886,818 = 110,341,964$$

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e parave të gatshme të mjaftueshme, disponueshmërinë e fondeve nëpërmjet instrumenteve adekuate kreditore dhe aftësinë për arkëtim në kohë, brenda afateve të përcaktuara të shumave të arkëtueshme nga palët e treta.

²¹³ Fondet Pensionale në Kosovë mbajnë shuma të caktuara në llogaritë e BQK edhe për pagesa të jashtëzakonshme të cilat kushtëzohen nga ligjet në fuqi.

5.3.1.10. Efektiviteti i Sistemit Pensional në Kosovë

Sipas Brady (2009). Crane, Heller dhe Yakoboski (2008), Hess dhe Impavido (2003) Choi, Laibson dhe Madrin (2006), efektiviteti²¹⁴ i Sistemit të ri Pensional në Kosovë e shpreh ndikimin e tij në qëndrueshmërinë dhe stabilitetin socio- ekonomik të vendit, përmes realizimit të objektivave socio- ekonomike që ndërlidhen me raportin në mes të rezultateve faktike dhe të rezultateve të pritura.

Andaj, sipas Mr Vladan Radlovački, Dr Bato Kamberović, Dr Nikola Radaković (2002), efektiviteti e shpreh kërkesën për përzgjedhjen e drejtë të qëllimeve socio- ekonomike, duke i përdorur burimet në dispozicion, principet për realizimin maksimal të objektivave²¹⁵. Kështu që efektiviteti në vete i përmbledhë; burimet, mjetet, metodat për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, në mënyrë që të arrihen rezultatet e planifikuara²¹⁶. Përmes efektivitetit shprehen aftësitë e Sistemit Pensional për të i vënë resurset disponuese në raport sa më të drejtë në realizimin e qëllimeve socio-ekonomike të parashtruara. Efektiviteti i Sistemit Pensional varet nga disa faktorë; *mënyra e qeverisjes dhe e menaxhimit, karakteristikat e sistemit pensional, burimet financiare në dispozicion, rregullat e sistemit financiar të vendit, shkalla e zhvillimit ekonomik dhe e punësimit, struktura e vjetërsisë së popullsisë, tregu i kapitalit financiar, etj.*

Modeli i Sistemit Pensional si faktor kushtëzues i efektivitetit e dikton drejtëpërsëdrejti mundësinë për të përcaktuar disponueshmërinë e burimeve financiare, për të zgjedhur

²¹⁴ Efektiviteti është aftësia për të zgjedhur objektivat e përshtatshme dhe mjetet e duhura për realizimin e tyre. E shpreh suksesin për arritjen e qëllimit të caktuar ("bërë gjënë e duhur", apo do të thotë, t'i bësh gjërat që duhen, në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur, gjegjësisht përmbushje adekuatë e një qëllimi, prodhim i një rezultati të synuar.

²¹⁵ Efektiviteti është veprimi i faktorëve të cilët ndikojnë në raport me realizimin e qëllimeve të parashikuara dhe të realizuara.

²¹⁶ Mr Vladan Radlovački, Dr Bato Kamberović, Dr Nikola Radaković, " *Principi opštega modela ocene efikasnosti i efektivnosti sistema menadžmenta kvalitetom podržane računarm* " Pregledni rad. XII međunarodna konferencija IS 2002, Vrnjačka Banja, Novembar 2002, str. 110-115

metodat e qeverisjes dhe të menaxhimit të tyre, duke realizuar objektivat e përshtatshme për arritjen e qëllimeve të parashtruara, të qëndrueshme dhe kualitative²¹⁷.

5.3.1.11. Efikasiteti i operimeve financiare të Sistemit Pensional

Sipas Brady (2009) efikasitetit i operimeve të fondeve pensionale konsiston në; *politikat qeverisëse, kornizës ligjore, zhvillimin e menaxhimit, vëllimin e operimeve, përdorimin mjeteve tekniko- teknologjike për procesimin e të dhënave, koston e administrimit, mbulimin kualitativ të nevojave për pagesën e anuiteteve pensionale, të cilat kanë ndikuar në funksionalitetin normal të Fondit Pensional si dhe në realizimin e vlerës së shtuar (kapitalizimet)*²¹⁸, si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve të domosdoshme të Fondit Pensional, kështu mendojnë Cinca (2002), Barros dhe Garcia (2006), Serrano dhe Mar Molinero (2001), Harris (2006).²¹⁹

Çështjet të cilat lidhen me konceptin e efikasitetit shpesh kuptohen si koncept i kursimit, sepse ndërlidhen me marrëdhëniet ndërmjet rezultateve krahasuar me shpenzimet, sepse aktivitetet e planifikuara financiare të Sistemit Pensional çojnë në arritjen maksimale të objektivave me kosto sa më minimale (raporti ndërmjet përdorimit minimal të burimeve financiare në dispozicion dhe të realizimit maksimal të qëllimeve).

Efikasiteti i një Fondi Pensional varet nga madhësia e tyre e cila ndikon në qëndrueshmërinë financiare përmes; *realizimit të lartësisë së përfitimeve nga investimet në tregun e kapitalit financiar dhe të kostove (kostos së menaxhimit dhe të kostos operacionale) të ndërlidhura me operimet e ndryshme respektive*²²⁰.

²¹⁷ Është e rëndësishme që Fondet Pensionale të mbajnë kosto sa më të ulëta, për të siguruar përfitime të pagueshme të pensioneve nga kontributet individuale (Efikasiteti rritet nga mënyra e përgjegjshmërisë së anëtarëve të Bordit Qeverisës në vendimmarrje.

²¹⁸ Anëtarët e Bordit Qeverisës të Fondit Pensional determinojnë rrezikun e investimeve, sepse ai varet nga masat e mundëshme që ata i ndërmarrin për të shmangur humbjen dhe për të rritur normën e kthimeve.

²¹⁹ Efikasiteti financiar është konceptuar si raport ndërmjet bilancit të kostove dhe të përfitimeve të operimit, i cili parashikohet përmes një plani që orienton zhvillimet e operacioneve efikase.

²²⁰ Teoriticienët e shohin relacionin në mes të madhësisë së Fondeve Pensionale dhe të efikasitetit në dy pikëpamje; a) pozitive dhe b) negative. a) Sipas Gallagher dhe Martin (2005), vështrimi nga pikëpamja pozitive i vë në raport të drejtë variablat ndikuese. b) Sipas Cicotello dhe Grant (1996), Droms dhe Walker (2001) dhe Grinblatt dhe Titman (1994) pikëpamja negative i vë në raport madhësitë e Fondeve Pensionale dhe performancën

Efikasiteti²²¹ i operimeve financiare të Sistemit Pensional në Kosovë e paraqet raportin në mes të rezultateve (kthimeve) dhe të investimeve (inputeve), të shprehura në rezultate për njësi të investimit apo të inputit.

Ndërsa efikasiteti i investimeve e shprehë raportin e kthimeve maksimale nga investimet vjetore, apo veprimi sa më i mirë i planifikimit dhe i realizimit të operimeve financiare mbi shfrytëzimin e inputeve financiare me shpenzime minimale (realizimi i qëllimeve racionale për të ardhmën).

Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës në vitin 2015 ka patur Asetet Neto të Përgjithshme nën menaxhim në shumën prej 1,229,333,328 €, ndërsa ka realizuar të ardhura Neto nga kthimet në shumën prej 28,389,646 €²²², mjetet nën menaxhim janë rritur për 13.0% krahasuar me vitin paraprak, dhe kapitali i saj aksionar i cili ishte i destinuar për shpagimin e pensioneve vjetore ishte në shumën prej 19,299,443 €²²³. Pra, vetëm nga realizimi i të ardhurave Neto nga kthimet që ishin realizuar në vitin 2015 në shumën prej 28,389,646 € janë mbuluar obligimet e Fondit Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për shpagimin e pensioneve vjetore në shumën prej 19,299,443 €. Nëse krahasohet shuma e kthimeve vjetore nga investimet e mjeteve financiare të Fondit Pensional të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ndaj shumës së nevojshme për shpagimin e anuiteteve pensionale vjetore, rezulton se shuma e kthimeve është më e madhe se sa nevoja për shpagime të anuiteteve pensionale për 0,47 herë ($28,389,646\text{€} / 19,299,443\text{€} = 1,47$), gjë që tregon se ky Fond Pensional e ka shkallën shumë të lartë të likuiditetit dhe të efikasitetit të mbajtjes së mjeteve nën menaxhim. Pra,

financiare. Nga kjo rezulton se përvojat, se Fondet Pensionale më të mëdha mund të arrijnë përfitime me të mëdha kete e konstatojnë Cheong (2007), Mahon, Donohoe (2006), Chon, Hong Huang, Kubik (2004), Bikker, Dreu (2009) dhe Ardon (2006).

²²¹ Efikasiteti i operimeve financiare e shpreh përdorimin e duhur të burimeve të disponueshme në raport me shpenzimet, ndërsa eficienca (ang.: efficiency) ngjashëm me produktivitetin e shpreh relacionin ndërmjet rezultatit dhe burimeve të përdorura (me përdorimin minimal të burimeve mbrenda kohës më të shkurtër të mundshme, arrihen rezultate maksimale, që nënkupton mënyrën e përdorimit të burimeve në dispozicion duke realizuar qëllimin maksimal, gjegjësisht kryerja e një funksioni në mënyrën më të mirë të mundshme, me sa më pak mund apo humbje.

²²² Kthimi bruto nga investimet e FP të TKPK për vitin 2015 ishte 28,389,646€, ndërsa Kthimet e tjera ishin 1,165,138€ = 29,554,784€

²²³ Raporti vjetor 2015, Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

të hyrat e Fondit Pensional të TKPK e shprehin raportin në mes të mjeteve të investuara dhe të kthimeve nga investimet.

Andaj, për të llogaritur efikasitetin e përdorimit të burimeve financiare, është e nevojshme që të definohen; *Të Ardhurat Neto, Të Hyrat Totale, Shpenzimet Totale*.

Të Ardhurat Neto- janë shumat e fituara nga Fondet Pensionale, pasi që nga Të Hyrat Totale të jenë zbritur Shpenzimet Totale, duke përfshirë amortizimin dhe taksat.²²⁴

Të Ardhurat Neto të Fondit Pensional= Asetet nën menaxhim- (Tarifat e ngarkuara + Shpenzimet investuese + Shpenzimet operacionale+Shpagimet e anuiteteve të pensioneve + Kontributet e paalokuara në fund të vitit)

Të Ardhurat Neto të Fondit Pensional të TKPK= 1,229,333,328€- (5,819,478€+ 4,442,773€+ 1,282,483€+ 19,299,443€+9,971,270€) = 1,229,333,328€- 40,815,447€=1,188,517,881€

Ndërsa, Kapitali i aksionarëve i përmban Asetet e Fondit Pensional, pasi të zbriten (minus) detyrimet ndaj tij.

Kapitali i Aksionarëve = Asetet nën menaxhim- (Vlera e mjeteve të tërhequra për vitin+Tarifat e ngarkuara për vitin+ Shpenzimet investuese për vitin+ Shpenzimet operacionale për vitin+ Kontributet e paalokuara në fund të vitit).

Kapitali aksionerëve = 1,229,333,328€- (19,299,443€+5,819,478€+4,442,773€+1,282,483€+ 9,971,270€)= 1,229,333,328€- 40,815,447€= 1,188,517,881€

$$ROE^{225} = \frac{\text{Të Ardhurat Neto}}{\text{Mesatarja e Ekuivalente të Aksionarëve}} =$$

$$ROE = \frac{1,207,817,324\text{€}}{1,188,517,881\text{€}} = 1,016\text{€}$$

Kështu që mund të konkludojmë se, për çdo 1 Euro të investuar, norma e kthimeve është 1,016€.

Norma e qëndrueshme e rritjes së (ROE)²²⁶ të Fondit Pensional të TKPK për vitin 2015 llogaritet si vijon;

²²⁴ http://www.financeformulas.net/Return_on_Assets.html#calcHeader

²²⁵ Return on Equity (ROE)- E shprehë raportin në mes të Të ardhurave Neto dhe të Kapitalit mesatar të aksionerëve.

$ROE = 2,3\% \times (1,229,333,328 \text{ €} / 19,299,443 \text{ €}) = 6,369\%$ e normës së rritjes së qëndrueshmërisë

$ROE = 6,369\% \times 13,0\% = 8,279\%$ norma e rritjes mesatare te qëndrueshmërisë.


Kurse, Norma e kthimeve nga pasuritë (ROA) rezulton nga raporti në mes të ardhurave Neto të Fondit Pensional të TKPK dhe të totalit mesatar të aktiveve të tij.

$$ROA^{227} = \frac{\text{Të ardhurat Neto}}{\text{Mesatarja e totalit të pasurive}} \times 100 = \frac{28,389,646 \text{ €}}{1,158,546,963 \text{ €}} \times 100 = 2.45\%$$

Norma e rritjes ROA dhe norma e brendshme e rritjes së Fondit Pensional të TKPK është llogaritur si vijon;

$$ROA = \frac{28,389,646 \text{ €}}{1,229,333,328 \text{ €}} \times 100 = 2,3\%$$

Norma e Rritjes së Brendshme = $2,3\% \times 13\%^{228} = 2,99\%$



Grafiku Nr.6. Rritja vjetore e çmimit të akcionit dhe kthimi bruto nga investimet e FP te TKPK 2011- 2015

Nga grafiku Nr.1. shihet se kthimet nga investimet e pasurive të Fondit Pensional të TKPK në vitin 2015 ishin 2,35% apo 29,554,784 € (kthimi bruto nga investimet 28,389,646 €

²²⁶ <http://accountingexplained.com/financial/ratios/return-on-equity>

²²⁷ Return On Assets (ROA)- E shprehë raportin në mes të Ardhurave Neto dhe të Pasurive (Totalit Mesatar të Aktiveve).

²²⁸ Llogaritja e rritjes së shumës së aseteve të përgjithëshme të FP të TKPK gjatë vitit 2015 $(1,229,333,328 / 1,087,760,598 = 1,1301506326 \times 100 = 113,051$ ose 13%).

dhe kthimet tjera 1,165,138€) të cilat përdoren për të shtuar shumën e mjeteve nën menaxhim dhe për të vlerësuar suksesin e realizimit të kthimeve nga pasuritë e investuara.

Efikasiteti në përfitimin e pensioneve varet nga aftësia financiare e çdo individi që të krijojë portfolio të pasur pensionale (varet nga lartësia e kontributeve pensionale dhe nga kapitalizimi i tyre si faktor i rëndësishëm) si dhe nga kostoja e administrimit të saj.

5.4. Ekuilibrat e modelit të Sistemit pensional në Kosovë²²⁹

Raporti në mes të hyrave financiare nga kontributet pensionale dhe të kthimeve nga investimet, në relacion me; *shpagimet e anuiteteve, shpenzimet e tërësishme, ndikimet makroekonomike të vendit dhe ndikimet e jashtme financiare e paraqesin shkallën e ekuilibrit të sistemit pensional në Kosovë.*

Cerin P. (2002) konstaton se Bordi Qeverisës²³⁰ i një Fondi Pensional vlerëson se, duhet të këtë kujdes në rregullimin e ekuilibrit midis asetëve financiare në disponim dhe të interesave të kontribuesve të cilët së shpejti dalin në pension.²³¹

Bordi Qeverisës i Skemes Pensionale e ka për detyrë të bën baraspeshimin e funksionimit të Skemave Pensionale, duke i marrë parasysh këto çështje dhe mbanë qëndrim të bazuar mbi parimin e investimeve të kujdesshme për kthimet e mundshme nga tregjet e kapitalit financiar. Mbi ekuilibrimin janë dhënë shumë teori, të cilat kanë pasur për qëllim të përkufizojnë gjendjen e ekuilibrit ekonomiko- social të sistemit pensional, duke përcaktuar komponentet e bartësve të modelit të ekuilibruar, të cilat shërbejnë për

²²⁹ Ekuilibri arrihet pasi të bëhet vlerësimi i kthimeve nga investimet pensionale për të paguar obligimet .

²³⁰ Cerin P. Communication in corporate environmental reports. Corporate Social Responsibility and Environmental Management 9(1): 46–66, (2002).

²³¹ Në varshmëri nga shkalla e ekuilibrit të fondeve pensionale, aplikohet strategjia e cila kontribon në balancimin e të hyrave të vazhdueshme të kontributeve pensionale, të cilat investohen me shkallë relativisht konzervative të rrezikut në periudha afatgjate dhe shpagimeve të anuiteteve pensionale, sipas periudhave të përshtatshme ligjore.

llogaritjen e pikës kritike, apo të “pikës së qendrës së rëndesës së modelit”²³², duke u bazuar në studimin statik dhe dinamik të operimeve të Fondeve Pensionale në tregun e investimeve ndërkombëtare dhe në administrimin e tyre.

Ekulibri i Fondeve Pensionale varet edhe nga sistemi makroekonomik i Kosovës dhe nga ndikimet e lëvizjeve financiare në tregjet ndërkombëtare të kapitalit financiar.

Carlo Cafiero and Renos Vakis (2006) konstaton se pozicioni i pikës së ekuilibrit²³³ paraqet gjendje stabile, moment të qetë të veprimit të tregjeve, gjegjësisht qëndrueshmëri të Sistemit Pensional.

Perdorime financiare afatgjate të qëndrueshme	Burime financiare afatgjate të qëndrueshme
Përdorime financiare afatshkurtëra	Burime financiare afatshkurtëra

Fig. Nr.2. Perdorimet dhe burimet financiare.

Pikat e stabilitetit të Sistemit Pensional përqëndrohen kryesisht në variablat e ndryshueshme të sistemit pensional dhe në kapacitetet e fondeve pensionale, të cilat mund të ruajnë pozicionin e qendrës stabile, nën ndikimin faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm (të makrosistemit ekonomik në Kosovë dhe të ndikimeve të jashtme financiare).

Pra, aktualisht Sistemi Pensional në Kosovë disponon me shumën e vlerës së aseteve financiare, të cilat janë të përafërta me buxhetin e Kosovës.

Kështu që mund të konkludohet se, demonstrimi i këtij modeli të Sistemit Pensional në Kosovë ka reprodukuar zhvillim kualitativ të fondeve pensionale, stabilitet financiar, stabilitet social, etj.

²³² “Pikat e rëndesave” të modelit mund të interpretohen si gjendje, momente vepruese të modelit të Sistemit Pensional, të cilat paraqesin stabilitet financiar, apo vetqëndrueshmëri.

²³³ Carlo Cafiero and Renos Vakis “Risk and Vulnerability Considerations in Poverty Analysis: Recent Advances and Future Directions, October 2006.

5.5. Planet pensionale

Planet pensionale janë një formë e kursimeve afatgjata të kontributeve pensionale, të krijuara gjatë tërë periudhës së punësimit të qëndrueshem, ku i punësuari përfiton të ardhura.

Sistemi i Pensioneve të Definuar ose sistemi investues i kontributeve pensionale, në Kosovë ka filluar të zhvillohet që nga viti 2002, ndërsa nga periudha 1999 deri në vitin 2002 nuk ka funksionuar asnjë formë apo model i Sistemit Pensional. Që nga viti 1945 deri në vitin 1999 ishte zhvilluar Sistemi Pensional i Transfereve Pensionale²³⁴ i cili në vitin 1999 kishte përfunduar. Koncepti i Sistemit të Kontributeve të investuara, i referohet programit në të cilin kontributet mblidhen dhe vendosen në llogaritë individuale (Portfolio e Llogarise Individuale të Kursimeve Pensionale) përgjatë periudhës që individët kontribuojnë, e më pas ato investohen në tregje të kapitalit financiar, për të siguruar pension në një të ardhme.

Portfolio e Llogarisë Individuale të Kursimeve Pensionale e pasqyron gjendjen e derdhjes së kontributeve të definuar pensionale nga ana e punëdhënësit dhe të punëmarrësit në llogarinë individuale të punëmarrësit.

Këto mjete financiare, të cilat janë në pronësi private, mandati i këtyre kursimeve është specifik, sepse;

- ato mund të përdoren vetëm për pension. dhe
- nuk mund të përdoren ose tërhiqen përpara moshës së pensionimit për asnjë arsye tjetër, sipas Kevin Dowd and David Blake (2013) merren për hua, për trajtime mjekësore e të ngjashme.²³⁵

²³⁴ Sistemi pensional i bazuar në transferime (njihet si PAYG – Pay As You Go), është program shtetëror që financohet nga tatimet ose kontributet që mblidhen nga popullata e punësuar. Sipas kësaj skeme, punëtorët aktual financojnë pensionistët aktual.

²³⁵ Kevin Dowd and David Blake “Good Practice Principles in Modelling Defined Contribution Pension Plans”, Pensions Institute Cass Business School 106 Bunhill Row London EC1Y 8TZ United Kingdom, September 2013

Paratë e grumbulluara në Sistemin e kontributeve pensionale të investuara kursehen gjatë tërë periudhës së punësimit, deri sa përfituesi të mbushë moshën e pensionimit (65 vjet), këto para të mbledhura në Fondin Pensional respektiv mbahen plotësisht të ndara nga buxheti shtetëror, ato investohen e nuk shpenzohen menjëherë, por shërbejnë për të shpëguar anuitete pensionale, apo për të blerë pension.

Ky sistem është më transparent ndaj pjesëmarrësve, pasi lejon definimin e qartë të drejtave të pronësisë mbi kontributet dhe kapitalizimet, për përfituesit e pensiononeve. Pensioni i tyre do të varet nga kontributet pensionale dhe nga kthimet e investimeve, minus shpenzimet e tërësishme të cilat e ngarkojnë llogarinë individuale.

Plani Pensional rregullohet në bazë të ligjeve në fuqi dhe në bazë të marrëveshjeve të veçanta të rregulluara në mes të; *institucioneve të specializuara për Sigurime Pensionale, të Fondeve Pensionale, të cilat janë të autorizuar për të ofruar pensione.*

Kompensimi i shtyrë pensional- Fondet Pensionale e bëjnë administrimin e llogarive individuale të kontributoreve, i sigurojnë pronarët e llogarive individuale, të cilat janë; të ruajtura, të kapitalizuara dhe të siguruara, në mënyrë që të shfrytëzohen për përdorim në periudhën e pensionimit, ky plan pensional ndryshe quhet "Kompensimi Shtyrë Pensional" sipas Newton L. Bowers, JR., James C. Hickman and Cecil J. Nesbitt (1979).²³⁶

5.5.1. Planet pensionale me përfitime të definuara

Plani pensional me përfitime të definuara i identifikon dobitë e veçanta, duke u shërbyer me një formulë e cila i merr parasysh faktorët struktural të pensionit (numrin e viteve të një pjesëmarrësi i cili punon për punëdhënësin, apo vitet e shërbimit të tij dhe lartësinë e rrogës së pjesëmarrësit, që do të jenë të pagueshme për një përfitues të pensionit, kur ai del në pension në moshën 65 vjeqare).²³⁷

²³⁶ Newton L. Bowers, JR., James C. Hickman and Cecil J. Nesbitt "The dynamics of pension funding: contribution theory, Transactions of society of actuaries 1979 Vol. 31

²³⁷ Investopedia Staff; <http://www.investopedia.com/contributors>

Planet pensionale me përfitime të definuara në aspektin e përfitimit të përfituesve karakterizohen nga:

- 1) Planet pensionale përshtaten në bazë të formulave për përfitime,
- 2) Planet Pensionale bazohen në kontributet vjetore nga viti në vit,
- 3) Planet Pensionale të bazuara në kontributet e punëdhënësit, të cilat shkojnë duke u zvogëluar, ndërsa përfitimet shkojnë duke u rritur.

Te planet pensionale me përfitime të definuara, shumat e kontabilizuar në bilancin e gjendjes, të cilat duhet të jenë të barabarta me Vlerën e Tanishme të Detyrimeve të Skemës së Përfitimeve të definuara (Vlera e Tanishme e Pagesave të Pritshme në të ardhmen, kërkohen për të shlyer obligimet që dalin nga shërbimet e punonjësve në periudhat aktuale dhe të mëparshme), të korrigjuara me Vlerën e Kostove të cilat rezultojnë me zvogëlim apo rritje të shpenzimeve, të cilat kushtëzojnë fitime apo humbje të drejtëpërdrejtë në pasuritë e bilancit të gjendjes së Skemës pensionale e cila gjeneron pensione respektive. Në këtë rast punëdhënësi bën korrigjime në Skemen e Planeve Pensionale me përfitime të definuara, duke mbuluar pjesën më të madhe të kostove, ose duke bërë korrigjime ndaj skemës pensionale përmes rritjes së nivelit të kontributeve dhe në të kundërtën, në qoftë se investimet dalin mirë, atëherë niveli i kontributeve mund të zvogëlohet.

Formula për një pension të caktuar mund të përcaktohet në bazë të shumës së pagës mesatare të pjesëmarrësit dhe kohëzgjatjes së shërbimit të punëdhënësi, siç është përkufizuar me rregullat e BQK-së, ose përcaktohet ndryshe me ligjin mbi pensionet. Individidi, si person fizik, për kontributet pensionale të paguara në fondin pensional përfiton të drejtën për zbritjen nga tatimet në të ardhurat personale (kur ai paguan individualisht). Ndërsa, kur punëdhënësi paguan kontribute pensionale për punëtorët e vet, ato i llogariten si shpenzime të ndërmarrjes së tij, duke ia zvogëluar kështu bazën për tatim në fitim.

Te planet pensionale me përfitime të definuara, përdoren formulat e përfitimeve, të cilat nuk bazohen vetëm në formulat e kontributeve, që nënkupton se elementet e rrezikut mbeten te punëdhënësi, të cilat nuk mund të paraqesin rreziqe aktuariane, ndërsa rreziqet e investimit i kalojnë palës së tretë, sepse detyrimet e tij janë të kufizuara nga kontributet që janë bërë gjatë tërë periudhës së kontribuimit.

Te planet pensionale me përfitime të definuara, punëdhënësi e bartë rrezikun e investimit, meqenëse kompania është garantues i një pensioni të bazuar mbi kohën e shërbimit të punonjësve pjesëmarrës në skemë, ku detyrimet e punëdhënësit nuk janë të kufizuara me shumat e kontributeve. Andaj, rreziqet nga kthimet e investimeve janë në barrë të punëdhënësit, sepse ai është përgjegjës për mbulimin e mangësive që dalin në skemën pensionale.

Faktori që i bën të ndryshme skemat me përfitime të definuara nga ato me kontribute të definuara, është përcaktimi i faktit se në barrë të kujt mbetet rreziku.²³⁸

Filozofia e planeve të pensioneve me përfitime të definuara është, shpërblimi i anëtarëve me pension gjatë tërë jetës pas daljes në pension (për anëtarët që kanë shërbyer me të ardhura gjatë tërë jetës, deri në pension).

5.5.2. Llojet e pensioneve në Kosovë²³⁹

Sipas Ligjit Nr. 04/l-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe te Ligjit Nr. 04/l-101 për Fondet Pensionale të Kosovës janë përcaktuar llojet e pensioneve si vijon;

- 1) Pensionet e Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti
 - a) Pensionet bazike të moshës,
 - b) Pensionet kontribut pagueuse të moshës,
 - c) Pensionet e aftësisë së kufizuar,
 - d) Pensionet e parakohshme,
 - e) Pensionet familjare dhe

²³⁸ <http://www.myretirementpaycheck.org/retirement-plans/defined-benefit-plans.aspx>

²³⁹ Në këtë studim nuk janë përfshirë përfituesit e Skemave Pensionale,²³⁹ të cilat janë rregulluar me ligje të veçanta (të cilat i rregullojnë skemat tjera sociale).

- f) Pensionet invalide të punës,
- 2) Pensionet e Shtyllës së II-të të financuara nga kontributet pensionale individuale
(Pensionet nga kursimet e detyrueshme të kontributeve pensionale individuale.)
- 3) Pensionet e Shtyllës së III-të të financuara nga punëdhënësit dhe kontributet individuale
(Pensionet plotësuese të punëdhënësit ose pensionet individuale suplementare.)

5.5.2.1. Pensionet e Shtyllës së I-rë të financuara nga shteti

Numri i përfituesve të pensioneve nga Shtylla e Parë buxhetore është prej 164 200 pensionistëve, prej tyre në Kosovë llogariten që janë mbi;

- 113.000 *pensionistë të moshës* cilët marrin nga 75 Euro në muaj në emër të Pensionit Bazë,
- 35. 638 *pensionistë kontribut dhënës*, të cilët përfitojnë të marrin nga 112 Euro në muaj,
- 17. 450 *pensionistë, persona me aftësi të kufizuar*, të cilët përfitojnë nga 60 Euro në muaj,
- 8. 780 *pensionistë, invalide të luftës*, të cilët kanë përfituar pensionin invalidor,
- 4. 065 *pensionistë, minatorë të Trepçës*, të cilët marrin nga 200 Euro në muaj,
- 531 *pensionistë të TMK-së*, të cilët e marrin pensionin e parakohshëm të TMK-së,
- 237 *pensionistë të FSK-së*, pjesëtarë të FSK-së²⁴⁰.

5.5.2.1.1. Skema e Pensioneve Bazë të Moshës

Pensionist përfitues nga Skema e Pensioneve Bazë të Moshës- përfshin të gjithë banorët rezident të Kosovës, cilët e arrijnë moshën e pleqërisë prej 65 vjetëve, pa marrur parasysh marrëdhënien e punës, ata përfitojnë pension bazë. *Përfituesit e Pensioneve Bazë të Moshës, kanë filluar të përfitojnë pension që nga viti 2002.* Numri i përfituesve të kësaj

²⁴⁰ Burimi: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Divizioni i Pensioneve

skeme në vitin 2017 ishte prej 122.716 pensionistëve, të cilët aktualisht marrin nga 75 Euro në muaj.

Vitet	Numri i shfrytëzuesve	Shuma Mujore	Buxheti i shpenzuar vjetor
2002	93.087	28 €	17.874.763,00
2003	108.279	35 €	44.459.960,00
2004	116.932	40 €	54.912.599,00
2005	124.893	40 €	59.313.333,00
2006	127.356	40 €	63.766.380,00
2007	131.874	40 €	63.133.100,00
2008	138.847	40 €	65.641.485,00
2009	130.347	45 €	73.603.960,00
2010	109.585	45 €	63.640.920,00
2011	107.145	45 €	61.196.210,00
2012	113.043	50 €	69.208.570,00
2013	117.042	60 €	87.340.090,00
2014	125.883	75 €	108.199.460,00
2015	132.000	75 €	120.456.558,00
2016	120.014	75€	117.600.660,00
2017	122.716	75€	113.079.075,00

Tabela. Nr.26. Numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve Bazë të moshës gjatë periudhës 2002-2017²⁴¹

5.5.2.1.2. Skema e pensioneve Bazë kontributive

Pas suprimimit të autonomisë së KSA Kosovës (28 Mars 1989) nga ana e RS Serbisë dhe zbatimit të “masave të përkohshme” në institucionet e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës, duke i shfuqizuar ligjet e Kosovës dhe duke i aplikuar ligjet e RS Serbisë, i kishte marrë kompetencat mbi qeverisjen e mjeteve të Fondit Pensional të Kosovës²⁴².

Kështu që pensionistët e Kosovës (të nacionalitetit shqiptar), të cilët e kishin fituar të drejtën për pension para vitit 1999, ata kishin marrë pension deri në vitin 1999. Mirëpo prej fillimit të vitit 1999, RS e Serbisë ia kishte ndërprer²⁴³ pagesën e pensioneve të gjithë pensionistëve shqiptarë në Kosovë, pa i njoftuar për shkaqet e ndërprerjes (ndryshimi i

²⁴¹ Të dhënat mbi numrin e përfituesve, shumën mujore dhe buxhetin e shpenzuar vjetor gjatë periudhës 2002-2014 sipas viteve. Burimi i informatave nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës.

²⁴² Me Ligjin mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor (“Sluzhbeni gllasnik SRS”, nr.27/1992), RS e Serbisë e kishte shfuqizuar Ligjin (e Kosovës) mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor (“Gazeta Zyrtare e KSAK”, nr.26/83 dhe 26/86), i kishte marrë kompetencat mbi qeverisjen e mjeteve financiare si dhe të drejtat dhe obligimet lidhur me të gjitha llojet e pensioneve në Kosovë.

²⁴³ Serbia ia kishte ndërprerë pagesën e pensioneve në kundërshtim me ligjet e RS Serbisë dhe me instrumentet juridike ndërkombëtare, duke shkelur kështu të drejtën e pasurisë (pronës), të paraparë në Nenin 1. të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

procedurave ligjore, ndryshimi i vendimeve individuale të plotfuqishme që kishin pensionistët) dhe pa iu mundësuar mbrojtjen ligjore, duke i privuar ata në mënyrë arbitrare nga e drejta për shfrytëzimin e pensionit²⁴⁴.

RS e Serbisë e kishte bërë ndërprerjen e pagesës së pensioneve, në bazë të qëndrimeve politike që kishin marrë Ministria e Punës dhe Ministria e Financave e RS Serbisë, me arsyetim të pamundësisë për vjeljen e kontributeve për sigurimin pensional dhe invalidor në Kosovë.

Pensionistët e Kosovës, të cilët e kishin fituar të drejtën e pensionit (të moshës, invalidor ose familjar) duhet të gëzojnë të drejtën për të shfrytëzuar e pensioni e fituar, në bazë të ligjit me aktvendim të plotfuqishëm.

E drejta e fituar e pensionit ka karakter të pasurisë (pronës së pensionistit)²⁴⁵ e cila duhet të mbrohet në mënyrë juridike me ligjet e shtetit, sepse ajo mund të trashëgohet e të bartet te anëtarët e ngushtë të familjes së pensionistit të vdekur (pensioni familjar).

Pensionistët kontributdhënës të Kosovës, përveç shumës së pensionit që kishin fituar, ata kishin fituar edhe sigurimin shëndetësor dhe prestacione e favore tjera të caktuara me ligj.

Kështu që në fund të vitit 1998, RS e Serbisë i kishte shkelur ligjet përkatëse dhe ato ndërkombëtare për shpagimin e pensioneve, duke i privuar ata nga e drejta për shfrytëzimin e pensionit për 86.383 pensionistë kontributdhënës të tri kategorive, si vijon;

Pensionistë të vjetërsisë (pleqërisë)	33.308
Pensionistë invalidorë (të punës)	25.045
Pensionistë familjarë	28.034

²⁴⁴ RS e Serbisë e kishte arsyetuar ndërprerjen e pagesës së pensioneve të pensionistëve kosovar me pamundësinë e vjeljes së kontributeve pensionale.

²⁴⁵ Ashtu sikur e trajton Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe kjo dispozitë ka epërsi mbi dispozitat e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Ndërsa deri në fund të vitit 1998 të drejtën e fituar për pensione jokontributdhënëse e kishin fituar 3.157 persona të dy kategorive, të cilëve iu kishte ndërprerë e drejta për pension nga ana e RS Serbisë, ishte si vijon:

Shfrytëzues të kompensimit për dëmtim trupor	1.266
Shfrytëzues të ndihmave dhe kujdesit	1.252
Pensionet e shkallës së dytë dhe të tretë	230
Pensionet e LANÇ	409

Skema e Pensioneve Bazë kontributive i përfshinë përfituesit, të cilët i kanë paguar kontributet për Sigurim Pensional e Invalidor (SPI) sipas dispozitave ligjore të (ish) sistemit pensional të RSFJ-së për më tepër se 15 vite (personat që mbushin moshën 65 vjeqare). Në vitin 2014, ata kanë përfituar Pensionin bazë të Moshës plus Pensionin Kontributiv në shumën prej 140 Euro (75 Euro+ 65 Euro= 140 Euro). Numri i përfituesve të pensioneve nga Skema e pensioneve bazë kontributive, në vitin 2014 ishte prej 38.651 pensionistëve, të cilët kishin përfituar shumën prej 61.895.592,00 Euro.

Viti	Numri i shfrytëzuesve	Shuma mujore	Buxheti i shpenzuar vjetor
2008	27.774	35 €	11.286.910,00
2009	22.883	35 €	12.104.470,00
2010	30.641	(45 + 35) = 80 €	30.899.760,00
2011	32.415	(45 + 35) = 80 €	31.670.450,00
2012	34.722	101€	42.037.781,00
2013	36.015	112 €	49.412.649,00
2014	38.651	(75+65) =140 €	61.895.592,00
2015	40.365	(75+65) =140 €	68.237.577,00
2016	41.315	158, 172, 186, 230	86.690.367,0
2017	43.300	158, 172, 186, 230	90.672.542,00

Tabela. Nr.27. Numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve Bazë kontributive gjatë viteve 2008- 2017

Nga Skema e Pensioneve Baze kontribuese në vitin 2017 kishin përfituar pension 43.300 pensionistë, të cilët ishin të kategorizuar në bazë të kualifikimit profesional si vijon; personat me kualifikim të ulët përfitojnë pension mujor prej 158 Euro; me kualifikim të mesëm përfitojnë pension mujor prej 172 Euro; me kualifikim të lartë përfitojnë pension prej 186 Euro; me kualifikim superior përfitojnë pension prej 230 Euro.

VITI	Buxheti i shpenzuar
2002	17.874.763,00
2003	44.459.960,00
2004	63.931.179,00
2005	77.360.640,00
2006	81.513.669,00
2007	76.041.175,00
2008	89.726.449,00
2009	100.194.985,00
2010	109.346.555,00
2011	108.187.116,00
2012	127.498.108,00
2013	156.399.937,00
2014	198.856.611,00
2015	211.339.320,00
2016	227.375.227,00
2017	226.829.937,00

Tabela. Nr.28. Totali i mjeteve të paguara për pensione nga Skema e Pensioneve Bazë²⁴⁶

5.5.2.1.3. Skema Pensionale Invalidore

Kjo skemë pensionale ka funksionuar deri në vitin 1999, ndërsa me nxjerrjen dhe aprovimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti²⁴⁷ (Ligjit NR. 04/L-131 te dates 05 Qershor 2014) në të ardhmen do të mbështetet edhe kjo kategori e pensionisteve nga Buxheti i Kosovës. Ndërkaq llogaritet se në Kosovë janë 17.450 persona me aftësi të kufizuar, të cilët përfitojnë nga 60 Euro në muaj.²⁴⁸

	2014	2015	2016	2017
Shuma	16.821.950,00	18.220.360,00	18.697.755,00	18.878.980,00
Nr. i përfituesve pensional invalidor	18.318	19.056	19.833	19.481
Shuma mujore	75	75	75	75

Tabela Nr.29. Përfituesit e Pensionit për personat me aftësi të kufizuar gjatë viteve 2014-2017

²⁴⁶ Me metodologjinë e deritshme të përcaktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe të përfshirjes së përfituesve të pensioneve, iu lejon 27.000 pensionistëve serbë e malazezë dhe mbi 6.000 shqiptarëve të marrin nga dy pensione, nga Serbia e Kosova (33.000x 80Euro = 2,640,000.00 Euro në muaj, apo për një vit e kap shumën prej 31,680,000.00 Euro).

²⁴⁷ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovë / nr.35 / 05 qershor 201

²⁴⁸ Invalidët e luftës janë 8. 780, të cilët kanë përfituar pensionin invalidor, minatorët pensionist të Trepçës janë 4.065, pensionistë të parakohshëm të TMK-së janë 531 dhe pensionist të pjesëtarëve të FSK-së janë 237.

	Numri i përfituesve sipas viteve 2010-2017	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1.	Pensionet bazike të moshës	109.858	107.145	113.043	117.042	125.883	132.000	120.017	122.716
2.	Pensionet kontributpagues të moshës	30.641	32.415	34.722	36.015	38.651	40.365	41.315	43.300
3.	Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës (DFDIL) dhe invalidet tjere	12.994	13.109	13.232	13.196	13.097	12.652	12.680	12.472 + 7.009
	Total	153.493	152.669	160.997	166.253	177.631	185.017	176.012	185.497

Tabela Nr.30. Numri i tërësishem i përfituesve të skemave pensionale; Shtylla e I- Pensionet baze (2010-2017)²⁴⁹

5.5.2.2. Pensionet e Shtyllës së II-të të financuara nga Kontributet Pensionale Individuale

Pensionet e Bazuara në Kursimet e kontributeve Individuale, janë pensione që Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ua paguan të gjithë personave që kanë kontribuar gjatë tërë periudhës së punesimit, deri në moshën e pensionimit, kur ata i plotësojnë kushtet sipas Ligjit mbi pensionet.

Pjesëmarrësi është i lirë të zgjedhë kompaninë e licencuar të sigurimeve, nga e cila blen pensionin vjetor sipas ofertës pensionale vjetore, si vijon:

- 1) Pensionin e veçantë jetësor, që paguhet deri në vdekjen e pjesëmarrësit.
- 2) Pensionin e veçantë jetësor, të garantuar për periudhën prej së paku pesë (5) vjet, në bazë të të cilit pjesëmarrësi (trashëgimtari ligjor) merr garancionin për pagesë të pensionit për periudhën 5 vjeqare (edhe nëse përfituesi i pensionit vdes gjatë periudhës së garancisë, shumat e papaguara do t'i përfitojnë trashëgimtarët e tij ligjor.
- 3) Pensionin vjetor të pagueshëm gjatë jetës së përfituesit pensional dhe vazhdon gjatë jetës së bashkëshortit të përfituesit pas vdekjes së tij, për pjesën e mbetur të jetës së saj apo të tij.
- 4) Pensionin vjetor të pagueshëm gjatë jetës së përfituesit pensional dhe vazhdon gjatë jetës së bashkëshortit të saj ose bashkëshortes së tij për pjesën e mbetur të jetës së tij ose të saj me një periudhë garancie prej së paku pesë (5) vitesh, në bazë të së cilës

²⁴⁹ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2018

nëse vdesin që të dy bashkëshortët gjatë periudhës së garancisë prej pesë (5) vitesh (ose periudhës më të gjatë të garancisë), pagesat e papaguara që do t'i ishin paguar bashkëshortit ose bashkëshortes nga dita e vdekjes së tij ose deri në fund të afatit të garancisë, do t'iu paguhen shfrytëzuesve që i ka paracaktuar pjesëmarrësi, ndërsa llojet e tjera të pensionit janë të cekura në rregulloret e BQK-së.

5.5.2.2.1. Mënyrat e tërheqjes së pensioneve nga kontributet e kursyera pensionale

Ligji mbi Fondet Pensionale parasheh që kontribuesit të cilët pensionohen nga fondet pensionale, mund t'i tërheqin mjetet në formë të;

- 1) Anuitetit,
- 2) Me një pagesë të vetme,
- 3) Transferimi i fondeve ne Programin e Terheqjes me Faza,
- 4) Etj.

5.5.2.2.2. Pensionet dhe pagesat e benefiteve të FP të TKPK në formë anuitetesh

Anuiteti²⁵⁰ është një produkt financiar, që zakonisht ofrohet nga kompanitë e sigurimit, i cili i siguron të ardhura mujore apo vjetore për individin. Për ndryshim, *anuiteteti* është një polisë sigurimi, të cilën një pjesëmarrës e blen nga një kompani e sigurimit, e cila përcakton pagesat mujore për tërë periudhën e definuar të përfituesit. Pra, anuitetet janë produkte financiare që konvertojnë shumën e kontributeve të kursyera në rrjedhë mujore parash.

²⁵⁰ Anuiteti është një produkt financiar, që zakonisht ofrohet nga kompanitë e sigurimit, i cili i siguron të ardhura mujore apo vjetore për individin. Është një polisë sigurimi të cilën një pjesëmarrës e ka blerë nga një kompani e sigurimit, e shprehur në formë të pagesave mujore për tërë jetën e pjesëmarrësit ose të përfituesit të tij. Ato e konvertojnë shumën e kontributeve të kursyera në rrjedhë mujore parash. Aktualisht përfituesit e Shtylles së dytë të pensioneve, përfitojnë anuitete të llogaritura pensionale, në tregun e sigurimeve të Kosovës do të ketë anuitete në të ardhmen, ku kontribuesit përmes anuitetit do të kenë mundësi që nga kursimet pensionale të tyre “të blejnë” pensionin e tyre. Produkti financiar anuiteti është i rregulluar me Ligjin mbi Pensionet në Kosovë, që parashihet të i ofrohet përfituesit nga kompanitë e sigurimit, duke i ofruar pension mujor apo vjetor.

Vlera e kursimeve të një kontribuesi në Fondin Pensional parashihet të përdoret për të blerë anuitet të përjetshëm me rastin e pensionimit, pra pension të përjetshëm.

Bazuar në të dhenat e FP të TKPK rezulton se bilanci mesatar i të gjitha llogarive në FKPK në fund të 2017-s ishte 3,003 Euro, gjë që sipas Rregullores në fuqi për tërheqjen e pensioneve (200 euro në muaj) ky bilanc mesatar do të ishte i mjaftueshëm për vetëm 15 muaj pension.

Në mungesë të produktit të anuitetit në Kosovë, Bordi Qeverisës i Fondit Pensional ka të drejtën ligjore për të aranzhuar, me miratimin e BQK-së, tërheqjen me faza të kursimeve pensionale.

Në të ardhmen, me rritjen e vazhdueshme të balanceve të llogarive, pritjet që në tregun e sigurimeve të Kosovës të ketë gjenerues të anuiteteve, ku kontribuesit nga kursimet e tyre pensionale mund “të blejnë” pensionin e tyre, të cilin do ta marrin në formë të anuiteteve.

Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës e ka rregulluar menyren e shfrytëzimit të kontributeve të kursyera, të cilat mund të përdoren vetëm me një qëllim, financimin e anuiteteve pensionale të kontos individuale të përfituesit të kontributeve, financimin e pensionit të një kontribuesi, por jo për qëllime të tjera.

Kontribuesit të cilët pensionohen në moshën 65 vjeqare, mund t'i tërheqin kontributet e kursyera në formë të anuiteteve ose me një pagesë të vetme, varësisht nga bilanci i llogarisë, do të tërheqë të gjitha paratë në portfolion e vet përjehërë.

Nëse bilanci i llogarisë së kontribuesit është deri në 2,000 euro, kontributet do të tërhiqen përnjëherë.

Nëse bilanci i llogarisë së kontribuesit është mbi 2,000 euro, kontributet e kursyera do të tërhiqen në faza.

Aktualisht, kёsti mujor pёr tёrheqjen nёpёr faza ёshtё €150, ose 1% e bilancit tё kursyer.

Një kontribues do të mund t'i tërheqë kursimet pensionale në formën e tërheqjes nën rregullat e formës së tërheqjes.²⁵¹

Kontribuesi mund t' i tërheqë kontributet e kursyera në këto raste;

Një kontribues mund të bëjë tërheqjen e kursimeve pensionale, pra të pensionohet nga Fondi Pensional, me të arritur moshën e pensionimit e cila sipas ligjit është mosha 65 vjeçare,

Një kontribues mund t' i tërheqë kursimet e veta pensionale para se të mbushë moshën 65 vjeçare, në rastin kur kontribuesi bëhet përherë i paaftë për punë.

Një kontribues mund t'i tërheqë kursimet pensionale, në rast se ai apo ajo emigron përherë nga Kosova.

Nëse një kontribues në fondin pensional vdes, atëhere trashëgimtarët e tij ligjorë do t'i tërheqin kursimet e pashfrytëzuara të kontribuesit.

Në rastet e vdekjes së kontribuesve, sipas Ligjit mbi Fondet Pensionale dhe të Rregullave të Pensioneve të BQK-së, i pensionuari futet në programin e tërheqjes në faza, atëherë trashëgimtarët e kontribuesit do të vazhdojnë t'i pranojnë pagesat e kontribuesit të ndjerë çdo muaj deri sa të shterren.

Në mungesë të licencimit të kompanive të sigurimit, të cilat ofrojnë produkte të ndryshme anuiteteve në Kosovë, Bordi Qeverises i Fondit Pensional mundëson tërheqjen e kursimeve pensionale me faza, në bazë të drejtës së përkohëshme ligjore dhe me miratimin e BQK-së në përputhje me Rregullat e Pensioneve.

Pra, në Kosovë vazhdon të mos jenë të licencuara kompanite e sigurimit të cilat do të ofronin produkte të anuiteteve pensionale.

²⁵¹ Raport Vjetor i FKPK- Trusti, Prishtine, 2012

Numri i llogarive me tërheqje prej themelimit(2002-2014) deri në vitin 2014 ishte 24,548 llogari.

Gjatë vitit 2014 Fondi Pensional i TKPK kishte miratuar 4,045 aplikacione të reja për tërheqjen e kursimeve pensionale. Numri i personave që i kishin tërhequr mjetet pensionale gjatë vitit 2014 (pasi kishin arritur moshën 65 vjeçare të pensionimit) ishin 3,095 ose 76,4% e aplikacioneve të miratuara, ndërsa në vitin 2013 ishin miratuar 2,676, ose 75,0% të kërkesave.

Vlera e tërheqjeve të kursimeve pensionale nga FP i TKPK në vitin 2014 ishte prej €14.3 mln (që përbëheshin nga kontributet nominale prej €12.3 mln Euro), që ishte për 32,8% më e lartë, krahasuar me vitin 2013, përkundër faktit që numri i llogarive nga të cilat ishin tërhequr mjetet financiare, ishte rritur me 13,4%²⁵².

Mjetet pensionale i kishin tërhequr 143 persona për shkak të invaliditetit, ose ishin miratuar 3,5% e aplikacioneve, ndërsa në vitin 2013 ishin miratuar 151 aplikacione ose 4,2% të kërkesave.

Nr. R.	Vitet	Nr. i kontributoreve TF	Pjesemarrja	Shuma e TF	Pjesemarrja
1	2008	146	7.2 %	€ 591,602	22.7 %
2	2009	213	9.9 %	€ 981,115	32.8 %
3	2010	469	17.2 %	€ 1,765,990	37.0 %
4	2011	918	32.0 %	€ 3,196,034	55.7 %
5	2012	1,324	40.6 %	€ 5,881,768	67.8 %

Tabela. Nr.31. Numri kontributoreve të cilët e bëjnë tërheqjen në faza

Kursimet e tërhequra nga trashëgimtarët e kontribuesve pensional që vdiqën²⁵³ para se t'i tërhiqnin fondet e tyre pensionale, nga Fondi Pensional i TKPK-ja në vitin 2014 ishin 810 raste, ndërsa në vitin 2013 ishin 740 raste, apo ishin 20.0% të aplikacioneve të miratuara.

²⁵² Këtë shpërputhje në mes të numrit të përfituesve dhe vlerës së tërhequr e arsyeton rritja prej 12.7% e bilancit mesatar të llogarive të kontribuesve, që në fund të 2014-s arriti në €2,376 , ndërsa në vitin 2013 ishte €2,107.

²⁵³ Në vitin 2014 në 35% të rasteve kontribuesit ishin më të rinj se 55 vjeç kur vdiqën, 26% ishin 55- 59, dhe 27% ishin 60-64 vjeç.

Gjatë viti 2014 mesatarisht janë realizuar fitime prej 16.5% nga të pensionuarit dhe trashëgimtarët, ndërsa në vitin 2013 kjo shifër ishte 11.1%. Shuma e tërhequr e mjeteve të kursyera pensionale pritet të rriten për shkak të investimit të tyre në tregun e kapitalit financiar dhe të rritjes së normës së kthimit, e cila mund të oscilojë rreth 16,7% , për shkak të rritjes eksponenciale.

Viti	Kontribute	Mjetet e TPF	Numri i llogarive me terheqje
2004-2012	28.200.000	28.200.000	
2013	9.700.000	10.700.000	
2014	12.300.000	14.300.000	
2015	15.800.000	19.300.000	28,981
2016	16.000.000	19,208,572	33,386
2017	22.100.000	27,739,656	38,512
Total	104.100.000	119,472,467	

Tabela. Nr.32. Vlera e mjeteve të tërhequra gjatë periudhës 2004 deri 2017

5.5.2.2.3. Transferimi i Fondeve Pensionale në Programin e Tërheqjes me Faza

Nëse një kontribues që pensionohet ka një bilanc prej €2,000 ose më shumë në llogarinë e tij të kursimeve pensionale, bilanci i llogarisë së tij transferohet në Programin e Tërheqjes me Faza, që nënkupton se ata do të marrin një pagesë mujore gjersa e gjithë shuma të shterojë.

Ndërsa në rastet, kur shuma e kontributeve të kursyera është mbi 2000 Euro, tërheqja e mjeteve do të bëhet në fazë, me pagesë mujore prej 100 euro ose 1% të vlerës së llogarisë në momentin e pensionimit.²⁵⁴

Që nga viti 2004 kanë filluar të tërhiqen kursimet pensionale nga Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Numri i llogarive me tërheqje ka arritur në 16,936 në shumën e mjeteve të tërhequra (nga viti 2004 deri më 2012) prej 28,196,094 Euro.

Transferimi i Fondeve në Programin e Tërheqjes me Faza, në vitin 2013 përbënte 73.5% të vlerave të tërhequra, ndërsa për vitin 2012: 67.8%.

²⁵⁴ Raport Vjetor i FKPK- Trusti, Prishtine, 2012

Me vazhdimin e rritjes së vëllimit të fondeve pensionale, që drejtohen në Programin e Tërheqjes në Faza, edhe numri i të pensionuarve në këtë program gjatë vitit 2013 është rritur në 58.8%.

Llogari me tërheqje gjatë vitit 2012 ishin 3,264, ndërsa në vitin 2011 ishin 2,868, prej të cilave;

a) Pensione të Moshës ishin 2,483,

b) Pensione të Paaftësisë ishin 96,

c) Pensione të vdekjes së kontribuesve para pensionimit ishin 685.

Pjesëmarrja e tërheqjeve për shkak të vdekjes së kontribuesit në tërheqjet e përgjithshme ishte 21,0%.

Viti	Numri i tërheqjeve		Vlerat e tërhequra	
	TF	Pjesëmarrja	TF	Pjesëmarrja
2008	146	12%	591,602	22,7%
2009	213	9,9%	981,115	32,8%
2010	469	17,2%	1,265,990	32%
2011	918	32%	3,196,034	55,7%
2012	1,324	40,6%	5,881,268	62,8%


Tabela Nr.33. Numri dhe vlera e të pensionuarve në programin e Tërheqjes me faza

5.5.2.2.4. Tërheqja e kontributeve pensionale me një pagesë të vetme

Nëse një kontribues që pensionohet ka një bilanc nën shumën prej €2,000 në llogarinë e tij të kursimeve pensionale, atëherë tërheqja bëhet nga pronari i portfolios pensionale nga bilanci i llogarisë së tij me një pagesë të vetme.

Në vitin 2014 janë derdhur mejetë financiare nga FP i TKPK në Fondin e Trenseferteve Pensionale (FTP)²⁵⁵ shumat në vlerë prej €10.9 mln, ndërkaq €3.4 mln janë tërhequr nga përfituesit, me një pagesë të vetme.

²⁵⁵ Transferimi i fondeve në pensionale (TFP) do të thotë derdhja e pensioneve në shuma mujore nga shuma totale e përfitimit, e cila depozitohet në Bankën Komerciale deri sa të shterohet. Administrimi i këtij fondi (TFP) ka filluar prej vitit 2011 e deri në Nëntor 2014 dhe iu kishte besuar fillimisht vetëm Bankës “Nova Lubljanska



Grafiku. Nr.7. Vlerat e mjeteve të tërhequra kundrejt kontributeve të tërhequra (në milion Euro)

5.5.2.3. Pensionet e shtyllës së III apo sigurimi pensional suplementar

Sigurimi Pensional Suplementar zhvillohet nga Komponenta e tretë e Skemes së pensioneve

vullnetare²⁵⁶, që zhvillohet përmes kursimit vullnetar të kontributeve pensionale në llogarinë individuale në Fond Pensional, të stimuluar nga lehtësirat tatimore për përfitim të pensionit suplementar (në moshën 65 vjeqare). Sigurimi Pensional Suplementar është formë e sigurimit pensional, në të cilën i siguruari e bartë rrezikun e investimit të kontributeve të pastërta të paguara në Fondin Pensional. Kjo skemë pensionale i përmban sigurimet pensionale dhe disa beneficione tjera financiare, apo përfitime tjera për ata individë të cilët kyçen në të. Sigurimi pensional suplementar, është komponentë shtesë që dallon nga Skema Pensionale e kontributeve të detyrueshme që funksionon në Kosovë.

5.5.2.3.1. Pensionet plotësuese individuale

Pensioni plotësues individual, është pensioni i blerë nga ofruesi i pensioneve, i cili e bën sigurimin e tij, sipas ligjit në fuqi. Ofruesi i pensionit mund të jetë një; *institucion*

Bankes- Prishtina,” ndërkaq prej dhjetorit 2014 i eshte besuar Bankës TEB dhe përbën 76.4% të vlerave të tërhequra për vitin 2014, ndërsa në vitin 2013 ishte 73.5%.

²⁵⁶ Forma dhe mënyra e implementimit të Skemes Pensionale Suplementare, është e rregulluar me Ligjin mbi pensionet në Kosovë Nr. 03/L-084

financiar, bankë, menaxhues i mjeteve, instrument për investime të hapura ose kompani e sigurimeve. Lartësia e pensionit, varet nga shkalla e kontribuimit, lartësia e pagave gjatë tërë periudhës së punësimit të punëmarrësit, kostos së administrimit, shpenzimeve të tjera, normës së kthimeve nga investimet, apo nga shkalla e kapitalizimit, etj.

Mjetet finaciare neto të akumuluar në një plan pensional me kontribute të dëfinuara, janë përcaktues i kualitetit të portfolios individuale, e cila shërben për të përfituar pronari i saj anuitete pensionale, apo për të blerë pension nga kompanitë e specializuara.

5.5.2.3.2. Pensionet Plotësuese të Punëdhënësit

Janë pensionet vullnetare, të cilat zhvillohen nga Skema Pensionale Suplementare (Shtylla e III e Sistemit Pensional të Kosovës). Këto pensione janë në barrë të punëdhënësit, sepse ai ua siguron punonjësve të vet këtë lloj të pensionit, në përputhje me Ligjin mbi pensionet.

Te pensionet suplementare pensioni i ardhshëm i punëtorit varet kryesisht nga lartësia e kontributit pensional.

Definimi i pensionit fillon nga punëdhënësi, përmes pagesës dhe raportimit të saktë të;

a) Lartësisë së kontributit pensional që punëdhënësi paguan për punëtorët e vet, e cila është deri në 10% mbi pagën bruto,

b) Planit pensional që zhvillohet nga Fondi Pensional, i cili e lejon pagesën edhe më të lartë se 10%, mbi pagën bruto (për shumën që e kalon këtë përqindje nuk ka lehtësime tatimore).

c) Lartësisë së kontributit pensional (në rastet kur atë e paguajnë bashkarisht punëdhënësi dhe punëmarresi), është deri në 20% të pagës bruto (10% punëdhënësi dhe 10% punëtori).²⁵⁷

²⁵⁷ Ligji nr. 04/l-101 për fondet pensionale të Kosovës- Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 10 / 8 maj 2012, Prishtinë.

6. KAPITULLI I VI: ANALIZA EMPIRIKE

6.1. Analizat statistikore

Për të bërë analizat e nevojshme statistikore, para se gjithash është e nevojshme që të bëhet përshkrimi i të dhënave statistikore, në mënyrë që të konstatohet përshtatshmëria e të dhënave të cilat do të shërbejnë për analizimin e relevant të problemit.

Në mënyrë që të bëhet analizimi i problemit sa më i saktë, është e nevojshme që të përdoren metodat sa më të përshtatshme dhe më adekuate, të cilat shpiejnë në nxjerrjen e rezultateve sa më të përpikëta të analizës.

Rezultatet e analizës shërbejnë pikësëpari për të konstatuar- diagnostifikuar gjendjen e shëndetshmërisë së problemit dhe për të bërë prognozimet e nevojshme të zhvillimit të problemit.

Metodat e aplikuara matematikore dhe statistikore shërbejnë për të analizuar dhe sqaruar, përdorimin e modeleve matematikore, të cilat përdoren për analizimin, diagnostifikimin dhe zgjidhjen e fenomeneve të ndryshme ekonomike, të cilat përfshijnë këto operime;

- 1) Rregullimin e intervaleve të besueshmërisë,
- 2) Paraqitjen grafike të trendit të variablave,
- 3) Testimin e stacionaritetit të variablave,
- 4) Testimin e hipotezave të modelit ekonometrik,
- 5) Prognozimin e zhvillimit të gjendjes së fenomenit,
- 6) Testimin e kointegrimit (Testi Johansen i kointegrimit, testet e regresionit linear), etj.

Për përpunimin e këtyre të dhënave është përdorur programi statistikor elektronik “Instrumental Variables Stata 14” dhe “Eviews 6”.

6.1.1. Përshkrimi i të dhënave

Të dhënat e përdorura në këtë studim janë përshtatur për të bërë analizën sa më të përpikët të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional të Kosovës, duke përfshirë;

- 1) Të dhënat e serive kohore,
- 2) Të dhënat makroekonomike,
- 3) Të dhënat mikroekonomike dhe
- 4) Të dhënat financiare, Brooks (2008), (Hill, Griffiths dhe Lim, 2011).²⁵⁸

Në këtë studim janë përfshirë të dhënat e serive kohore për periudhën 2002-2014, sepse sendërtimi i sistemit të ri Pensional në Kosovë ka filluar që nga viti 2002.

Ndërtimi i serive statistikore është përftuar nëpërmjet shfrytëzimit të treguesve sekondar, të përdorur në vend, nga ana e institucioneve relevante në Kosovë.

Në kuadër të këtij studimi është përcaktuar *variabla e varur* (pensionet) dhe janë përcaktuar *variablat e pavarura*; 1) GDP, 2) popullsia, 3) punësimi, 4) rrogat, 5) kontributorët, 6) kontributet, 7) investimet, të cilat kanë shërbyer për testimin e hipotezave të parashtruara.

Gjatë realizimit të kërkimit shkencor, rëndësi e veçantë i është kushtuar grumbullimit, sistemit, klasifikimit, përshkrimit dhe përpunimit të të dhënave.

Të dhënat të cilët janë përdorur në analizën empirike, janë të dhëna dytësore, të mbledhur nga institucione relevante, në baza vjetore të publikuara nga; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Departamenti i Pensioneve), Fondi Pensional i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondi Pensional Slloveno- Kosovar, Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Ministria e Financave të Kosovës, etj.

Pra, seria prej 13 observimeve është e mjaftueshme për realizimin e hulumtimit empirik, e cila mund të shërbejë për nxjerrjen e përfundimeve sa më reale dhe të besueshme.

²⁵⁸ Të dhënat e serive kohore- janë të dhënat kuantitative ose kualitative, të cilët janë mbledhur në një ose më shumë variabla për një periudhë të caktuar kohore.

Të dhënat e kryqëzuara ndërsektoriale- janë të dhënat të cilat grumbullohen për një variabël ose për disa variabla, në varësi të shtrirjes së analizës.

Të dhënat panel ose “longitudinal data”- definohen si kombinim i të dhënave të serive kohore dhe të dhënave të serive të kryqëzuara ndërsektoriale. Këto të dhëna përbëhen nga grupe të dhënash; të dhënat e kryqëzuara, të dhënat ndërsektoriale, të dhënat e vrojtuesve gjatë dy ose më shumë periudhave kohore.

Kështu që rezultatet e modelit të analizuar, duhet të shihen në këndvështrimin statistikor, duke u bazuar në faktorët që ndikojnë në ndërtimin e qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë.

Përpara se të futen variablat në model, ato testohen duke e bërë;

Testimin e stacionaritetit, apo testimin e rrënjëve unitare.

Modelimin ekonometrik;

- a. Testi i normalitetit,
- b. Testi i korelacionit serial- Korrelacioni serial Durbin-Watson si dhe Heteroskedasticiteti,
- c. Testi i homoskedasticitetit dhe
- d. Testi i stabilitetit të modelit

6.1.2. Prognoza

Testimi i kointegrimit (Testi Johansen i kointegrimit).

Me tutje është bërë analiza e regresionit linear, duke e testuar variablën e varur në raport me variablat shpjeguese në analizën e regresionit.


Shfrytëzimi i rezultateve të modelit ekonometrik ka shërbyer për testimin e zbatimit të teorive ekonomike nga fusha e pensioneve, në veçanti të qëndrueshmërisë së sistemit pensional në Kosovë.


Pra, nga rezultatet e këtij kërkimi kemi arritur deri te analizimi dhe testimi i dy hipotezave, duke bërë analizën e serive kohore të variablave ekonomike.

Përdorimi i teknikave të shumta (duke filluar nga metodat e regresionit²⁵⁹ klasik deri tek ato të kointegrimit), të cilat mundësojnë vlerësimin e parametrave të cilët shprehin ndërvlerësinë dhe lidhjen e variablave të pavarura me variablën e varur (të pensioneve) për të vërtetuar hipotezen e parashtruar.

²⁵⁹ Metoda e regresionit bazohet mbi supozimin se të gjithë variablat e përfshira në model janë stacionarë. Kur seritë ekonomike janë jo-stacionare për parametrat e ekuacionit, metoda e regresionit mund të jep vlerësime jo të vlefshme.

6.1.3. Paraqitja grafike e trendit të variablave





Grafiku. Nr. 8. Paraqitja grafike e trendit te variablave

6.1.4. Testi stacionaritetit²⁶⁰ të variablave (Unit Root Test)

Një nga cilësitë më të rëndësishme të analizimit të serisë së të dhënave në studim, është prirja luhatëse e serive rreth vlerës mesatare, e cila statistikisht emërtohet stacionaritet²⁶¹.

Cilësia e stacionaritetit më tepër është cilësi statistikore, se sa veçori e paracaktuar e treguesve ekonomik, kështu që në varësi të kësaj cilësie përcaktohet edhe metodologjia ekonometrike dhe interpretimi i rezultateve ekonomike, gjë që përmes testimeve statistikore ato përcaktojnë stacionaritetin.

Mungesa e kësaj cilësie te seritë kohore e konfirmon praninë e rrënjës njësi, në procesin e gjenerimit të të dhënave të një serie.

Një proces përkufizohet si proces stacionar, nëse i plotëson këto tri cilësi:

²⁶⁰ Seria kohore është stacionare nëse ajo ka mesatare, variancë dhe kovariancë konstante, pra që nuk varen nga koha “t”, seria kohore nuk ka rrënjë unitare (Unit Root). seria konsiderohet si proces jo-stacionar, atëherë kur ajo nuk ka tendencë të shkojë drejt mesatares afatgjatë.

²⁶¹ Treguesit që përshkruajnë gjendje kryesisht janë jostacionar, ndërsa flukset janë stacionare. Stacionariteti i flukseve mund të ndryshojë, në varësi të përfshirjes së harkut kohor, që mbulon seria e të dhënave në dispozicion

(a) Cilësia mesatare konstante apo $E[y_t] = \text{konstante } A$ t,

(b) Cilësia e variaciones konstante 'joinfinit' në vlerë apo $\text{Var}[y_t] = \text{konstante } A$ t,

(c) Cilësia e kovariancës konstante midis vrojtimeve $\text{Covar}[y_t, y_{t+n}] = \text{konstante } A$ t,

Çdo seri kohore para se të përdoret në një model regresi, duhet t'i bëhet testimi i stacionaritetit.

Nëse seria kohore është stacionare në formën nivel, apo nëse pas diferencimit të rendeve të ndryshëm, seria kthehet në stacionare, atëherë të gjitha variablat janë të integruara në rendin e parë²⁶² dhe lidhja afatgjatë mund të analizohet nëpërmjet metodës së regresionit klasik të Katrorëve më të Vegjël.

Testet e regresionit kërkojnë që seritë kohore të kenë në të njëtin rend të integritit.

Nëse variablat kanë rende të ndryshme të integritit, atëherë metoda e zakonshme e regresit e Katrorëve më të Vegjël (OLS) nuk mund të përdoret.

Testet e stacionaritetit përcaktojnë rendin e integritit të serive kohore. Seritë kohore mund të diferencohen disa herë, derisa ato të kthehen në seri stacionare.

Nëse seria ka një rrënjë unitare²⁶³, ajo është seri stacionare dhe shënohet me $I(0)$, kurse seritë të diferencuara shenohen me $I(1)$.

Seria kohore është stacionare nëse ajo ka; *mesatare, variancë*²⁶⁴ dhe *kovariancë konstante*, ndërsa kur seritë nuk varen nga koha "t", seritë kohore nuk kanë rrënjë unitare (Unit Root).

Seria konsiderohet si jostacionare, kur nuk ka tendencë të shkojë drejt mesatares afatgjatë.

²⁶² Nëse variablat kanë rende të ndryshëm të integritit, atëherë mund të zbatohet testi Johansen i kointegrimit.

²⁶³ Rrënja unitare ndihmon për të identifikuar stacionaritetin e serisë kohore

²⁶⁴ Varianca e serisë kohore varet nga koha "t" dhe shkon në infinit, nëse koha "t" shkon në infinit.

Nëse seritë kohore janë jostacionare, atëherë modelimi me metodën e katrorëve më të vegjël do të gjenerojë një regresion të rastit.

Diferencimi i rendit të parë nënkupton gjenerimin e një serie të re kohore, ku çdo vlerë e paraqet diferencën e vlerës në kohën “t” me vlerën në kohën “t-1”.

Diferencimi i rendit të dytë kërkon që diferenca të bëhet me vlerën në kohën “t-2” dhe mund të vazhdohet kështu me radhë.

Në rast se seria kohore quhet e pavlefshme statistikisht, ajo paraqet probleme në procesin e parashikimit.

6.1.5. Testi stacionaritetit të variablave përmes testit të ADF (Augmented Dickey–Fuller)

Për të konstatuar stacionaritetin e serive kohore, duhen krahasuar vlerat statistikore të llogaritura përmes testit të ADF (Augmented Dickey–Fuller test), të vlerave kritike të saj, në shkallët përkatëse të rëndësisë së saj: niveli 1%, 5% dhe 10%.

Duke përdorur programin statistikor “Eviews 6.0” është bërë testi ADF (Augmented dickey Fuller) ose me testin Q (Box Pierce) i cili ka rezultuar: D(X1,2).

ADF Test Statistic	-3.562113	1% Critical Value*	-4.4613
		5% Critical Value	-3.2695
		10% Critical Value	-2.7822

Tabela Nr. 34. Testi stacionaritetit të variablave përmes testit të ADF

*Konkludim 1: Asnjë variabël pa diferencë nuk rezulton stacionare.*²⁶⁵ Stacionare

*rezultojnë vetëm variablat me diferencë: D(X2,2) D(X3) D(X4,2) D(X5) D(X6) D(X7,2) D(X8) D(X9) D(X10) D(X11) D(Y) D(Y1) dhe D(Y2)*²⁶⁶

²⁶⁵ Varianca e serisë kohore varet nga koha “t”, ajo shkon në infinit, nëse koha “t” shkon në infinit. Nëse seritë kohore janë proçese jo-stacionarë, atëherë modelimi me metodën e katrorëve më të vegjël do të gjenerojë një regresion të rastit (spurious regression). Nëse një seri kohore rezulton jo-stacionare, ajo mund të kthehet në stacionare duke e diferencuar atë.

²⁶⁶ Nëse vlera stistikore e testit ADF është më e ma dhe se vlera kritike, atëhere seria kohore është stacionare, ndërsa në të kundërtën seria paraqet jo stacionaritet.

Nëse një seri kohore është stacionare pa u diferencuar, ajo quhet seri e integruar e rendit zero $I(0)$ ²⁶⁷.

Rezultatet e përmbledhura të testit Phillips-Perron konfirmojnë rezultatet e testit ADF për stacionaritetin e variablave.

Zbatimi i testeve për evidentimin e lidhjes afatgjatë midis pensioneve dhe të variablave të tjerë, është testimi për stacionaritet.

Nga testi ADF rezulton se seritë kohore janë stacionare (vlerat e koeficienteve të probabiliteteve dhe të gabimeve standarde). Pasi që asnjë variabël pa difference nuk rezulton stacionar, atëhere testet e rrënjës njësi të treguesve nuk e rrëzuan hipotezën e pranisë së rrënjës njësi në nivel (jo në diferencë të parë).²⁶⁸

Testi i stacionaritetit ose rrënjës njësi konsiston në testimin e regresionit:

$$\Delta y_t = \alpha \Delta y_{t-1} + x'_t d + \beta_1 \Delta y_{t-1} + \dots + \beta_q \Delta y_{t-q} + e_t$$

x është treguesi që paraqet “konstanten” apo “konstanta plus trendi”, $\alpha = \rho - 1$,

Hipoteza zero dhe hipoteza alternative janë;

$$H_0: \alpha = 0 \text{ dhe}$$

$$H_1: \alpha < 0.$$

Prania e vlerave të shkuara (Δy_{t-q}) në regresion shërben për testimin e korrelacionit midis mbetjeve e dhe testimin stohastik të serive statistikore.

*Testimi i stacionaritetit përmes Testit Augmented Dickey-Fuller (ADF test)*²⁶⁹

²⁶⁷ Nëse seria bëhet stacionare, pasi diferencohet një herë, quhet e integruar e rendit të parë $I(1)$, e kështu me rradhë.

²⁶⁸ Në diferencë të parë, treguesit nuk devijojnë nga mesatarja historike konstante (jo zero), në intervale të ndryshme kohore, testet e rrënjës njësi mund të japin rezultate të ndryshme,

²⁶⁹ Në statistikë, testimi përmes testit Dickey- Fuller teston një njësi të një rrënje, njësi të pranishëm në një model autoregressive, e cila është vërtetuar pas stacionaritetit David Dickey Fuller dhe Wayne.

Një model i thjeshtë është;

$$y_t = \rho y_{t-1} + u_t$$

Testi Augmented Dickey Fuller mundëson për të bërë analizën e ecurisë së variablave në studim.

Sipas Harris dhe Sollis (2003) bëhet analiza e mirëfilltë për modelet ekonometrike, nevojitet që të bëhet një vëzhgim në lidhje me mundësinë e trendeve kohore të

y_t - është variabla e interesit, t është indeksi koha, ρ është një koeficient, dhe u_t dhe është termi gabim.

Një rrënjë njësi është e pranishme, nëse $\rho = 1$. Modeli do të jetë jo- stacionare në këtë rast Modeli i regresionit mund të shkruhet si

$$\nabla y_t = (\rho - 1)y_{t-1} + u_t = \delta y_{t-1} + u_t$$

∇ - është operatori i parë.

Ky model mund të vlerësohet dhe testimi për një rrënjë njësi është ekuivalente me testimin $\delta = 0$

(ku $\delta \equiv \rho - 1$).

t - ka një shpërndarje të caktuar sipas testit Dicke - Fuller .

Ka tre versione kryesore të testit :

1. Test për një rrënjë njësi :

$$\nabla y_t = \delta y_{t-1} + u_t$$

2. Test për një rrënjë njësi me domethënie

$$\nabla y_t = a_0 + \delta y_{t-1} + u_t$$

3. Test për një rrënjë njësi me domethënie dhe prirje e kohës deterministe:

$$\nabla y_t = a_0 + a_1 t + \delta y_{t-1} + u_t$$

Çdo version i testit ka vlerat e veta kritike, e cila varet nga madhësia e mostrës . Në çdo rast, hipoteza zero është se ka një rrënjë njësi, $\delta = 0$. Testet kanë ndikueshmeri të vogël, nëse nuk mund të bëhet dallimi në mes të proceseve të vërteta për njësi rrënjë ($\delta = 0$) dhe proceset pranë njësi rrënjë (δ është afër zeros).

Kjo quhet problem me "ekuivalencë afër vëzhgimi ".

Nëse seria y është stacionare (ose prirje stacionare), atëherë ajo ka një tendencë për t'u kthyer në një konstante (ose trend të determininuar).

Niveli i serisë do të jetë një parashikues i rëndësishëm i ndryshimit të periudhës së ardhshme, dhe do të ketë një koeficient negativ.

Nëse, nga ana tjetër , seria është e integruar, atëherë ndryshimet pozitive dhe ndryshimet negative do të ndodhin me probabilitetet, që nuk varen në nivelin aktual të serise.

$$\nabla y_t = a_0 + u_t$$

mund të rishkruhet si

$$y_t = y_0 + \sum_{i=1}^t u_i + a_0 t$$

Një prirje deterministe vjen nga $a_0 t$ dhe një afat stohastik ndërpres;

$$y_0 + \sum_{i=1}^t u_i$$

Duke rezultuar në atë që është përmendur si një prirje stohastike. Ekziston edhe një zgjerim i testit Dickey - Fuller (DF), e cila heq të gjitha efektet strukturore (autokorrelacionit) në seritë kohore dhe pastaj teston duke përdorur të njëjtën procedurë

shfaqura në nivel dhe në diferenca, në këtë mënyrë konstatohen seritë kohore, se a janë stacionare apo jostacionare.²⁷⁰

Prandaj, rezultatet e testit ADF sugjerohet që të verifikohen me testet tjera të stacionaritetit²⁷¹, si testi Phillips-Perron (PP test).²⁷²

Testimi për rrënjën njësi (stacionaritet) të serive kohore vjetore në intervalin kohor 2002- 2014 është realizuar me anë të testit Augmented Dickey Fuller Test (ADF)

Testimi i stacionaritetit të serisë së mbetjeve për të cilat përdoret testi i zgjeruar Dickey-Fuller, i cili konsiston në ndërtimin e ekuacionit.

Nëse me $\{X_t\}$ shenohet procesi stohastik dhe $F_X(x_{t_1+\tau}, \dots, x_{t_k+\tau})$ përfaqëson funksionin kumulativ, ku $\{X_t\}$ varet nga $t_1 + \tau, \dots, t_k + \tau$, atëhere, $\{X_t\}$ është stacionar për të gjitha variablat k , për të gjitha τ , dhe për të gjitha $t_1, \dots, t_k$,

$$F_X(x_{t_1+\tau}, \dots, x_{t_k+\tau}) = F_X(x_{t_1}, \dots, x_{t_k}).$$

Që nga τ nuk ka ndikim në $F_X(\cdot)$, F_X nuk është funksion i kohës me testin ADF (Augmented Dickey Fuller) ose me testin Q (Box Pierce): $D(X1, 2)$.

6.2. Përfundimet mbi vërtetimin e hipotezave të punimit

Bazuar në rezultatet e analizës empirike, përmes së cilës janë bërë testimet e variablave nga këto modele;

1) Testi i stacionaritetit, apo test i rrënjëve unitare, 2) Testi i normalitetit, 3) Testi i korelacionit serial- Korrelacioni serial Durbin-Watson si dhe Heteroskedasticiteti, 4) Testi i homoskedasticitetit dhe 5) Testi i stabilitetit të modelit, 6) Testimi i kointegrimit (Testi Johansen i kointegrimit).

²⁷⁰ Ky test nuk konsiderohet si shumë i besueshëm për zgjedhjet e vogla, sepse tenton të hedhë poshtë hipotezën zero, kur ajo është e vërtetë dhe ta pranojë atë, kur është e gabuar.

²⁷¹ Stacionariteti mund të testohet edhe me testin Phillips-Perron.

²⁷² Ky test përdoret te zgjedhjet e vogla, duket se ky test tenton të hedhë poshtë hipotezën zero, kur ajo është e vërtetë dhe ta pranojë atë, kur është e gabuar.

Sipas rezultateve të testeve të pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se asnjë variable pa difference nuk rezulton stacionar. Stacionare rezultojnë vetëm variablat me difference:

$D(X2,2)$ $D(X3)$ $D(X4,2)$ $D(X5)$ $D(X6)$ $D(X7,2)$ $D(X8)$ $D(X9)$ $D(X10)$ $D(X11)$ $D(Y)$ $D(Y1)$ dhe $D(Y2)$

*Konkludim 1: Testi stacionaritetit të variablave, rezulton se asnjë variabël pa diferencë nuk rezulton stacionar.*²⁷³

Stacionare rezultojnë vetëm variablat me diferencë:

$D(X2,2)$ - GDP;

$D(X3)$ - Buxheti i Kosovës;

$D(X4,2)$ - Investimi i mjeteve neto nën menaxhim;

$D(X5)$ - Kthimet nga investimet;

$D(X6)$ - Kontributet e arkëtuara;

$D(X7,2)$ – Popullsia;

$D(X8)$ - Nr. i të punësuarëve;

$D(X9)$ - Paga mesatare;

$D(X10)$ - Nr. i kontributorëve në TKPK;

$D(X11)$ - Nr. i të pensionuarëve;

$D(Y)$ $D(Y1)$ - Vlera vjetore e pensioneve të shpërndara (Shtylla e dytë) dhe $D(Y2)$ - Vlera vjetore e shpagimit të pensioneve vjetore (Shtylla e dytë).

²⁷³ Varianca e serisë kohore varet nga koha “t”, ajo shkon në infinit, nëse koha “t” shkon në infinit dhe nëse seritë kohore janë procese jo-stacionare, atëherë modelimi me metodën e katrorëve më të vegjël do të gjenerojë një regresion të rastit (spurious regression). Nëse një seri kohore rezulton jo-stacionare, ajo mund të kthehet në stacionare duke e diferencuar atë.

Pra përmes testimit të variablave është vërtetuar qëndrueshmëria e Sistemit Pensional në Kosovë.

Nga testimet e lartpërmenduara është vërtetuar se;

Hipoteza Zero; $H(0)$ nuk qëndron,

$H(0)$ "Faktorët makroekonomik dhe mikroekonomik NUK ndikojnë në masë të konsiderueshme në qëndrueshmërinë e Sistemit pensional të Kosovës, ndërsa

Hipoteza Alternative; $H(1)$ qëndron.

$H(1)$ "Faktorët makroekonomik dhe mikroekonomik ndikojnë në masë të konsiderueshme në qëndrueshmërinë e Sistemit pensional të Kosovës.

Vërtetimi i hipotezave me konceptin e modelit të stacionaritetit (mbi ekuilibrin afatgjatë të treguesve ekonomik)²⁷⁴, tregon ndërlidhmërinë mbi qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional në Kosovë,²⁷⁵ gjë që vërteton se Sistemi Pensional në Kosovë është i qëndrueshëm dhe ka efekte të ndikimit afatgjatë në Sistemin ekonomiko-social në Kosovë.

Pra, tendenca e pasqyrimin të gjendjes së qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional në Kosovë, ka tendencë të lëvizë prej qëndrueshmërisë së mesme kah e larta, gjë që kjo tendencë paraqet stabilitetin afatgjatë të Sistemit Pensional.

Rezultatet e studimit njëherit kanë shërbyer për të bërë parashikimin e qëndrueshmërisë së sistemit pensional në të ardhmen, nga janë nxjerrë rekomandimet për propozimin e politikave në fushën e Sistemit Pensional të Kosovës.

²⁷⁴ Hipoteza nuk është normë, nuk është rregull, por është përshkrim i gjendjes faktike që të mund të aplikohet.

²⁷⁵ Modeli mbi ekuilibrin afatgjatë të treguesve ekonomik.

<https://www.scribd.com/document/208985039/Granger-1981-Properties-of-Time-Series-Data>

Aneks: Të dhënat e përdorura 1.

Vitet	Totali i shpenzimeve	GDP	Buxheti i Kosoves	Investimi i mjeteve neto nën menaxhim	Kthimet nga investimet	Kontributet e arkëtuara
Viti	X1	X2	X3	X4	X5	X6
2002	8607.16	2860000000	538000000	8607166	0	8607166
2003	37832.68	3023000000	532000000	37832687	0	29022645
2004	84803.34	3100000000	773000000	84803347	1000000	44405108
2005	145808.69	3220000000	758200000	145808692	11000000	51723234
2006	215103.57	3330000000	723400000	215103575	16000000	56667095
2007	279579.86	3530000000	891400000	279579860	6000000	63809652
2008	255742.98	3784000000	888600000	255742981	-91000000	72775328
2009	380704.77	3892000000	1032600000	380704774	47000000	82757959
2010	495273.00	4028000000	1126101000	495273000	26455249	94648860
2011	595384.32	4640000000	1264000000	595384324	33136413	108027702
2012	739753.94	4910000000	1303000000	739753940	54000000	113038633
2013	913182.73	5230000000	1352000000	913182738	71000000	119100000
2014	1087760.59	5450000000	1426000000	1087760598	67000000	128700000
2015	1204565.58	5807000000	1600000000	1229333328	28389646	137519615
2016	1176006.60	6070200000	1600000000	1417970874	64120284	151503736
2017	1207907.50	6282200000	2000000000	1634648056	102172681	159757519

Tabela. Nr. 54. Të dhenat e përdorura.

Aneks: Të dhënat e përdorura 2.

Vitet	Popullsia	Nr. i të punësuarëve	Rroga mesatare	Nr. i kontributorëve në TKPK	Nr. i të pensionuarëve	Buxheti vjetor i shpenzuar për Pensionet Bazë (Shtylla e parë)	Vlera e vjetore e pensioneve të shpërndara (Shtylla e dytë)	Kodi për vitet
Viti	X7	X8	X9	X10	X11	Y1	Y	T
2002	2042000	99500	140	87333	0.00	17874763	0.00	1
2003	2016000	164192	167	144977	48.00	44459960	48000.00	2
2004	2041000	183514	189	168718	192.00	54912599	56746.00	3
2005	2070000	199580	194	235420	683.00	59313333	363063.00	4
2006	2100000	205252	195	235442	1451.00	63766380	1163733.00	5
2007	2126000	229282	199	281120	1579.00	63133100	1829046.00	6
2008	2102000	222009	211	222009	2019.00	65641485	2600910.00	7
2009	2190000	237476	270	237476	2151.00	73603960	2988991.00	8
2010	2223000	249756	310	249756	2729.00	63640920	4774806.00	9
2011	1733872	255562	368	255562	2868.00	61196210	5738591.00	10
2012	1815606	261892	372	261892	3264.00	69208570	8161101.00	11
2013	1820631	281388	400	281388	3567.00	87340090	10749867.00	12
2014	1804944	290055	430	285914	4048.00	108199460	14278841.00	13
2015	1771604	296900	441	297466	4433.00	120456558	19299443.00	14
2016	1783531	286848	449	312672	4405.00	117600660	19208575.00	15
2017	1798506	323689	454	352849	5126.00	113979075	27739647.00	16

Tabela. Nr.55. Të dhënat e përdorura

7. KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Konkluzione

- 1) Reforma e Sistemit Ekonomik e cila në thelb e kishte ndryshimin e karakterit të pronës (kalimin nga prona shoqërore, gjegjësisht publike në pronën private), si dhe ndryshimin e konceptit të ekonomisë socialiste- vetëqeverisëse, në ekonominë e tregut të lirë, e cila i kishte kushtëzuar shumë ndryshime në sistemin politik, ekonomik dhe shoqëror.
- 2) Reforma ekonomike kishte ndikuar në reformimin e Sistemit Pensional në Kosovë, duke e ndryshuar konceptin e tij të mëparm, i cili udhëheqej nga “parimi i solidaritetit” për t’u udhëhequr me “parimin e vetëqëndrueshmërisë” ekonomike.
- 3) Braktisja e Sistemit Pensional (Pay as You Go, apo gjenerata paguan kontribute pensionale për gjeneratën) ishte e arsyeshme, sepse ky sistem pensional ishte bërë i pa qëndrueshëm dhe ishte bërë barrë e buxhetit shtetror, nga se shkalla e punësimit ishte më e vogël në raport me shkallën e pensionimit.
- 4) Fondi i vjetër Pensional i Kosovës ishte grabitur në mënyrë të dhunshme nga Fondi Pensional i RS Serbisë, kështu që autoritetet e Kosovës (UNMIK- administratori i përkohshëm i Kosovës) ishin të detyruara të krijojnë një Sistem të ri Pensional, që nuk mbështetej në Fondin e mëparm Pensional.
- 5) Modeli i ri i Sistemit Pensional në Kosovë ishte konceptuar nga institucionet e ndryshme profesionale botërore (USAID, World Bank, OECD, etj.) me autorizim të UNMIK-ut. Koncepti i Sistemit të ri Pensional ishte bazuar në disa përvoja të vendeve të Amerikës Latine (Çile), të disa vendeve të Evropës (Finlanda, Suedia), dhe të SHBA-së, si dhe ishte bazuar në disa parime; *respektimin e të drejtave themelore të njeriut, gjithëpërfshirjen, kontributet e definuara, pensionet e merituar, etj.*
- 6) Modeli i sistemit të ri Pensional ishte konceptuar si sistem shumë shtyllor. Përvojat e deritanishme kanë treguar se sistemet shumë shtyllore, mundësojnë krijimin e Fondeve Pensionale, të cilat do të vetëfinancohen dhe do të bëhen të vetëqëndrueshme (konkurrense në treg, të besueshme, të përgjegjshme, të kujdesshme, transparente, të mbikqyrura gjatë tërë periudhës së operimit të tyre).
- 7) Sistemi i ri Pensional është i aftë të; *përballojë kërkesat për pensionim, sipas ritmit të plakjes eventuale të popullsisë, ofron norma të mira të kthimit nga investimet e kontributeve pensionale, eliminon disa prej deformimeve të tregut të punës, redukton politizimin e sistemit pensional dhe heq pasiguritë fiskale kur numri i pensionistëve rritet kundrejt numrit të kontribuesve.*
- 8) Sistemi pensional në Kosovë qeveriset mbi bazë të principeve të qeverisjes korporative, duke iu përmbajtur në mënyrë rigoroze kërkesave ligjore, për të mos lënë hapësirë për manipulime dhe keqpërdorime të detyrës (për qëllime të shtrëngjes së agjendave politike apo përfitimeve personale), ashtu që të bëhet në mënyrë transparente.

- 9) Anëtarët e Bordit Qeverisës të FP TKPK manifestojnë kujdes, përgjegjësi e kulturë të lartë gjatë marrjes së vendimeve ekipore, duke u shërbyer me principet e vendosura që më parë. Ata janë profesionistë të moralshëm e të kujdesshëm në matjen e shkallës së rreziqeve financiare si pasojë e politikëbërjes (ata i respektojnë rregullat e përgjithëshme profesionale dhe etike gjatë qeverisjes korporative).
- 10) Politikat e qeverisjes së Fondeve Pensionale janë të fokusuara në funksionalizimin efikas të Fondeve Pensionale dhe të krijimit të stabilitetit shoqëroro- ekonomik.
- 11) Krijimi i politikave të qëndrueshme të Fondeve Pensionale në Kosovë bazohen në principet, metodat dhe instrumentet politike, të konceptit të filosofisë konzervative.
- 12) Për të minimizuar shkallën e riskut të këtyre fondeve, politikëbërësit e bëjnë transferimin e riskut, te palet tjera, duke blerë siguri sa më të madhe për ruajtjen e vlerës së mjeteve të Fondeve Pensionale.
- 13) Politikat qeverisëse të Fondeve Pensionale janë të pa ndikueshme nga ndërhyrja e Qeverisë së shtetit.
- 14) Sistemi Pensional i Kosovës zbaton standarde të larta, lidhur me përkufizimin e përgjegjësisë fiduciare të anëtarëve të Bordit Qeverisës dhe menaxhuesve (Afirmimi i mëtejshëm i përgjegjësisë fiduciare të Bordit Qeverisës të Fondeve Pensionale të Kosovës, mbetet një nga faktorët më qenësor, në ruajtjen e stabilitetit dhe të qëndrueshmërisë së Sistemit Pensional të Kosovës). Duke patur parasysh rëndësinë për përfaqësimin e interesave të përfituesve të Fondeve Pensionale, ata përgjigjen para institucioneve mbikqyrëse në mënyrë morale, profesionale dhe materiale, kështu që përgjegjësia në përfaqësim të interesave të kontributorëve ndikon në rritjen e shkallës së qëndrueshmërisë së tërë Sistemit Pensional të Kosovës.
- 15) Sistemi Pensional i Kosovës është sistem i mbikqyrrur nga Banka Qendrore e Kosovës, gjë që e bën këtë sistem më stabil dhe më të qëndrueshëm. Mbikqyrja e operimit të Fondeve Pensionale është e shumëfishtë (Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, OECD, etj.) dhe ndikon në rritjen shkallës së sigurisë së operimeve të tyre dhe të qëndrueshmërisë.
- 16) Sistemi Pensional i Kosovës është transparent ndaj kontributorëve dhe ndaj publikut (Skemat pensionale në Kosovë aplikojnë politika transparente dhe të kujdesëshme, ashtu që operimet e tij mund të; maten lehtë, mbikqyren lehtë, reagojnë shpejt dhe në mënyrë adekuate në rast devijimi, konstatohen veprimet historike, si dhe mund të parashikohen zhvillimet e proceseve të ardhshme ekonomike e sociale në Kosovë.
- 17) Transparenca ndikon drejtëpërsëdrejti në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.
- 18) Me ndryshimin e Ligjit mbi pensionet në Kosovë dhe me braktisjen e Rregullores 2001/35 (UNMIK), janë nxjerrur disa ligje dhe rregullore të nevojshme, për ta bërë sistemin pensional sa më funksional dhe më të qëndrueshëm. Zhvillimi i infrastrukturës ligjore e fuqizon dhe stabilizon Sistemin Pensional në Kosovë.
- 19) Potenciali i burimeve njerëzore në Kosovë është i volitshëm, sepse moshë mesatare e kontribuesve është 39 vjeq, të cilëve iu mbetet një periudhë kualitative për të kursyer kontribute pensionale deri në moshën e pensionimit (65 vjeq).

- 20) Politikat makroekonomike në Kosovë ndikojnë në; zhvillimin ekonomik, rritjen e shkallës së punësimit, rritjen e kursimeve të kontributeve pensionale, krijimin e stabilitetit shoqëroro- ekonomik dhe në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional të Kosovës.
- 21) Punësimi dhe papunësia janë të ndërlidhura me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe nivelin e arsimit të popullatës. Vlerësohet se në tregun e punës në Kosovë, për çdo vit hynë mbi 25.000 persona, ndërsa nga tregu dalin mbi 8000 persona. Punësimi formal dhe pagesat e kontributeve pensionale në Fondin Pensional, ndikojnë në qëndrueshmërinë e Sistemit Pensional.
- 22) Shkalla e papunësisë është problem kyç në stabilitetin ekonomiko- social. Shkalla e papunësisë duhet të zvolgëlohet përmes krijimit të vendeve të reja të punës, duke fuqizuar sektorët ekonomik të cilët do të kontribuojnë më shumë në zbutjen e papunësisë.
- 23) Shkalla e informalitetit të punësuarit në Kosovë është akoma e lartë, gjë që shihet se potenciali i popullsisë aktive vjetore për punë është prej 61.097 personave. Ata nuk janë të lajmëruar në Administratën Tatimore të Kosovës, e as nuk kontribuojnë në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.
- 24) Paga minimale mujore në Kosovë në vitin 2015 (deri në moshën 35 vjeçare është 130 € dhe mbi moshën 35 vjeçare është 170 €) sillet rreth 150€ në muaj. Paga mesatare neto të shumica e punonjësve ishte rreth 350 € në muaj. Paga Neto Mesatare në Kosovë për Sektorin publik është 441 €, derisa në Sektorin privat është rreth 230€. Nivelet aktuale të pagës minimale janë të ulëta, dhe se mund të rriten pa implikime të mëdha për punëdhënësit.
- 25) Shkalla e rënjes së kontribuesve sezonal, mund të jetë njëri nga faktorët e uljes së normës së kontributeve të arkëtuara.
- 26) Numri i kontribuesve nga Institucionet publike; *Bizneset individuale, Shoqëritë akcionare, Përfaqësitë e bizneseve të huaja dhe organizatat të tjera, vërehet se ka rritje më të theksuar.*
- 27) Bazuar në analizat aktuale të derdhjes së kontributeve pensionale, rezulton se Fondet Pensionale nuk posedojnë të dhëna të plota mbi: *pagat bruto të punëtorëve, të hyrat nga orët shtesë, kontratat mbi vepër, kontributet vullnetare, mëditjet, e të hyra tjera në formë të ardhurash personale*, për të vlerësuar me një siguri më të lartë rrjedhën e derdhjes së domosdoshme, të kontributeve pensionale në Fondet Pensionale të Kosovës.
- 28) Të vetëpunësuarit (mbi gjysma) paguajnë vetëm minimumin e kontributeve pensionale të kërkuar me ligj, kështu që rrezikojnë të mos kursejnë mjaftueshëm për pensionimin e tyre. Nga të punësuarit rezulton se 4.5% të tyre kontribuojnë nën pagën minimale, përkatësisht 3.7% kontribuojnë sipas pagës minimale të tyre, ndërsa pjesa tjetër prej 91.8% e tyre kontribuojnë mbi pagën minimale.
- 29) Kontributet e definuara e kanë origjinën e njohur të kontribuimit në Fondet Pensionale dhe përgjegjësia e menaxhimit të tyre bie në barrë të Fondit Pensional.
- 30) Kontributet e definuara të Fondeve Pensionale gjatë investimeve indeksohen dhe sjellin normë më të madhe të kthimit, krahasuar me normën e interesit për deponime të kursimeve në bankat komerciale.

- 31) Kostoja e mirëmbajtjes së portfoliove individuale nga ana e Fondeve Pensionale, është më e ulët se sa norma e kthimit (Portfoliot individuale të kontribuesve pensional të FP të TKPK janë gjithëherë likuide).
- 32) Portfoliot individuale të kontributorëve pensional në Kosovë, nuk sigurojnë blerje të pensioneve por ato shpërndahen në formë aniutetesh të shterrëshme.
- 33) Shuma e mjeteve të tërësishme nën menaxhim të Sistemit Pensional të Kosovës është në rritje të vazhdueshme (ka arritur shumë e përafërt të Buxhetit të Kosovës).
- 34) Fondet Pensionale i investojnë mjetet e veta (aktualisht 90%) në Tregun e kapitalit financiar jashtë vendit (vetëm 10% investohet, apo mbahet në vend).
- 35) Ivestimet e Fondeve Pensionale në tregun e kapitalit financiar ndërkombëtar nuk janë pa rrezik (kriza financiare e vitit 2008, kishte ndikuar në zhvlerësimin e aseteve të investuara të FP të TKPK), por Fondet Pensionale në vazhdimësi e bejnë vlerësimin e shkallës së rrezikut të mjeteve të investuara.
- 36) Lidhur me zhvlerësimin e mjeteve financiare të FP të TKPK gjate Krizes financiare te vitit 2008- 09 nuk ishin ndërmarrur masa të përgjegjësisë ndaj anëtarëve të Bordit Qeverisë, apo ndonjë masë tjetër e përmirësimit, sepse ishte konsideruar se zhvlerësimi i mjeteve financiare kishte rezultuar jashtë mundësisë së ndikimit të tyre.
- 37) Investimet e disponueshme për shitje të mjeteve të FP të TKPK, të cilat investohen në Fondet e Përbashkëta për Investime të Hapura, klasifikohen si të disponueshme për shitje sipas; *shumes se mjeteve per investime, normes se kthimeve, kosos se investimeve, shkalles se rrezikut, etj.*
- 38) Fondet Pensionale në Kosovë zbatojnë politika të qëndrueshme lidhur me menaxhimin e faktorëve të riskut, të bazuara në principet që burojnë nga direktivat e OECD.
- 39) Modeli i Sistemit Pensional në Kosovë disponon shkallë të lartë të likuiditetit, sepse të hyrat nga kursimet e kontributeve gjatë tërë kohës së mbajtjes në Fondet Pensionale të investuara në tregun e kapitalit financiar dhe ato kapitalizohen, ndërsa shkalla e shpenzimeve të tërësishme dhe financimi i anuiteteve pensionale, gjegjësisht i pensioneve është shumë e ulët në raport me mjetetet e Fondeve Pensionale.
- 40) Likuiditeti i Fondeve Pensionale është inkurajues, nga fakti se portfoliot individuale e kanë ruajtur shkallën e shëndetshmërisë.
- 41) Qëndrimi i politikëbërësve të Fondeve Pensionale, është menaxhimi i likuiditetit dhe përcjellja e lëvizshmërisë së treguesve relevant në periudha të shkurtëra kohore, për të bërë manaxhimin efektiv të likuiditetit, i cili ndikon drejtëpërsëdrejti në cilësinë e vetëqëndrueshmërisë së Sistemit Pensional dhe në përballin e krizave financiare të brendshme dhe të jashtme.
- 42) Kosova përdorë valutën Euro, edhe pse nuk është anëtare e Euro- Zonës, kështu që mundësia e rritjes së shkallës së inflacionit është e kufizuar, sepse faktorët e kushtëzimit të inflacionit mbahen nën kontroll të rrept të BQE.
- 43) Dilemat lidhur me faktin se sa do të rezistojë Reforma e Sistemit Pensional ndikimeve të jashtme, do të varet shumë nga shkalla e impenjimit dhe e ndërvarësisë së Sistemit Pensional të Kosovës me faktorët makroekonomik ndërkombëtar.

- 44) Gjendja e mjeteve financiare të Fondeve Pensionale ndikojnë në kualitetin e pagesës së anuiteteve pensionale, gjegjësisht të pensioneve dhe paraqiten si faktorë kyç në stabilitetin socio-ekonomik.
- 45) Tërheqjet e kursimeve dhe refondimet ose pagesat e benefiteve, të cilat u paguhen pjesëmarrësve ose pasardhësve të tyre, si dhe refondimet e kontributeve të gabuara, njihen në periudhën në të cilën njësitë përkatëse janë riblerë.
- 46) Kontributet e shpaguara të Fondit të Kursimeve Pensionale marrin pjesë me 5% të Mjeteve nën menaxhim të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.
- 47) Numri i përfituesve nga Skema e Pensioneve Bazë të moshës është 125.883, te cilët perfitojnë nga 75 € në muaj, ndërsa shuma vjetore është prej 108,199,460.00€.
- 48) Numri i përfituesve të Skemës së Pensioneve Bazë kontributive është 38.651, ndërsa Buxheti i shpenzuar vjetor sillet rreth 61,895,592.00 €.
- 49) Korniza e kompletuar me Aktet e përgjithëshme juidike, ka nikuar në; ngritjen e nivelit të qeverisjes, administrimit të Sistemit pensional, përgjegjësisë, saktësisë dhe të azhurnimit të dhënave statistikore të besueshme (rreth grumbullimit të kontributeve pensionale, punësimit, kontribuesve, investimeve, kthimeve nga investimet, shpenimet, portfoliot e kontributoreve, anuitetet pensionale, pensionet).
- 50) Në vazhdimësi është duke u bërë azhurnimi me kohë dhe korrigjimi i listave të përfituesve të Pensioneve Bazë dhe Kontributdhënës në Skemën Bazike të pensioneve, sepse ndikon në ulje të shumës së buxhetit për pagesën e pensioneve.
- 51) Institucionet ekonomike e kanë ngritur nivelin e angazhimit për saktësimin dhe azhurnimin e të dhënave statistikore të besueshme rreth punësimit dhe pjesëmarrjes së kontribuesve në sistemin pensional të Kosovës si dhe të përfituesve të pensioneve, me qëllim që institucionet vendimmarrëse të kenë të dhëna të freskëta, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.
- 52) Indikatorët statistikore janë inkurajues për matjen e ndikimit të faktorëve mikroekonomik dhe makroekonomik, se sa ndikojnë në stabilitetin socio- ekonomik.
- 53) Përdorimi i Teknikës dhe Teknologjisë Informative nga ana e Fondeve Pensionale, ka ndikuar në: saktësimin e të dhënave individuale, informimin, transparencën, ofrimin e shërbimeve nga distanca, duke përmbushur Standardet Ndërkombëtare për informim për institucionet financiare si dhe duke siguruar kapacitete të mjaftueshme për të ruajtur informatat e rëndësishme në vendet shumë të sigurta jashtë vendit, gjë që e bëjnë Sistemin Pensional të pa lëndueshëm.
- 54) Ngritja permanente e kapaciteteve profesionale është e ndërlidhur me nevojat për edukim dhe aftësim profesional të vazhdueshëm të fuqisë punëtore, gjithmonë duke u bazuar në avacimet tekniko- teknologjike dhe në kërkesat e zhvillimit të trendeve ekonomiko- shoqërore në vend dhe në Botë.

7.2. Rekomandimet

- 1) Në mënyrë të vazhduar të bëhet adaptimi i rregullave mbi funksionimin sa më efikas të Fondeve Pensionale.
- 2) Te adaptohen rregullat shtesë për mbikqyrjen e Fondeve Profesionale.
- 3) Në vazhdimësi të adaptohen rregulla nga ana e BQK, të cilat e mbajnë larg ndikimin e institucioneve shtetërore në funksionimin dhe zhvillimin e politikave të Fondeve Pensionale.
- 4) Të mbikqyret në vazhdimësi zbatimi i rregullave mbi llogaridhënien (përgjegjësinë) e organeve qeverisëse dhe menaxhuese të Fondeve Pensionale.
- 5) Të bëhet vlerësimi permanent gjatë përzgjedhjes, matjes së performancës profesionale dhe etike të anëtarëve të organeve qeverisëse dhe menaxhuese të Fondeve Pensionale.
- 6) Të përcillet me kujdesin maksimal, orientimi i investimeve të mjeteve të Fondeve Pensionale në Tregjet e Kapitalit Financiar Global, duke bërë matjet paraprake të shkallës së mundëshme të rrezikshmërisë.
- 7) Në politikat e investimeve të mjeteve të Fondeve Pensionale, të dominoje filozofia e “investimeve konzervative”, duke patur parasyshë se parimet kryesore mbi menaxhimin e mjeteve të Fondeve Pensionale janë; ruajtja, kapitalizimi dhe shpërndarja.
- 8) Ndertim i partneritetit me Fondin për Garanci Kreditore.
- 9) Transparenca e vazhdueshme mbi pasqyrimin e performancës së operimit të Fondeve Pensionale garanton; dukshmëri të qartë të funksionimit të Fondeve Pensionale dhe e shton besueshmërinë e kontributorëve ndaj tyre.
- 10) Është i domosdoshëm demonopolizimi i Fondeve Pensionale me kontribute mandatore (të detyrueshme), sepse e mundëson zhvillimin e lirisë së kontributorit për të zgjedhur se në cilin Fond Pensional do të kontribuoj dhe e mundëson zhvillimin e konkurrentshmërisë.
- 11) Përqëndrimi i vazhdueshëm i Fondeve Pensionale në gjenerimin e pensioneve të merituar.
- 12) Reduktimi i skemave pensionale të Shtyllës së parë.
- 13) Ngritja e vazhdueshme e kujdesit rreth azhurnimit dhe sigurimit të dhënave të fondeve Pensionale në Sistemin Teknologjise Informative .
- 14) Organizimi i institucioneve financiare të cilat shesin produkte pensionale në Kosovë.
- 15) Institucionet qeverisëse të Kosovës të fokusohen në zhvillimin e politikave makroekonomike të cilat gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe stabilitet social.

8. LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

8.1. Burime Parësore

1. Aaron, H.J. (1999). Behavioural dimensions of retirement economics. Brookings Institution Press. AI (2010). Ag-tafels 2003-2008. Technical report, Actuarieel genootschap en actuarieel instituut, Groenewoudsedijk 80, 3528BK, Utrecht, The Netherlands.
2. Adrian Civici "Iluzionet monetare" - Mashtrimet e medha, Shtepia e Botimeve Studimore, Ekonomia, Tirane, 2011.
3. Alberto R. Musalem "Assessing the Governance and Transparency of National Public Pension Funds- Pablo Souto- Center for Financial Stability, Argentina- Published: June 1, 2012
4. Allayannis G., Mozumdar A., 2004, The investment-cash flow sensitivity puzzle: can negative cash flow observation explain it?, Journal of Banking and Finance 28, 901–930
5. Almeida H., Campello M. 2001, Financial Constraints and Investment-Cash Flow Sensitivities: New Research Directions, Mimeo, New York University
6. Andenas, M., & Wooldridge, F. (2009). European Comparative Company Law. New York: Cambridge University Press.
7. Andrew Schnackenberg " Measuring transparency: towards a greater understanding of systemic transparency and accountability"- Department of Organizational Behavior Weatherhead School of Management Case Western Reserve University Cleveland OH 44106-7235
8. Antonella Stirati "Employment theory in the history of economic thought", An overview, Dipartimento di Economia Università degli Studi Roma Tre, 2012
9. Ashish Dafria "The Rise in Defined Contribution Pension Plans And The Stock Market Boom, Glucksman Institute for Research in Securities Markets The Leonard N. Stern School of Business, April 1, 2002
10. Assel Izenkova "Measures to Improve the Transparency of Pension Systems in Crisis Management" 2012 International Conference on Economics, Business Innovation IPEDR vol.38 (2012) © (2012) IACSIT Press, Singapore
11. Azhurnim i raportit për respektimin e standardeve dhe kodeve (RRSK) të kontabilitetit dhe auditimit, Qershor 2012 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës- Raporti Vjetor 2013
12. Benjamin Klein & Keith B. Leffler, The Role of Market Forces in Assuring Contractual Performance, 89 J. Pol. Econ. 615, 615-17 (1981)
13. Benartzi, S. and Thaler, R. (2001). How much is investor autonomy worth? The Journal of Finance, Volume 57, Issue 4, 1593-1616
14. Blake David, Pension Schemes and Pension Funds in the United Kingdom, Oxford University Press, 2nd Edition, forthcoming

15. Blinder A. (1988). Why is the Government in the Pension Business? In: Wachter S.M. (ed): Social Security and Private Pensions, Massachusetts
16. Bodie, Z., Merton, C. and Samuelson, W. (1991). Labor supply flexibility and portfolio choice in a life cycle model. *Journal of Economic Dynamics and Control*, 16, 427-49
17. Brealy, R. A., Myers, S. C., & Allen, F. (2008). *Principles of Corporate Finance*. McGraw-Hill International Edition.
18. Canadian Association of Pension Supervisory Authorities; Guideline Nr.4; Pension Plan Governance Guidelines and Self- Assessment questionnaire, October 24, 2004
19. Campbell, J. and Viceira, L. (2002). *Strategic Asset Allocation: Portfolio Choice for Long-Term investors*. Oxford University Press
20. Cleary S., 1999, The relationship between firm investment and financial status, *Journal of Finance*
21. Chong, A., & Lopes-de Silanes, F. (2007). *Investor Protection and Corporate Governance: Firm-Level Evidence Across Latin America*, Stanford University Press. Du Plessis, J. J., Hargovan, A., & Bagaric, M. (2011). *Principles of Contemporary Corporate Governance*. Oxford University Press.
22. Christopher J. Peters, Equality Revisited, 110 Harv. L. rev. 1210 (1997);
23. Christopher A. Pissarides and Giovanna Vallanti "Productivity Growth and Employment" - Theory and Panel Estimates, CEP Discussion Paper No 663, December 2004
- Cui, J, F de Jong, and E. Ponds (2006). Intergenerational risk sharing within funded pension schemes. *Netspar*.
24. Code of the Dutch Pension Funds
25. Cui, J, F de Jong, and E. Ponds (2005). The value of intergenerational transfers within funded pension schemes. *Netspar*.
26. Daniel Friedmann, Restitution for Wrongs: The Measure of Recovery, 79 Tex. L. Rev. 1879 (2001);
27. David Blake (Pensions Institute, Birkbeck College), Andrew Cairns (Heriot Watt University), Kevin Dowd (Sheffield University) "PensionMetrics: Stochastic Pension Plan Design and Value-at-Risk during the Accumulation Phase 1, August 2002D. Gordon Smith, The Critical Resource Theory of Fiduciary Duty, 55 Vand. L. Rev. 1399, 1406 (2002)
28. Deloof, M., 2001, Belgian intragroup relations and the determinants of corporate liquid reserves, *European Financial Management*
29. Dohmen, T., Falk, A., Huffman, D., Sunde, U., Schupp, J. and Wagner, G. (2005). Individual Risk Attitudes: New Evidence from a Large, Representative, Experimentally-Validated Survey. IZA DP No. 1730
30. Donkers, B., Lourenço, C., Goldstein, D. and Dellaert, B. (2013). Building a distribution builders: design considerations for financial investment and pension decisions. *Netspar Design paper 20*
31. Du Plessis, J. J., Hargovan, A., & Bagaric, M. (2011). *Principles of Contemporary Corporate Governance*. Oxford University Press.

32. Elez Osmani, Rozafa Ristani, Tregjet dhe institucionet financiare, Instituti per kërkime shkencore dhe zhvillim, Botimi i dytë, Shkodër, 2013
33. Estelle James nga Banka Boterore & Sarah Brooks nga Duke University (2002), “ The Political Economy of Structural Pension Reform“ published in Course on Pension Reform 2nd Generation & Implementation Issues“ Volume II, Warsaw, Poland, by World Bank Institute.
34. Estelle James (World Bank) and Sarah Brooks (Duke University); The political Economy of Structural Pension Reform
35. Ernest J. Weinrib, Restitutionary Damages as Corrective Justice, 1 theoretical inquiries L. 1 (2000).
36. Felix Goltz, David Schröder “Hedge Fund Transparency: Where Do We Stand?
37. Fiona Stewart “Pension Fund Investment in Hedge Funds” OECD Working Papers on Insurance and Private Pensions No. 12 “
38. George Kopits and Jon Craig “Transparency in Government Operations”- International Monetary Fund, Washington DC, January 1998
39. Goltz Felix, Schröder David “Hedge Fund Transparency: Where Do We Stand?
40. Hansjörg Herr, Milka Kazandziska, Silke Mahnkopf-Praprotnik “Theoretical debate about minimum wages”, Global labour university working papers, paper no. 6, feb 2009
41. Hal Swerissen, Faculty of Health Sciences, La Trobe University; Understanding the Sustainability of Health Programs and Organisational Change, A Paper for the Victorian Quality Council, June 2007
42. Harry M. Markovitch, Portfolio Selection, Efficient Diversification of Investments (New York; John Wiley and Sons, Inc., 1959)
43. Herbert A. Simon “A formal theory of the employment relationship”- source: econometrica, vol. 19, no. 3 (jul., 1951), pp. 293-305
44. Hereijgers Patrick (2013-012), “ How to Measure and Apply Risk Preferences in the Second Pension Pillar, MSc Thesis, Tilburg University
45. Izenkova Assel (2012), “Measures to Improve the Transparency of Pension Systems in Crisis Management”, International Conference on Economics, Business Innovation IPEDR vol.38 (2012) © (2012) IACSIT Press, Singapore
46. Jensen M.C., 1986, Agency costs of free-cash-flow, corporate finance, and takeovers, American Economic Review
47. James R. Hollyery, B. Peter Rosendorff, and James Raymond Vreeland “Measuring Transparency”- Department of Political Science, University of Minnesota, Wilf Family Department of Politics, New York University, Mortara Center for International Studies, Georgetown University, April 2013
48. Jack Brennan: Chairman & CEO (2002), The Vanguard Group with Marta McCave „ Straight talk on Investing“ John Wiley & Sons, Inc. Hoboken New Jersey, USA
49. Jeremy Waldron, Does Law Promise Justice?, 17 Ga. St. U. L. Rev. 759 (2001);
50. Jim Naughton “The Impact of Footnote Transparency on Managerial Discretion, Evidence from FAS132R Pension Disclosure”- Harvard Business School

51. John Rogers- Director (1995), Investment Service, NAPF Guide; Investment Management Trustees` Pocket Guide, Launched in UK
52. Johan Maynard Keynes “Teoria e pergjitheshme e punesimit, interest dhe parase”, Plejad 2006
53. Joseph Raz, The morality of freedom (1986);
54. Joshua D. Rauh “Own company stock in defined contribution pension plans: a takeover defense?” Received 15 November 2004; received in revised format 16 June 2005; Accepted 7 July 2005
55. Jubilee Campus, Nottingham NG8 1BB, UK, respectively. The authors thank an anonymous referee for helpful comments, and the BSI Gamma Foundation and UBS Global Asset Management for financial support for this project.
56. Kahneman, D. and A. Tversky (1984). Choices, values and frames. American psychologist 39, 341{350.
57. Karl Brunner, Allan H. Meltzer “The theory of employment and unemployment”- Carnegie Mellon University Research, Chapter 4 of monetary theory (tentative title) presented at the konstanz seminar, May 1978.
